


Trafikimi njerëzor – si duhet të hetohet ai

Manual treinimi për oficerët e zbatimit të ligjit



Ky botim është përpunuar në kuadër të projektit “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore-Faza 1”, financuar nga Komisioni Europian dhe i vënë në jetë nga ICMPD në bashkëpunim me EF dhe FIAPP.

Manuali është botuar me ndihmën e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorit Paul David Newton dhe në asnjë mënyrë nuk do të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Europian apo të ICMPD-së.

Autor:

Paul David Newton

Ekipi i ICMPD-së:

Ivanka Gerogjeva, Steve Harvey, Martijn Pluim, Enrico Ragaglia, Brigitte Stevkovski dhe Elisa Trossero

Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD)

Gonzagagasse 1

A-1010 Vjenë

Austri

www.icmpd.org

E drejta e autorit:

Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit

Austri, 2015

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në asnjë lloj forme, elektronike apo mekanike, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, apo ndonjë sistem arkivimi apo kërkimi të informacionit, pa lejen e zotëruesve të së drejtës së autorit.

Formatimi nga Marc Rechdane

Botuar dhe lidhur në Vjenë, Austri

ISBN: 978-3-902880-31-4

ISBN: 978-3-902880-32-1 (versioni elektronik)

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
2.	Fjalorth.....	7
3.	Lënda.....	9
4.	Përshkrimi i lëndës	11
4.1	Planet mësimore.....	11
4.2	Studimet e rasteve.....	11
4.3	Ushtrimet me rastet	11
4.4	Lojrat me role.....	11
4.5	Burimet mediatike.....	11
4.6	Prezantimet me PowerPoint.....	11
5.	Indeksi i lëndës	12
5.1	Planet mësimore.....	12
5.2	Studimet e rasteve.....	12
5.3	Ushtrime me rastin	12
5.4	Lojrat me role.....	12
5.5	Burimet mediatike.....	13
5.6	Prezantimet me PowerPoint.....	13
6.	Bibliografi	14

1. Hyrje

Ky material trainimi u hartua në kuadrin e projektit *Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore – Faza 1 (THB/IFS/1)*, i cili u financua nga Bashkimi Europian nën Instrumentin e tij të Stabilitetit¹ për të luftuar krimin e organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore (TQNj) në Azerbajxhan, Bosnjë-Hercegovinë, Moldavi dhe Turqi. Projekti u zbatua gjatë periudhës janar 2013 – shtator 2014 nga ICMPD-ja (Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit) në partneritet me FIIAPP (Fundación Internacional y para Iberoamérica de Administración y Políticas Públicas) dhe EF (Expertise France) dhe u përqendrua mbi bashkëpunimin kombëtar, rajonal dhe trans-rajonat në drejtim të zbatimit të ligjit.

Në kuadrin e këtij projekti, u përmirësua kapaciteti i vendeve përfituese të tij për të mbledhur dhe analizuar të dhënat që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore; u promovua ndarja e informacionit në mes tyre dhe koordinimi më i mirë në fushën e trajtimit të trafikimit njerëzor; u rrit dhe u bë më efektiv kapaciteti i një sërë grupesh interesi për të trajtuar dhe luftuar krimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Projekti përbëhej nga tre komponentë. Komponenti 1 u përqendrua mbi mbledhjen dhe analizën e të dhënave/inteligjencës, me objektiv përmirësimin e njohurive bazë mbi trafikimin e qenieve njerëzore në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Komponenti 2 siguroi një platformë për ndarjen sistematike të informacionit brenda dhe midis të katër vendeve përfituese. Komponenti 3 synoi shtimin e kapacitetit të grupeve të rëndësishme të interesit, përfshirë agjencitë e linjës së parë, të zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe të prokurorëve, etj., për të identifikuar situatat e TQNj dhe shkelësit e ligjit.

Ky material trainimi u përgatit brenda Komponentit 3 të fazës së parë të projektit me qëllim rritjen e kapacitetit të aktorëve të rëndësishëm për të trajtuar çështjet e trafikimit njerëzor më me efektivitet. Materiali u hartua nga një ekspert i pavarur i zbatimit të ligjit dhe u ndërtua mbi njohuritë e fituara gjatë zbatimit të Komponentëve 1 dhe 2 të projektit. Materiali i trainimit u testua dhe u përshtat më tej nëpërmjet një sërë sesionesh trainimi të realizuara në Azerbajxhan, Bosnjë-Hercegovinë, Moldavi dhe Turqi në muajt korrik dhe gusht të 2014.

Materiali është menduar që të përdoret në një mënyrë sa më praktike. Për trainuesit ky material shërben si një udhërrëfyes dhe material mbështetës, por, gjithsesi, trainuesit inkurajohen ta përdorin atë si një material bazë, madje përmbajtja dhe metodat e lëvrimit të trainimit mund të përshtaten sipas natyrës dhe formatit të audiencës.

¹ Instrumenti për Stabilitet (IFS) synoi të lidhë problemet e sigurisë me ato të zhvillimit. Objektiv kryesor ishte të mbështette masat për ruajtjen apo ri-vendosjen e kushteve nën të cilat vendet partnere të BE-së të mund të ruanin synimet e tyre afat-gjata zhvillimore. Në mars 2014 u themelua Instrumenti kontribues për Stabilitet dhe Paqe (IcSP), i cili erdhi në jetë pas IFS. Për më shumë informim mbi IcSP shih: http://ec.europa.eu/dgs/fpi/what-we-do/instrument_contributing_to_stability_and_peace_en.htm (2014-08-06).

2. Fjalorth

Fjalorthi i termave, shkurtesave dhe akronimeve të përdorura në këtë material:

BE	Bashkimi Europian
FV	Formati ku shënohen vendimet dhe arsyetimet mbështetëse të vendimit të marrë pas hetimeve të kryera
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit
ID	Identiteti
IfS	Instrumenti për Stabilitet
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
LR	Lojë me role
Matrica e shqyrtimit të riskut	Mjet pamor në ndihmë të shqyrtimit të një risku të mundshëm
BM	Burim mediatik
OJQ	Organizatë jo qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
PEACE	Një akronim i përdorur për të përcaktuar modelin e intervistimit – planifikimi dhe përgatitja, angazhimi dhe shpjegimi, tregimi, mbyllja dhe vlerësimi
PM	Plani mësimor
PP	PowerPoint
PTSD	Çrregullim i stresit post traumatik
ShSK	Shqyrtim i skenës së krimit
SR	Studim i Rastit
TANj	Trafikimi anti-njerëzor
THS	Teknikat hetimore të specialistit
TIP	Trafikimi i personave ²
TQNj	Trafikimi i qenieve njerëzore
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UR	Ushtrim me Rastin
Vendi i Blertë	Vend imagjinar (me ngjyrë të blertë) i përdorur në material
Vendi Blu	Vend imagjinar (me ngjyrë blu) i përdorur në material
Vendi i Kuq	Vend imagjinar (me ngjyrë të kuqe) i përdorur në material

² Vini re, termat TQNj dhe TIP përshkruajnë të njëjtën dukuri – trafikimin njerëzor. Është thjesht një zgjedhje stili nga organizata të ndryshme. Nuk ekziston asnjë dallim ligjor apo i ndonjë natyre tjetër midis këtyre dy akronimeve.

3. Lënda

Lënda është e ndarë dhe do të trajtohet sipas llojeve të ndryshme të prezantimit.

Si më poshtë:

- Planet mësimore
- Studimet e rasteve
- Ushtrimet me rastet
- Lojrat me role
- Burimet mediatike
- Prezantimet me PowerPoint

Koncepti bazë është që të gjitha llojet e përdorura për prezantimin e lëndës ndërlidhen me njëri-tjetrin me anë të planeve mësimore. Kështu, për shembull, plani mësimor trajton lëndën që duhet të jepet në mënyrë didaktike (d.m.th. paraqitja e lëndës me leksione). Në shumë raste planet mësimore mund të përmbajnë, po ashtu, disa ushtrime në grupe të vogla (ose dhe të mëdha) që mund të organizohen nga ju. Pjesa më e madhe e planeve mësimore identifikojnë edhe mënyra të tjera të prezantimit të lëndës që mund të përdorni ose në mbështetje të metodës së prezantimeve dhe ushtrimeve, ose për të zgjeruar më tej njohuritë.

Arsyeja e propozimit të këtyre mjeteve është që të lejohet “ri-përdorimi” i lëndës në një seri kontekstesh të tjera dhe të parandalohet dublimi i materialit.

Rekomandohet që t'i hidhni një sy një ose më shumë planeve mësimore për të kuptuar më mirë në praktikë se si është kjo strukturë.

4. Përshkrimi i lëndës

4.1 Planet mësimore

Planet mësimore ndjekin të njëjtën strukturë bazë, si vijon:

- Hyrja përmban:
 - Objektivat – objektivat e përgjithshme të leksionit
 - Audiencia që synohet – dhënia e hollësive rreth grupeve për të cilat është hartuar materiali
 - Njohuritë e mëparshme – çfarë njohurish i zotëron tashmë audiencia
- Temat kryesore, secila e ndarë sipas:
 - Kohës – koha kur mendohet të trajtohet tema
 - Metodës – metodat e sugjeruara të prezantimit të lëndës
 - Informacionit për trainuesin – një varietet mënyrash të prezantimit

4.2 Studimet e rasteve

Një studim rasti është një shtjellim i hollësishëm i një rasti të TQNj që nga fillimi deri në fund. Këto studime përmbajnë një sërë mëdyshjesh komplekse. Studimet e rasteve pasqyrojnë rastet e ndodhura realisht në vendet përfituese të projektit.

4.3 Ushtrimet me rastet

Një ushtrim me rastin përcaktohet si një tregim i thjeshtë dhe i shkurtër i një aspekti të TQNj, p.sh. ndalimi i një automjeti për një kontroll rutinë.

4.4 Lojrat me role

Loja me role realizohet me ndihmën e disa udhëzimeve konkrete mbi si krijohet ndërveprimi midis studentëve që kanë marrë përsipër të luajnë një rol në një mjedis mësimor. Këto role mund të lidhen me punën e të angazhuarve në luftën anti-trafik, ose të pasqyrojnë përvojat e viktimave, të të dyshuarve apo të dëshmitarëve.

4.5 Burimet mediatike

Një burim mediatik është çfarëdo lloj imazhi, video, apo prezantimi me audio ose me grafikë.

4.6 Prezantimet me PowerPoint

Ky lloj prezantimi ka të bëjë me paraqitjen e lëndës mësimore në formatin PowerPoint. Zakonisht këto përdoren për të zhvilluar temat specifike të njohurive teknike. Paraqiten, përgjithësisht, në formën e një teksti të thjeshtë, por që kanë imazhe dhe lidhje me burime të tjera mediatike.

5. Indeksi i lëndës

5.1 Planet mësimore

Plani mësimor 1.....	Migrim i paligjshëm apo TQNj?
Plani mësimor 2.....	Treguesit
Plani mësimor 3.....	Intervistat përzgjedhëse
Plani mësimor 4.....	Vlerësimi i rrezikut
Plani mësimor 5.....	Nevojat e viktimës
Plani mësimor 6.....	Intervistat në bazë provash
Plani mësimor 7.....	Teknikat hetimore të specialistit
Plani mësimor 8.....	Shënimet mbi vendimet
Plani mësimor 9.....	Shqyrtim i skenës së krimit

5.2 Studimet e rasteve

Studimi i Rastit 1.....	Shfrytëzim i punës
Studimi i Rastit 2.....	Shfrytëzim seksual
Studimi i Rastit 3.....	Shfrytëzim i shërbimeve në familje
Studimi i Rastit 4.....	Shfrytëzim i veprimeve të paligjshme

5.3 Ushtrime me rastin

Këto të gjithë paraqiten në një dokument të vetëm “Ushtrimi mbi Rastin”:

Ushtrimi mbi Rastin 1.....	Person i zhdukur
Ushtrimi mbi Rastin 2.....	Në rrugë
Ushtrimi mbi Rastin 3.....	Shërbim në familje
Ushtrimi mbi Rastin 4.....	Shtëpi publike
Ushtrimi me Rastin 5.....	Ferma
Ushtrimi me Rastin 6.....	Veprimtari e paligjshme – lypja

5.4 Lojrat me role

Loja me rolin 1.....	Në rrugë
Loja me rolin 2.....	Shërbim në familje
Loja me rolin 3.....	Shfrytëzim i punës

5.5 Burimet mediatike

Burimi mediatik 1.....	Skenari “Ferma e pulave”
Burimi mediatik 2.....	Ushtrimi “Survejimi”
Burimi mediatik 3.....	Ushtrimi mbi skenën e krimit

5.6 Prezantimet me PowerPoint

PowerPoint 1.....	Përkufizimi i TQNj dhe migrimit të paligjshëm
PowerPoint 2.....	Identifikimi i TQNj
PowerPoint 3.....	Intervistat
PowerPoint 4.....	Vlerësimi i rrezikut
PowerPoint 5.....	Nevojat e viktimës
PowerPoint 6.....	Shqyrtim i skenës së krimit

6. Bibliografi

CARIM EAST – Consortium for Applied Research on International Migration, Legal Aspects of Struggle against Human Trafficking in Azerbaijan, Alovsev Aliyev, June 2013

ICMPD Training Needs Analysis – Fight against Trafficking in Human Beings – Phase 1 (THB/IFS/1) – For beneficiary countries of Azerbaijan, Bosnia and Hercegovina, Moldova, and Turkey, May 2014 (unpublished)

ILO Combating forced labour: a handbook for employers and business. International Labour Office, Geneva, 2008

ILO Operational indicators of trafficking in human beings. International Labour Office. Geneva, 2009

OSCE Needs Assessment Report, Anti-trafficking response in Republic of Azerbaijan: Assistance and services available to victims of trafficking and forced labour, Baku 2012

OSCE Office of the Special Representative and Co-ordinator for Combating Trafficking in Human Beings, Trafficking in Human Beings for the Purpose of Organ Removal in the OSCE Region: Analysis and Findings, Occasional Paper Series no.6 July 2013
<http://www.osce.org/chtb/103393>

OSCE Report of the Tenth Alliance against Trafficking in Persons Conference – “Unprotected Work, Invisible Exploitation: Trafficking for the Purpose of Domestic Servitude”, Vienna, 17-18 June 2010 <http://www.osce.org/secretariat/75804>

OSCE Trafficking in human beings for the purpose of labour exploitation – A reference paper for Bosnia and Hercegovina 2011

Reigeluth, C.M. et al Instructional-Design Theories and Models – A New Paradigm of Instructional Theory Volume II, Lawrence Erlbaum Associates, 1999

Scott, S, G.Craig, A.Geddes Experiences of Forced Labour in the UK Food Industry, Bristol University, 2012

Shepherd, E. Investigative Interviewing: The Conversation Management Approach. Oxford University Press, 2010

UN Protocol against the smuggling of migrants by land, sea and air, supplementing the United Nations convention against transnational organized crime, General Assembly resolution 55/25. New York, NY, United Nations General Assembly, 2000.

UN Protocol to prevent, suppress and punish trafficking in persons, especially women and children, supplementing the United Nations convention against transnational organized crime. General Assembly resolution 55/25. New York, NY, United Nations General Assembly, 2000

UNODC Anti-Human Trafficking Manual for Criminal Justice Practitioners, 2009, New York

UNODC Case law database <http://www.unodc.org/cld/index.jsp>

UNODC First Aid Kit for the Use by Law Enforcement Responders in Addressing Human Trafficking, 2010, Vienna

UNODC Global Report on Trafficking in Persons, 2012, Vienna

<https://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/global-report-on-trafficking-in-persons.html>

USDOS. Trafficking in Persons Report 2013. Washington, DC, United States of America Department of State, 2013 and 2014 <http://www.state.gov/j/tip/ris/tiprpt/>

Zimmerman, C, M. Hossain, K. Yun, B, Roche, L. Morrison, and C. Watts, 2006, Stolen Smiles. The physical and psychological health consequences of trafficking in women, London School of Hygiene and Tropical Medicine: London.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Objektivat.....	5
1.2	Audienca e synuar	6
1.3	Njohuritë e mëparshme	6
2.	Përkufizimet ndërkombëtare	7
2.1	Kohëzgjatja.....	7
2.2	Mësimdhënia	7
2.3	Informacioni për trainuesin	7
3.	Legjislacioni kombëtar	9
3.1	Kohëzgjatja.....	9
3.2	Mësimdhënia	9
3.3	Informacioni për trainuesin	9
4.	Ushtrimi “Tri vendet”	10
4.1	Kohëzgjatja.....	10
4.2	Mësimdhënia	10
4.3	Informacioni për trainuesin	10
4.4	Tregimi i rastit – pjesa 1	11
4.5	Tregimi i rastit – pjesa 2	12
4.6	Tregimi i rastit – pjesa 3	13

1. Hyrje

Ky leksion hedh një vështrim mbi përkufizimet ndërkombëtare të Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj) dhe të Kontrabandimit të Migrantëve.

Vetëm në një numër të pakët situatash legjislacioni i juridiksioneve të ndryshme pasqyron drejtpërdrejt përkufizimet ndërkombëtare; në pjesën më të madhe të juridiksioneve përkufizimet ndërkombëtare janë të modifikuara në një mënyrë apo tjetër.

Përkufizimet ndërkombëtare përshtaten vazhdimisht dhe janë përdorur ndër vite si bazë për legjislacionet kombëtare; situata sot është që një numër i madh (por jo i gjithë) legjislacioni mbi TQNj dhe Kontrabandimin e Migrantëve në botë është përshtatur tashmë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ndër përfitimet që kanë studentët nga të mësuarit e përkufizimeve ndërkombëtare, janë:

- Të kuptojnë parimet që janë në themel të legjislacionit “të tyre”.
- Për rrjedhojë, të përvetësojnë më mirë legjislacionin e tyre kombëtar.
- Të ndihmohen për të kuptuar më mirë legjislacionin e juridiksioneve të vendeve të tjera.
- Kjo, nga ana tjetër, do të lehtësojë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Legjislacioni është një temë e rëndësishme, por mund të jetë, në një farë mënyre, një temë disi “e thatë”. Ka rëndësi që praktikuesit jo vetëm t’i kujtojnë tekstet legjislativë, por edhe të fitojnë aftësi që t’i kuptojnë e t’i zbatojnë ato në praktikë.

Për këto arsye, ky mësim ka një paraqitje didaktike, e cila ndiqet nga një ushtrim ndërveprues që i aktivizon studentët dhe u lejon atyre të venë në jetë legjislacionin përkatës në një sërë rrethanash.

Rekomandohet fort që përkufizimet ndërkombëtare t’i trajtoni në atë mënyrë që të mund të përfshihen në leksion edhe përkufizimet nga legjislacioni përkatës i juridiksionit të vendit ku punoni.

1.1 Objektivat

Pas përfundimit të leksionit, studentët duhet të jenë të aftë të:

- Mbajnë mend elementet e përkufizimeve ndërkombëtare të TQNj dhe të kontrabandimit të migrantëve.
- Shpjegojnë dallimet kryesore midis të dyve.
- Zbatojnë përkufizimet ndërkombëtare në një sërë kontekstesh dhe formash të TQNj.

(si alternativë)

- Rikujtojnë elementet e legjislacionit përkatës kombëtar.
- Zbatojnë legjislacionin kombëtar në një sërë kontekstesh.

1.2 Audiencia e synuar

Ky leksion është për cilindo që mund të ndeshet me TQNj në punën e tij, përfshirë:

- Punonjësit socialë.
- Punonjësit e organizatave jo-qeveritare (OJQ).
- Oficerët e policisë.
- Prokurorët.
- Anëtarët e gjyqësorit.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Nuk kërkohen njohuri të mëparshme mbi këtë lëndë.

2. Përkufizimet ndërkombëtare

2.1 Kohëzgjatja

20 - 25 minuta.

2.2 Mësimdhënia

Metoda e rekomanduar për lëvrimin e kësaj pjese të sesionit është paraqitja didaktike e PowerPoint, “Përkufizimet e trafikimit të qenieve njerëzore (TQNj) dhe të kontrabandimit të migrantëve”.

2.3 Informacioni për treinuesin

Informacioni është i njëjtë me atë të prezantimi me PowerPoint, por është i përfshirë këtu për lehtësinë tuaj dhe shpjeguesi referimi.

TQNj përcaktohet si:

- **Akti** – çfarë ka ndodhur.
- **Mënyrat** – si ka ndodhur.
- **Qëllimi** – përse ka ndodhur

“**Akti**” është:

- Rekrutim.
- Transportim.
- Transferim.
- Strehim.
- Pritje personash.

“**Mënyrat**” janë:

- Kërcënimi ose përdorimi i forcës apo i formave të tjera të shtrëngimit ose rrëmbimit.
- Gënjeshtria.
- Mashtrimi.
- Shpërdorimi i pushtetit ose shfrytëzimi i pozitës së të pambrojturit.
- Nëse pranimi nga ana e viktimës nuk ka qenë real, një trafikant nuk mund të përdorë në mbrojtje të vetvetes faktin që viktima kishte pranuar vetë.
- Një person jo domosdo i nënshtrohet forcës apo kërcënimit për dhunë që të trafikohet.

“Synimi” është:

- Shfrytëzimi.

“Shfrytëzimi” përfshin (të paktën):

- Shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual.
- Punën ose shërbimet me detyrim.
- Skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë.
- Shërbimet.
- Heqjen e organeve.

Përkufizimi i **“Kontrabandimi i migrantëve”** është:

“Sigurimi i hyrjes së paligjshme të një personi në një shtet palë, shtetas i të cilit nuk është ky person, dhe as banor i përhershëm i atij shteti, me qëllim që të përftojë, drejtpërdrejt ose jo, një të mirë financiare apo materiale.”

Dallimet kyçe midis TQNj dhe Kontrabandimit të Njerëzve janë:

Shtrëngimi

- TQNj nënkupton rekrutimin me anë të kërcënimit, mashtrimit, abuzimit të autoritetit, etj.
- Kontrabandimi i njerëzve nuk e nënkupton këtë: kontrabandimi nuk është shtrëngues.

Tipari transnacional

- TQNj mund të jetë i brendshëm, brenda një shteti, përveç përtej kufirit shtetëror.
- Kontrabandimi i njerëzve duhet të jetë përtej kufijve ndërkombëtarë

Shteti dhe individi

- Kontrabandimi i migrantëve është një krim kundër politikave të migrimit dhe rendit publik të shteteve.
- TQNj është një krim kundër individëve.

3. Legjislacioni kombëtar

3.1 Kohëzgjatja

Ndryshon në varësi të legjislacionit përkatës.

3.2 Mësimdhënia

Metoda e rekomanduar për lëvrimin e kësaj pjese të sesionit është një paraqitje didaktike, e ngjashme me atë të përdorur për legjislacionin ndërkombëtar, si më lart.

3.3 Informacioni për trainuesin

Është në dorë të trainuesit të vendosë se si të trupëzojë më mirë legjislacionin kombëtar në këtë leksion. Alternativat, megjithatë, përfshijnë:

- Prezantimin didaktik të menjëhershëm të tij, mbas prezantimit të legjislacionit ndërkombëtar.
- Realizimin e ushtrimit 'krahaso dhe dallo' ndryshimet midis legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Zhvillimin e ushtrimit të mëposhtëm dhe në përfundim të tij prezantimin e legjislacionit kombëtar dhe kërkimin nga grupi ta zbatojë atë tek skenarët e ushtrimit.

4. Ushtrimi “Tri vendet”

4.1 Kohëzgjatja

20 – 25 minuta.

4.2 Mësimdhënia

Kjo është një metodë energjike dhe ndërvepruese e paraqitjes para studentëve të koncepteve ligjore kyçe të TQNj dhe Kontrabandimit të Njerëzve. Kjo metodë është përdorur shumë herë në situata të ndryshme dhe ka tërhequr përherë një vëmendje dhe komente pozitive.

Përdorni një sërë vendesh imagjinare në klasë me anë të grupimit konkret të studentëve nëpër karrike dhe zhvillimit të një lojë të thjeshtë me role.

4.3 Informacioni për trainuesin

Vendosni tri grupe karrikesh para klasës. Nga e majta në të djathtë: grupi i majtë i karrikeve duhet të ketë tri karrike; grupi i mesëm duhet të ketë pesë; grupi në të djathtë duhet të ketë tri karrike.

Grupi i majtë i karrikeve do të quhet “Vendi i Blertë”; grupi në qendër “Vendi i Kuq”; grupi në të djathtë është “Vendi Blu”.

Po të dëshironi, mund të vendosni ngjyrat pranë çdo grupi/vendi.

Tani mund të ftoni gjashtë vullnetarë të futen në rol, ose, për të marrë një reagim më pozitiv, mund t’u kërkoni studentëve që thjesht të ulen në karriket – nuk do t’u kërkohet që të flasin!

Tre ulen te “Vendi i Blertë”; dy te “Vendi i Kuq”, dhe një te “Vendi Blu”.

Për qëllimet e këtij plani mësimor, përdoren germat, por mund të dëshironi të përdorni emrat e aktorëve që luajnë role.

A, B dhe C janë të “Vendi i Blertë”; D dhe E te “Vendi i Kuq”; F është te “Vendi Blu”.

Tani duhet të filloni të tregoni rastin, duke përdorur pauzat për t’i mundësuar grupit të studentëve, të mbetur në panel, të vendosin se çfarë veprash penale janë kryer gjatë zhvillimit të ngjarjes. Jepet informacion që t’ju mundësojë të pyesni secilin grup ‘aktorësh’ pas mbarimit të detyrës.

4.4 Tregimi i rastit – pjesa 1

Lexoni pjesën si më poshtë:

“Vendi i Blertë është një vend shumë i varfër. Shumë nga banorët e tij ëndërrojnë të shkojnë në një vend të pasur me emrin Vendi Blu; midis Vendit të Blertë dhe atij Blu shtrihet Vendi i Kuq, i varfër dhe ky, por jo aq sa Vendi i Blertë.

A dhe B janë fermerë të varfër në Vendin e Blertë; ata duan të shkojnë të Vendi i Kuq. Për këtë pyesin bashkëbanorët e tyre dhe marrin vesh që C mund t'i ndihmojë që të ikin. Atëherë, takojnë C dhe ai/ajo u thotë që mund t'i ndihmojë, por kjo ndihmë do t'i kushtojë secilit 5,000 dollarë për kokë. A dhe B bien dakord. Në datën e caktuar, C mbërrin me një automjet dhe dërgon A dhe B në një vend të largët në kufi me Vendin e Kuq. Më pas, ai/ajo u tregon shtegun dhe u shpjegon se në anën tjetër të kufirit do t'i presë dikush.”

Tani, zhvendosni A dhe B tek grupi i karrikeve të Vendit të Kuq.

Ndaloni dhe pyesni grupin se çfarë veprash penale janë kryer deri në atë moment.

Në këtë fazë, në bazë të informacionit të dhënë, duket se kemi të bëjmë me rastin e imigrimit të paligjshëm (nga ana e A dhe B), dhe me kontrabandim njerëzish (nga ana e C).

Deri këtu nuk dijmë se cili është qëllimi i C. Mund të dalë që, pavarësisht nga pamja e parë, C ka për qëllim t'i dorëzojë A dhe B në duart e trafikantëve, në cilin rast C mund të kryejë krimin e trafikimit njerëzor. Ky moment mund të përmendet nga një student, por në rast se nuk do të përmendet, atëherë mund të konsideroni që ta pyesni ju grupin se çfarë do të përbënte për ta një krim i trafikimit njerëzor.

Ka të ngjarë që mund të nisë ndonjë debat, një ose më shumë studentë mund të venë në dukje vështirësinë e të provuarit se C ka kryer krimin e trafikimit njerëzor. Kjo është e vërtetë, por provoni të pyesni grupin se cilat do të ishin metodat hetimore që do të provonin se kemi të bëjmë me një krim. Shembujt që mund të ndihmojnë në këtë drejtim janë teknikat e specialistit, si për shembull, shqyrtimi i të dhënave dhe i përmbajtjes së komunikimeve, hetimet e mëtejshme në lidhje me veprimtaritë e C në të kaluarën, nëse këto veprime kanë përfunduar në trafikim, si dhe monitorimi i C për të ndjekur veprimet e tij/të saj në të ardhmen.

4.5 Tregimi i rastit – pjesa 2

Lexoni pjesën si vijon:

“Menjëherë pas kalimit të kufirit të Vendit të Kuq, A dhe B priten nga D. D u thotë atyre se ai/ajo do t'i shoqërojë gjatë gjithë rrugës në drejtim të Vendit Blu. Udhëtimi do të vazhdojë disa ditë. A dhe B shoqërohen deri tek një fermë e largët ku priten dhe fshihen nga disa njerëz të tjerë. Pas dy ditësh, D vjen me një kamion. Rreth 20 vetë ngjiten në pjesën e mbyllur të kamionit dhe ai nis për rrugë. Udhëtimi është i gjatë dhe kushtet poshtë mbulesës së kamionit janë të këqija. A sëmuret. B dhe njerëzit e tjerë fillojnë të trokasin fort mbi paretet e konteinerit të kamionit dhe të thërrasin.

Kamioni ndalet dhe D afrohet tek njerëzit për të folur me ta. Kur dëgjon se A është sëmure, ai/ajo i bën një ofertë A: D do ta çojë A në një fermë të mikut të tij E. A do të mund të shërohet dhe do të filojë aty një punë, derisa D të kalojë përsëri nga ato anë. Ditët në fermën e E janë të gjata, por paga është e mirë. Do të ketë ushqim dhe A do të mund të flejë në një fjetore.

A pranon dhe dërgohet te ferma e E. Me të mbërritur te kjo fermë, A kupton se do t'i duhet të flejë në dysheme, nën disa karkasa makinash. Do t'i duhet të punojë 12 orë në ditë; nuk do të ketë asnjë lloj page. E shpjegon se e ka marrë A të punojë në këmbim të strehimit dhe ushqimit. Ushqimi është i varfër.

B vazhdon me D. Tri ditë më vonë, dyert e konteinerit hapen. Ndodhen në një qytet. D u thotë se janë në kryeqytetin e Vendit Blu dhe se tani janë të lirë të shikojnë punën e vet”.

Ndaloni këtu dhe pyesni grupin së çfarë krimesh, sipas mendimit të tyre, janë kryer deri në këtë çast.

Në sipërfaqe duket që D ka trafikuar A te ferma e E, dhe me këtë veprim ka konsumuar krimin e trafikimit njerëzor. D, gjithashtu, duket se ka kryer krimin e kontrabandimit të njerëzve duke i sjellë A dhe B te Vendi i Kuq dhe B te Vendi Blu. Serish, të provuarit se kemi të bëjmë me krimin e trafikimit njerëzor të D, do të varet nga synimi i tij/i saj. Ka shumë mundësi që D ka besuar realisht që A do të trajtohej mirë nga ana e E. Megjithatë, hetimet rreth marrëdhënies midis D dhe E mund të na japin prova që D ka qenë shumë i ndërgjegjshëm se çfarë do të ndodhte me A.

Është e qartë që E ka kryer një krim të trafikimit të qenieve njerëzore.

B kryen veprën penale të migrimin të paligjshëm. Duhet të vihet në dukje që migrimi i paligjshëm i ndërmarrë nga B nuk është një krim i parashikuar nga protokollat ndërkombëtare. Të vetmet krime të migrimin, të parashikuara nga protokollat ndërkombëtare, janë ato kur (shkurtimisht) ekziston sigurimi i një hyrjeje të paligjshme të një personi në një vend për përfitime financiare apo materiale.

4.6 Tregimi i rastit – pjesa 3

Lexoni pjesën si vijon:

“B lëviz nëpër kryeqytetin e Vendit Blu për rreth tri ditë. Ai/ajo ka shumë uri dhe përpiqet të gjejë punë nëpër vende të ndryshme. Ditën e tretë hyn në restorantin e F dhe i kërkon punë. F i thotë B se e di që ai (ose ajo) është një migrant i paligjshëm i ardhur nga Vendi i Blertë dhe se mund të punojë te restoranti, por pa pagesë. Do t'i duhet të punojë deri 16 orë në ditë, nuk do të ketë ditë pushimi, do të flejë në dyshtemenë e kuzhinës dhe do të ushqehet vetëm me mbetjet e ushqimeve. B pranon.

Ndërkohë, A ndihet më mirë në Vendin Blu dhe tanimë, sipas fermerit E, po shkakton ca shqetësime. E lidhet me D, i cili mbërrin në fermë, merr A dhe e kalon në Vendin e Kuq. D e çon A në kryeqytet. A kërkon të gjejë punë, por nuk arrin të gjejë asgjë. Për rrjedhojë, A fillon të lypë nëpër rrugët e atij kryeqyteti.”

Këtu ndaloni dhe pyeteni grupin se me çfarë vepre penale, sipas tyre, kemi të bëjmë këtu.

Del që F ka kryer krimin e trafikimit të qenieve njerëzore, sepse ka shfrytëzuar faktin që B ishte i pambrojtur, i brishtë. Shfrytëzimi i cënueshmërisë së një personi është një koncept që mund të shkaktojë mosdakordësi. Mund të argumentohet se shumë transaksione punësimit mund të kenë të bëjnë, në një mënyrë apo tjetër, me shfrytëzimin e cënueshmërisë së një personi që është në prag të urisë.

A nuk është trafikuar sepse mori një vendim të pavarur, që të lypë- pra, nuk është duke u shfrytëzuar nga asnjë person.

D ka kryer krimet e kontrabandimit të personave, edhe duke kaluar A në Vendin Blu. Pavarësisht, nga faktet e dhëna në këtë rrëfenjë, ai/ajo nuk ka kryer ndonjë krim tjetër të trafikimit njerëzor. D, thjesht, i ka braktisur A dhe B në Vendin Blu; nuk është përfshirë në rekrutimin e B për të punuar te restoranti i F ose në ndonjë formë tjetër shfrytëzimi të B.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat e të mësuarit	5
1.3	Njohuritë e mëparshme	5
2.	Treguesit e TQNj	6
2.1	Kohëzgjatja	6
2.2	Mësimdhënia	6
2.3	Informacioni për trainuesin	6
3.	Menaxhimi i procesit të identifikimit të TQNj	8
3.1	Kohëzgjatja	8
3.2	Mësimdhënia	8
3.3	Informacioni për trainuesin	8
4.	Veproni sipas gjykimit tuaj	10
5.	Apendiksi A – treguesit e TQNj	11

1. Hyrje

1.1 Audiencia e synuar

Të gjithë ata që gjatë punës së tyre mund të bien në kontakt me viktimat e mundshme të Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj).

1.2 Objektivat e të mësuarit

Me përfundimin e këtij leksioni, studentët do të jenë në gjendje të:

- Rikujtojnë veprimet që kërkohen gjatë përpjekjes për të identifikuar treguesit e TQNj.
- Planifikojnë menaxhimin e takimeve fillestare.
- Shpjegojnë logjikën e planit që kanë përgatitur.
- Demonstrojnë si zbatohen këto plane në skenarët e improvizuar.
- Përshkruajnë se si do t'i kryejnë veprimet/takimet operacionale.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Nuk kërkohen njohuri të mëparshme të kësaj lënde.

2. Treguesit e TQNj

2.1 Kohëzgjatja

Rreth 1 orë ose 1 orë e gjysmë, në varësi të madhësisë së grupit dhe numrit të përdorur të Ushtrimeve mbi Rastet (shih më poshtë).

2.2 Mësimdhënia

Ushtrime në grupe të vogla duke përdorur Ushtrimet mbi Rastet që gjinden te Apendiksi A i këtij plani mësimor.

2.3 Informacioni për treinuesin

Përgjithësisht, intervistat përzgjedhëse do të realizohen mbasi të jenë identifikuar më parë disa tregues mbi rastin e ndeshur. Kjo mund të arrihet ose si pjesë e një operacioni të planifikuar për mbledhjen e informacionit të fshehtë gjatë veprimeve rutinë të intervistimit në kufi, në porte, aeroporte, ose gjatë një veprimtarie rutinë, të zakonshme, të zbatimit të ligjit.

Në Apendiksin A, në vijim, përshkruhen treguesit e TQNj në tri etapa të ndryshme. Rekomandohet t'u hidhni një vështrim të mirë këtyre etapave, që të fitoni njohuritë e duhura para fillimit të leksionit. Mund të ketë dhe disa specifika, të lidhura këto me vendin ku punoni, ose me formën mbizotëruese që karakterizon TQNj në atë vend, të cilat mund të dëshironi t'i përfshini në leksion.

Ushtrimet mbi Rastet ofrohen specifikisht për të mbështetur leksionin, por këto ushtrime mund të përdoren edhe për shumë leksione të tjera.

Gjithsej, ka gjashtë raste, që mbulojnë të gjitha llojet dhe fazat e para të TQNj. Ato janë:

- Person i zhdukur.
- Në rrugë.
- Shërbimet në familje.
- Shtëpitë publike.
- Ferma.
- Veprimtaria e paligjshme – lypja.

Çdo ushtrim mbi rastin, ndjek të njëjtin format të parashtrimit të tij, si vijon:

- Tregimi (rrëfenja ose historia e rastit)
- Cilët janë treguesit në këtë rast?
- Ç'gjë duhet kërkuar?
- Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?
- Si do të veproni?

Secili ushtrim mbi rastin ofron shpjegime të shumta, që do t'ju ndihmojnë gjatë dhënies së leksionit.

Ushtrimi

Ndani studentët në deri gjashtë grupe të vogla (një për secilin Ushtrim mbi Rastin). Jeni ju ai që do të vendosni mbi numrin e grupeve që do të krijohen, në varësi të numrit të studentëve në klasë, të roleve të tyre dhe natyrës së TQNj në vendin ku bëhet trainimi.

Shpërndani pjesën e parë të secilit Ushtrim mbi Rastin për çdo grup, d.m.th. pjesën e tregimit.

Gjithashtu, shpërndani Apendiksin A të këtij plani mësimor – Treguesit e TQNj – për çdo grup.

Udhëzoni grupet që të lexojnë me kujdes pjesën e rrëfenjës së rastit dhe ta ballafaqojnë me përmbajtjen e Apendiksit A.

Caktoni 10 deri 15 minuta për secilin grup që të identifikojnë treguesit që gjinden te rrëfenja e rastit.

Në përfundim, punoni me secilin grup në prani të të gjithë studentëve, duke u kërkuar fillimisht që të lexojnë pjesën e rrëfenjës së rastit, dhe më pas të identifikojnë treguesit në të. Për këtë mund të shfrytëzoni informacionin që gjindet në seksionin “Cilët janë treguesit në këtë rast?” të secilit Ushtrim mbi Rastin.

3. Menaxhimi i procesit të identifikimit të TQNj

3.1 Kohëzgjatja

Një ose një orë e gjysmë, sipas madhësisë së grupit dhe numrit të Ushtrimeve mbi Rastin.

3.2 Mësimdhënia

Është një kombinim i paraqitjes didaktike me një ushtrim në grup të vogël.

3.3 Informacioni për treinuesin

Mënyra sesi do ta prezantoni këtë pjesë të leksionit do të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë këtu edhe përgatitjen edhe përvojën e pjesëmarrësve.

Ju mund të:

- Lehtësoni zgjerimin e njohurive duke dhënë shpjegimet tuaja shtesë.
- Prezantoni në mënyrë didaktike.
- Përdorni kombinimin e të dyja metodave.

Cilëndo metodë që do të përdorni, Teknikat Kyçe për identifikimin e TQNj të dhëna në vijim, do t'ju ndihmojnë të jepni informacione shtesë gjatë sesionit të pyetjeve.

- Nëse keni mundësi, studioni grupin/individin për të gjetur treguesit, para se të flisni me të/ta..
- Vini re se ku ndodhet secili student, kur e takoni fillimisht grupin; kjo mund t'ju ndihmojë të përcaktoni më mirë rolet që mund të luajë secili.
- Nëse është e mundur, caktoni një person që të bëjë pyetje, ndërkohë që të tjerët të aktivizohen për të vëzhguar reagimet dhe ndërveprimet brenda vetë grupit.
- Vëzhguesit duhet të gjejnë shënjat e miqësisë, të frikës apo të ndonjë emocioni tjetër që mund të shfaqen ndër pjesëmarrësit e grupit të tyre.
- Mendoni një pyetje për grupin dhe ndiqni se kush përgjigjet. Kjo mund të tregojë se cili pjesëmarrës është në krye të situatës.
- Konsideroni mundësinë e nxitjes së çdo pjesëmarrësi të grupit të bëjë pyetje. Ndiqni nëse ndonjëri kërkon të përgjigjet në vend të tjetrit. Edhe njëherë, ky do të ishte një tregues se kush është në kontroll të situatës.
- Vazhdoni me këtë ushtrim për sa kohë keni nevojë të identifikoni se kush mund të jetë “zëdhënësi” i grupit.
- MOS LEJONI që këta “zëdhënësia” të mbajnë grupin nën kontrollin e tyre.

- “Zëdhënësata” përfshijnë njerëzit që pretendojnë të jenë punëmarrës/menaxherë.
- Përpiguni që të flisni me secilin person individualisht.
- Kur ndani grupin, bëheni menjëherë me të gjithë anëtarët, dhe jo duke larguar vetëm një person.
- Po t’i lini njerëzit bashkë kjo mund të krijojë rrethana frikësimi të tjetrit, dhe, nga ana tjetër, trafikantët mund të identifikojnë se kush është duke ju informuar.
- Kini kujdes nga njerëzit që dalin vullnetarë për të shërbyer si përkthyes, pasi mund të jenë trafikantë.
- Në disa rrethana, mund t’ju duhet të përdorni “përkthyesit vullnetarë”. Përdorini ata sa më pak të jetë e mundur, dhe vetëm për të gjetur faktet bazë. Gjithmonë, kontrolloni më pas se çfarë ju kanë thënë ata.
- Në rast se planifikoni një vizitë apo operacion, merrni me vete përkthyesin (e autorizuar).
- Viktimat e dyshuara mund të kenë nevojë për ndihmë, kur flitet me ta.
- Mos përdorni përkthyesin si ndihmësin tuaj, për këtë rol kërkohen kualifikime të tjera.
- Mos përdorni “miqtë” në dukje të viktimës, pa një analizë shumë të kujdesshme të tyre.
- Në rast se planifikoni një vizitë apo operacion, merrni me vete njerëzit e përshtatshëm.
- Bëni një kërkim/analizë ligjore të mjedisit/vendit/mjetit ku keni gjetur personat.
- Bëni një kërkim/analizë ligjore të personave që keni gjetur.
- Regjistroni çfarë keni gjetur dhe ku i keni gjetur.
- GJITHMONË MBANI PARASYSH ANALIZËN SHKENCORE – shumë nga gjetjet mund të kenë një vlerë të madhe për hetimin.

Ushtrimi

Sipas grupeve të përdorura më parë, kërkoni nga studentët të mendojnë rreth pyetjeve si më poshtë, duke iu referuar Ushtrimit të tyre mbi Rastin:

- Çfarë duhet kërkuar?
- Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?
- Si do veproni?

Në përfundim, diskutoni me secilin grup në prani të të gjithë pjesëmarrësve. Përdorni informacionin e gjetur te secili Ushtrim mbi Rastin, që mund t’ju ndihmojë në seancën e diskutimit.

Loja me rolin

Provoni të zhvilloni Lojën me Rolin 1 – Në rrugë.

Kjo lojë me rolin bazohet te Ushtrimi mbi Rastin 2 – Në rrugë.

Ajo do t’ju lejojë që nëpërmjet simulimit të situatës, të zhvilloni më tej njohuritë.

Udhëzimet e plota mbi si do të mund të zhvillohet Loja me Rolin, jepen më tej tek vetë loja me rolin.

4. Veproni sipas gjykimit tuaj

Ekzistojnë një numër i madh burimesh të përfshira në këtë program trainimi, që mund t'i përshtatni sipas kushteve apo audiencës përkatëse. Ju, po ashtu, mund të përdorni strukturën bazë të Ushtrimeve mbi Rastin për të krijuar ushtrimet tuaja mbi rastet që do t'i përgjigjeshin drejtpërdrejt dhe në mënyrën më të përshtatshme kontekstit ku jeni duke zhvilluar trainimin.

5. Apendiksi A – treguesit e TQNj

Këta tregues mund të grupohen në mënyra të ndryshme.

Fillimisht, ata grupohen sipas:

- Vendeve/lokaliteteve burim.
- Vendeve/lokaliteteve tranzit.
- Vendeve/lokaliteteve destinacion.

Së dyti, vendet burim dhe tranzit ndahen sipas aspekteve të ndryshme të procesit të TQNj. Këtu përfshihen (me dallime të vogla midis të dy vendeve/lokaliteteve):

- Rekrutimi.
- Njoftimi.
- Mjedisi.
- Transporti.
- Komunikimet.
- Financat.

Së treti, treguesit e vendit/lokalitetit të destinacionit ndahen në “Tregues të përgjithshëm”, “Fëmijët” dhe format e ndryshme të shfrytëzimit, përfshirë:

- Shfrytëzimin seksual.
- Shfrytëzimin e punës.
- Shërbimet nëpër familje.
- Veprimtarinë e paligjshme.

Në vendet/lokalitetet burim

Rekrutimi

- Mashtrimi, duke treguar histori rreth mundësive për punë, që janë ose fallso, ose të perealizueshme, si për shembull punë si yll kinemaje. Në këto histori, përfshihen dhe ato që tregohen nga rekrutuesit e dyshuar, që thonë se janë yje basketbolli, biznesmenë të pasur, etj.
- “Përbetimet” që bëhen para se të bëhet nisja. Kjo lidhet me besimet tradicionale në disa pjesë të botës dhe përdoren si një metodë kontrolli; përbetimet, etj., mund të referohen si “të bërit magji”, “prishës të mendjes”, etj.
- Paraqitja e një fotografie të një gruaje bashkë me pjesë nga veshja e saj, veçanërisht në rastet kur paraqiten fotografi të një gruaje edhe të veshur, edhe të zhveshur. Ky është një tregues tjetër të një mase kontrolli që lidhen me besimin tradicional, dhe shumë shpesh është një shtrembërim i shëmtuar i praktikave tradicionale.
- Njerëzit që janë larguar papritur nga vendbanimi i tyre.
- Dëmtimet e dukshme apo kërcënimet e bëra mund të sugjerojnë se për të “rekrutuar” një person është përdorur forca apo shtrëngimi.
- Gjymtimet tek fëmijët që kuptohen se nuk kanë ndodhur natyralisht, veçanërisht kur këto dallohen tek dy apo më shumë fëmijë. Në disa lokalitete burim, fëmijët sakatohen qëllimisht për t'i nxjerrë në rrugë të lypin.
- Fëmijët që kontraktohen përkundrejt një “tarife”.
- Personat e zhdukur që mungojnë për një kohë të gjatë. Ky, më së shumti, mund të jetë rasti i fëmijëve.

Njoftimi

- Njoftimet mbi mundësitë e migrimit, veçanërisht kur kjo mundësi migrimi për te vendi/lokaliteti (lokalitetet) i përmendur, është i kufizuar.
- Njoftimet që flasin ose nënkuptojnë që nuk do të ketë kosto për personin që migron (migrimi mund të jetë transnacional ose i brendshëm). Në rastet e trafikimit, ndodh rrallë që paratë të paguhen para nisjes; më shpesh praktikohet që trafikantët t'u thonë viktimave që ato/ata mund të paguajnë paratë kur të mbërrijnë në vend.
- Ofrimi i punës për një gjini të caktuar, ose vetëm për të rinjtë.
- Ofrimi i punëve në industri të veçanta, shërbime tregtare ose lloje punësimesh me një mundësi të lartë të shfrytëzimit për TQNj. Kjo ndryshon sipas vendit. Si shembuj mund të sjellim disa forma të punës në tekstile, shërbime nëpër familje ose punë që shoqërohen me shërbime seksuale, d.m.th. punët nëpër bare si kërcimtare, ose në degë të tjera të industrisë së argëtimit.
- Këto njoftime mund të bëhen në forma nga më të ndryshmet: me postera në dyqane, agjenci udhëtimi, apo në formë broshurash, fletushkash, njoftimesh nëpër gazeta, etj.
- Çdo provë rreth ofertave, ftesave të pakërkuara, ose propozimeve për të punuar në një lokalitet/vend tjetër.
- Informacione sekrete të ofruara nga njerëzit që sugjerojnë në formën e njoftimeve të fshehta, por që në thelb kanë të njëjtën përmbajtje si njoftimet që dalin formalisht në publik.
- Dhuratat që u bëhen fëmijëve dhe të rinjve nga të rriturit pa asnjë arsye të dukshme.

10

- Agjencitë e udhëtimit, të cilat ofrojnë punësim pa kontratë pune dhe të cilat paguajnë shpenzimet e bëra nga punëmarrësi.

Mjedisi

- Shtëpitë publike, nga ku punëtorët e seksit kanë migruar në zona të tjera. (Ata/ato mund të jenë larguar me dëshirën e tyre, por edhe mund të jenë mashtruar).
- Çdo gjë që mund të sugjerojë që një fëmije apo një të riu mund t'i jetë afruar një person me moshë më të madhe që është përpjekur të "bëhet mik" me të në ndonjë mjedis pranë një jetimoreje, shkolle, ose ndonjë vend tjetër, ku mblidhen, takohen të rinjtë që janë të pambrojtur.
- Njerëzit që ofrojnë punësim nëpër vendet ku mblidhen migrantët e mundshëm, që kërkojnë punë, si nëpër stacionet e autobuzave, të kamionëve, etj.
- Prania e agjencive të pa-autorizuara të punës që rekrutojnë për punë në një vend/lokalitet tjetër.

Transporti

- Çdo provë mbi shoqërimin ose kontrollimin e lëvizjes së tjetrit.
- Fëmijë që udhëtojnë në shoqërinë e njerëzve që nuk janë prindërit e tyre dhe as familjarë.
- Grupe fëmijësh që udhëtojnë me një të rritur. (Këto shenja mund të jenë tregues që i rrituri është një "rekrutues".)

Komunikimet

- Letrat, telefonatat, mesazhet me e-mail, etj., të dërguara në adresë të vendit/lokalitetit origjinë që tregon se personit që ka migruar i është ndaluar liria e lëvizjes, etj., në vendin/ lokalitetin e destinacionit.

Financat

- Paratë e paguara prindërve apo kujdestarëve për të marrë një fëmijë në formën e një punëtori "të kontraktuar", ose në një formë të ngjashme me këtë. Këto para mund të konsiderohen fare pa vlerë për hetuesit e disa juridiksioneve.
- Informata ose të dhëna sekrete që sugjerojnë se janë bërë përpjekje për të tërhequr/ rekuperuar borxhin e dhënë më parë të afërmëve. Ky lloj rekuperimi mund të ndodhë shumë më vonë pas largimit të personit nga vendi/lokaliteti i origjinës.
- Dërgesat nga migrantët, veçanërisht në rastet kur paratë i dërgohen të afërmit të një migranti nga dikush tjetër. Ka rëndësi të mbahet parasysh që paratë dërgohen edhe prej migrimit të ligjshëm dhe kontrabandimit, të dyja këto situata që nuk kanë të bëjnë me TQNj. Gjithsesi, disa trafikantë dërgojnë para tek familjarët me qëllim që të nxisin bashkëpunimin e mëtejshëm të viktimës, të zvogëlojnë mundësitë e arratisjes dhe të mbështesin mbrojtjen e vetes së tyre në rast se arrestohen. Megjithatë është e vështirë të bëhet dallimi midis dërgesave në një situatë të TQNj nga format e tjera të dërgesave, një kontroll i i mirë nga palët e treta i të gjithë procesit, mund të sjellë si rezultat që dërgesat e parave kanë lidhje me një situatë të TQNj.

Në vendet/lokalitetet tranzit

Transporti

- Njerëz të grumbulluar nëpër grupe, dokumentet e të cilëve i mban vetëm një person.
- Grupe në lëvizje që nuk flasin të njëjtën gjuhë, ose kanë njohuri të pakta të gjuhës së vendit ku ndodhen. Ky tregues mund të jetë provë e njerëzve të kaluar kontrabandë, ose TQNj.
- Rrugët e përdorura nga njerëz që vijnë nga zona që njihen për TQNj, sipas informatave të marra, apo hetimeve të mëparshme. Në rastet e TQNj përdoren si automjetet private ashtu dhe publike.
- Transporti është paguar nga një person tjetër. Transporti mund të jetë publik, por nëse është privat, atëherë pagesa mund t'i jetë shlyer shoferit të makinës ose të kamionit. Kjo pagesë mund të jetë bërë nga një person që udhëton me viktimën(at) e dyshuar(a) të TQNj, ose nga një palë e tretë që nuk është e pranishme.
- Çdo provë mbi oferta për të transportuar njerëz pa autorizimin përkates, veçanërisht kur bëhet fjalë për transportim përtej kufirit. (Rëndësia e kësaj prove mund të ndryshojë nga një vend tek një tjetër, pasi një transport i tillë, i paautorizuar në disa vende, mund të jetë diçka normale në vendet e tjera. Ka vende ku konsiderohet si tepër e parregullt që të transportosh pasagjerë të pa-autorizuar.)
- Çifte ose grupe të vogla njerëzish, ku disa kanë bileta vetëm vajtje, dhe të tjerët vajtje dhe ardhje. Kjo mund të sugjerojë që ata me bileta vetëm vajtje janë viktimë të mundshme të TQNj, dhe ata me kthim, trafikantë të mundshëm. Kjo mund të jetë me rëndësi të veçantë në rast se ata me biletë vetëm vajtje kanë ndërmarrë udhëtimin me propozimin e atyre me biletë vajtje e kthim, dhe kur dëshmohet që të parët nuk e kanë ditur se shoqëruesi(t) i(e) tyre ka(në) biletën e kthimit. Në disa vende, një tregues shumë i fortë i TQNj ka qenë rasti kur bileta e kthimit ka qenë prerë për fluturimin e kthimit brenda ditës, ose me po atë linjë.
- Blerjet e biletave 'online,' ose në momentin e fundit, veçanërisht kur flitet për bileta avioni. Kjo mund të lidhet me dërgimin në adresë të trafikantëve të një përgjigjeje të menjëhershme që njofton 'shitjen e mallit', ose për t'ju shmangur dhe marrë masa kundër hetimit të mundshëm në të ardhmen.
- Fëmijët që udhëtojnë në shoqërinë e personave që nuk janë prindër apo familjarë të tyre.
- Ndalimi afër kufirit apo pikave të kontrollit për të ndryshuar mënyrën e transportit, për shembull, zbritjen nga mjeti për të vazhduar udhëtimin me këmbë.
- Njerëzit që zotërojnë dokumentin e identifikimit të një personi tjetër (apo dokumente të tjera) kur ndalohen për kontrole rutinë, ose kur kontrollohen tek pikat kufitare.
- Dorëzimi dhe/ose marrja e dokumentit të identitetit apo të udhëtimit para ose pas kalimit të pikës të kontrollit. (Është tregues edhe për pikën si më sipër).

Mjedisi

- Strehimi i një grupi paguhet nga një person. Kjo mund të dëshmojë që anëtarët e tjerë të grupit nuk kanë qasje tek paraja.

Financat

- Një person zotëron paratë, në një kohë kur anëtarët e tjerë të grupit që udhëton, nuk kanë të holla. Kjo, përsëri, tregon pamundësinë e tyre të qasjes tek të hollat.
- Një person zotëron monedhat e vendit ku ndodhen, kur të tjerët në grup nuk zotërojnë të tilla.

Komunikimet

- Thirrjet e rregulta telefonike, veçanërisht telefonatat me jashtë vendit tëk të njëjtët persona. Mund të dalin prova që thirrjet telefonike drejtohen tek vendet që njihen si vende/lokalitete origjine të TQNj.

Në vendet/lokalitetet destinacion

Treguesit e përgjithshëm

- Një ndjesi subjektive e viktimës që asaj/atij i duhet të punojë kundër dëshirës së vet.
- Kushte të detyruara të punës.
- Pamundësi nga ana e viktimës që të negociojë kushtet e punës.
- Pamundësi nga ana e viktimës që të largohet nga puna.
- Shfaqje të frikës dhe të ankthit.
- Komunikim i kufizuar me të tjerët.
- Mosnjohje e gjuhës.
- Mosbesim ndaj autoriteteve.
- Frikë të flasin për statusin e tyre të imigrimit.
- Pasaporta ose dokumentet e tjera identifikuese mbahen nga një person tjetër.
- Një person me dokumente fallso identifikimi ose udhëtimi.
- Një person që është pikasur pranë një lloj lokali, që me shumë gjasa përdoret për shfrytëzim.
- Një person që nuk e di adresën e banesës apo të punës.
- Persona që flasin në emër të personit, të cilit i jeni drejtuar me pyetje.
- Kushte të këqija të banimit, ose jashtë standardit.
- Lëndime fizike që duken se janë shkaktuar nga goditjet.
- Dëmtime ose lëndime tipike për disa lloj punësh apo masa shtrënguese.
- Dëmtime të shkaktuara dukshëm nga masat shtrënguese.
- Pamundësi qasjeje te fitimet nga puna.
- Çdo provë se po ushtrohet kontroll mbi lëvizjet e tjetrit.
- Një person që vepron sikur është duke zbatuar vullnetin/udhëzimet e një tjetri.
- Një person që ka ndjesinë se nuk mund të largohet.
- Numri i shtuar i orëve /ditëve të punës.
- Punë pa pagesë (ose një pagesë fare e vogël).
- Nuk ka ditë pushimi.
- Kontakt i kufizuar me familjen ose me botën jashtë.
- Personi ka ardhur nga një vend/lokalitet që njihet si burim i trafikimit.
- Kërcënimet ndaj viktimës ose një pale të tretë.
- Premtime fallso.
- Masa kufizuese.
- Ndërveprim i kufizuar ose aspak njerëzor.
- Mungesë qasjeje ndaj kujdesit mjeksor.
- 'Disiplinim' nëpërmjet dënimesh.
- Kontakt shumë i kufizuar shoqëror.
- Personi kërcënohet se do ta dorëzojnë tek autoritetet.
- Personi është i bindur se është i detyruar nga një borxh që duhet ta shlyejë.
- Kërcënimet për, ose dhuna reale ndaj një personi, ose ndaj anëtarëve të familjes, apo të afërmëve të viktimës.
- Vendosja në një situatë varësie.

Fëmijët

- Sistemim më vete për fëmijët e tjerë.
- Ushqimi veç nga anëtarët e tjerë të 'familjes'.
- Të ushqyerit vetëm me mbetje ushqimore.
- Veshje pune për fëmijë ose veshje seksi.
- Fëmijë që udhëtojnë të pashoqëruar nga të rriturit.
- Fëmijë që udhëtojnë në grup me persona, me të cilët nuk kanë asnjë lidhje.
- Pretendime se kanë 'gjetur' një fëmijë të pashoqëruar.
- Lodra, shtretër ose veshje fëmijësh në lokale të papërshtatshme, p.sh. shtëpi publike, fabrika, etj.
- Shprehje frikësimi ose sjellje që nuk përshtaten me moshën e fëmijës.
- Nuk ka qasje në arsim.
- Nuk ka kohë të luajë.
- Nuk ka mundësi të lidhet me prindërit apo kujdestarin.
- Nuk ka shoqe/shokë të moshës së saj/të tij jashtë vendit të punës, etj.
- Fëmijë të pashoqëruar, që mbajnë numra telefoni taksie.

Shfrytëzimi seksual

- Nën 30 vjeç (ndryshon në varësi të vendit/lokalitetit dhe tregut).
- Njoftime për shtëpitë publike, etj., që ofrojnë gra nga grupe të veçanta etnike/kombëtare.
- Fjetja në vendin e punës.
- Klientela është për një grup të caktuar etnik.
- Tatuazhe ose shenja të tjera që identifikojnë se janë 'pronë' e shfrytëzuesve.
- Komente të klientëve të punëtorëve të seksit, që thonë se punëtorja/punëtori nuk bashkëpunoi.
- Zhvendosja e grave nga një shtëpi publike tek tjetra, ose që punojnë nëpër vende të ndryshme.
- Gratë që shoqerohen gjithmonë nga dikush, p.sh. për në punë dhe nga puna, në dyqane, etj.
- Gratë që punojnë me orë të gjata, ose që nuk kanë ditë pushimi (ose pak).
- Grupe grash që banojnë ose udhëtojnë në grup.
- Gra me shumë pak rroba në trup.
- Pjesa më e madhe e rrobave janë 'seksi'.
- Njohin vetëm fjalë në gjuhën lokale që lidhen me seksin, ose me llojin e klientelës.
- Gra që nuk zotërojnë para të vetat.
- Grupe grash që udhëtojnë bashkë, por që përdorin gjuhë të ndryshme mes tyre.
- Nuk arrijnë të japin identitetin e tyre.
- Prova të seksit të pambrojtur dhe/ose të dhunshëm.
- Prova që viktimat e dyshuara nuk mund të refuzojnë seks të pambrojtur, etj.
- Prova që personi është blerë ose shitur.
- Prova që grupet e grave janë nën kontrollin e të tjerëve.

Shfrytëzimi për punë

Shembujt përfshijnë: punët në bujqësi, në ndërtim ose në fabrikë, me paga të ulëta dhe orë të gjata pune, në industrinë e argëtimit ose të shërbimeve, etj.

- Njoftimet janë në gjuhë të huaj.
- Vendet ku punojnë migrantë, por ku njoftimet më të rëndësishme (mbi shëndetin dhe sigurinë) nuk janë në gjuhë të huaj.
- Punëmarrësi apo menaxheri nuk arrin të tregojë dokumentet e kërkuara kur punëson punëtorë migrantë.
- Punëmarrësi apo menaxheri nuk arrin të ofrojë borderotë mbi pagat e punëtorëve.
- Pajisje jashtë standardit për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.
- Mungesë shenjash paralajmëruese për shëndetin dhe sigurinë.
- Pajisje të projektuara apo të modifikuara që të përdoren nga fëmijët.
- Prova të dhunimit të ligjeve/kodit të punës.
- Grupe njerëzish që jetojnë në vendin e punës dhe që dalin shumë rrallë, ose aspak.
- Kushte të mjerueshme ose të papërshtatshme fjetjeje (nëpër godinat bujqësore apo industriale).
- Mungesa e veshjeve të përshtatshme për punën që bëjnë (p.sh. mungesa e pajisjeve mbrojtëse apo e veshjeve të ngrohta).
- Masat e sigurisë që merren për t'i mbajtur njerëzit kyçur brenda.
- Çdo provë që dëshmon se punëtorëve u kërkohet të paguajnë vetë për mjetet e punës, ushqimin apo strehimin, ose që për këtë qëllim u bëhet zbritje nga rroga e tyre.
- Nuk kanë qasje tek fitimet.
- Nuk ekziston kontrata e punës.
- Punohet me orë të gjata.
- Varësia nga punëmarrësi për një sërë elementesh të jetës së tyre, p.sh. për punën, transportin, strehimin, etj.
- Strehimi i imponuar me dhunë.
- Pamundësia për t'u larguar nga mjedisi pa punëmarrësin.
- Kufizimi i lëvizjeve.
- Përdoren gjobat/dhuna për disiplinim.
- Të ushqyerit me mbetjet ushqimore.
- Ushtrimi i dhunës, i kërcënimit, i abuzimit, apo të sharjeve.
- Mungesa e trenimit apo kualifikimit për punën që bëjnë dhe/ose e çertifikatave, liçencave, etj.

Shërbimet nëpër familje

- Të jetuarit me një familje.
- Mos ulja në një tavolinë me anëtarët e familjes.
- Mos pasja e një hapësire të vetën/private.
- Fjetja në një vend të papërshtatshëm.
- Punëmarrësi e raporton si një person të zhdukur.
- Pamundësia të dalë nga shtëpia ku punon, për arsye sociale.

- Edhe kur del nga shtëpia, është gjithmonë e/i shoqeruar nga punëmarrësi.
- Ushqehet vetëm me mbetje ushqimore.
- Shahet, abuzohet, kërcënohet ose dhunohet.

Veprimtaritë e paligjshme

- Fëmija, i moshuari apo migrantët me aftësi të kufizuara që lypin, aktivisht apo pasivisht, nëpër vendet publike ose transportin publik.
- Gjymtimet fizike që duket se janë shkaktuar qëllimisht.
- Çdo provë, që dëshmon se grupi është zhvendosur kolektivisht për një periudhë të caktuar kohe nëpër një numër vendesh.
- Grupet e mëdha me fëmijë të së njëjtës etni, që lëvizin nën shoqerimin e një numri të vogël të rriturish.
- Zhvendosja e njerëzve brenda mjeteve të transportit publik, p.sh. lëvizja nëpër të gjithë trenin.
- Veprimet në formë bandash të organizuara kriminale.
- Bandat me grupe me të njëjtën përkatësi etnike.
- Bandat që kanë në përbërje kryesisht fëmijë.
- Një i rritur i vetëm është kujdestar i shumë fëmijëve.
- Lindja e formave të reja të bandave kriminale.
- Dënimet që jepen kur nuk është mbledhur/vjedhur aq sa u është caktuar.
- Të gjithë anëtarët e bandës jetojnë bashkarisht.
- Të gjithë anëtarët e bandës kanë udhëtuar bashkarisht drejt vendit të destinacionit.
- Anëtarët e bandës që jetojnë me persona që nuk janë të afërmit e tyre.
- Dëshmi mbi veprat e njëjta penale të këtij personi në një vend tjetër.
- Të mitur të pashoqeruar që “janë gjetur” nga të rriturit me të njëjtën përkatësi etnike/kombësi.
- Zhvendosjet brenda ditës me grupime të mëdha në distanca të largëta, p.sh. nga një qytet tek tjetri.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat mësimore	5
1.3	Njohuritë paraprake	5
2.	Qëllimi i një interviste përzgjedhëse për TQNj	6
2.1	Kohëzgjatja	6
2.2	Mësimdhënia	6
2.3	Informacion për trainuesin	6
3.	Sfidat e një interviste përzgjedhëse për TQNj	7
3.1	Kohëzgjatja	7
3.2	Mësimdhënia	7
3.3	Informacioni për trainuesin	7
4.	Modeli PEACE	8
4.1	Kohëzgjatja	8
4.2	Mësimdhënia	8
4.3	Informacioni për trainuesin	8
5.	“PEACE” për intervistat përzgjedhëse të TQNj	10
5.1	Kohëzgjatja	10
5.2	Mësimdhënia	10
5.3	Planifikimi dhe përgatitja – informacioni për trainuesin	10
5.4	Përfshirja dhe shpjegimi- informacion për trainuesin	12
5.5	Tregimi – informacioni për trainuesin	13
5.6	Mbyllja – informacioni për trainuesin	14
5.6	Vlerësimi – informacion për trainuesin	16
6.	Aneksi A – shembuj pyetjesh që mund të përdoren për intervistat përzgjedhëse	18
6.1	Pyetjet për fazën e rekrutimit	18
6.2	Pyetjet për fazën e transportit	18
6.3	Pyetjet për fazën e shfrytëzimit	19

1. Hyrje

Synimi i këtij mësimi nuk është që t'ju mësoj si të realizoni një intervistë të plotë viktimë/viktimë dëshmitare/i (e) dyshuar, por të ofrojë një praktikë të mirë bazë për t'u përdorur specifikisht gjatë intervistave përzgjedhëse.

Për intervistimin është përdorur një version i përshtatur i modelit standard PEACE.

1.1 Audiencia e synuar

Ky leksion synon cilindo që mund të ndeshet me Trafikimin e Qenieve Njerëzore (TQNj) në profesionin e tyre, përfshirë:

- Oficerët e policisë.
- Rojet e kufirit.
- Inspektorët e punës.
- Punonjësit socialë.
- Inspektorët e shëndetësisë dhe sigurisë.
- Punonjësit e arsimit.

Në këtë mësim jepen një numër ushtrimesh që janë për disa forma të veçanta të TQNj, dhe kontekstet e tyre mund të mos kenë shumë lidhje me disa nga profesionistët e mësipërm. Programi mësimor jep një seri ushtrimesh mbi rastet që mund t'i përshtaten një profesioni të caktuar duke përdorur për këtë qëllim elementet bazë të këtij plani mësimor.

1.2 Objektivat mësimore

- Të përshkruajë sfidat që mund të ndeshen gjatë intervistës përzgjedhëse për TQNj.
- Për të nënvizuar qëllimin e një interviste përzgjedhëse për TQNj.
- Për të kujtuar elementet bazë të modelit të intervistimit PEACE.
- Për të përshkruar se si mund të përshtaten modeli PEACE te intervistat përzgjedhëse.
- Për të shpjeguar metodat e ndryshme që përdoren për intervistat përzgjedhëse të planifikuara dhe të paplanifikuara.

1.3 Njohuritë paraprake

Mendohet që studentët e kanë përfunduar tashmë Mësimin 2, 'Treguesit e Trafikimit të Qenieve Njerëzore'.

Në varësi të audiencës, ju mund të dëshironi që para këtij leksioni, të jepni pjesë të zgjedhura të Mësimin 6, 'Intervistat mbi bazën e provave'.

2. Qëllimi i një interviste përzgjedhëse për TQNj

2.1 Kohëzgjatja

5 – 10 minuta.

2.2 Mësimdhënia

Mësimi mund të jepet në mënyrë didaktike duke përdorur informacionin e paragrafit të mëposhtëm. Megjithatë, konceptet nuk janë dhe aq të ndërlukuara dhe audienca mund të ndihmohet me disa përvoja/praktika të mëparshme të zbatimit të ligjit.

2.3 Informacion për treinuesin

Qëllimi i intervistës përzgjedhëse për TQNj është që të identifikojë nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personi është trafikuar, dhe nëse po, çfarë veprimi duhet ndërmarrë.

Në përgjithësi, intervistat përzgjedhëse do të kryhen pasi të jenë identifikuar disa tregues. Kjo mund të jetë pjesë e një operacioni të fshehtë të planifikuar më parë, gjatë veprimeve rutinë të kontrollit në kufi, porte dhe aeroporte, ose gjatë veprimeve rutinë të zbatimit të ligjit.

3. Sfidat e një interviste përzgjedhëse për TQNj

3.1 Kohëzgjatja

5 – 10 minuta.

3.2 Mësimdhënia

Mësimdhënie didaktike bashkë me ndërhyrjet lehtësuese.

3.3 Informacioni për trainuesin

Intervistat përzgjedhëse janë në fakt të ngjashme me shumë lloje të tjera intervistash që kryhen nga zbatuesit e ligjit. Gjithsesi, në këtë rast ata përballen me një sërë sfidash të veçanta, përfshirë:

- Koha – shpesh ka pak kohë në dispozicion.
- Vendi – ka shumë të ngjarë që të kryhet në kushte larg kushteve ideale, si anash rrugës, nëpër vendet e punës, në mjetet e transportit publik, etj.
- Fshehtësia – lidhet edhe me vendin ku ndodheni, por shpesh nuk e realizon dot sepse shpesh herë janë të pranishëm persona të tjerë, përfshirë edhe trafikantët e mundshëm.
- E drejta ligjore – ju mund të mos keni të drejtë ligjore që të ndaloni dikë.
- Treguesit – megjithëse mund të jenë të identifikueshëm, mund të mos japin mundësi për të marrë ndonjë vendim.
- Intervistat përzgjedhëse realizohen si nga njerëzit që mbajnë një pozicion afër ligjzbatuesve (si p.sh. inspektorët e punës apo të fabrikës) ashtu dhe ata që nuk kanë pozicione të zbatuesve direktë të ligjit (si p.sh. personeli i OJQ-ve ose punonjësit socialë) pa një training të mëparshëm apo përvojë në intervistim.

4. Modeli PEACE

4.1 Kohëzgjatja

5 – 10 minuta.

4.2 Mësimdhënia

Rekomandohet që të përdoret metoda didaktike për trajtimin e strukturës bazë të modelit PEACE.

Një pjesë e studentëve mund të mos ketë dëgjuar mbi modelin PEACE. Për ta shpjeguar atë, mund të përdoren metoda lehtësuese, por ka të ngjarë që të mos jetë shumë efektive, të kërkojë kohë, dhe kjo veçanërisht për intervistat përzgjedhëse.

Mund të ndodhë që studentët të kenë dijeni mbi modelin PEACE pasi mund të kenë bërë trainime për llojet e tjera të intervistimit. Megjithatë, njohja nga ana e tyre mund të mos jetë e plotë, sepse ka dallime midis zbatimit të modelit PEACE në intervistat përzgjedhëse dhe llojeve të tjera të intervistave. Madje, edhe kur njihet modeli PEACE, rekomandohet që të trajtohen nga ana didaktike parimet bazë të modelit, para se të vazhdohet me temat e tjera.

Faqja 1 (me titull PEACE- Bazat) e prezantimit në PowerPoint të “Modeli PEACE i intervistimit për TQNj”, e zberthen akronimin si më poshtë.

4.3 Informacioni për treinuesin

Modeli i intervistimit PEACE do të zberthehet në etapat si vijojnë:

- **P** – Planning and preparation → planifikimi dhe përgatitja
- **E** – Engaging and explaining → përfshirja dhe shpjegimi
- **A** – Account → tregimi
- **C** – Closure → mbyllja
- **E** – Evaluation → vlerësimi

PEACE – shpjegimi më me hollësi

- Planifikimi dhe përgatitja – mbulon fusha siç është planifikimi se ku do të bëhet intervista, kush do ta bëjë atë dhe cilat do të jenë pyetjet që do të bëhen.
- Përfshirja dhe shpjegimi – ndërtimi i një marrëdhënieje ose raporti me personin që do të intervistohet, identifikimi i intervistuesve dhe shpjegimi i arsyes se përse bëhet intervista.
- Tregimi – pjesa më e madhe e intervistës gjatë së cilës personi që intervistohet rrëfen ngjarjen që i ka ndodhur. Të intervistuarit inkurajohen të “flasin lirshëm” (edhe me ndërprerje) të ngjarjeve. Pastaj biseda zhvillohet më tej duke bërë një sërë pyetjesh.
- Mbyllja – pas verifikimit që personi i intervistuar nuk ka asgjë tjetër për të shtuar, shpjegohet se çfarë do të ndodhë më pas dhe falenderohet për kohën që ju kushtuan.
- Vlerësimi – analiza rreth çfarë është thënë dhe marrja e vendimit mbi veprimin që kërkohet, si për shembull, a duhen kryer intervista të tjera apo të realizohen kërkime të mëtejshme.

5. Modeli “PEACE” për intervistat përzgjedhëse të TQNj

5.1 Kohëzgjatja

Rreth një orë pa llogaritur lojrat me role. 3 orë po të përdoren lojrat me role.

5.2 Mësimdhënia

Metoda që rekomandohet në këtë rast është një paraqitje didaktike e informacionit të mëposhtëm, ose lehtësimi me anë të zbulimit të informacionit nëpërmjet pyetjeve e përgjigjeve.

Lehtësimi mund të realizohet gjatë sesionit plenar duke përdorur formatin e “shkëmbimit të mendimeve”, dhe duke shënuar përgjigjet në një tabelë.

Vazhdohet më pas me dhënien e mësimin, duke u bazuar mbi një nga studimet mbi rastin.

5.3 Planifikimi dhe përgatitja – informacioni për treinuesin

Planifikimi dhe përgatitja janë etapa thelbësore, kur bëhet fjalë për Intervistat Përzgjedhëse të viktimave të mundshme të TQNj.

- **Të jeni i përgatitur** – për takimet e planifikuara dhe të paplanifikuara me viktimat e mundshme të TQNj.
 - I paplanifikuar – përpiquni të kuptoni se si paraqitet trafikimi njerëzor në vendin ku po punoni, si mund të jenë llojet e trafikimit me të cilat mund të ndesheni dhe me treguesit që mund ta zbulojnë atë. Merrni në konsideratë ndikimin që ushtron TQNj mbi viktimat. Kjo ka shumë rëndësi, sepse viktimat e TQNj mund të reagojnë ndryshe nga ç’mund të prisni ju. Merrni parasysh se cilat janë të drejtat tuaja ligjore dhe çfarë opsionesh keni për zbatimin e procedurave, si për shembull, ato të parashkruara në mekanizmin tuaj kombëtar të referimit.
 - I planifikuar – me çfarë gjuhësh do t’ju duhet të komunikoni? Siguroni që të keni në dispozicion përkthyes të kualifikuar. Cilët persona mund t’ju vijnë në ndihmë? Si do të përdoren ata? Çfarë informacioni duhet t’u jepet atyre? A keni ndonjë mundësi zgjedhjeje të vendit, ku duhet të kryhet intervista përzgjedhëse?
- **Të njihni bazat** – ekzistojnë disa teknika të thjeshta dhe efektive që mund të përdorni për të menaxhuar takimet (e planifikuara dhe të paplanifikuara) me viktimat e mundshme

të TQNj. Mesimi 2, 'Treguesit e trafikimit të qenieve njerëzore', jep shpjegimet mbi këto teknika dhe sugjeron disa ushtrime që mund t'ju ndihmojnë t'i veni ato në praktikë.

- **Mos dëmtoni** – mund të ketë rrethana në të cilat intervistimi i viktimave të TQNj mund t'u shkaktojë atyre dëme serioze. Në rast se mendoni se rasti në fjalë përbën një rrezik të tillë, përpiquni të gjeni mënyra të tjera për të hetuar dhe/ose merrni në konsideratë shtyrjen e intervistës.
- **Komunikoni me kolegët** – mund të ndodhë që fare papritur t'ju duhet të kryeni një intervistë përzgjedhëse. Bisedoni me kolegët tuaj rreth mënyrës sesi të planifikoni një intervistë; kush duhet të bëjë pyetjet, si duhet t'i ndani njerëzit, çfarë duhet të siguroni ndërkohë, etj.

Ushtrimi

Ndani grupet në çifte. Shpërndani Ushtrimin e Rastit 3 'Shërbimi në familje', ose lexojeni atë me zë të lartë.

Në rast se studentët kanë përfunduar tashmë Mësimin 2 'Treguesit e trafikimit të qenieve njerëzore', ata mund të jenë familjarë me këtë ushtrim të rastit. Megjithatë, ia vlen që të bëhet një rifreskim i dijeve të tyre rreth këtij rasti. Në qoftë se ata e kanë përfunduar Mësimin 2, kjo mund të ndihmojë në kursimin e kohës për të realizuar këtë ushtrim.

Udhëzoni çiftet që të planifikojnë dhe përgatiten për një intervistë përzgjedhëse me një vajzë. Do të supozohet se nuk do të keni nevojë për përkthyes.

U jepni çifteve pesë minuta për të planifikuar. Shpjegoni se ky përcaktim kohor është realist; dhe në fakt, është ndoshta shumë më tepër nga sa do t'ju duhet në situata të jetës reale.

Ndërkohë që ata planifikojnë, nxitini çiftet duke përmendur situata të tilla, si: 'vajza thotë se punëdhënësi i saj po vjen në shtëpi dhe ajo ka akoma shumë punë për të bërë', ose, 'se është e shqetësuar dhe kërkon t'i kthehet punës sa më shpejt', etj. Këto përsëritini vetëm njëherë.

Pas pesë minutash, njoftoni që koha mbaroi dhe kaloni në sesionin plenar.

Kërkoni një çift vullnetar që të paraqesin planin e tyre të intervistimit përzgjedhës dhe logjikën që kanë përdorur.

Ftoni çiftet e tjera që të thonë diçka dhe të shtojnë mendimet e tyre.

Bëni pyetje-përgjigje mbi bazën e informacionit të përfutur më lart.

Pyetini çiftet se si u ndjenë nën presionin e kohës. A ishte real? Si do ta menaxhonin këtë presion kohor në jetën reale?

Së fundi, pyetini të gjitha grupet se çfarë mund të bëjnë për të patur një plan intervistimi për këto lloj rastesh që mund t'ju ndodhin gjatë punës së tyre. Kini parasysh, se kjo përgatitje nuk duhet të kufizohet vetëm me skenarin e TQNj në familje.

5.4 Përfshirja dhe shpjegimi- informacion për trainuesin

Intervistat duhet të bëhen duke mbajtur gjithmonë parasysh nevojën për të vendosur një marrëdhënie besimi dhe një raport me viktimën e mundshme të TQNj.

Dëgjoni dhe respektoni – duhet pranuar që çdo përvojë është unike për secilin individ. Dëgjoni me vëmendje dhe aktivisht, dhe tregohuni i hapur.

Fillimisht bëni pyetje të përgjithshme – përdorni një stil normal bisede; mund të mos jetë i përshtatshëm për të gjitha rastet, por ky stil ju ndihmon që ta përfshini në bisedë personin që intervistoni.

Nuk duhet të duket sikur po bëni një intervistë përzgjedhëse – kjo përdoret për llojet e tjera të intervistave PEACE (ku rekomandohet që t'u tregoni të intervistuarve se cili është qëllimi i intervistës). Në rast se ju thoni se po intervistoni për TQNj, shumë njerëz ndoshta nuk do të dijnë se çfarë kërkoni të thoni, dhe ata që e kuptojnë, mund të frikësohen dhe të mos flasin. Po ta thoni këtë, ju mund t'i dërgoni pa dashje një sinjal edhe trafikantit. Apendiksi A ju sugjeron disa pyetje, që duhet t'ju ndihmojnë të krijoni një mënyrë të natyrshme bisedimi.

Përdorni gjestet/gjuhën trupore – buzëqeshni ose përdorni shenja të përshtatshme që tregojnë se ju nuk jeni një kërcënim për të intervistuarin dhe se dëshironi vetëm të bisedoni. Edhe nëse nuk e njihni kulturën/traditën e personit, bëni ç'të mundni që ai/ajo të ndihet i/e qetë.

Vëzhgoni personin me të cilin flisni në kërkim të shenjave të qetësisë të tij/të saj, si buzëqeshjet dhe xhestet trupore që flasin për mirëkuptimin e personit. Përpikuni të kuptoni se çfarë i qetësoi dhe shfrytëzoni ata tregues për të ecur më tej me bisedën.

Shenja e fshehtë – mund t'i sugjeroni personit që të përdor ndonjë shenjë të fshehtë në rast se e ndjen veten të rrezikuar në mjedisin ku është, si p.sh. 'ngre gishtin e majtë tregues të dorës nëse mendon se je në rrezik'.

Loja me role

Organizoni lojën me role, 'Punëtori në familje'. Në dokumentin që shpjegon këtë lojë do të gjeni udhëzimet e plota se si ta menaxhoni atë.

Loja 'Punëtori në familje' ndahet në dy seksione. Ju mund të gjykoni që të bëni vetëm seksionin e parë, i cili kërkon përdorimin e fazës, 'Përfshirja dhe shpjegimi' të intervistës përzgjedhëse sipas modelit PEACE. Seksioni i dytë ka të bëjë me fazën, 'Tregimi' (si më poshtë).

Loja 'Punëtori në familje' ofron gjithashtu udhëzime mbi si mund të modifikohet loja duke shfrytëzuar dhe lojrat 'Ferma', ose 'Shtëpia publike'. Kjo ju jep alternativa për ta bërë leksionin sa më të afërt që të jetë e mundur me interesat e audiencës.

5.5 Tregimi – informacioni për treinuesin

Intervistat mbi provat ekzistuese sipas PEACE fillojnë me ‘një kujtesë të lirë’. Kujtesa e lirë bëhet nga një person që tregon historinë e tij/të saj, pa u ndërprerë nga intervistuesi.

Duke përdorur këtë metodë për intervistat përzgjedhëse ka mundësi që të mos jetë e përshtatshme për të gjitha rastet e kontrollimit. Në rastet kur koha është shumë e shkurtër, gjë që ndodh në më të shumtën e herëve, intervistuesi duhet të marrë nën kontroll drejtimin e intervistës.

Marrja nën kontroll e intervistës nuk do të thotë thjesht bërja drejtpërdrejt e pyetjeve të mbyllura: po të fillojë intervista me pyetjen e mbyllur ‘A jeni trafikuar’, vetëm sa do të frikësojë pjesën më të madhe të viktimave të TQNj dhe do të vendosë një pengesë midis jush dhe atyre.

Ndonëse metoda e ‘kujtesës së lirë’ mund të mos jetë e përshtatshme në të gjitha intervistat përzgjedhëse, mund të jenë të përshtatshme disa teknika të tjera. Fillimisht duhen përdorur pyetjet e hapura, të mbahen shënime përgjigjet dhe të bëhen sqarimet e nevojshme me anë të pyetjeve të tjera të hapura, ose, kur shihet e përshtatshme, me anë të pyetjeve të mbyllura.

Një shembull për të pasqyruar se kur janë të dobishme pyetjet e mbyllura, është kur pyetjet e hapura nuk janë duke dhënë një informacion të qartë dhe duket që personi është i frikur. Në fakt është mjeti i fundit, por ju mund të merrni parasysh bërjen e pyetjeve të drejtpërdrejta, si ‘A ke frikë nga ndonjë person?’ Kjo mund të kombinohet me ‘shenjën e fshehtë’ të përshkruar më lart te ‘Përfshirja dhe shpjegimi’.

- **Pyetjet e hapura** – filloni intervistën përzgjedhëse me një pyetje të hapur, të përshtatur me situatën, por jo të lidhur drejtpërdrejt me TQNj, për shembull, “çfarë pune bën?”
- **Zhvilloni më tej përgjigjen e marrë** – në varësi të përgjigjes së tyre, zhvilloni më tej intervistën me anë të pyetjeve të tjera, si “Pra, puna juaj është _____? (përmendni këtu natyrën e punës që bën i intervistuari) ose, “Më thuaj, të lutem, si ja kalove sot”. Një shembull se si mund të zhvillohet më tej përgjigja e marrë, është të thuash, “Pra ju _____? (përmendni këtu ndonjë aktivitet për të cilin foli i intervistuari). “Sa orë do t’ju duhet ta mbaroni atë?”, e kështu me radhë.
- **Pyetjet e mbyllura** – në disa raste mund të vendosni të përdorni një pyetje plotësisht të mbyllur, si “Në punën tuaj (përmendni vendin e tyre të punës) a punoni më shumë se dymbëdhjetë orë në ditë?”, ose “A e filloni punën para se të lindë dielli/ por kur e mbaroni, me perëndimin e diellit?”
- **Temat** që mund të prekni kur intervistoni janë: ku fle, ku ushqehet e me çfarë ushqehet, nëse del pas pune, nëse ka ndonjë shenjë dëmtimi fizik apo gjymtimi. Çfarëdo teme që vendosni të trajtoni, gjithmonë filloni me një pyetje të hapur, demonstroi se jeni një dëgjues i vëmendshëm dhe aktiv, dhe përdorni pyetje plotësisht apo pjesërisht të mbyllura vetëm kur të jetë e përshtatshme.

- **Filloni të përdorni pyetje të drejtpërdrejta të lidhura me TQNj, me shumë kujdes** – filloni duke pyetur se si ndihet tani, dhe më pas vazhdoni me atë çfarë i ka ndodhur në të kaluarën.
- **Dëgjimi aktiv** – bëhet fjalë për një sërë teknikash që demonstrojnë se jeni duke dëgjuar, gjë që ndihmon për të ndërtuar një lidhje me ta dhe i inkurajon që të vazhdojnë e të tregojnë historinë e tyre. Një nga këto teknika është që të përsëritni pjesët e rrëfenjës apo të përgjigjes së personit dhe të bëni komente mbi atë çfarë kanë shprehur ata ndërkaq. Kjo ndihmon që të dëshmoni se jeni duke i ndjekur dhe dëgjuar në mënyrë aktive.
- **Shenja e fshehtë** – provoni t'i thoni personit që të përdorë një shenjë, në rast se nuk mund t'i përgjigjet një pyetjeje të caktuar, një shenjë për 'Po', dhe një shenjë tjetër për 'Jo'. Për më shumë informacion, shihni seksionin 'Tregimi', më poshtë.
- **Vlerësoni në vazhdimësi** – a përputhet ajo që thuhet me atë që dini mbi procesin e TQNj, mbi si përgjigjet personi të cilit i drejtoheni, po dëmtimet apo provat e tjera fizike, që mund të vihen re, dhe a mund të gjykohej normale këto shenja sipas rrethanave lokale?

Loja me role

Përdorni lojën 'Punëtori në familje'. Në dokumentin ku trajtohet kjo lojë, jepen udhëzime të plota si duhet të menaxhohet kjo lojë.

Loja 'Punëtori në familje' është e ndarë në dy seksione. Seksioni i dytë shqyrton fazën 'Tregimi' të një interviste përzgjedhëse sipas modelit PEACE.

5.6 Mbyllja – informacioni për trainuesin

Ekzistojnë dallime në mënyrën se si mund të mbyllet një intervistë përzgjedhëse sipas PEACE me një intervistë PEACE mbi bazën e provave.

Në rast se intervista ka prodhuar informacion të mjaftueshëm që t'ju ndihmojë të vendosni nëse keni të bëni me trafikim, dhe nëse do t'ju duhet të ndërmerri një veprim, ju duhet t'i tregoni personit se cili do të jetë ai veprim. Gjithsesi, vetëm një thënie mund të mos jetë e mjaftueshme. Për shembull, mund t'i kërkonti një viktime të mundshme të TQNj që të vijë me ju; por në rast se zbatuesi i ligjit e kërkon këtë, shumë njerëz mund të mendojnë se bëhet fjalë për arrestim apo ndalim. Megjithatë mund të jetë e vështirë, do t'ju duhet të bëni të pamundurën për të shpjeguar mirë se çfarë do të ndodhë në vijim; në të kundërt, viktime e dyshuar mund të mos bashkëpunojë më tej.

Ju mund të keni ndjesinë se keni të bëni me një rast TQNj, por nuk keni informacion të mjaftueshëm për të ndërmarrë një veprim të drejtpërdrejtë. Në këtë rast, do ta mbyllni intervistën duke i dhënë personit informacionin mbi si duhet të veprojë në rast se dëshiron të kontaktojë zbatuesit e ligjit ose agjencitë e tjera përkatëse.

Në këtë situatë, merrni në konsideratë sugjerimet e mëposhtme:

- Pyeteni nëse ka ndonjë gjë tjetër për t'ju thënë.
- Jepini personit mundësinë t'ju thotë nëse është i/e frikësuar apo ndjejnë ndonjë rrezik.
- Jepini personit mundësinë t'ju bëjë një shenjë në përgjigje të një pyetjeje të drejtpërdrejtë në lidhje me frikën apo të qenit në rrezik.
- Shpjegoni se çfarë mund të bëjnë në rast se janë në rrezik dhe jepuni të dhënat e kontakteve të policisë, apo linjës telefonike falas, “helpline”, etj.
- Në rast se janë pjesë e një grupi, bëni të pamundurën që ata të mos kthehen tek ai grup, përderisa të mos keni biseduar me anëtarët e tjerë të grupit, apo të mos keni biseduar me kolegët, të cilët kanë biseduar tashmë me anëtarët e tjerë të grupit.
- Mos bëni premtime që nuk do të mund t'i mbani.
- Siguroni detajet e kontakteve të mundshme.
- Duhet të theksohet me forcë që edhe nëse mund të mendoni se nuk ka informacion të mjaftueshëm nga intervistuesi që të konfirmohet TQNj, për ju mund të ketë shumë mënyra për të vepruar. Shembujt, si më poshtë:
 - Nëse ka lëndime, mund të jetë ushtruar dhunë mbi viktimën, që mund ta hetoni.
 - Mund të ketë probleme të shëndetit dhe të sigurisë në vendin ku qëndron personi, të ushqimit, etj., kështu që ose ju, ose persona nga ndonjë agjenci tjetër mund të ndërmerrni veprimet e rastit.
 - Personi që intervistohet mund të jetë një fëmijë, ose ju mund të dyshoni se keni të bëni me një fëmijë; kjo mund t'ju japë autoritet që ta dërgoni në një vend të sigurt ose përkujdesjeje.
 - Po ashtu, nëse i intervistuari është një i rritur i rrezikuar, mund të keni autoritetin që ta largoni atë nga ai rrezik.
 - Mund të identifikoni shkelje të rregullave të shëndetit, sigurisë apo higjenës, etj., gjë që mund t'ju lejojë juve, ose ndonjë agjencie tjetër, që të ndërmarrë veprimet e nevojshme.
 - Mund të ndesheni me shkelje, shkelje të rregullave të migrimit ose punësimit, të cilat ju detyrojnë ose ju lejojnë që ta ndaloni personin që intervistohet. Kjo mund të jetë një situatë shumë sfiduese, pasi jeni duke arrestuar apo ndaluar një person, por, do t'ju duhet edhe të ruani një raport me të në mënyrë që të rritni mundësinë që ai/ajo t'ju japë informacionin që kërkon në lidhje me TQNj.
 - Po këto konsiderata kanë vend kur arrestoni/ndaloni një person për një krim që ka kryer, sepse ishte i/e detyruar të veprojë në atë mënyrë nga trafikantët. Si shembuj mund të shërbejnë vjedhjet, krimet seksuale, lypja, etj. Në disa raste mund të keni të drejtën e arrestimit; në të tjerat, do të jeni i detyruar të arrestoni fillimisht dhe më pas të diskutoni rrethanat me hetuesit dhe prokurorët, të cilët mund të vendosin nëse të pushojnë procedimin penal kundër një viktime të dyshuar të TQNj, apo të nisin një proces gjyqësor për të rrëzuar akuzat penale.

Ushtrim

Përdorni nxitjen e mendimeve të pjesëmarrësve me pyetje përgjigje në lidhje me si mund të mbyllet intervista përzgjedhëse, duke marrë shkas nga lojrat me role. Plotësoni përgjigjet me informacionin si më lart.

5.7 Vlerësimi – informacion për trainuesin

Në disa intervista me karakter më zyrtar, ju mund të keni mundësi që të shpenzoni më shumë kohë për të vlerësuar atë që sapo dëgjuat. Megjithatë, në disa intervista përzgjedhëse, kjo kohë mund të jetë shumë e kufizuar.

Vlerësimi i intervistave përzgjedhëse mund të jetë i vështirë, pasi do t'ju duhet të merrni një vendim duke qenë në terren, me informacion të pakët, dhe duke ditur se nuk do të keni më rast ta takoni personin serish, në qoftë se nuk ndërmerrni një veprim.

Kur bëni vlerësimin e intervistës, merrni parasysh si vijon:

- Përpiquni që të vlerësoni në vazhdimësi, përgjatë gjithë intervistës.
- Në rast se nuk jeni i kenaqur me atë që ju kanë thënë, komentojeni me kolegët tuaj.
- Analizoni nëse tregimi që dëgjuat përputhet ose jo me rrethanat e tjera, si për shembull, me kushtet fizike dhe mendore të personit, apo provat e marra në vendin që janë gjetur.

Ushtrim

Pyeteni të gjithë grupin pjesëmarrës se cili është mendimi/vlerësimi i tyre i përgjithshëm mbi rastin për të cilin u realizua dhe u diskutua loja me role.

A sugjeron intervista që personi është një viktimë e TQNj?

Cilat janë argumentet mbështetëse për këtë vlerësim?

Cili do të jetë veprimi që do të ndërmarrin ata në vijim?

Në rast se ata mendojnë se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për të treguar se rasti me të cilin janë ndeshur është një rast TQNj, dhe për rrjedhojë, nuk mund të marrin një veprim të drejtpërdrejtë, atëherë kërkoni se cili do të ishte veprimi që do të duhet të kryejnë.

Ushtrim

Ky ushtrim u përdor gjatë fazave pilot të hartimit të materialit mësimor. Ai mund të përdoret ose si një mjet formues ose si përmbledhje në fund të mësimit.

Identifikoni gjashtë pjesëmarrës për të luajtur rolin e ‘pasagjerëve’.

Shpjegojni secilit pjesën që do të luajë në lojë dhe çfarë do t’u thotë rojeve/policëve të kufirit etj. Duhet të ketë disa dallime midis tregimeve të çdonjërit dhe për secilin mund të jenë si më poshtë:

- Një person, pa arsim profesional, udhëton me pak të holla drejt një vendi ku ai/ajo ka shpresë të gjejë punë.
- Një person me arsim profesional (elektriçist, hidraulik, etj.) që kthehet nga pushimet në vendin e punës ku ai/ajo punon prej tre vitesh.
- Një person me aftësi profesionale, i cili po udhëton drejt një vendi me një kontratë nga agjencia e punësimit.
- Një person me aftësi profesionale pa kontaktë pune, por me një plan për t’u kthyer brenda një muaji në rast se ai/ajo nuk do të gjejë punë, dhe me të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar fjetjen dhe biletën e kthimit, nëse do të jetë rasti.
- Një person jo profesionist që ka marrë rrugën në përgjigje të një njoftimi në internet për punë si punëtor ndërtimi. Ai/ajo nuk ka kontratë pune, por vetëm një numër telefoni për ta kontaktuar, kur të mbërrijë në destinacion.
- Një person jo profesionist me një kontratë pune, që përmban një specifikim jo realist të punës në krahasim me aftësitë konkrete të tij/të saj dhe me kushte pune tepër të mira pune.

Më pas, pjesës tjetër të klasës duhet t’i jepen shpjegime për rolet që do të luhen (“Kemi të bëjmë me një tren/autobuz që lëviz nga pika “X” tek pika “Y”, etj.) dhe t’u thuhet që ata duhet të bëjnë një intervistë të shpejtë përzgjedhëse të secilit personazh në ‘tren/autobuz’.

Ndani klasën në çifte. Secili çift duhet të ketë parasysh mësimin mbi intervistën përzgjedhëse dhe se duhet të përgatitin intervistimin e njërit prej udhëtarëve në ‘tren/autobuz’.

Pasi të kenë kaluar pesë minuta, kërkoni që secili nga çiftet e krijuara të marrë në intervistë njërin nga ‘pasagjerët’.

Plotësoni me pyetje përgjigje shpjegimet që jep secili çift, pasi të kenë mbaruar intervistimet e ‘pasagjerëve’.

6. Aneksi A – shembuj pyetjesh që mund të përdoren për intervistat përzgjedhëse

6.1 Pyetjet për fazën e rekrutimit

- Çfarë ju është thënë rreth punës që do të bënit?
- Çfarë përvoja keni për të kryer këtë lloj pune?
- Çfarë page/kushtesh pune ju kanë ofruar për këtë punë?
- Si e morët vesh që ofrohet ky vend pune?
- Në rast se ju ka folur dikush rreth këtij vendi pune, kush ishte ai person?
- Si jeni marrë vesh për këtë vend pune: duke takuar personin, me telefon, me mesazh në celular, me e-mail?
- Në rast se keni dëgjuar për këtë punë nëpërmjet një njoftimi, ku e keni gjetur këtë njoftim? Çfarë thuhej në atë njoftim? A ju ndodhet ai njoftim akoma?
- Kush paguan për udhëtimin tuaj për tek vendi i ri i punës?
- Në rast se nuk e paguani ju, kush e paguan? Çfarë ju është thënë për kthimin nga ana juaj e të hollave të kësaj pagese?
- Çfarë ju është thënë në lidhje me nisjen/rrugën që do të bëni/mjetin e transportit që do të përdoret?
- Kur do të niseni?

6.2 Pyetjet për fazën e transportit

- Me kë jeni duke udhëtuar?
- Si i kanë emrat?
- Si i keni njohur ata?

- Keni të holla me vete?
- Sa?
- Ia keni dhënë paratë tuaja ndonjërit që t'ua mbajë?
- Kush e pagoi biletën tuaj?
- A keni dokumente udhëtimi (biletë, etj.)?
- Në rast se nuk i keni ju, a e dini se kush i ka?
- Në rast se ndonjë tjetër person i ka dokumentet e udhëimit, kur ia dhanë atij personi?
- Keni me vete ndonjë dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë, etj.)?
- A mund të më thoni çfarë rruge ndoqët deri këtu?

6.3 Pyetjet për fazën e shfrytëzimit

Çfarë lloj pune keni bërë?

- Çfarë lloj pune keni bërë më parë?
- Cila nga këto punë ju ka pëlqyer më shumë?
- Cilat ishin anët e mira dhe ato të këqija të atyre punëve?
- Përsa kohë punuat në secilën nga to?
- Kur e mbyllët punën si _____ (plotësoni llojin e punës që kanë thënë)?
- Çfarë keni bërë midis mbarimit të një pune dhe fillimit të tjetrës?
- Çfarë pune bëni tani?
- Këto janë të gjitha punët që keni bërë deri tani?
- Më duket një punë interesante. A mund të më flisni më gjatë për të?
- A i përgjigjet kjo lloj pune asaj që mendonit se do të bënit para se të vinit këtu? (Në rast se përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është 'Jo', atëherë pyeteni 'Përse nuk punove në atë punë, edhe kur erdhe këtu?').

Sa janë paguar?

- Çfarë pune bëni? Duket si një punë e vështirë. Sa para merrni për atë lloj pune?
- Sikur të mund të kurseni ca para, çfarë do të bënit me to?
- Sa e largët është për ju kjo mundësi? A ju duhen pak apo shumë të holla për ta realizuar dëshirën tuaj?
- A keni patur mundësi të lini ca të holla menjanë qëkur filluat këtë punë?
- Po të kishit pak para menjanë, për çfarë do të dëshironit t'i shpenzonit ato?
- Kush ju a mban paratë në rast se kurseni pak?
- Sa ju paguajnë për punën që bëni?

Kushtet e punës

- Në ç'orë filloni punën në mengjes?
- Kur mbaroni?
- Ku shkoni për të ngrënë?
- Çfarë ushqimi ju pëlqen në vendin e punës?
- Çfarë bëni gjatë kohës së pushimit?
- Gjatë pushimit të drekës, çfarë bëni me të mbaruar ushqimin?
- Më flisni pak për vendin tuaj të punës. Sa i madh është? Çfarë pamje ka?
- Çfarë ndodh në një ditë të nxehtë apo të ftohtë? A ka freskues apo ngrohës?
- Duhet të keni etje kur punoni nëpër fusha. Si arrini ta shuani etjen?
- Sa zgjat pushimi juaj?
- A mund të largoheni nga fabrika / bari / restoranti ku punoni gjatë pushimit të ditës?

Liria e lëvizjes

- Çfarë keni dëshirë të bëni gjatë ditës së pushimit?
- Kush ju shoqëron?
- Çfarë blini zakonisht?
- Çfarë keni blerë qëkur keni ardhur këtu?
- A dilni ndonjëherë vetëm?
- Çfarë lloj ushqimi ju pëlqen? Ku është restoranti më i afërt që e shërben këtë ushqim? A keni qenë atje? Kur ishte hera e fundit që keni shkuar në një restorant?
- A frekuentoni ndonjë xhami / kishë / tempull? Cilin nga këto? Kur i organizojnë atje shërbimet fetare, lutjet, etj.? Kur ishte hera e fundit që keni qenë atje?

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Objektivat mësimore	5
1.2	Audienca e synuar	5
1.3	Njohuritë e mëparshme	6
2.	Përkufizimi i rrezikut.....	7
2.1	Kohëzgjatja.....	7
2.2	Mësimdhënia	7
2.3	Informacioni për trainuesin	7
3.	Matrica e 'vlerësimit të rrezikut'	11
3.1	Kohëzgjatja.....	11
3.2	Mësimdhënia	11
3.3	Informacioni për trainuesin	11
4.	Vlerësimi dinamik i rrezikut	13
4.1	Kohëzgjatja.....	13
4.2	Mësimdhënia	13
4.3	Informacion për trainuesin	13
5.	Rreziku i trafikimit	14
5.1	Kohëzgjatja.....	14
5.2	Mësimdhënia	14
5.3	Informacion për trainuesin	14
6.	Asgjë nuk është e përkryer	19

1. Hyrje

Vlerësimi i nivelit të rrezikut është shumë i rëndësishëm për rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj). Çdo person që angazhohet në luftën kundër TQNj ka nevojë të jetë i ndërgjegjësuar rreth procesit, në mënyrë që ata të mund të ofrojnë një kontribut të bazuar mbi informacionin e duhur, kur atyre do t'u kërkohet që të veprojnë.

Vlerësimi i rrezikut në fushën e TQNj është, ndoshta, një detyrë veçanërisht e ndërlikuar në disiplinat e drejtësisë penale dhe në ato të lidhura me të. Shpesh ndeshen shumë individë të angazhuar e të shpërndarë në zona të ndryshme gjeografike (përfshirë edhe në vendet e huaja), të cilët shfrytëzojnë njerëzit e frikësuar që mund të mos duan të bashkëpunojnë me ju.

Megjithatë, parimet bazë janë të thjeshta dhe janë diçka që ne i ndjekim në jetën tonë të përditshme në të gjitha aspektet e jetës sonë. Ky plan mësimor i ndihmon studentët të përftojnë njohuri të mira rreth asaj se çfarë janë duke kryer realisht, dhe si mund të përdoren në kontekstin e TQNj.

Treinuesve u këshillohet që këtë plan mësimor të mos e trajtojnë si mësim “më vete”. Ky subjekt duhet të preket vazhdimisht dhe të trajtohet gjatë mësimëve të tjera të këtij programi, të ushtrimeve me rastet dhe studimeve të rasteve.

1.1 Objektivat mësimore

Me përfundimin e këtij moduli, studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të mbajnë mend parimet bazë të Vlerësimit të Rrezikut.
- Të shpjegojnë se çfarë nënkuptojnë termat: ‘Largo’, ‘Zvogëlo’, ‘Menjano’ dhe ‘Transfero’.
- Të përshkruajnë një ‘matricë të vlerësimit të rrezikut’.
- Të shpjegojnë konceptin e ‘vlerësimit dinamik të rrezikut’.
- Të zbatojnë parimet e vlerësimit të rrezikut në një situatë TQNj me anë të një ushtrimi simulimi.

1.2 Audiencia e synuar

Ky mësim është i përshtatshëm për çdo person që mund të ndeshet me TQNj gjatë punës, përfshirë:

- Punonjësit socialë.
- Personelin e OJQ-ve.
- Policët.
- Prokurorët.
- Anëtarët e gjyqësorit.

Mësimi përmban një numër ushtrimesh që lidhen me format dhe kontekstet e ndryshme të TQNj, që mund të mos jenë shumë të afërta me profesionet e mësipërme. Programi ofron një seri të gjërë ushtrimesh të tjera që mund të përshtaten me profesionin e ndjekësve të programit duke përdorur parimet bazë të këtij plani mësimor.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Nuk kërkohet zotërimi i njohurive të mëparshme.

2. Përkufizimi i rrezikut

2.1 Kohëzgjatja

20 – 25 minuta.

2.2 Mësimdhënia

Metoda e rekomanduar e shpjegimit të kësaj pjese të mësimit është paraqitja didaktike dhe ushtrimet.

2.3 Informacioni për trainuesin

Rreziku përkufizohet si një mundësi e lindjes së një kërcënimi për sigurinë dhe e pasojave që mund të ketë, nëse lind.

Vetë vlerësimi i rrezikut është identifikimi i rreziqeve; se sa të rënda do të ishin pasojat e lindjes së tij, dhe se cili do të jetë plani i mëtejshëm i veprimit.

Ndonëse vetë shprehja ‘vlerësimi i rrezikut’ mund të mos jetë familjare për ju, ky është një proces të cilin e ndeshni shumë shpesh gjatë ditës, madje më së shumti pa vetëdije. Gjatë jetës së përditshme ky proces nuk ka nevojë të jetë një proces i vetëdijshëm, sepse vetë jeta ju ka mësuar si të ndjeni rrezikun dhe si ta menjanoni apo si të merreni me të. Në përgjithësi, ky proces në përditshmërinë tuaj është shumë efektiv; po të mos ishte kështu, ju mund të mos ishit tani këtu. Problemi i vërtetë lind atëherë kur ju ndesheni me një rrethanë për të cilën nuk keni përvojë, ose kur një diçka e re, e panjohur, hyn në mjedisin tuaj.

Për shumë praktikantë, trafikimi njerëzor ka shumë mundësi që të përbëjë një nga këto përvoja/probleme të reja. Duke qenë se është i ri dhe i ndërlikuar, ka mundësi që të mos jeni në gjendje t'i analizoni/vlerësoni si duhet dhe me efektivitet rreziqet që ky trafikim paraqet.

Ushtrim – Kapërcimi i rrugës

Ky ushtrim përdor situata me të cilat ndeshemi përditë për të pasqyruar konceptin e vlerësimit të rrezikut, se si mund të ndryshojë natyra e rrezikut, dhe se si duhet trajtuar ky rrezik. Dhe kjo arrihet mjaft lehtë në mjedisin e klasës.

Megjithëse ushtrimi duket i lehtë dhe gazmor, ai përmban një mesazh serioz dhe shërben si një hyrje e përshtatshme për ta përvetësuar këtë koncept, dhe përvoja ka treguar që ai të jep dorë për ta zbatuar këtë në skenarët e TQNj.

Ju mund ta përdorni këtë si ushtrim në klasë, ose mund ta tregoni si histori.

Kërkoni nga klasa që të dalin tre vullnetarë.

Dy do të jenë kalimtarët, ndërsa i treti do të jetë shoferi i makinës.

I shpjegoni klasës se janë në një vend ku makinat lëvizin në krahun e majtë (Mbretëria e Bashkuar, Australia, India, Japonia, etj.).

Njeri nga kalimtarët është nga ai vend, tjetri është një vizitor nga një vend ku makinat lëvizin në krahun e djathtë të rrugës (SHBA, Gana, Franca, Serbia, etj.).

(Ju mund ta ndryshoni skenarin e majtë/e djathtë sipas vendit ku jeni).

Të dy kalimtarët janë gati të kapërcejnë rrugën.

Shoferi po nget makinën drejt dy kalimtarëve.

U thoni kalimtarëve që të shikojnë në drejtimin nga presin që të lëvizë trafiku.

Kalimtari që shikon në drejtimin e duhur qendron në trotuar, kalimtari që shikon në drejtimin e gabuar, ‘goditet nga makina’.

Nuk ka rëndësi nëse kalimtarët diskutojnë se cili ishte drejtimi nga duhet të kishin parë, apo nëse komente të ngjashme vijnë nga audienca – ju mund ta përdorni këtë moment për të gjeneruar më shumë energji në klasë, duke u kërkuar të shprehin argumentet e tyre përse mendojnë kështu dhe jo ndryshe, etj.

Tani mund të trajtoni konceptin, si vijon:

- Kush ose çfarë ishte në rrezik?
- Cili ishte rreziku?
- Sa serioz ishte rreziku?
- Çfarë veprimi duhet ndërmarrë? Largo, Prano, Pakëso, Menjano, Transfero?

Kjo mund të realizohet ose duke paraqitur informacionin e mësipërm në mënyrë didaktike, ose duke lehtësuar ushtrimin “Kapërcimi i rrugës”, në këtë mënyrë:

Pyetja: Kush ose çfarë ishte në rrezik?

Përgjigja:

- Kalimtarët.
- Ndoshta shoferi.
- Ndoshta përdoruesit e tjerë të rrugës dhe dëshmitarët.

Pyetja: Çfarë është rreziku?

Përgjigja:

- Lëndimi fizik dhe psikologjik i shoferit.
- Dëmtimi i makinës.
- Vonesat ndërkohë që policët merren me ngjarjen, aksidentin rrugor.
- Kostot e hetimit të aksidentit.
- Kostot e zhdëmtimit, trajtimi i palëve të dëmtuara.
- Trauma e shkaktuar dëshmitarëve.
- Lajm i keq për industrinë e turizmit.

Pyetja: Cili është niveli i rrezikut?

Përgjigja:

- Niveli i rrezikut është i ndryshëm midis dy kalimtarëve, sipas ngjarjes së treguar.
- Niveli i rrezikut do të ishte i njëjtë për të dy, nëse do të goditeshin nga makina – mund të kishin pësuar ndonjë dëmtim të lehtë, ose rreziku do të ishte fatal për të dy.
- Ndryshimi qendron në gjasën e rrezikimit të secilit vizitor.
- Një banor i vendit ku udhëtohet në të majtë, do të shikonte me shumë mundësi dhe automatikisht djathtas, do të kishte më shumë mundësi që ta vinte re makinën, dhe të menjanonte në këtë mënyrë rrezikun.
- Vizitori nga një vend ku udhëtohet djathtas, do të shikonte, me shumë gjasë, majtas, nuk do ta vinte re makinën, do të goditej dhe do ta pësonte goditjen.

Pyetja: Çfarë do të duhet të bëjë kalimtari që vjen si vizitor nga një vend ku udhëtohet majtas?

- Ta largojë
- Ta pranojë
- Ta zvogëlojë
- Ta menjanojë; dhe

- Ta transferojë vetë rrezikun?

Përgjigjet:

Ta largojë

Ai/ajo thjesht mund të mos kishte udhëtuar në ato vende ku udhëtohet majtas (pra, largohet ideja e udhëtimit në atë vend).

Ta pranojë

Ai/ajo thjesht mund të kishte shkelur në rrugë me shpresën se nuk do të ketë trafik në atë moment, ose që shoferi do ta vinte re, ose që makina do të ecte me shpejtësi të vogël dhe të mos shkaktonte dëmtime (pra, pranon të veprojë me idenë se do të mund të shmangë rrezikun).

Ta zvogëlojë

Ai/ajo mund të ishte mësuar dhe ndërgjegjësuar, se në cilin drejtim lëviz trafiku në vendin që viziton. Ai/ajo edhe mund të harrojë për një moment dhe në mendje t'i mbetet ajo që ka mësuar nga përditëshmëria në vendin e tij/të saj, por kjo ka pak mundësi që të ndodhë.

Ta menjanojë

Ai/ajo mund të përdorë kryqëzimet e rregullta të rrugës, nënkalimet, urat, etj., ose thjesht mund të merrte një taksì për të menjanuar rreziqet.

Ta transferojë

Kalimtari mund të mos jetë në gjendje që t'i largojë/transferojë të gjitha rreziqet, por disa nga to, po. Për shembull, po të kishte marrë një taksì, disa nga rreziqet me të cilat do të ndeshesh në rast se do t'i duhej të paguante shpenzimet e spitalit në rast aksidenti, do t'i transferoheshin sigurimeve shëndetësore të shoferit të taksisë.

Ju veproni vetëm mbi bazën e njohurive që keni

Vini re, ju mund të merrni vendim në lidhje me rrezikun vetëm duke e vënë atë në balancë me informacionin që keni, ose me informacionin që normalisht pritët të merret nga ju.

3. Matrica e 'vlerësimit të rrezikut'

3.1 Kohëzgjatja

10-15 minuta, në varësi nëse do të përdoret edhe ushtrimi.

3.2 Mësimdhënia


Metoda që rekomandohet për trajtimin e kësaj pjese të sesionit është një kombinim midis prezantimit didaktik dhe një ushtrimi.


3.3 Informacioni për treinuesin


Një mjet i dobishëm për të vlerësuar nivelin e rrezikut është 'matrica e vlerësimit të rrezikut'.

Niveli i rrezikut

	1	2	3	4	5
Mundësia e rrezikut	2	4	6	8	10
	3	6	9	12	15
	4	8	12	16	20
	5	10	15	20	25

 Rrezik i ulët

 Rrezik i mesëm

 Rrezik i lartë

Siç mund ta vini re, aksi vertikal shënon 'sa gjasë' ka që të ndodhë diçka, ndërsa aksi horizontal shënon nivelin e rrezikut të pasojave të një ndodhie. Numrat janë shumëfishe të kolonave që vijjnë nga lart dhe poshtë kalojnë në të majtë. Pra, niveli më i ulët i rrezikut është: pika 1 për nivelin e rrezikut dhe 1 për mundësinë që të ndodhë – 1 x 1 është baraz më 1. Niveli më i lartë i rrezikut është 5 x 5, d.m.th. 25.

Vini re edhe ngjyrimet e secilit seksion. Madje, edhe nëse gjasa që të ndodhë një ngjarje është e lartë, aty ku çiftohet me një nivel shumë të ulët të nivelit të pasojës, rreziku i përgjithshëm mbetet thuajse i tërë i gjelbër; i njëjti arsyetim zbatohet aty ku niveli i rrezikut është i lartë, por mundësia që të ndodhë ai rrezik është shumë e ulët.

Kombinimi i ngjyrave dhe i pikëzimeve lejon që të perceptohen me sy nivelet e rreziqeve dhe të bëhen krahasime midis niveleve të rrezikut për rreziqet që keni identifikuar tashmë.

Ushtrim

Ftojini të gjithë studentët të përdorin 'matricën e vlerësimit të rrezikut' për personazhet e ushtrimit 'Kapërcimi i rrugës', që u trajtua më lart.

4. Vlerësimi dinamik i rrezikut

4.1 Kohëzgjatja

Afërsisht 10 minuta.

4.2 Mësimdhënia

Prezantim didaktik.

4.3 Informacion për trainuesin

Vlerësimi dinamik i rrezikut (i cili njihet edhe si 'vlerësim i vazhdueshëm i rrezikut') është procesi i vlerësimit të vazhdueshëm, pra se si mund të ndryshojë vlerësimi i rrezikut në varësi të mbledhjes së informacionit dhe zhvillimit të ngjarjeve.

Ka shumë rëndësi që rreziku të vlerësohet vazhdimisht në rastet e TQNj, pasi rrethanat që e karakterizojnë atë mund të ndryshojnë shumë shpejt.

Sigurisht që nuk është e lehtë të jepen udhëzime për çdo situatë të mundshme, por këtu po japim disa ilustrime:

- Niveli i rrezikut të një sulmi është i lartë në rastin kur trafikanti i dyshuar ka një karakter të dhunshëm dhe ka sulmuar viktimën, apo ka një histori rastesh të tjera të dhunës dhe është në gjendje të lirë.
- Viktima është larguar në një vend sekret dhe të sigurt; në këtë rast niveli i përgjithshëm i rrezikut të një sulmi zvogëlohet.
- Një banor i strehëzës është dëgjuar duke folur në telefon duke përshkruar vendin ku ndodhet strehëza; niveli i rrezikut të sulmit bëhet më i lartë.
- Analiza e telefonatës së këtij banori tregon se ai/ajo ka kontaktuar trafikantin e dhunshëm, që është ende në gjendje të lirë; niveli i rrezikut të sulmit tanimë është i lartë, dhe ka shumë mundësi që të ngjasë.
- Personi u arrestua afër strehëzës, u padit dhe u ndalua në pritje të procedimit; niveli i rrezikut të sulmit u zvogëlua.

5. Rreziku i trafikimit

5.1 Kohëzgjatja

Afërsisht 45 minuta.

5.2 Mësimdhënia

Metoda e rekomanduar e trajtimit të kësaj pjese të sesionit mësimor është një kombinim midis prezantimit didaktik dhe një ushtrimi.

5.3 Informacion për trainuesin

Kush apo çfarë rrezikohet?

(Vini re, lista e mëposhtme nuk është një listë shterruese)

- Viktimat e TQNj.
- Familjet e viktimave.
- Çdokush që angazhohet me hetimin e rastit, dhënien e ndihmës, etj.
- Dëshmitarët.
- Arritja e një rezultati të sukseshëm nga hetimi.
- Besimi i viktimave të mundshme, që mund të kishin bashkëpunuar.

Cili është rreziku?

(Vini re, lista e mëposhtme nuk është një listë shterruese)

- Sulmi ndaj/kanosje të viktimave të TQNj ose të familjeve të tyre nga kriminelët.
- Kërcënimi i dëshmitarëve.
- Kriminelët do të vazhdojnë të viktimizojnë njerëz të tjerë, në rast se nuk dënohen.
- Nuk do të kemi dëshmi nëse viktimat/dëshmitarët humbasin besimin te sistemi.
- Refuzimi ose izolimi i viktimave në rast se kthehen në shtëpi pa një mbështetje.
- Kriminelët do të zbulonin teknikat hetimore, të cilat do të kompromentoheshin.

Cili është niveli i rrezikut?

Kjo varet nga një numër faktorësh, përfshirë këtu edhe përgjigjet ndaj pyetjeve të mëposhtme:

- A ka mundësi që kriminelët të arrijnë deri te viktima ose familja e saj/e tij?
- Sa të dhunshëm janë kriminelët?
- Si është gjendja shëndetësore e viktimës(ave)?
- Si është gjendja psikologjike e viktimës(ave)?
- Në rast se zbulohet një teknikë hetimore, sa të rënda do të ishin pasojat për të ardhmen?

(Vini re, kjo listë nuk është një listë shterruese)

Çfarë veprimi duhet ndërmarrë?

Kjo varet nga të gjithë faktorët e mësipërm, shembujt përfshijnë:

- Vendosja e viktimave të dyshuara të TQNj në vende të sigurta strehimi, si dhe marrja e masave të tjera për mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Ofrimi i këshillimit dhe i trajtimit mjeksor për viktimat e traumatizuara/të dëmtuara.
- Paraqitja e kërkesës për ndalimin e të dyshuarve.
- Ofrimi i mbështetjes për viktimat e TQNj që kthehen në shtëpi.
- Ofrimi i lehtësive për dëshmitarët/viktimat për të dhënë dëshminë e tyre nëpërmjet videove, ose në mënyrë anonime.
- Përdorimi i metodave për të ruajtur teknikat hetimore që përdoren, për shembull, kontaktimi i viktimave të dyshuara nën pretekstin e operacioneve rutinë të zbatimit të ligjit.

(Edhe këtu, lutemi vini re që kjo listë nuk është shterruese).

Ushtrim – Realizimi i vlerësimit të rrezikut në TQNj

Pjesa 1

Ky ushtrim përdor Ushtrimin me Rastin 5, 'Ferma', për të parë si mund të vihen në jetë parimet e vlerësimit të rrezikut.

Ndani klasën në grupe të vogla.

Shpërndani pjesën e parë të ushtrimit të rastit dhe kërkoni nga grupet që të identifikojnë, si më poshtë:

- Kush osë çfarë rrezikohet?
- Cili është rreziku?
- Cili është niveli i rrezikut?
- Çfarë veprimi duhet ndërmarrë? Largo, Prano, Zvogëlo, Menjano, Transfero?

Treinuesi:

Kush ose çfarë rrezikohet?

- Rreziku më i madh u kanoset njerëzve në fermë.
- Mund të rrezikohen edhe njerëzit që i blejnë patatet.

Cili është rreziku?

Në këtë fazë, rreziku më i madh duket se është përkeqësimi i shëndetit të njerëzve në fermë, ata nuk kanë ndonjë veshje speciale për punën që bëjnë, nuk kanë mjetet e duhura higjienike (tualetet, lavamanë për t'u larë) dhe ata, gjithashtu, jetojnë e flejnë në kushte të papërshtatshme. Ata mund të dëmtohen ose të marrin ndonjë sëmundje. Përveç këtyre, aty është vendosur dhe një pajisje teknike, nga e cila mund të dëmtohen apo të marrin ndonjë infeksion.

Rreziku për shëndetin publik mund të mos konsiderohet si një rrezik i menjëhershëm në rrethanat që paraqiten. Në rast se njerëzit përpunojnë ushqimin në një vend ku nuk kanë tualetet apo mjetet e duhura për respektimin e pastërtisë dhe higjienës, duket se ka një rrezik për përhapjen e sëmundjeve tek personat që e konsumojnë atë ushqim.

Mund të ketë edhe shumë rreziqe të tjera, por duke u bazuar vetëm mbi çfarë kemi vëzhguar nuk mund të jemi të sigurt për të tjerat. Kjo nuk do të thotë që ne duhet ta pranojmë situatën, përkundrazi. Rrethanat sugjerojnë që duhen bërë kërkime të ndryshme para se të kryejmë një vlerësim të suksesshëm të rrezikut.

Cili është niveli i rrezikut?

Është vështirë të përcaktohet niveli i rrezikut mbi bazën e informacionit që ofrohet. Për shembull, mund të jetë që vendi ku flihet të mos jetë i përshtatshëm, por që nuk paraqet një rrezik real për shëndetin. Faktorët që mund të ndikojnë mbi nivelin e rrezikut dhe ta ndryshojnë atë janë kushtet mbizotëruese të klimës, atëherë duhet patur parasysh se për cilën periudhë të vitit bëhet fjalë, si është lloji i 'shtretërve', çfarë përdoret për mbulesë, si është sistemi hidraulik i ndërtesës, etj. Një shtrat i thatë dhe i pastër ka shumë pak gjasë që të shkaktojë dëmtime, dhe niveli i rrezikut është i ulët. Në të kundërt, një vend i lagur dhe i pisët, ka gjasë për një nivel shumë të lartë të rrezikut.

Shqetësimi më i madh është mungesa e tualetit dhe e pajisjeve higjienike. Kjo mund të vlerësohet me një kontroll më të hollësishëm të vendit dhe intervistim të të pranishmëve.

Çfarë veprimesh duhen ndërmarrë?

Përsëri, kjo do të varet nga çfarë do të gjeni me saktësi dhe realisht. Nëse rezulton se nuk ka pajisjet e duhura higjienike, atëherë duhet marrë seriozisht në konsideratë që njerëzit të **largohen** nga ajo situatë. Kjo realizohet pavaresisht nëse kemi të bëjmë apo jo me trafikim njerëzor. Mund të jetë që pajisjet higjienike të mos jenë të përsosura, por të jenë të përshtatshme, dhe në këtë rast, mund të **pranohet** kjo situatë / ky "rrezik". Po ashtu, mund të jetë e nevojshme që të sugjerohen masa të thjeshta, duke **zvogëluar** në këtë mënyrë një rrezik.

Edhe nëse nuk është TQNj, përsëri do të ketë nevojë për një veprim nga agjencia përkatëse për të pakësuar rrezikun si për punëtorët, ashtu dhe për publikun.

Pjesa 2

I kujtoni grupit që një nga punëtorët deklaroi gjatë intervistës përzgjedhëse se njeriu që flet gjuhën e vendit, i ka kërcënuar disa herë duke u thënë që nëse 'sillen keq', do ta pësojnë me 'këtë', dhe kjo 'këtë' është një shkop bejzbolli, me të cilin ai vjen vërdallë dhe herë pas here e përplas atë pas dyshemesë. Punëtori ua tregon oficerëve të policisë vendin ku mbahet shkopi i bejzbollit.

Oficerët intervistojnë burrin që ka shkopin e bejzbollit. Ai jep emrin e tij, të cilin oficerët e kontrollojnë në sistemin e të dhënave inteligjente. Ata i kërkojnë këtij burri të zbrasë xhepat. Kur zbrasen, në xhepat gjinden një numër kartash identiteti të personave që ishin intervistuar më parë. Një nga ato kartat ka foton e tij, por me emër tjetër. Kur kontrollohet emri në sistem, del që ky person ka qenë dënuar për ushtrim dhune.

Kush ose çfarë rrezikohet?

- Punëtorët e fermës.
- Hetimet e ardhshme.

Cili është rreziku?

- Del që punëtorët në fermë janë në rrezik të paktën nga një pasojë psikologjike për shkak të kërcënimeve, të kombinuara me sjelljen e dhunshme të atij burri dhe me historikun e tij si i dënuar për ushtrim dhune.
- Hetimi në të ardhmen rrezikohet sepse nëse oficerët e policisë nuk janë duke marrë masa efektive ndaj këtij personi, atëherë dëshmitarët e mundshëm sigurisht që do të frikësohen dhe, ka shumë të ngjarë që të mos bashkëpunojnë më.

Cili është niveli i rrezikut?

- Po e theksojmë përsëri, është e vështirë të vlerësohet me saktësi të plotë cili është niveli i rrezikut. Megjithatë, është e qartë që ka gjasa të dëmtimit të mundshëm, dhe niveli i kërcënimit është mjaft i lartë, pasi janë identifikuar disa prova rreth dhunës dhe se kjo dhunë mund të shkaktojë pasoja serioze.
- Mbani parasysh, se rreziqet e mundshme të identifikuara më parë, në një fazë më të hershme, ende mbeten si të tilla edhe në një fazë të mëvonshme.

Çfarë veprimi duhet ndërmarrë? Largo, Prano, Zvogëlo, Menjano, Transfero?

- Ju mund të mendoni që ta **largoni** rrezikun që paraqet njeriu që bënte kërcënime. Këtë mund ta arrini duke e arrestuar/ndaluar atë. Në këtë fazë, ende nuk është e qartë nëse kemi të bëjmë me rast të TQNj (megjithëse, sa më shumë të dhëna mblidhen, aq më shumë duket se kemi të bëjmë pikërisht me një rast të tillë), por këtu të paktën kemi të bëjmë me siguri me një rast dhune.
- Ju mund të këni mundësinë që ta **largoni** rrezikun duke i dërguar punëtorët në një vend të sigurt. Megjithatë, kjo do të nënkuptojë që ju të keni tashmë një vend ku t'i dërgoni këta punëtorë. Hapësirat për strehim janë të pakëta dhe shpesh të padisponueshme për viktimat e dyshuara të TQNj për shfrytëzimin e punës. Në rast se ju i largoni viktimat e dyshuara nga ai vend dhe ata nuk kanë se ku të qendrojnë, apo me se të ushqehen, ata mund të pësojnë edhe nga disa rreziqe të tjera, përfshirë dhe ri-trafikimin.

6. Asgjë nuk është e përkryer

Ka rëndësi të mbahet parasysh që asnjë sistem i vlerësimit të rrezikut nuk mund të jetë i përkryer, në mënyrë të veçantë po të flasim për një kontekst aq të ndërlikuar si ai i TQNj.

E vetmja gjë që mund të bëni është që të përpiqeni ta kryeni detyrën tuaj sa më mirë dhe të realizoni, ashtu siç pritet nga ju, një vlerësim të ndershëm të rastit.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat e mësimdhënies	6
1.3	Njohuritë e mëparshme	6
2.	Ndikimi i TQNj mbi viktimat e tij	7
2.1	Kohëzgjatja	7
2.2	Mësimdhënia	7
2.3	Informacioni për trainuesin	7
3.	Nevojat e viktimës.....	11
3.1	Kohëzgjatja	11
3.2	Mësimdhënia	11
3.3	Informacioni për trainuesin	11

1. Hyrje

Kuptimi dhe trajtimi i nevojave të viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj) është i një rëndësie të madhe për cilindo që është i përfshirë në luftën kundër kësaj dukurie.

Së pari, të ndihmuarit e viktimave të krimit është një domosdoshmëri dhe nevojë bazë njerëzore, pasi viktimat duhet të marrin veten nga pasojat që le krimi mbi ta, të zhvillojnë potencialin e tyre njerëzor dhe të kontribuojnë në shoqëri.

Së dyti, veçanërisht në rastin e TQNj, trajtimi dhe ardhja në ndihmë të viktimës mund të jetë një detyrim specifik ligjor.

Së treti, për sistemin e drejtësisë penale, ekziston një konsideratë praktike, sipas së cilës, në rast se nuk merreni me nevojat e viktimës, mund të mos arrini të keni një dëshmitar/e dhe për rrjedhojë nuk do të keni dhe as një rast hetimi e gjykimi.

Megjithëse në shumicën e rasteve ekzistojnë individë dhe agjenci që kanë një rol specifik për t'u ardhur në ndihmë viktimave, është përgjegjësia e gjithsecilit që të ofrojë ndihmë që nga momenti kur identifikohet një viktimë e mundshme. Në rast se nuk jepet kjo mbështetje e shpejtë, viktimat mund të kthehet në gjendjen e të pambrojturit dhe/ose të mos japë informacion dhe të dhëna të dobishme.

Për të kuptuar se si mund të trajtohen nevojat e viktimës, ka rëndësi të kuptohet fillimisht ndikimi që ka ushtruar TQNj mbi viktimat e tij, dhe si realizohet ky ndikim. Për këtë arsye, pjesa e parë e këtij mësimi merret me një vëzhgim mbi ndikimin që ushtron TQNj mbi viktimat.

Pjesa e dytë merret me domethënien e këtyre efekteve për profesionistët anti-TQNj dhe eksploron disa hapa praktikë për trajtimin e tyre.

1.1 Audiencia e synuar

Ky mësim është për cilindo që mund të ndeshet me TQNj gjatë rrjedhës normale të punës së tij/të saj, përfshirë:

- Oficerët e policisë.
- Rojet e kufirit.
- Inspektorët e punës.
- Punonjësit socialë.
- Inspektorët e shëndetësisë dhe të sigurisë.
- Punonjësit e arsimit.

1.2 Objektivat e mësimdhënies

- Të listojë sfidat me të cilat përballen viktimat e trafikimit.
- Të identifikojë se kush mund të ndihmojë viktimat.
- Të sqarojë se si ndihma për shërimin fizik dhe psikologjik të viktimës do të ndihmojë që ai/ajo të marrë pjesë në procesin e drejtësisë penale.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Nuk kërkohet ndonjë njohje e mëparshme e lëndës.

2. Ndikimi i TQNj mbi viktimat e tij

2.1 Kohëzgjatja

30 minuta.

2.2 Mësimdhënia

Paraqitja didaktike e “informacionit për treinuesin”.

2.3 Informacioni për treinuesin

Faktikisht të gjitha qeniet njerëzore kanë përjetuar ndonjë ngjarje traumatike: vdekja e një të dashuri, ndonjë dëmtim për shkak të një aksidenti, humbja e vendit të punës, etj. Për shumicën e njerëzve, trauma është një dukuri jetë-shkurtër. Ata e marrin veten nëpërmjet proceseve natyrale të shërimit psikologjik të trurit, mbështetjes së të afërmëve dhe miqve, dhe rehabilitimit fizik.

Por, rekuperimi prej traumës bëhet i vështirë në rast se mbi personin ndikojnë një numër faktorësh. Në disa raste, individët mund të jenë të predispozuar ndaj traumës, mund të kenë pësuar ndonjë traumë të hershme, veçanërisht në rastet kur ata kanë përjetuar ngjarje të dhimbshme në të kaluarën, nga të cilat nuk e kanë marrë veten plotësisht. Disa situata lufte, për shembull, mund të prodhojnë ngjarje të shumëllojta me ndikim të fortë traumatik. Disa situata të tjera, mund të mos kenë këtë intensitet, por mund të zgjasin në kohë. Abuzimi në familje, për shembull, mund të paraqitet në formën e një seri incidentesh, të cilat po të merren veç e veç, mund të mos duken traumatike. Megjithatë, në kombinim me njëri tjetrin dhe po të vazhdojnë gjatë, mund të jenë tepër traumatizuese.

Thelbi i traumës është se “ajo mposht mekanizmat rregullues psikologjikë dhe biologjikë të viktimës. Kjo ndodh kur burimet e brendshme dhe të jashtme të individit janë të papërshtatshme për të mposhtur kërcënimin e jashtëm”.³

Të qenit viktimë e TQNj është në vetvete një ngjarje shumë traumatike. Më poshtë trajtohen faktorët që kontribuojnë në shkaktimin e kësaj traume.

³ UNODC. Manuali i anti-trafikimit njerëzor për praktikantët e drejtësisë penale – Moduli 3: Reagimet psikologjike të viktimave të

Ngjarjet

Përvoja e një viktime të TQNj ka mundësi të jetë me ngjarje si të paparashikueshme ashtu dhe të pakontrollueshme. Natyra e procesit të 'rekrutimit' për TQNj është se viktima 'parashikon' se diçka do të ndodhë (p.sh. "do të kem punë me një rrogë të mirë") që në fakt nuk ndodh (ato nuk fitojnë asgjë). Paparashikueshmëria do të mbetet një karakteristikë e të gjithë procesit të TQNj.

Humbja e kontrollit mbi jetën e tyre është, po ashtu, një element kyç. Viktimat ka të ngjarë që të mendojnë (dhe shpesh atyre kështu u thuhet) se do të kenë kontroll mbi veprimet e tyre, mbi jetën e tyre ("Do të kem mundësi të jetojë siç bëj normalisht) kur, në fakt, ato do të qendrojnë nën kontrollin e plotë të të tjerëve ("Nuk duhet të largohesh nga ky vend, dhe do të bësh atë çfarë do të thonë").

Masat e kontrollit

Viktimat mund të kontrollohen në mënyra të ndryshme, përfshirë kufizimin e lëvizjes, ushtrimin mbi to të dhunës dhe të abuzimit.

Të gjitha këto terma duhet të përvetësohen gjërësisht, dhe ato janë shpesh të ndërlidhura. Për shembull:

- 'Lëvizja' mund të kufizohet me anë të vendosjes së masave fizike, si mure, dryna, tela me gjemba. Lëvizja mund të kufizohet edhe me anë të kërcënimeve, përdorimit të dhunës mbi viktimat ose familjet e tyre, kërcënimit se do të kallëzohen tek autoritetet për "krimin" që kanë bërë, ose se do t'u hiqen 'privilegjet'.
- 'Dhuna' mund të marrë formën e një sulmi të drejtpërdrejtë fizik, kërcënimesh verbale, dhunës ndaj të tjerëve, madje edhe në formën e përmendjes së mundësisë së përdorimit të dhunës.
- 'Abuzimi' mund të marrë shumë forma, duke filluar nga ushtrimi i dhunës deri tek poshtërimi i përhershëm dhe goditja e ndjenjës së vetë-respektit të personit.

Trauma shumëfishe

Një aspekt i rëndësishëm i traumatizimit të viktimave të TQNj është karakteri i saj shumëfish: ekzistojnë shumë ngjarje traumatizuese të formave nga më të ndryshmet. Disa nga to do të ishin të vetëmjaftueshme për të shkaktuar traumë (një përdhunim, ose një aksident i rëndë industrial, për shembull), por kur këto ndodhin të kombinuara me efektet e tjera të TQNj, trauma bëhet shumë më e rëndë.

Pra, cilat janë pasojat e këtij traumatizimi?

Simptomat e traumës

Më poshtë do të ndeshemi me simptomat që janë identifikuar në rastet e TQNj. Duhet të vihet në dukje që studimet e hershme u përqendruan kryesisht mbi viktimat e TQNj për shfrytëzimin seksual. Megjithatë, studimet më të vonshme kanë gjetur simptoma të ngjashme tek viktimat e formave të tjera të TQNj. Simptomat e identifikuar janë:

- Të njëkohshme.
- Fizike.
- Mendore.
- Çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD)

Të njëkohshme

Kjo ka të bëjë me praninë e llojeve të shumta të simptomave në të njëjtën kohë. Studimet kanë treguar se gati gjysma e viktimave të TQNj për shfrytëzim seksual, për shembull, mund të përjetojnë 12 simptoma të ndryshme fizike deri në 14 ditë pas përvojës së TQNj. Kjo më pas fillon të ulet, por edhe pas 28 ditësh, 7 përqind nga to ende përjetojnë 11 simptoma të ndryshme.

Fizike

Nga simptomat më të shumta të raportuara të TQNj për shfrytëzim seksual, ishin:

- Lodhja.
- Humbja në peshë.
- Simptomat neurologjike (shqetësime të sistemit nervor, si dobësim muskular, konfuzion, dhimbje).
- Problemet gastrointestinale (dhimbje stomaku dhe barku).

Mendore

Nga simptomat të raportuara më shpesh dhe të vëzhguara rreth shëndetit mendor janë:

- Depresioni.
- Ankthi.
- Armiqësia.

Çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD)

Ky çrregullim është një çrregullim i shëndetit mendor i shkaktuar nga ekspozimi ndaj një ose një numri më të madh ngjarjesh traumatike.

Pasojat e identifikuara të PTSD përfshijnë:

- Kujtime të përsëritshme të ngjarjeve traumatike.
- Shenja pagjumësie.
- Nuk është në gjendje që të përjetojë emocione.

Ekziston një dallim midis një PTSD 'të thjeshtë' dhe 'komplekse'. PTSD e thjeshtë është produkti i një ngjarjeje të vetme traumatike; PTSD komplekse është produkti i ngjarjeve shumëfishe.

Viktimat e TQNj kanë prirje të vuajnë nga PTSD komplekse, pasi ata/ato përjetojnë shpesh ngjarje shumëfishe traumatizuese.

Simptomat e PTSD kanë prirje të ulen me kalimin e kohës, megjithëse kjo varet nga rrethanat dhe nga individi përkatës. Ai edhe mund të shfaqet përsëri në rastet e një stresi.

Siç u vu në dukje më lart, është ende duke u mbledhur informacioni mbi TQNj për shfrytëzim seksual (thujse ekskluzivisht të grave), gjë që sugjeron se rastet e PTSD ende ndeshen ndër këta individë.

Ushtrim

Ky ushtrim duhet të trajtohet me shumë kujdes e ndjeshmëri.

Kërkoni nga të gjithë studentët të reflektojnë mbi një ngjarje traumatike në jetën e tyre. Mund të ketë ndodhur diçka në jetën e tyre personale dhe profesionale.

U thoni atyre se nuk do t'u kërkohet që të diskutojnë rreth tyre.

Lejoni një minutë për një reflektim të heshtur.

Kërkoni nga studentët të reflektojnë mbi ndikimin që ka patur ajo ngjarje mbi jetën e tyre. Dhe tani kërkoni që ata të mendojnë se cili do të ishte ndikimi nëse do të përjetonin një ngjarje të dytë traumatike të jetës së tyre në po të njëjtën kohë, ose shpejt menjëherë pas ngjarjes së parë.

Ky ushtrim ka shumë mundësi që të krijojë një atmosferë reflektimi dhe qetësie në klasë.

Kërkoni nga studentët se çfarë do të ishte e dobishme, sipas mendimit të tyre, për t'u ardhur në ndihmë personave që kanë kaluar trauma. Mbani shënim sugjerimet sipas mënyrës suaj dhe gjallëroni diskutimet me ndërhyrjet tuaja.

3. Nevojat e viktimës

3.1 Kohëzgjatja

30 minuta.

3.2 Mësimdhënia

Paraqitja didaktike e 'informacionit për trainuesin'.

3.3 Informacioni për trainuesin

Parimet e përgjithshme të përmbushjes së nevojave të viktimës janë:

- Viktimat e trafikimit duhet të identifikohen si viktima të krimit.
- Ata/ato nuk duhet të trajtohen si kriminelë.
- Ata/ato nuk duhet të trajtohen vetëm si një burim provash.

Identifikimi i personave si viktima

Ky është një element kritik i veprimtarisë anti-TQNj dhe nuk është gjithmonë i lehtë për t'u arritur. Më poshtë jepen shembuj mbi rastet e dështimeve gjatë procesit të identifikimit:

- Kur mbrohet idea se gratë apo burrat të përfshirë janë 'thjesht prostituta' (duke përdorur një pikëpamje paragjyquese për personat që janë punëtorë seksi) dhe kur mbyllen sytë ndaj çdo treguesi të TQNj.
- Kur jepet përfundimi që një raport i krijuar për shfrytëzimin e punës është thjesht një çështje kontrate.
- Kur besohet që njerëzit janë 'të pazotë', 'pa shtëpi e katandi', 'pjanecë', 'të varur nga droga', dhe jo se janë persona të brishtë, të shfrytëzuar realisht si skllëvër.
- Kur pranohen ankesat se janë 'vjedhur' dhe akuza të tjera për krime nga punëdhënësit kundër 'punëmarrësve', pa bërë kërkime apo hetime.
- Kur trajtohen njerëzit si migrantë të parregullt dhe nuk hetohen rrethanat se përse këta njerëz ndodhen në një vend/lokal të caktuar.

Mos trajtimi i viktimave si kriminelë

Shumë viktimat të TQNj do të kenë kryer ndonjë 'krim' si pjesë e procesit të TQNj. Kjo mund të vijë si rrjedhojë e kalimit të paligjshëm të kufirit, të punës pa dokumentet e nevojshme, ose prej të qenit i/e shfrytëzuar për aktivitete të paligjshme, si lypja apo vjedhja.

Trajtimi i viktimave jo thjesht si burim prove

Viktimat e TQNj janë qartësisht një burim i rëndësishëm i provës. Dhe, në fakt, ata/ato janë prova më e rëndësishme. Në rast se ju nuk i trajtoni si qenie njerëzore dhe nuk përkujdeseni për nevojat e tyre bazike, ka mundësi që nuk do t'i keni më këto burime për një kohë të gjatë. Kjo ndodh sepse viktimat mund të mos bashkëpunojnë me procesin hetimor dhe/ose të refuzojnë të japin dëshmi në gjykatë.

Reagimi i sugjeruar

Reagimi në tërësi në lidhje me procesin që ndodh pas trafikimit duhet të synojë që viktimat të jenë sa më të sigurta që të jetë e mundur për jetën e tyre, dhe të ndihen jashtë rrezikut.

Më poshtë, jepen disa veprime kyç që duhet të ndërmerreni me qëllim që të arrihet ky objektivi.

Duhet të mbahet parasysh që struktura reaguese ndaj këtyre nevojave ndryshon nga një juridiksion në tjetrin, në varësi të burimeve të disponueshme, natyrës së rastit specifik dhe kërkesave të legjislacionit të vendit. Sugjerohet që në një numër rastesh të ndërmerren disa aksione të nevojshme (si për shembull, sigurimi i masave sociale mbështetëse), që mund të mos jenë të disponueshme formalisht. Kjo duhet të realizohet në një mënyrë që të mos shkelen ligjet e vendit dhe vetëm pas një vlerësimi të mirë të rrezikut që mund të vijë prej këtyre marrëveshjeve informale.

Faza e hetimit

- Që në fillim, vlerësoni rrezikun që ekziston për viktimën; vazhdoni të shqyrtoni rrezikun për gjatë gjithë kohës së trajtimit të rastit të viktimës.
- Vlerësoni gjendjen fizike dhe psikologjike të viktimës dhe siguron trajtimin përkatës për të sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Përdorni një gjuhë të thjeshtë e të qartë me viktimën dhe siguron që ai/ajo ju ka kuptuar.
- Shpjegoni se kush jeni dhe cili është roli juaj; veproni në mënyrë të ngjashme me të gjithë personat që janë përfshirë në proces.
- Shpjegoni se cilat janë të drejtat e tyre sipas sistemit të vendit. Shembujt përfshijnë lejen për të qendruar, të drejtën për të patur pranë një punonjësi social mbështetës dhe masat për strehimin/sistemimin e tyre.
- Edhe sikur të mos ketë një 'të drejtë', rregull specifik për mbështetje sociale, sidoqoftë përpiquni ta siguronit atë.
- Sa herë që të keni mundësi, jepni shpjegime për çfarë po ndodh dhe për shkakun se përse po ndodh.

- Kontrolli apo ekzaminimi mjeksor të bëhet vetëm me lejen e informuar të viktimës.
- Mos bëni premtime që nuk do të mund t'i mbani.
- Punoni me punonjësit e disiplinave të tjera për të planifikuar një metodë trajtimi realiste dhe shumë-disiplinore.
- Përdorni teknikat e duhura të intervistimit kur intervistoni viktimat e cënueshme.
- Njihuni me jurisdiksonin në vendin tuaj nëse parashikon tërheqjen e akuzës penale, kur përcaktohet që personi e ka kryer atë krim vetëm si viktimë e shfrytëzimit, pjesë e TQNj.
- Siguroni mbrojtje për dëshmitarët dhe (nëse është e nevojshme) familjen e tyre nëpërmjet marrjes së masave si, strehim i sigurt, mbajtja sekret e detajeve të vendstrehimit, planifikimi i ndihmës uirgjente, etj.

Para-gjykimi dhe gjykimi

- Vazhdoni me vlerësimin dinamik të rrezikut
- Vazhdoni të jepni shpjegime mbi çfarë është duke ndodhur, duke folur edhe për seancat dëgjimore, procesin gjyqësor (përfshirë, për shembull, masat mbrojtëse që merren si, lidhjet me ekran dhe video), kush do të jetë i pranishëm gjatë seancave dëgjimore, etj.
- Mbani hapur 'kanalet' e komunikimit përgjatë fazave të para-gjyimit dhe gjyimit.
- Me ndihmën e profesionistëve përkatës monitoroni gjendjen fizike dhe psikologjike të viktimës.
- Vazhdoni të punoni me praktikantët e fushave të tjera për të identifikuar nevojat specifike të viktimave individuale.
- Mund të ekzistojë një proces formal i ofrimit të mbështetjes sociale dhe praktike për viktimat e TQNj; në rast se nuk ekziston një i tillë, përpiquni ta siguroni atë.
- Ofroni një strehim që t'i përgjigjet nivelit të rrezikut me të cilin përballet viktimja.
- Në rast se po konsideroni që ta ktheni viktimën te vendi origjinë, shqyrtoni fillimisht rrezikun dhe vendosni nëse ekziston ose jo një mbështetje për viktimën atje, para së ta ktheni atë.
- Kujdesuni për elementet bazike, si për shembull si do të udhëtojë viktimja deri në gjykatë.
- Nëse viktimat janë të detyruara apo jo që të dëshmojnë në gjyq, kjo varet nga jurisdiksonet. Atje ku sistemi ligjor e lejon dhe viktimat refuzojnë të japin dëshmi, kjo duhet të respektohet. Në rast se sistemi ligjor parashikon që ata të japin dëshmi, ka rëndësi që kjo të shpjegohet mirë dhe të ofrohet e gjitha mbështetja e mundshme.

Pas-gjykimi

- Mbani parasysh që nevoja për të mbështetur viktimën vazhdon edhe pas mbarimit të procesit gjyqësor.
- Identifikoni dhe punoni me organizatat që ofrojnë shërbimet e përshtatshme të ri-integrimit dhe rehabilitimit.
- Siguroni një 'kanal' komunikimi për t'ua mundësuar viktimave që të raportojnë për çdo shqetësim të tyre, apo kërcënim të sigurisë së tyre.

Ushtrim

Ky ushtrim bazohet tek Ushtrimi mbi Rastin – Shtëpia publike.

Ky ushtrim mund të organizohet në grupe të vogla ose në të gjithë klasën.

Lexoni pjesën e parë të ushtrimit (deri tek 'Cilët janë treguesit e pranishëm në këtë rast?'), ose (më e këshillueshme) shpërndani kopje për të gjithë studentët që ta lexojnë vetë ushtrimin.

Kërkoni nga studentët që gjatë leximit të kenë parasysh pyetjet e mëposhtme:

- Në çfarë gjendje fizike mendoni se do t'i gjeni këto gra?
- Cilat janë simptomat e traumës me të cilat mendoni se do të ndesheni tek këto gra?
- Cilat do të ishin, sipas mendimit tuaj, 'nevojat e menjëhershme të viktimës'?
- Sipas natyrës së punës që bëni, si do t'i trajtonit ju këto nevoja?

Informacion për treinuesin për të gjallëruar diskutimet

(Shënimet e mëposhtme janë vetëm disa pika kyçe dhe nuk duhet të merren si pika shtruese).

- Duket sikur gratë nuk kanë kryer seks të mbrojtur. Ka shumë mundësi që të kemi të bëjmë me një rrezik të lartë të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.
- Kushtet e përgjithshme të lokalit duken jo të shëndetshme, kështu që gratë mund të vuajnë nga një sërë sëmundjesh dhe dobësisish që lidhen me këto kushte.
- Nga ajo çfarë mund të vemë re, duket se ushqimi që gjindet në këtë lokal është i papërshtatshëm, pra mund të gjejmë simptoma të kequshqyerjes.
- Ka shenja, prova të gjakut të gjendur në disa nga 'kabinat', gjë që mund të tregojë që disa (në mos të gjitha) gra janë dhunuar fizikisht.
- Ne ende nuk mund të shprehemi derisa t'i kemi intervistuar vetë gratë dhe të kemi marrë rezultatet e analizave mjeksore, por fakti që gratë jetojnë aty ku punojnë dhe se lokali duket të jetë me një 'volum të madh pune', do të thotë që ato do të kenë edhe simptomat e raskapitjes.

Trauma

- Megjithëse në këtë moment nuk mund të themi me saktësi se cila është situata e saktë, nëse viktimat kanë pranuar vetë, apo jo, gjithsesi duket që gratë janë trafikuar dhe janë përdhunuar shumë herë.
- Në varësi të kohës që ato kanë qendruar në atë lokal, ky numër mund të jetë me qindra, ose dhe me mijra herë.

- Për këtë arsye, ju keni mundësi që të dalloni praninë e simptomës PTSD, përfshirë kujtimet që u vijnë ndërmend në mënyrë përsëritëse, vështirësitë në gjumë dhe një farë mpirje, mos ndijim të emocioneve.
- Ato ka mundësi që të vuajnë dhe nga simptoma të tjera, përfshirë depresionin, ankthin dhe armiqtësinë ndaj të tjerëve.

Nevojat e menjëhershme

- Duket se vlerësimi i gjendjes fizike të çdo gruaje duhet të jetë prioriteti i parë në këtë rast, pra duhet të ndërmerret veprimi i trajtimit të tyre në aspektin fizik dhe shëndetësor.
- Kushtet e papastërtisë së lokalit sugjerojnë që sigurimi i veshjeve të pastra dhe i mundësive për larje për gratë do të jenë prioriteti i prioriteteve (pasi të vendoset nëse do të bëhen ekzaminime/analiza shkencore të mjedisit).
- Duhet të merret parasysh edhe nëse gratë janë ushqyer, kur dhe ku.
- Duke hamendësuar se kemi të bëjmë me TQNj, gratë duhet të zhvendosen në një vend të sigurt.
- Gratë mund të kenë edhe ankthe nga kërcënimet që mund t'u kanosen atyre, apo familjeve të tyre, ose që shfrytëzimi seksual i tyre do të bëhet një çështje publike ndër komunitetet e tyre.

Trajtimi i nevojave

- Është i një rëndësie vendimtare që grave t'u shpjegohet se çfarë do të ndodhë më pas.
- Kontrolli mjeksor duhet të realizohet me mundësinë e parë praktike (në varësi të pranimit nga ana e tyre).

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat e të mësuarit	5
1.3	Njohuritë e mëparshme	6
2.	Bashkëbisedimet	7
2.1	Çfarë është një bashkëbisedim?	7
2.2	Të folurit me radhë, temat dhe autoriteti.....	9
3.	PEACE.....	12
3.1	Shpjegimi i modelit PEACE	12
3.2	Cili është qëllimi i intervistës mbi bazën e provave?	12
3.3	Struktura krahasuese e bashkëbisedimeve me karakter të përgjithshëm dhe e intervistave PEACE	12
4.	Planifikimi.....	14
5.	Përfshirja dhe shpjegimi	19
6.	Tregimi	22
7.	Mbyllja.....	28
8.	Vlerësimi	29
9.	Vënia në praktikë	30

1. Hyrje

Intervistimi i viktimave, i dëshmitarëve dhe i të dyshuarve është një element kritik për çdo hetim krimi. Intervistimi mbi bazë provash mund të ketë diçka mistike rreth vetes dhe mund të shihet si një proces i ndërlikuar dhe sfidues për ata të cilëve do t'u duhet ta ndjekin.

Ky leksion ka për bazë filozofinë që i shikon intervistat mbi bazën e provave si një bisedë të thjeshtë, të zakonshme që bëhet për një qëllim të caktuar. Sapo studentët të kuptojnë se elementet e bisedave të përgjithshme që ata bëjnë shumë herë gjatë ditës, pra përvoja e fituar gjatë jetës së përditshme, do t'i ndihmojë të zhvillojnë intervistimin mbi bazë provash në mënyrë krejt të pavetëdijshme.

Sfidat e ndeshura nëpër intervistat e kryera në rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj) (në veçanti të viktimave) janë të ndryshme nga ato që ndeshen në rastet e krimeve të tjera. Ato janë të ngjashme më shumë me intervistat e bëra në rastet e përdhunimeve, abuzimeve seriale dhe të sulmeve të dhunshme. Problemet kryesore që dalin, janë:

- Krimet e TQNj mund të jenë shumë komplekse, dhe zgjasin shpesh për një periudhë të gjatë kohe, në shumë vende dhe me shumë individë të lidhur me krimin. Kjo do të thotë që janë të shumta ngjarjet që duhet të mbajë mend viktimat.
- Ndikimet traumatizuese të krimit të TQNj mbi viktimat, ndikojnë mbi aftësinë e tyre për të mbajtur mend ngjarjet.
- Metodot e kontrollimit të jetës së tyre nga ana e trafikantëve, si përfshirja e viktimave në veprime të paligjshme, shfrytëzimi i statusit të migrimit të paligjshëm, ose i pasojave që mund të kenë familjarët e tyre, mund të bëjnë që viktimat të mos thonë të vërtetën.
- Nëpërmjet një trajtimi dhe intervistimi të kujdesshëm dhe të ndjeshëm shpesh bëhet e mundur që të merret një rrëfim i vërtetë i ngjarjeve. Megjithatë, në rastet kur ky rrëfim ndryshon nga rrëfimi i dhënë më parë për ngjarjet, mund të shkaktojë probleme në fazën e seancave dëgjimore në gjyq.
- Kujdesi pas-intervistës është shumë i rëndësishëm, në rast se viktimat do të pranojnë të jetë dëshmitare për të dhënë provat në gjyq.

1.1 Audiencia e synuar

Leksioni synohet fillimisht për ata që kanë një rol në menaxhimin e hetimeve të TQNj, përfshirë:

- Cilindo që realizon intervistat e viktimave, të dëshmitarëve dhe të dyshuarve mbi bazën e provave .

1.2 Objektivat e të mësuarit

Në përfundim të këtij mësimi studentët do të jenë në gjendje të:

- Përcaktojnë objektivin e përgjithshëm të të gjitha intervistave të zbatuesve të ligjit.
- Identifikojnë pesë fazat e intervistës, të cilat janë:
 - Planifikimi dhe përgatitja.
 - Përfshirja dhe shpjegimi i procesit dhe i përmbajtjes.
 - Tregimi nga ana e viktimës/dëshmitarit.
 - Mbyllja e intervistës në mënyrën e duhur.
 - Vlerësimi i përmbajtjes së intervistës.
- Shpjegojnë përse duhen planifikuar më parë intervistat.
- Përshkruajnë hapat praktikë që duhen bërë për planifikimin e një interviste.
- Identifikojnë se si duhet të përfshihet një person në një intervistë mbi bazën e provave (qoftë një dëshmitar/e, qoftë një viktimë apo i/e dyshuar).
- Shpjegojnë se kur intervista duhet të kalojë në fazën e Tregimit.
- Shpjegojnë konceptin e 'kujtesës së lirë'.
- Identifikojnë se cilat do të jenë pyetjet e hapura, specifike, të mbyllura dhe ato sugjestionuese dhe të shpjegojnë dallimet midis tyre.
- Përshkruajnë se si duhet të mbyllet një intervistë.
- Identifikojnë hapat praktikë që duhen ndermarrë në ndihmë të vlerësimit të intervistës.
- Planifikojnë dhe përgatitin një intervistë të simuluar të një viktime/dëshmitari.
- Identifikojnë veprimet dhe mënyrat e duhura të përfshirjes dhe dhënies së shpjegimeve gjatë intervistave të viktimës/dëshmitarit.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Është e dëshirueshme që studentët të kenë përfunduar më parë Mësimin 3, 'Intervistat përzgjedhëse në rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore'.

Çfarë është një intervistim?

Intervistimi i viktimës, apo e një të dyshuari nga ana e oficerit të policisë, është në thelb një bashkëbisedim. Ndërkohë që ka disa dallime kyçe në krahasim me bashkëbisedimet që bëhen çdo ditë, intervistimi ka shumë më shumë ngjashmëri sesa dallime me bashkëbisedimet.

Me synimin që të bëheni një intervistues efektiv, fillimisht ju duhet të kuptoni se çfarë janë bashkëbisedimet; qëllimin, strukturën e tyre, si dhe teknikat e zotërimit të tyre. Meqenëse bëni me qindra, ose madje dhe mijra bashkëbisedime në ditë, ju e dini tashmë se çfarë do të thotë kjo për ju, apo jo? Në rast se jeni shumë të vetëdijshëm për to, atëherë ju do të arrini t'i realizoni ato si duhet; në rast se jeni si shumica prej nesh, ka mundësi që të mos arrini.

Ky leksion trajton fillimisht strukturën e bashkëbisedimeve të përgjithshme, në mënyrë që mësimet e përfuara këtu të zbatohen për një lloj më të specializuar intervistimi, atij të intervistës së kryer nga oficeri i policisë.

2. Bashkëbisedimet

2.1 Çfarë është një bashkëbisedim?

Ky seksion përmban informacion rreth rregullave bazë të një bashkëbisedimi. Qëllimi i tij është të nisë një proces të mësuarit ku të identifikohet se si transferohen komponentët e një bashkëbisedimi të përgjithshëm (të cilin e njeh dhe e praktikon secili nga ne) tek intervistat mbi bazën e provës. Me fjalë të tjera, duke u përqendruar mbi atë çka bëjnë njerëzit (pavarësisht se mund të mos jenë të vetëdijshëm për këtë) do të përpiqemi që të thjeshtojmë procesin e një intervistimi efektiv që bëhet mbi bazën e provës.

Këtu keni mundësi zgjedhjeje. Ose mund të zhvilloni e të lehtësoni një diskutim në të gjithë klasën, fillimisht, dhe më pas të kaloni tek ushtrimi 'Në vëzhgim të një bashkëbisedim', ose mund të nisni me ushtrimin dhe më pas me diskutimet.

Përvoja ka treguar se nisja me ushtrimin në fillim nxit energjitë në klasë dhe është i dobishëm për një farë thyerjeje akulli; ana e metë mund të konsiderohet që ndonjë pjesëmarrës mund të ngatërrohet disi.

Lehtësimit i diskutimit

Drejtohuni studentëve me pyetjen e mëposhtme:

Çfarë është një bashkëbisedim?

Një bashkëbisedim mundëson:

- Shkëmbimin e informacionit.
- Sinjalizon krijimin e një marrëdhënieje midis pjesëmarrësve (mund të përforcojë një marrëdhënie ekzistuese ose të vendosë një marrëdhënie të re).
- Është shumë më tepër se vetëm një fjalë e thënë, pasi ai nënkupton një sërë komunikimesh të tjera, jo verbale (Non Verbal Communications/NVC).

Si strukturohet një bashkëbisedim?

Çdo bashkëbisedim ka të njëjtën strukturë bazë:

- Hapja.
- Shkëmbimi.
- Mbyllja.

Rregullat bazë të një bashkëbisedimi janë:

- Kërkohej një bashkëpunim.
- Sinjalizohet bashkëpunimi.
- Nëse ti fillon, tjetri duhet të vazhdojë.
- Mbyllja nuk duhet të ngatërrojë apo të fyejë tjetrin.

Shembull

Dy vetë që e njohin njëri-tjetrin takohen në një korridor. Njëri thotë, 'Ç'kemi, si je?' Tjetri përgjigjet 'Mirë'. Në këtë rast nuk ka bashkëpunim, dhe përgjigja e personit të dytë dha sinjalin se ata nuk duan të bashkëpunojnë.

Dy vetë të tjerë takohen në korridor, njëri thotë, 'Ç'kemi, si je?'. Tjetri përgjigjet, 'Mirë, po ti?' Në këtë rast, është dhënë sinjali i bashkëpunimit. Personi i parë mund të kishte thënë thjesht 'Mirë', duke sinjalizuar që ata nuk duan që bisedimi të shkojë më tutje, por kjo do të tingëllonte jo normale dhe jashtë një farë 'rregulli' të pranuar përgjithësisht. Duke nisur kontaktin, këta persona sinjalizuan që duan të flasin; një ndërprerje e menjëhershme, etj., mund të jetë fyese.

Pavarësisht nga sa u tha realisht, komunikimi jo verbal mund të kundërshtojë dhe tejkalojë kuptimin e fjalëve të shprehura. Për shembull, 'Kalofsh mirë' është një frazë e këndshme dhe pozitive me të cilën mund të mbyllesh takimin, por po u tha duke nënqeshur dhe shtrëmbëruar fytyrën, do të përçojë një mesazh tërësisht të ndryshëm, madje mund të tingëllojë edhe si një kërcënim.

Ushtrim – vëzhgimi i një bashkëbisedimi

Zgjidhni dy pjesëmarrës dhe kërkoni që të bëjnë një bashkëbisedim.

Nxirrini 'bashkëbiseduesit' nga dhoma.

Propozoni bashkëbiseduesve temën mbi çfarë mund të flasin (për shembull) përse mbështesin një klub futbollit dhe jo një tjetër, apo lojtarin e tyre të parapëlqyer, apo çfarë u pëlqen në stilin e lojës së atij sportisti, etj.

Jepuni rreth 5 minuta që të vendosin së bashku. Në fund të bashkëbisedimit, secili nga bashkëbiseduesit do të dijë se cili është mendimi i tjetrit në lidhje me temën që diskutohet.

Ndani pjesën e mbetur të klasës në tri grupe dhe për secilin grup jepni një nga tri pyetjet e mëposhtme rreth bisedimit të dy bashkëbiseduesve:

- Si u hap biseda? (vëzhgo se në çfarë pozicionesh u vendosën të dy, se si u prezantuan, se si e trajtuan temën, etj.).
- Si u prezantuan temat e tjera? (të ftohen të tjerët për të bërë komentet e tyre).
- Cilat ishin komunikimet jo verbale të tyre gjatë bashkëbisedimit (qendrimi, xhestet e duarve, vështrimet, etj.)

U thoni vëzhguesve që ata duhet thjesht të vëzhgojnë. Nuk duhet të përfshihen në bisedë, dhe në rast se dëshirojnë, mund të mbajnë shënime.

Vendosni dy karrige pranë njëra-tjetrës, duke ruajtur një farë largësie.

Ftojini të dy bashkëbiseduesit brenda në dhomë, drejtojini nga karriget dhe u thoni të fillojnë bashkëbisedimin.

Ndalojini pas pesë minutash dhe jepni dy tre minuta për reflektim. Kjo kohë do të lejojë që bashkëbiseduesit të mendojnë nëse mësuan ndonjë gjë nga biseda midis tyre, ndërsa vëzhguesit do të kenë pak kohë për të reflektuar nëse arritën të gjenin përgjigje për pyetjen e shtruar për ta.

Pyetini bashkëbiseduesit nëse tani janë më të qartë mbi atë çfarë ‘mendon, ndjen’ partneri tjetër mbi temën e diskutuar? Kërkoni nga ata që të japin disa shembuj mbi atë që arritën të mësojnë.

Tani, zbuloni para të gjithë klasës se cilat ishin pyetjet që u dhanë vëzhguesve, për të cilat duhet të gjenin përgjigjet nga vëzhgimi i bashkëbiseduesve.

Kërkoni nga vëzhguesit të flasin për gjetjet e tyre.

Udhëzime shtesë

Pritet që të paktën diçka të dalë nga vëzhgimet, por edhe nëse në përgjithësi përgjigjet do të jenë të pamjaftueshme, dhe pa shumë hollësira, kjo do të vlejë për të arritur në një pikë, d.m.th. në atë që ne nuk përqendrohemi shumë në atë çfarë bisedojmë me tjetrin – bisedimet thjesht ndodhin. Ndërsa ne, si intervistues mbi bazën e provave, duhet të ndalojmë e të mendojmë më gjatë mbi bashkëbisedimin dhe si ndodh ai.

2.2 Të folurit me radhë, temat dhe autoriteti

Ky seksion trajton disa koncepte formale mbi si strukturohen bashkëbisedimet.

Shkëmbimi i vendeve

Një bashkëbisedim nënkupton, sigurisht, që informacioni të shkëmbehet me radhë, njëherë nga njëri, e pastaj nga tjetri. ‘Rregullat’ bazë të të folurit me radhë janë:

- Bashkëbiseduesit njëherë marrin radhën e të folurit, dhe pastaj atë të të dëgjuarit.
- Ndërrimi i vullnetshëm i radhës ushtron një farë presioni mbi dëgjuesin që ai të marrë radhën e të folurit.
- Refuzimi i ‘ofrimit’ të ndryshimit të radhës e kthen mbrapsht presionin mbi folësin e parë, dhe ai do të vazhdojë të flasë.

- Një ndryshim i pavullnetshëm i radhës, ku njëri ndërpret tjetrin, është si një kërkesë nga njëri që t'ia marrë 'fjalën' tjetrit.
- Presioni për të marrë 'radhën e të folurit', kur kjo ju sinjalizohet juve, është një shenjë pozitive.

Ndërrimi i radhës sinjalizohet sipas mënyrave të mëposhtme:

- Verbale – ndalimi i vullnetshëm i të folurit dhe kërkimi i një përgjigjeje nga tjetri, duke thënë si për shembull, "Po ti, çfarë mendon?"
- Jo-verbale – tundja e kokës, bërja e xhesteve, ndryshimi i shprehjes së fytyrës, afrimi ose largimi fizikisht nga pjesëmarrësit e tjerë, nxjerrja e tingujve të ndryshëm, pa nxjerrë ndonjë fjalë, etj.

Shpejtësia dhe shpeshësia e ndërrimit të radhës:

- Të rriturit, duke patur një përvojë të gjatë rreth bashkëbisedimit, i njohin mirë 'rregullat' e ndërrimit të radhës.
- Në një bashkëbisedim midis një të rrituri dhe një fëmije, një i rritur futet në mësim me pa vetëdije duke e marrë radhën pa prituri të mbarojë tjetri (ndoshta nga nervozizmi) dhe kështu ze pjesën më të madhe të kohës së të folurit, dhe përgjigjet që merr nga fëmija, janë të kufizuara.
- Një marrëdhënie e ngjashme si kjo, 'prind-fëmijë', mund të vëzhgohet midis 'njëzve me autoritet' (p.sh. policëve), kur ata intervistojnë persona që njerëzit 'me autoritet' i konsiderojnë si persona që nuk kanë autoritet.
- Kjo metodë mund të çojë tek pyetjet e mbyllura, të hamendjet dhe konfirmimi i tyre, etj.

Kontrolli dhe kujdesi

Gjithë pjesëmarrësit në bashkëbisedim marrin vendimin nëse ushtrojnë kontroll ose jo, nëpërmjet:

- Sigurimit të së drejtës për të folur.
- Zgjedhjes së temës së diskutimit dhe sigurimit të vazhdimësisë së tij.
- Kujdesjes – kujdesjes për veten – kujdesjes për personin tjetër.
- Vetes –përrjashton personin tjetër pa i lënë atij asnjë perspektivë.
- Të tjerëve – merr parasysh me vetëdije pikëpamjet e shprehura nga të tjerët, etj.

Zgjedhja e temës

Temat prezantohen duke bërë një koment, duke dhënë pikëpamjet e veta, ose duke shtruar një pyetje. Pas shkëmbimit të ideve mbi atë temë (që mund të vazhdojë për pak kohë), një nga pjesëmarrësit mund ta zhvendosë bisedën më tej duke prekur një tjetër temë.

Marrëdhëniet e autoritetit/pushtetit

Struktura e një bashkëbisedimi shpesh pasqyron marrëdhënien e autoritetit/pushtetit midis pjesëmarrësve. Ajo, madje, mund të përdoret (me vetëdije ose pa vetëdije) pikërisht për të përforcuar marrëdhënien e 'pushtetit'.

Zakonisht, një pjesëmarrës 'i pushtetshëm' do të marrë kohën më të madhe të të folurit, do të kontrollojë ndërrimin e 'radhës' dhe vendosë se çfarë temash diskutohen. Të marra së bashku, kjo ka shumë të ngjarë që të nxisë një sjellje prej të nënshtruarit nga ana e pjesëmarrësit më pak 'të pushtetshëm'.

Në rastin e policit, dalin në pah një numër çështjesh. Edhe kur nuk ka një sjellje aktive prej një 'pushtetari' nga ana e intervistuesit polic, vetë fakti që policët janë anëtarë të forcës së policisë do të nënkuptojë që ata, ka shumë mundësi, që të konsiderohen të pushtetshëm nga ana e personit që intervistohet. Dhe kjo mund të sjellë si pasojë që personi të përgjigjet me një farë nënshtrimi. Disa oficerë policie mund ta konsiderojnë veten si të 'pushtetshëm' dhe të ushtrojnë presion aktiv thjesht duke folur më të shumtën e kohës në dispozicion, etj. Madje, shumë nga ata mund të mendojnë se mënyra e të shprehurit të vetësigurisë së tepruar të çon drejt së vërtetës.

Në të kundërt, kjo mënyrë të foluri, mund të shkaktojë pasoja të rënda. Sa më shumë të flasë intervistuesi, aq më pak mundësi ka personi i intervistuar që të marrë fjalën. Në rast se intervistuesi merr më të shumtën e kohës, ka shumë pak gjasë që ai/ajo të dëgjojë edhe atë përgjigje që mund të vijë nga i intervistuari. Në këtë lloj rrethane, i intervistuari merr mesazhin e gabuar që ai/ ajo është aty, në atë vend, për të dëgjuar dhe jo për të folur. Dhe rezultati i përgjithshëm do të jetë që kjo do të zvogëlojë, madje edhe menjanojë tërësisht mundësinë e marrjes së informacionit nga personi i intervistuar.

Për këtë arsye, duhet të bëhet kujdes e t'i ofrohet mundësia të intervistuarit, që ta ketë të plotë kohën e të folurit, të zgjedhë temën për zgjidhjen e çështjes në fjalë.

Pra, intervistuesit duhet të jenë shumë të ndjeshëm e të kujdesshëm edhe ndaj ndikimit të 'marrëdhënies së pushtetit' dhe të marrin të gjitha masat e mundshme për ta pakësuar këtë ndikim. Në planin e ardhshëm mësimor, do të diskutohen disa nga mënyrat se si mund të realizohet kjo.

3. PEACE

3.1 Shpjegimi i modelit PEACE

PEACE është një akronim që përdoret si shkurtim i metodës së intervistimit, e përdorur kryesisht nga zbatuesit e ligjit. Ky akronim zërthehet, si vijon:

- Planifikimi dhe përgatitja (**P**lanning and preparation)
- Përfshirja dhe shpjegimi (**E**ngaging and explaining)
- Tregimi (**A**ccount)
- Mbyllja (**C**losure)
- Vlerësimi(**E**valuation)

3.2 Cili është qëllimi i intervistës mbi bazën e provave?

Intervistat mbi bazë provash janë bashkëbisedime të strukturuar që bëhen për një qëllim të caktuar – për të mësuar një ngjarje (ose seri ngjarjesh) nga viktimat, dëshmitarët ose të dyshuarit. Informacioni i përftuar nga kjo intervistë përdoret së bashku me informacionet e tjera për të vendosur rreth drejtimit që do të ndërmerret veprimi, si akuzimi i një personi për një krim, zhvillimi i intervistave të tjera, apo i kërkimeve të mëtejshme.

Edhe në ato raste kur rezultati i një interviste nuk pranohet drejtpërdrejt si provë (për shembull, kur disa kërkime policore të fazës së parë bëhen nëpër disa jurisdiksione, ose kur intervistat bëhen nga agjenci të tjera pa një rol të drejtpërdrejtë në të, të zbatuesve të ligjit), është një praktikë e mirë që të ndiqet modeli PEACE dhe udhëzimet mbi zbatimin e këtij modeli, që jepen në këtë plan mësimor.

Një intervistë mbi bazë provash nuk është një përpjekje për të siguruar një rrëfim nga viktimat, apo për të siguruar një histori që të 'përputhet' me provat e tjera, ose të konfirmojë paragjykimet apo stereotipat e krijuara nga intervistuesi.

3.3 Struktura krahasuese e bashkëbisedimeve të përgjithshme dhe e intervistave PEACE

Struktura e intervistave PEACE është e ngjashme me atë të bashkëbisedimeve të përgjithshme, përveç disa elementesh specifike shtesë.

Faza	Bashkëbisedimi	Intervista PEACE
Para	<p>Planifikimi</p> <p>Ndoshta mund të kërkohet, por, zakonisht, bëhet fare pak planifikim i vetëdijshëm.</p>	<p>Planifikimi</p> <p>Kërkon një planifikim të vetëdijshëm bazuar mbi informacionin në dispozicion.</p>
Në fillim	<p>Hapja</p> <p>Mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të qëllimit të bisedës, pjesëmarrësve dhe marrëdhënieve.</p>	<p>Përfshirja dhe shpjegimi</p> <p>Duhet të jepet një informacion specifik rreth qëllimit të intervistës, të dhënave mbi intervistuesin, etj., por edhe në përputhje me normat shoqerore për të patur biseda të frytshme dhe pozitive.</p>
Në mes	<p>Shkëmbimi</p> <p>Duhet respektuar normat shoqerore për të treguar gatishmërinë për shkëmbim, bashkëpunim, dëshirë për të vazhduar bisedën, etj.</p> <p>Në shumë raste, faza e shkëmbimit mund të sinjalizojë marrëdhëniet e pushtetit.</p> <p>Nganjëherë bashkëbisedimi është i strukturuar sipas temave, por shpesh herë nuk është i tillë.</p>	<p>Tregimi</p> <p>Duhet ndjekur normat bazë shoqerore, por duhet respektuar dhe marrë në konsideratë dhe planifikuar ndërrimi i radhës, etj.</p> <p>Duhet përdorur, në veçanti, teknika të tilla si ngadalësimi i të folurit, ofrimi i kontrollit atij që intervistohet, nxitja e kujtesës së lirë për ngjarjet duke përdorur pyetje lehtësuese, etj.</p> <p>Tregimi duhet të strukturohet sipas planifikimit dhe informacionit që përftohet gjatë përparimit të bisedës.</p>
Në fund	<p>Mbyllja</p> <p>Mund të marrë forma të ndryshme. Ajo shënon fundin e bisedës, mund të përmbledhë rezultatin ose të forcojë marrëdhënien.</p>	<p>Mbyllja</p> <p>Duhet të respektojë format shoqerore, por edhe të përmbajë informacionin specifik mbi çfarë do të ndodhë më pas dhe duhet t'i japë intervistuesit një mundësi dhe siguri që problemet do të ndiqen.</p>
Më pas	<p>Vlerësimi</p> <p>Mund të bëhet formalisht, por më së shumti ndodh që përmbajtja e bashkëbisedimit ose nuk vlerësohet me vetëdije, ose vlerësimi është i brendshëm dhe jo formal.</p>	<p>Vlerësimi</p> <p>Duhet bërë me vetëdije, të jetë specifik për të identifikuar nëse u arritën objektivat dhe cilat janë mundësitë hetimore. Vlerësimi duhet përdorur si bazë për intervistat e ardhshme.</p>

4. Planifikimi

Duhet të planifikoni (sa më mirë që të jetë e mundur) të gjitha fazat e intervistës. Sigurisht, ajo që do të thuhet nga personi i intervistuar gjatë intervistës, mund të ndryshojë planin e parapërgatitur, por ekzistojnë shumë aspekte të intervistës që, gjithsesi, duhet të planifikohen paraprakisht. Këtu përfshihet gjetja e informacioneve ekzistuese dhe identifikimi i problemeve me interes, si për shembull i disa çështjeve praktike të tilla, si pajisjet e përdorura, etj. Duhet të planifikohet se cili do të jetë qendrimi që do të mbahet karshi të intervistuarit, cilat do të jenë temat e përgjithshme dhe specifike që lidhen me, apo janë të nevojshme për t'u diskutuar në rastin në fjalë.

Çështjet praktike

Përfshijnë:

- Për çfarë bëhet fjalë deri në këtë pikë, pra çfarë informacioni disponohet deri këtu?
- Çfarë kërkojmë të dijmë?
- Ku do të realizohet intervista?
- Kush do ta bëjë intervistën?
- Si do të bëhet regjistrimi i saj?

Historia e rastit deri në këtë pikë

Historia e rastit përftohet duke përdorur një numër burimesh, përfshirë rrethanat në të cilat u gjetën individët, vendin ku u gjetën, në ç'kushte ishin kur u gjetën, çdo gjë që mund të kenë thënë para këtij momenti, çfarë sendesh zotëronin, etj.

Çfarë kërkojmë të dijmë

Ky është synimi i intervistës. Përgjithësisht, objektivi parësor do të jetë të përftojme një histori sa më të ndershme e të saktë të mundshme të rastit. Në disa rrethana mund të ketë disa objektiva parësore, për shembull, kur besohet që njerëzit janë në rrezik të një dëmtimi serioz dhe kur besohet që intervista mund të jetë në gjendje që t'i lokalizojë këto rreziqe. Është e qartë se edhe në këtë rast historia që tregohet duhet të jetë e sinqertë, por këtu objektivi parësor është përqendrimi fillimisht tek lokalizimi i atyre rreziqeve.

Ka shumë mundësi që të ketë një numër objektivash specifike, si identifikimi i rolit që ka një i dyshuar i veçantë, identifikimi i sistemeve të komunikimit, dhe përcaktimi nëse është mbajtur nën kontroll personi, dhe në ç'mënyrë.

Një tjetër praktikë e mirë është identifikimi i çdo 'pyetjeje të rëndësishme që do të vijë në ndihmë të hetimit' (më me hollësi më poshtë), si për shembull pyetjet që nevojiten për të provuar një akuzë, ato që nevojiten për të sqaruar çdo dykuptimësi apo problem që mund të ndihmojë të mblidhet informacion rreth lëvizjeve të individëve kyçë për rastin që diskutohet.

Ku do të realizohet intervista?

Kjo mund të jetë e përcaktuar nga legjislacioni i vendit dhe rrethanat tuaja. Minimumi bazë që duhet të sigurohet për vendin ku do të bëhet intervista, përfshin:

- Sa më i pastër dhe i rehatshëm që të jetë e mundur,
- I pajisur me tavolina dhe karriget e mjaftueshme, etj.
- Sa më larg ndonjë shqetësimi të mundshëm.
- I pajisur me mjetet e punës, në respektim të legjislacionit dhe udhëzimeve, etj.

Kush do ta bëjë intervistën?

Edhe kjo do të përcaktohet nga një kombinim i legjislacionit dhe rrethanave të veçanta të vendit ku ndodheni. Rekomandohet, si më poshtë:

- Në rastin më të mirë, duhet të bëhen të paktën dy intervista.
- Intervistuesit duhet të trajnohen si duhet, për shembull, për intervistimin e viktimave të cënueshme.
- Intervistuesit duhet të shfaqin sjelljet e duhura ndaj të intervistuarve.

Gjinia e intervistuesit përbën një problem, që ka kohë që debatohet fort nëpër rrethet e anti-TQNj. Në disa jurisdiksione, ky nuk përbën problem sepse legjislacioni e diktton se si duhet vepruar (d.m.th., duke folur në përgjithësi, kur të intervistuarat janë femra, intervistat duhet të bëhen nga intervistuese femra). Në ato raste kur ka mundësi zgjedhjeje, disa debatues argumentojnë që burrat duhet të intervistojnë gratë, me arsyetimin se disa gra u përgjigjen më mirë intervistuesve burra se sa gra. Ndërkohë që ky arsyetim mund të ketë një farë vlere, konsensusi i përgjithshëm është që mundësisht femrat të intervistohen nga femrat, veçanërisht kur ka gjasë se mund të zbulohen informacione intime rreth veprimtarisë seksuale.

Si do të bëhet regjistrimi?

Kjo është një tjetër çështje që do të përcaktohet nga kombinimi i legjislacionit me rrethanat e ngjarjes. Disa konsiderata kyçe në këtë pikë do të jenë:

- Çdo lloj regjistrimi elektronik ul presionin mbi intervistuesin dhe mundëson që intervistat të vazhdojnë në mënyrë të 'lirshme'.

- Regjistrimet kapin reagimet, gjë që është një ndihmesë për seancat dëgjimore në gjyq (megjithëse, varet edhe nga lloji i reagimit, që mund të rezultojë ndonjëherë edhe si disavantazh).
- Regjistrimi elektronik (veçanërisht një video) mund të lejojë njohjen e personit që po intervistohet, ose të paktën që i intervistuari mund të ndjejë frikë nga identifikimi.
- Edhe në rastet kur përdorni forma të ndryshme regjistrimi, është praktikë e mirë që të mbahen shënime rreth pikave kyçe që përmenden nga i intervistuari, pasi mund të jetë shumë e vështirë që të kapen ato edhe njëherë tjetër, sidomos kur bëhet fjalë për regjistrime shumë të gjata.

Qendrimi

Për një çast përqendrohuni mbi qendrimin që do të mbani gjatë intervistës. Kjo nënkupton edhe si do ta qetësoni personin në mënyrë që dhe ju të keni mundësinë më të mirë për të përfutur një rrëfim sa më të saktë e të plotë që të jetë e mundur.

Qendrimi që kërkohet në këtë rast është shumë i ngjashëm me qendrimin që mbahet gjatë bashkëbisedimeve. Disa persona, si për shembull, bashkëbiseduesit e aftë, duket se i bëjnë këto veprime instiktivisht. Më poshtë do të bëjmë një ushtrim të vogël për të kuptuar se cili mund të jetë një qendrim i përshtatshëm.

Ushtrim – Qendrimi

Qëllimi i këtij ushtrimi është, sigurisht, të demonstrojmë qendrimet e përshtatshme që duhen mbajtur për një intervistë. Ky ushtrim do të demonstrojë, gjithashtu, se sa rëndësi ka që proceset e përdorura në këtë ushtrim të arrijnë të qetësojnë situatën.

Ky ushtrim ka mundësi që të shkaktojë pak humor – por ky është, pjesërisht, edhe synimi i tij, i cili pasohet edhe me ndonjë koment mbi të. Humori është pozitiv, por duhet të menaxhohet me qëllim që humori i tepërt të mos të pengojë marrjen e mesazhit serioz të këtij sesioni.

Kërkoni nga të gjithë të pranishmit që të buzëqeshin.

Ka shumë mundësi që disa të fillojnë të qeshin. Atyre duhet t'u thuhet që të buzëqeshin dhe jo të qeshin. Kjo duhet bërë me qetësi, si për të qetësuar studentët ashtu dhe për të demonstruar ndikimin qetësues që ka buzëqeshja mbi të tjerët. Trainuesi mund të demonstrojë 'buzëqeshjet' e sforcuara, ekstreme, për të treguar se cilat janë qartësisht buzëqeshjet e sforcuara dhe të pavërteta.

Më pas, trainuesi do t'u kërkojë atyre që të tregojnë diçka të trishtueshme; dhe në këtë rast ata duhet të duken të shqetësuar.

Ajo çfarë do të tregohet duhet të jetë pak e trishtë, p.sh. "Unë nuk fjeta dot mbrëmë, sepse nuk më la lehja e një qeni". Këtu mund të ketë përsëri vend për pak humor, si dhe një mundësi për të eksploruar dhe demonstruar nivelet e ndryshme të shqetësimit të shprehur.

Kërkoni nga të gjithë studentët që të marrin një qendrim të lirshëm.

Duart duhet të mos mbahen afër gojës, krahët duhet të mos mbahen të kryqëzuara mbi gjoks, dhe duhet të qendrohet drejt, jo shtrembër, por dhe jo duke e tepruar me qendrimin 'gatitu'.

Treinuesi mund të dëshirojë të lëvizë nëpër klasë, duke marrë qendrimet të ndryshme – ose shumë afër studentëve, ose tepër larg, duke qendruar shtrembër, apo gatitu, etj., duke i pyetur studentët se me cilin qendrim ato ndihen më mirë. Kjo duhet të vazhdojë përsa kohë të arrihet me konsensus se cili është qendrimi i duhur. Treinuesit mund të zgjedhin të tregojnë përrallën Godilocks (vajza dhe tre arinjte) – duke u ndalur në të tri situatat me të cilat vajza Godilocks ndeshet kur hyn në shtëpinë e tre arinjve para se të gjejë se cili është për të opsioni më i mirë, ose opsioni i tretë.

Studentëve do t'u kërkohet më pas që të marrin pozicionin më korrekt ndaj një partneri.

Zgjidhni një student/e dhe uluni para tij/saj në një pozicion të lirshëm, të qetë.

Kërkoni personit t'ju thotë se çfarë mendon rreth një teme neutrale, p.sh. si është koha, cili është ushqimi i preferuar, etj.

Ndërkohë që personi është duke folur, përkuluni përpara dhe afrojeni shumë.

Kërkoni nga grupi që të shpjegojnë se çfarë jeni duke bërë dhe çfarë bëhet mirë, apo gabim.

Pastaj, kërkoni nga studentët që të përkulen përpara dhe të kalojnë nëpër të njëjtin proces dhe të gjejnë se cila është 'largësia e duhur e përkuljes'.

Treinuesi duhet t'ju thotë tani studentëve që të imagjinojnë sikur sapo kanë takuar personin që kanë përballë. Si e përshëndesin njëri-tjetrin, etj.?

Pjesëmarrësit duhet ta demonstrojnë këtë me veprimet e tyre.

Fill pas kësaj duhet të gjallërohet seanca me pyetje përgjigje rreth rolit që luan kultura e vendit, gjinia dhe marrëdhëniet e pushtetit.

Mbani kontaktin me sy me studentin që jep përgjigje.

Përsëri, ndiqni një model të ngjashëm – a është kjo e tepërt? Kërkoni nga studentët që të thonë se çfarë është mirë apo gabim për pozicionin që diskutohet.

Më pas, studentët duhet të bëjnë një vetdemonstrim me kolegët e tyre se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet bërë në lidhje me qendrimin.

Tundja e kokës – treinuesi i kërkon një individ të flasë rreth temës që diskutohet – dhe tund kokën gjatë kësaj.

Kërkoni që të bëhet ky veprim nga çiftet – dikush thotë diçka dhe tjetri tund kokën – më pas ndërrojnë rolet.

“Tingujt mbështetës” – trainuesi i bën dikujt një pyetje – tund kokën dhe ndërkohë lëshon ca tinguj – dhe më pas, kur personi pushon së foluri, pushon edhe trainuesi.

Përkruani se cilat janë fjalët mbështetëse (pa ua rritur vlerën), përdorimi i “ëhë-ëhë” dhe i heshtjes.

Kërkoni që çiftet e studentëve të praktikojnë këto ushtrime.

Përfundoni duke thënë që ndërkohë që kjo seancë mund të ketë qenë disi argëtuese, qëllimi i saj është që t’ju ndihmojë të ndërtoni raportin e nevojshëm me të intervistuarin, për të përfutur një tregim të historisë së tij/të saj, sa më të saktë dhe gjithëpërfshirës.

Temat e përgjithshme

Temat e përgjithshme duhet të jenë çështje të hapura, të lira – koha, sporti, interesat personale, përvojat e përbashkëta të përgjithshme, etj.

Duhet të shfrytëzohet mundësia që të kontrollohet nëse i intervistuari ndihet mirë, rehat, nëse ka ngrënë, nëse ka pushuar sa duhet, etj.

Temat specifike

Duhet të jepen detaje rreth identitetit të intervistuesve dhe të të gjithë personave që janë të pranishëm në intervistë. Duhet të përshkruhet qëllimi dhe struktura e intervistës, po ashtu, duhet të shpjegohet përdorimi i çdo lloj pajisjeje, si pajisjet e regjistrimit video apo audio.

5. Përfshirja dhe shpjegimi

Këtu flitet, kryesisht, për artin e vënies në praktikë të qendrimeve tuaja të planifikuara, duke i përfshirë të intervistuarit në biseda të përgjithshme, dhe duke kaluar më pas në tema specifike si, tek hollësitë mbi njerëzit e pranishëm, strukturën e intervistës, synimet të saj, etj.

Këtu tani është koha për të trajtuar edhe:

- Kërkimin e përqendruar (me pyetje e përgjigje).
- Raportimin e gjithçkaje.
- Transferimin e kontrollit.

Kërkimi i përqendruar

Mbajtja mend saktësisht e elementeve kërkon një vëmendje të përqendruar dhe fokusim intensiv. Sigurojuni që të ketë sa më pak tërheqje vëmendjeje që të jetë e mundur. Pranoni që mund të mos jetë e lehtë që të kujtohen të gjitha veprimet dhe qetësoni të intervistuarit që të jenë sa më të shpenguar që të jetë e mundur.

Raportoni gjithçka

Personi që intervistohet mund të mos dojë që të japë vullnetarisht të gjithë informacionin që ka. Kjo mund të ndodhë për shkak të një marrëdhënieje reale apo të hamendësuar të pushtetit me intervistuesin, ose për shkak të hamendësimit nga ana e të intervistuarit që intervistuesi e di tashmë se çfarë dhe si ka ngjarë (ky opinion mund të përforcohet nga një qendrim jo profesional i një intervistuesi të pazotë).

I intervistuari mund të bëjë dhe ndonjë 'redaktim' të asaj që ka thënë më parë, për ta paraqitur historinë sa të besueshme dhe, për rrjedhojë, bindëse. Krijimi i besueshmërisë nuk do të thotë gjithmonë se rrëfimi i historisë është i saktë, megjithëse shpesh mendohet se besueshmëria është edhe saktësi.

Për këtë arsye, duhet t'u kërkohej të intervistuarve që të 'raportojnë gjithçka', me fjalë të tjera, të mos lenë asgjë pa thënë. Megjithatë, duke thënë thjesht 'raporto gjithçka që di' ka shumë mundësi që të mos jetë e mjaftueshme, veçanërisht kur keni të bëni me një viktimë dëshmitare të cënueshme. I tërë mjedisi – rrethanat, sjellja e intervistuesit, komunikimet jo verbale të tij/të saj, etj. – duhet të bëjnë që i intervistuari të ndihet mirë dhe i/e qetë, për t'i dhënë mundësinë më të mirë që ai/ajo të japë sa më shumë informacion që të jetë e mundur.

Ushtrim – Një detyrë e thjeshtë

Kërkoni nga një student të përshkruajë një veprim të thjeshtë - përgatitja e një filxhani çaji, apo hypja në ashensor, etj.

Pasi të bëhet përshkrimi, ndani këtë përshkrim në pjesë përbërëse, gjë që do t'ju ndihmojë të demonstroi deri në ç'nivel detajesh mund ta zbërtheni këtë përshkrim.

Duke përdorur shembullin e 'filxhanit të çajit', përshkrimi i veprimit mund të fillojë me 'veni të vlijë pak ujë, vendosni filtrin e çajit në kupë dhe hidhni mbi të ujin e vluar'. Këto veprime mund të zhvillohen më tej duke thënë, 'Keni vënë ujin të vlijë? A mund të më përshkruani se si e keni bërë këtë?' Kjo pyetje mund të marrë si përgjigje si p.sh., 'Hidhet pak ujë në një enë. Vendoset ena mbi furnellë, hapet gazi dhe ndizet, dhe pastaj uji fillon të vlijë'. Por edhe kjo mund të zhvillohet më tej, duke pyetur 'Ku e merrni ujin?' – 'Nga rubineti' – 'Ku është rubineti?' – 'Në kuzhinë' – 'Më shpjegoni llojin e rubinetit' dhe kështu me radhë.

Kjo duhet të vazhdojë derisa të bëhet e qartë idea se deri në ç'nivel mund të arrihet me zbërthimin e detajeve në rast se del e nevojshme.

Përndryshe, ju mund të vendosni ta përgatitni vetë kupën e çajit duke shpjeguar dhe treguar me detaje se çfarë do të thotë 'raporto gjithçka di' dhe nivelin e informacionit që ky raportim mund të japë.

I thoni grupit të studentëve që mund të përdoret kjo qasje për të demonstruar nivelin e informacionit që kërkohet nga të intervistuarit.

Transferimi i kontrollit

Ka shumë mundësi që i intervistuari të presë që të ketë një mori pyetjesh nga intervistuesi. Kjo vjen nga idea që është krijuar për një intervistues sikur është një përfaqësues i pushtetit, por edhe nga përshkrimet që jepen nëpër media të intervistave policore, si intervista që udhëhiqen nga intervistuesi.

Roli i intervistuesit në një intervistë njohjeje është ai i lehtësuesit, ndihmuesit. Me fjalë të tjera, intervistuesi ndihmon që i intervistuari të japë një përshkrim sa më të saktë të ngjarjes. Kjo nënkupton që intervistuari duhet t'ia kalojë, t'ia transferojë kontrollin mbi intervistën pikërisht tek i intervistuari.

Ky kalim kontrolli duhet të bëhet në mënyrë të qartë për të intervistuarin.

Ushtrim – Transferimi i kontrollit

Treinuesi duhet t'i thotë klasës që 'kalimi i kontrollit' bëhet gjatë gjithë kohës së bashkëbisedimit të përgjithshëm (më lart u trajtua sesioni i 'kalimit të radhës nga njëri te tjetri).

Treinuesi duhet të kërkojë pas kësaj, që të jepen disa shembuj.

Kjo mund të nënkuptojë shpjegime të tilla si, 'Ku ishte?', 'Çfarë po bëje?', etj.

Më pas treinuesi duhet të shpjegojë shkurtimisht konceptin 'maksimumi i sasisë'. Kjo bëhet që studentët të arrijnë të përftojnë informacionin e kërkuar nga bashkëbisedimi, por jo më shumë se kaq. Ky është parimi bazë i një bashkëbisedimi, të cilin e mësojmë që në moshë të re dhe në rast se nuk e respektojmë atë, do të kalohet pastaj në fyerje të tjetrit. Intervistuesit duhet të respektojnë rregullin 'maksimumi i sasisë' përsa kohë nuk kanë udhëzime të qarta sipas të cilave mund të kërkohen sa më shumë detaje që të jetë e mundur.

Treinuesi duhet të kërkojë nga studentët që ata të japin shembuj frazash apo fjalish që i tregojnë të intervistuarit se janë ata që kanë nën kontroll bashkëbisedimin.

Këto fraza mund të jenë:

- 'Unë nuk isha aty. Nuk e di se ç'ndodhi. Por, ti ishte atje. Më thuaj, të lutem, se çfarë ndodhi.'
- 'Të lutem më trego se ç'mban mend ti.'
- 'Mos harro asnjë hollësi, të lutem. Dua të dëgjoj prej teje gjithë çfarë di.'

6. Tregimi

Është disi e vështirë të përcaktohet se kur është çasti i duhur që një intervistë të kalojë nga faza 'Përfshirja dhe shpjegimi' tek faza 'Tregimi'.

Personi që intervistohet mund të japë vullnetarisht informacion gjatë fazës 'Përfshirja dhe shpjegimi'. Kjo mund të ndodhë, për shembull, në fillim gjatë një bisedimi më të përgjithshëm, i cili do të çojë më pas drejt zbulimeve të fakteve specifike të çështjes nën hetim. Ata mund të kërkojnë shpjegime të mëtejshme për konceptet që do t'i ndihmojnë të nisin të tregojnë historinë e tyre që përmban të dhëna të rëndësishme për hetimin.

Nisja e fazës së tregimit nuk do të thotë fundi i fazës 'Përfshirja dhe shpjegimi'. Intervistuesi mund të ketë nevojë që të ripërsërisë disa koncepte gjatë intervistës, si p.sh. të 'raportoni gjithçka'. Intervistuesit do të kenë me siguri nevojë që të shpjegojnë edhe konceptet e reja, si p.sh. 'riformulimi me mend i kontekstit të ngjarjes'.

Se si do të menaxhohet me saktësi kjo fazë, varet nga intervistuesi. Dhe ka të ngjarë që të përcaktohet nga faktorë të tillë, si personaliteti dhe zhvillimi mendor i të intervistuarit, rrethanat e rastit dhe niveli i përvojës së intervistuesit.

Procesi është një proces i rrjedhshëm. Struktura nuk është e ngurtë, nuk ka pse të respektohet me çdo kusht në të gjitha detajet. Është thjesht një kuadër për të ndihmuar intervistuesit që të përftojnë një tregim sa më të saktë e të plotë për rastin në fjalë.

Bëni kujdes që të mbani një qendrim, pozicionim të rregullt të trupit, etj., siç dhe u vendos gjatë fazës së planifikimit që trajtuam më lart.

Struktura e tregimit

Metoda e përgjithshme do të ishte që fillohet nga tema më e gjërë, për të kaluar drejt më specifikes. Ky kalim mund të zërë gjithë kohën e intervistës, ose, gjatë intervistës mund të ketë disa procese kalimi nga 'e gjëra tek specifikja'. Fazat e një interviste janë përgjithësisht:

- Kujtesa e lirë.
- Pyetjet e hapura.
- Pyetjet e mbyllura specifike.
- Në varësi të rrethanave, kalimi prapë tek kujtesa e lirë, e kështu me radhë.

Kujtesa e lirë

Kujtesa e lirë përdoret nga personi për të treguar historinë pa ndërprerje apo pa ndërhyrje me pyetje nga ana e intervistuesve.

Të intervistuarve duhet t'u thuhet që të tregojnë rastin e tyre me fjalët e tyre dhe të japin sa më shumë hollësi që të mundën, d.m.th. ata duhet të 'raportojnë gjithçka' që dijnë. Intervistuesit mund të kërkojnë të përdorin metodën 'përshkruani një detyrë të thjeshtë', të trajtuar më parë.

Tregimi me kujtesë të lirë mund të jetë shumë i shkurtër, ndoshta me vetëm pak fjalë. Por, mund edhe të zgjasë.

Teorikisht, një tregim me kujtesë të lirë ka mundësi të japë të gjithë informacionin që kërkohet nga intervistuesi, por kështu ndodh në raste të rralla. Kjo do të thotë që intervistuesit duhet të kthehen mbrapsht tek faza e kujtesës së lirë dhe të përpiqen të ndihmojnë rrjedhën e tregimit me anë të pyetjeve.

Në rastin më të mirë intervistuesit duhet të jenë dy. Njëri mund të drejtojë pyetjet, ndërsa tjetri të mbajë shënim përgjigjet. Edhe në rastet ku intervista është duke u regjistruar në audio ose video, mbajtja e shënimeve është një praktikë e mirë pasi i mundëson intervistuesit të nënvizojnë fushat ku do të duhet të drejtohet më tej intervista.

Ushtrim – Pyetjet për kujtesën e lirë

Pyeteni të gjithë klasën "Çfarë lloj pyetjesh do të përdorni për të filluar një tregim me kujtesë të lirë?"

Shembujt përfshijnë pyetjet:

"A mund të më tregosh, të lutem, gjithë çfarë di?"

"A mund të më tregosh, të lutem, se çfarë ndodhi?"

"A mund të më përshkruash çfarë ndodhi dje/javën e shkuar?"

Pyetjet e hapura

Pyetjet e hapura shpesh përcaktohen si pyetjet Kush-, Çfarë-, Ku-, Kur-, Përse-, Në ç'mënyrë, ose si '5 pyetje me WH' (në anglisht). Në pyetjet që lidhen me TQNj bën përjashtim pyetja 'Përse', e cila nuk përdoret përgjithësisht, pasi mund të nënkuptojnë fajësimin e viktimës.

Pyetjet e hapura duhet të përdoren për të zhvilluar tregimin me anë të kujtesës së lirë. Pyetjet e hapura janë zgjedhja e parapëlqyer, sepse i lejojnë të intervistuarit të japin çdo lloj përgjigje që dëshirojnë, duke përmirësuar në këtë mënyrë mundësitë që ajo që tregohet të jetë e saktë, duke parandaluar edhe problemet e mëvonshme që mund të dalin në mbrojtje të së vërtetës së tregimit.

Ushtrimi 'kupa e çajit' është një shembull i thjeshtë se si mund të zhvillohet një tregim me kujtesë të lirë duke përdorur pyetjet e hapura.

Intervistuesit duhet të përqendrohen në një mënyrë të strukturuar mbi pikat me interes në fazën e tregimit me kujtesë të lirë. Për shembull, një tregim me kujtesë të lirë të rastit të TQNj, mund të kalojë shpejt nga faza e rekrutimit, transportit tek ajo e shfrytëzimit. Tregimi i rekrutimit mund të jetë i thjeshtë, “Pashë një njoftim në internet, aplikova dhe pastaj erdha këtu”. Në këtë fazë, informacioni është shumë sipërfaqësor, por përmban disa pika me interes të madh për intervistuesin dhe që janë me vlerë për hetimin.

Shembujt e pyetjeve të hapura që mund të përdoren për të zhvilluar tregimin, përfshijnë:

- “A mund të përshkruash se si e gjete njoftimin në internet?”
- “Çfarë thuhej në të?”
- “A mund të më përshkruash se si ishte kjo faqe e internetit?”
- “Cilat ishin udhëzimet për të aplikuar për punë?”
- “Ku ndodheshe kur e pe njoftimin në internet?”
- “Çfarë kompiuteri ishte duke përdorur, kur e pe njoftimin?”
- “Kur ishte hera e fundit që takove gruan/burrin e përfshirë në këtë njoftim?”
- “Ku e takove atë për herë të parë?”
- “Çfarë të tha?”

Shembujt e disa pyetjeve të tjera të hapura të përgjithshme, janë:

- “A mund të ma përshkruash, të lutem, dhomën?”
- “Nga je?”
- “Çfarë ndodhi më pas?”
- “Kush ishte atje?”
- “Kur ndodhi?”
- “Çfarë bëri ai/ajo?”
- “Kush të goditi?” (kjo presupozon që personi ka treguar tashmë se është goditur – dhe mund të shërbejë si një pyetje orientuese nëse fakti i pësimit të goditjes nuk ka qenë përmendur më parë).

Pyetjet e mbyllura specifike

Pyetjet e mbyllura janë pyetje të cilat marrin vetëm dy përgjigje të mundshme – “Po” ose “Jo”. Përdorimi i pyetjeve të mbyllura paraqet një numër rreziqesh.

Siç është përshkruar më parë, kur u trajtuan ‘Marrëdhëniet e pushtetit’, të intervistuarit mund të japin përgjigjen që ai/ajo e ndjen se çfarë përgjigje do t’i pëlqente intervistuesit. Për pyetjen “A të goditi ai?”, për shembull, nëse personi përgjigjet “Po”, mund të jetë e vështirë të kuptohet nëse i i dyshuari e ka goditur me të vërtetë, apo nëse i intervistuari kërkon thjesht t’ia bëj qejfin intervistuesit, duke dhënë një përgjigje që do t’i pëlqente intervistuesit.

Megjithatë, ekzistojnë disa rrethana ku ju mund të përdorni pyetjet e mbyllura specifike. Këtu përfshihen rrethanat kur një i intervistuar nuk e kupton, ose nuk mund t’i përgjigjet një pyetjeje të hapur. Për shembull, nëse pyetja “Sa e madhe është dhoma?” nuk ka marrë përgjigje, ajo mund të riformulohet në formën “A ishte më e madhe se kjo dhomë?”

Pyetjet e papërshtatshme

Ekzistojnë një numër pyetjesh të papërshtatshme.

Zgjedhja e detyruar

Kjo lidhet me pyetjen ku intervistuesi ka përcaktuar paraprakisht disa parametra. Për shembull: “Çfarë ngjyrë kishte makina, e verdhë apo jeshile?” Makina, fare mirë, mund të kishte qenë blu apo një ngjyrë tjetër, por e formuluar kështu nuk të le alternativë. I intervistuari mund të thotë “nuk ishte asnjera nga këto, por ishte...”, ose të mos i përgjigjet fare kësaj pyetjeje; dhe serish këtu duhet mbajtur parasysh ndikimi i marrëdhënies së pushtetit dhe dëshira e mundshme për të kënaqur intervistuesin. Për shkak të ndikimit që mbart TQNj mbi viktimat, të intervistuarit mund të mos dëshirojnë të sfidojnë diçka që është dukshëm gabim dhe mund të mos japin asnjë përgjigje.

Pyetjet shumëfishe

Thënë thjesht, këto janë pyetje me një numër pyetjesh të përmbledhura në një, për shembull: “Kush ishte në makinë? Ku ishte makina? Sa ishte ora?” Kjo lloj pyetjeje vendos një barrë të panevojshme mbi të intervistuarin. Nga ana tjetër, i intervistuari mund të mos dëgjojë mirë të gjithë pyetjen, dhe mund të përqendrohet vetëm në pjesën e fundit të saj, ose të ketë harruar tashmë pyetjet e tjera ndërkohë që i përgjigjet pjesës së parë të saj.

Pyetjet (ç)orientuese

Një pyetje orientuese është një pyetje që provokon një përgjigje specifike. “Xhoni të goditi?” është një shembull i cili është realisht një deklaratë, që mund të tingëllojë edhe si një komandë.

Një variant i një pyetjeje orientuese është pyetja çorientuese. Për shembull, “Sipas meje, ju patë një makinë të kuqe, apo jo?” Mund të mos ketë patur asnjë lloj makine, madje edhe po të ketë patur, ajo mund të mos ishte me ngjyrë të kuqe.

Pyetjet orientuesë/çorientuese mund të përdoren qëllimisht për të marrë një përgjigje të caktuar, mund të bëhen për t'i rënë shkurt, ose mund të bazohen mbi një informacion fallso që besohet si i vërtetë nga intervistuesi.

Ndryshimi i rendit kohor

Kjo do të thotë që të ndryshosh kahun kohor, nga kërkesa që i intervistuesi të kujtojë ngjarjet në rendin kronologjik në kërkesën që t'i kujtojë ato në rendin e kundërt kronologjik, d.m.th. të shkuarit mbrapsht në kohë, duke pyetur, për shembull, “Çfarë kishte bërë ti para kësaj?”, dhe pasi të kesh marrë përgjigjen e kësaj pyetjeje, të pyesësh serish, “Po para asaj, çfarë pate bërë?”.

Kjo metodë mund të përdoret për të nxitur ndonjë kujtesë të re te i intervistuari dhe provuar nëse tregimi është i vërtetë, apo i mësuar 'përmendësh'. Është një metodë e diskutueshme dhe është shumë e vështirë për shumë vetë që të kujtohen për ngjarjet duke ndjekur kahun e kundërt kronologjik.

Rekomandohet seriozisht që ju të mos e përdorni këtë metodë kur intervistoni viktimat/dëshmitarë të TQNj. Për shkak të efektit të traumatizimit, viktimat/dëshmitarë ka mundësi që të kenë vetë ide të ngatërruara rreth rendit kohor të ngjarjeve, dhe po t'u kërkosh që të kujtojnë ngjarjet duke i marrë mbrapsht në kohë, do të shkaktojë një ngatërrim më të madh dhe do të gjenerojë kontradikta të panevojshme që më vonë mund të shfrytëzohen nga mbrojtja.

Ndryshimet e perspektivës

Kjo është një teknikë e ngjashme me atë të kthimit të kahur kohor. Një shembull për këtë mund të jetë: "Ju po thoni së ishit të ulur në karrike kur e patë atë burrin. Imagjinoni sikur tani jeni në këmbë pranë derës. Më përshkruani se çfarë shikoni në këtë rast".

Serish, arsytimi për këtë qasje është se ajo gjeneron një kujtesë të re, dhe, përsëri është një qasje e diskutueshme.

Për po të njëjtat arsye që u dhanë më lart, rekomandohet seriozisht që të mos e përdorni këtë metodë, kur intervistoni viktimat/dëshmitarë të TQNj.

Nxitjet e kujtesës

Këto janë teknika për të inkurajuar zgjimin e kujtesës.

Për të ndihmuar kujtimin e ndonjë emri apo pjese të tekstit, pyetjet mund të jenë:

- "Sa germa kishte fjala?"
- "A e kujton dot se me çfarë shifre fillonte numri?"
- "A ngjan ajo me ndonjë fjalë tjetër që di ti?"

Shembujt e pyetjeve për të marrë informacion me karakter përshkruar përfshijnë:

- "Çfarë ngjyre ishin sytë e atij burri?"
- "A mund të më përshkruash se si ishte veshur burri? Nis nga pjesa e sipërme e trupit dhe vazhdo poshtë deri te këmbët. Qetësohu njëherë. Pusho sa të duash".
- "Ju po thoni se burri ishte 'trupmadh'. Më i madh se kush?"

Kur përdoret kjo teknikë, është e rëndësishme të qendrohet brenda kontekstit të asaj që thonë të intervistuarit. Për shembull, nëse i intervistuari thotë, "Pashë një hije burri te dritarja" (një përvojë pamore kjo), nuk mund të kaloni nga këtu e të thoni, "po mirë, çfarë dëgjove?" (një pyetje kjo që lidhet me një përvojë dëgjimore dhe jo pamore). Një reagim korrekt i intervistuesit do të ishte, "Pe një hije burri? A mund të ma përshkruash këtë hije, si ishte?", duke vazhduar

ndoshta me nxitje të kujtesës. Në rast se i intervistuari flet në një çast për një zhurmë që pat dëgjuar, ju sigurisht mund ta pyesni disi më gjatë për këtë, ose mund të kaloni te problemi i zhurmës, kur të jeni i kënaqur me informacionin që keni marrë nga përshkrimi i asaj që ishte parë nga viktimat/dëshmitare.

Pyetjet e rëndësishme nga pikëpamja hetimore

‘Pyetjet e rëndësishme hetimore’ janë pyetje që janë veçanërisht kuptimplote për rastin që shqyrtohet. Ato ndeshen si në intervistat e viktimave, ashtu dhe në ato të të dyshuarve. Janë pyetje që hetuesit i kuptojnë si të rëndësishme, sepse lidhen me kërkesat ligjore, me njohjen nga ana e tyre të rastit në fjalë, ose me përvojën që kanë në ndjekjen e hetimeve.

Shumë të intervistuar mund të mos kuptojnë se çfarë është e rëndësishme për një hetim. Të tjerë mund të kuptojnë disi se çfarë është e rëndësishme, por prej turpit apo frikës (në rastin e viktimave dëshmitare), ose dëshirës për të mos kriminalizuar veten (në rastin e të dyshuarve) nuk e thonë atë që dijnë gjatë intervistës, në rast se nuk nxiten që të shprehen për atë që dijnë.

Si një shembull i thjeshtë në rastin e një interviste me dëshmitar mund të shërbejë komenti gjatë një ‘kujtese të lirë’ që trafikanti i dyshuar “më mori në telefon”. Për të maksimalizuar vlerën e këtij komenti, ai nuk duhet lënë pa vëmendje, por të zhvillohet më tej. ‘Pyetjet e rëndësishme hetimore’ në këtë rast do të bëhen rreth telefonit ku u bë thirrja, orës së telefonatës, sa kohë zgjati ajo, çfarë u tha me saktësi, etj. Intervistuesit duhe të përdorin pyetjet ndihmëse për të arritur të marrin informacionin e kërkuar.

Rasti i një përgjigjeje më të ndërlikuar të një dëshmitari do të jetë ai mbi një situatë që lidhet me një rast të qartë përdhunimi. Në thuajse të gjitha jurisdiksonet, ekziston një përkufizim ligjor i përdhunimit që parasheh penetrimin seksual të trupit të personit. Në rast se kjo nuk provohet, atëherë nuk është rast përdhunimi. Rrëfimi fillestar mund të sugjerojë që ka patur penetrim, por deklarata e dhënë, duke mos qenë e kthjellët, nuk kënaq kërkesat e ligjit. Për këtë arsye, hetuesit duhet të pyesin më tej personin për të përcaktuar nëse flitet ose jo për penetrim. Është e qartë që i gjithë ky rast duhet të trajtohet me një kujdes dhe takt shumë të madh.

Në rastin e një interviste me një të dyshuar, një shembull për përdorimin e pyetjeve të rëndësishme për hetimin mund të ketë të bëjë me përcaktimin e alibisë së të dyshuarit. I dyshuari mund të japë një alibi, të cilën intervistuesi e di që mund ta provojë se është e rreme. Është e qartë nga ‘pikëpamja e rëndësishme hetimore’, që i dyshuari përballet me një sfidë për të provuar vërtetësinë e alibisë së tij. Se kur dhe si duhet të bëhet kjo, mund të jetë një vendim taktik i vështirë, dhe shpesh diktohet nga kërkesat e legjislatcionit të vendit.

Gjatë fazës së planifikimit ju do të jeni në gjendje të identifikoni të paktën disa ‘pyetje të rëndësishme hetimore’; për shembull, në rast se akuza fillestare sugjeron që kemi të bëjmë me përdhunim, ju duhet të kërkonit fakte që t’i përgjigjen standardit të pranuar ligjor për këtë vepër penale. Përgjigjet e të intervistuarve gjatë intervistës do të japin shkas për të bërë ‘pyetje të tjera të rëndësishme hetimore’.

7. Mbyllja

Mbyllja është një rast i mirë për të qartësuar çdo gjë që mund të mos jetë kuptuar, dhe për të ndihmuar sa më shumë që të jetë e mundur që i intervistuari të largohet nga intervista me një ndjenjë pozitive mbi të. Kjo është e rëndësishme si nga pikëpamja psikologjike, ashtu dhe nga ajo njerëzore. Mbyllja, gjithashtu, përdoret për të sqaruar çështjet praktike, si nëse ka nevojë për intervista të mëtejshme, apo jo, nëse do të deklarohet që viktimës-dëshmitare ka të ngjarë t'i kërkohej të marrë pjesë në procesin gjyqësor, etj.

Pikat kyçe për t'u patur parasysh në këtë fazë janë:

- Përmbledhja e pikave kryesore të intervistës për të kontrolluar që si ju ashtu dhe i intervistuari të kuptoni se çfarë u tha gjatë intervistës.
- Dëshmitari duhet falenderuar, por jo lavdëruar, për kohën që kaloi me intervistuesin.
- Atyre u duhet shpjeguar se cilat do të jenë fazat e tjera.
- Dëshmitarët duhet të pyeten nëse kanë ndonjë pyetje, të cilat duhet të marrin përgjigje për aq sa e lejojnë rrethanat.
- Në asnjë rrethanë nuk duhet të bëhen premtime që nuk do të mund të mbahen (p.sh. dhënia e statusit të rezidentit).
- Viktimave duhet t'u jepet mundësia që të bëjnë 'deklaratën personale të viktimës', e cila është një deklaratë që tregon se cilat kanë qenë ndikimet e krimit mbi ta.
- Duhet të jepet informacion mbi ndihmën dhe mbështetjen e disponueshme; në pjesën më të madhe të rasteve të TQNj, hetuesit dhe të tjerët do të kenë menduar dhe marrë masa për të ofruar ndihmë sipas marrëveshjeve të rëna dakord më parë dhe në përputhje me mekanizmat kombëtarë të referimit.

8. Vlerësimi

Një vlerësim i strukturuar i asaj që është thënë gjatë intervistës do të lejojë planifikimin e intervistave dhe të hetimeve të mëtejshme. Ai do t'ju lejojë, gjithashtu, që të gjykoni nëse metoda e përdorur nga ju për të realizuar intervistën ka qenë e suksesshme, dhe nëse do t'ju duhet që të ndryshoni diçka në intervistat e tjera.

Pikat kyçe për vlerësimin që duhen mbajtur parasysh, janë:

- Pas çdo interviste duhet të bëhet vlerësimi i saj.
- Pas secilës interviste duhet të bëhet vlerësimi i rrezikut në dritën e informacionit të përftuar. (Mbani shënim që vlerësimi i rrezikut duhet të jetë në mendjen tuaj gjatë gjithë intervistës në rast se zbulohet ndonjë e dhënë që kërkon marrjen e një veprimi të menjëhershëm).
- Mbani parasysh gjendjen mendore dhe fizike të personit që intervistohet dhe në bazë të saj vendosni se çfarë ndihmë duhet të oftohet.
- Punoni bashkë me anëtarët e tjerë të grupit hetimor për të identifikuar, analizuar dhe vepruar në bazë të mundësive për hetim të mëtejshëm të të dhënave, që zbulohen nga intervista.

9. Vënia në praktikë

Të gjitha Studimet e Rasteve ofrojnë mundësi për të organizuar lojra me role, në mënyrë që të përfitohet më shumë njohuri nga intervistat dhe për t'i vënë ato në praktikë.

Nëse dëshironi, mund ta përdorni lojën e mëposhtme me role, ose mund të shfrytëzoni strukturën dhe përmbajtjen e saj për të organizuar lojra të tjera me role.

Loja me role

Shikoni mundësinë e organizimit të Lojës me Role 3 – Shfrytëzimi i punës.

Kjo lojë bazohet mbi Studimin e Rastit 1 – Shfrytëzimi i punës.

Ajo ju mundëson që të zhvilloni më tej nivelin e njohurive nëpërmjet metodës së simulimit.

Udhëzimet e plota, mbi si do të mund të organizohet kjo lojë, jepen tek vetë loja me role.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Audienca e synuar	6
1.2	Objektivat e të mësuarit	6
1.3	Njohuritë e mëparshme	6
2.	Terminologjia për të gjitha SIT-et.....	7
2.1	Kohëzgjatja.....	7
2.2	Mësimdhënia	7
2.3	Informacioni për trainuesin	7
3.	Teknikat ndërlidhëse.....	8
3.1	Kohëzgjatja.....	8
3.2	Mësimdhënia	8
3.3	Informacion për trainuesin	8
4.	Përgjimet e komunikimeve.....	9
4.1	Kohëzgjatja.....	9
4.2	Mësimdhënia	9
4.3	Informacion për trainuesin	9
5.	Të dhënat e komunikimeve.....	12
5.1	Kohëzgjatja.....	12
5.2	Mësimdhënia	12
5.3	Informacioni për trainuesin	12
6.	Vëzhgimi	16
6.1	Kohëzgjatja.....	16
6.2	Mësimdhënia	16
6.3	Informacioni për trainuesin	16
7.	Informatorët dhe agjentët sekretë.....	22
7.1	Kohëzgjatja.....	22
7.2	Mësimdhënia	22
7.3	Informacioni për trainuesin	22

1. Hyrje

Materiali në këtë leksion ka për synim të japë një pamje se si mund të përdoren Teknikat Hetimore të Specialistit (SITs) në hetimet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Ai nuk synon të jetë një program gjithëpërfshirës trainimi mbi si duhet të përdoren teknikat individuale nga pikëpamja operacionale.

SIT-et janë:

- Përgjimet e komunikimeve.
- Të dhënat e komunikimeve.
- Vëzhgimet.
- Informatorët dhe agjentët e fshehtë.

Teknikat e specialistit në hetimet e Trafikimit të Personave mund të përdoren për të:

- Identifikuar
 - Trafikantët.
 - Viktimat.
 - Lokalin.
 - Rrjetet e komunikimit.
 - Metodot e transportimit.
 - Njoftimet publike.
 - Sistemet financiare.
- Përcaktuar se cilat janë mundësitë e provave dhe të dhënave sekrete.
- Zhvilluar ato mundësi.
- Konfirmuar provat e gjetura, qoftë nëpërmjet teknikave të specializuara hetimore, apo hetimeve të tjera.

SIT-et i drejtojnë hetimet drejt aktivitetit kriminal 'në kohë reale', dhe kjo përbëm rreziqe më vete. Hetuesit dhe menaxherët e hetimit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë, vlerësojnë dhe t'i trajtojnë ato rreziqe. Përdorimi i SIT-eve në rastet e TQNj ka mundësi që të të nxjerrë përballë sfida, që nuk ndeshen tek llojet e tjera të hetimit. Jeni duke hetuar një 'krim që është në zhvillim e sipër'. Shumë hetime të 'krimeve në zhvillim e sipër' (krimi i furnizimit të drogës, për shembull) nuk përbëjnë një rrezik të menjëhershëm për viktimën, dhe të japin mundësi për të ndërhyrë para se ndonjë anëtar i publikut të jetë në rrezik dëmtimi. Rastet e TQNj, megjithatë, mbajnë në vetvete rrezikun e kudo gjendur të rrezikut nëpërmjet dhunimit, sulmit fizik, ose gjymtimit në punë e sipër. Hetuesit duhet ta mbajnë gjithmonë parasysh këtë dhe të planifikojnë ndërhyrje të tilla që të mbrojnë si viktimën, ashtu dhe teknikën e përdorur të specialistit.

Ky plan mësimor trajton SIT-et sipas rendit që paraqiten më lart.

1.1 Audiencia e synuar

Ky mësim synohet, para së gjithash për ata që kanë një rol në menaxhimin e hetimit të TQNj, përfshirë:

- Oficerët e policisë që menaxhojnë hetimet e TQNj.
- Specialistët e SIT-eve që punojnë për hetimet e TQNj.
- Prokurorët.
- Gjykatësit hetimorë dhe të tjerë, që ofrojnë garancitë dhe autorizimet për përdorimin e SIT-eve në hetimet e TQNj.

1.2 Objektivat e mësimit

Me përfundimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë formën bazë të SIT-eve të mëposhtme:
 - Përgjimin e komunikimit.
 - Të dhënat e komunikimit.
 - Vëzhgimin.
 - Informatorët dhe agjentët sekretë.
- Shpjegojnë konceptin e 'technikave ndërlidhëse'.
- Të njohin konceptet e mëposhtme që lidhen me të gjitha SIT-et:
 - Ç'është Produkti.
 - Cili është Synimi.
 - Cilat janë Objektivat.
- Njohin çështjet kyçe të rëndësishme për çdo SIT.
- Zbatojnë konceptet e SIT-eve te ushtrimet e rasteve të simuluar dhe te studimet e rasteve.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Pritet që të gjithë studentët të kenë të paktën njohuri bazë mbi hetimin e krimit në përgjithësi, si dhe mbi menaxhimin e krimit në përgjithësi.

2. Terminologjia për të gjitha SIT-et

2.1 Kohëzgjatja

5-10 minuta.

2.2 Mësimdhënia

Prezantimi didaktik i 'Informacioni për trainuesin' (2.3) si më poshtë, i ndjekur nga një ushtrim rasti.

2.3 Informacioni për trainuesin

Termet e më poshtëm janë të përbashkët për të gjitha SIT-et.

- **Produkti** – ky është informacioni që vjen nga përdorimi i teknikës. Ai mund të jetë në formën e:
 - Regjistrimeve audio ose video.
 - Zbardhjeve me shkrim.
 - Dëshmisë verbale.
 - Të dhënave nga sistemet si për shembull, nga ofruesit e shërbimit të sistemit të komunikimit.
- **Shënjestra** – në përgjithësi, një individ që është në qendër të një teknike të veçantë.
- **Objektivat** – objektivat e përdorimit të një SIT-i në rastin e TQNJ, përfshijnë:
 - Gjetjen nëse personi është apo ka qenë trafikuar.
 - Planifikimin për shpëtimin/rekuperimin e viktimave të dyshuara të TQNJ.
 - Identifikimin:
 - Të të dyshuarve të mundshëm.
 - Të automjeteve të përdorura.
 - Të metodave (modis operandi) të trafikantëve.
 - Të vendeve të përdorura për rekrutimin, transportim apo shfrytëzim të viktimave të TQNJ.
 - Përcaktimin nëse ka viktima të tjera.
 - Mbajtjen shënim e mjeteve të përdorura për kontrollin e viktimës.
 - Identifikimin e linjës së kërkimit që duhet ndjekur për hetimin e komunikimeve dhe të aktiviteteve financiare të rrjeteve të TQNJ.
 - Sigurimin e provave në mbështetje të ndjekjes dhe dënimit të trafikantëve.

3. Teknikat ndërlidhëse

3.1 Kohëzgjatja

30-40 minuta

3.2 Mësimdhënia

Prezantimi didaktik i 'Informacion për trainuesin', i dhënë si më poshtë.

3.3 Informacioni për trainuesin

Secila nga teknikat e shpjguara në vijim, konsiderohet si një teknikë e rëndësishme dhe e fuqishme hetimore në fushën e aplikimit të saj. Megjithatë, ndikimi është shumë më i madh në rast se përdoret në kombinim me teknika të tjera, ose kur lidhen me një teknikë tjetër hetimore të specialistit (SIT).

Kur bëhet ndërlidhja e teknikave, rritet niveli i produktit të një teknike. Ajo ka gjasë të japë shkas për mundësi të reja hetimore.

Më poshtë po japim shembuj të 'ndërlidhjes':

- Ndjekja me këmbë, e kombinuar me vëzhgimin në lëvizje dhe analizën e të dhënave të komunikacioneve. Kjo jep një pasqyrë shumë të hollësishme të lëvizjeve të shënjestrës dhe qëllimit të atyre lëvizjeve.
- Përdorimi i informatorëve, i kombinuar me vëzhgimin ndërhyrës (intruziv). Kjo jep një konfirmim të informacionit të informatorit dhe është një tregues se ai apo ajo janë agjentë të besueshëm.
- Analiza e të dhënave të komunikimit, e kombinuar me përgjimin e komunikacioneve. Kjo i lejon hetuesit që të identifikojnë shënjestra të tjera të mundshme për hetimin e komunikimeve të tyre, ose për përdorimin e formave të tjera hetimore të karakterit më të përgjithshëm apo të hetimit me anë të SIT.

Trainuesit duhet të shfrytëzojnë çdo mundësi gjatë lëvrimin të këtij leksioni që të inkurajojnë studentët të reflektojnë dhe përshkruajnë se si mund të lidhen në mes tyre teknikat SIT.

4. Përgjimet e komunikimeve

4.1 Kohëzgjatja

30-40 minuta

4.2 Mësimdhënia

Prezantimi didaktik i 'Informacioni për trainuesin', i ndjekur nga një ushtrim mbi rastin.

4.3 Informacion për trainuesin

Përgjimi i komunikimeve është "modifikimi i, ndërhyrja me ose monitorimi i transmetimeve të një sistemi komunikimi me qëllim që përmbajtja e çdo komunikimi të bëhet e disponueshme për një person të ndryshëm nga dërguesi apo pritësi i synuar i atij komunikimi".¹

Përgjimi i komunikimit është një teknikë tepër ndërhyrëse (intruzive). Se si përdoret ajo, ndryshon nga një vend tek tjetri, duke filluar që nga përdorimi i tij vetëm për të mbledhur të dhëna sekrete deri tek përdorimi rutinë për të mbledhur prova për hetimet penale. Cilido që të jetë pozicioni i saktë ligjor i teknikës, përdorimi i saj rregullohet në mënyrë universale nëpërmjet lëshimit të autorizimeve, garancive sipas rrethanave të përcaktuara me ligj.

Sistemet e komunikimit përfshijnë:

- Postën, p.sh. letrat.
- Telefonatat.
- E-mailet.
- Fakset.
- Telegramet.
- Mesazhet në celular.

Në rastin e një përgjimi të komunikimit, 'produkti' që vjen nga përdorimi i kësaj teknike mund të jetë një shirit regjistrimi të bisedës, një zbardhje e asaj bisede ose kopje letrash, e-mailesh, faksesh, etj.

Përgjimi i komunikimeve do të realizohet në thuajse të gjitha rastet nga teknikë të trainuar specifikisht për këtë detyrë, por që menaxhohen nga hetuesi i TQNj. Hetuesit duhet të lidhen gjithnjë me specialistët për të diskutuar se çfarë është ajo që duan të arrijnë në një hetim dhe çfarë është e mundur dhe praktike. Disa çështje kyçe për t'u marrë parasysh, janë:

¹ UNODC, *Anti-Human Trafficking Manual for Criminal Justice Practitioners* (2009).

- Meqenëse dikush mund të rrezikohet nga një dëmtim serioz, është mëse e këshillueshme që monitorimi në rastet e TQNj të jetë 24 orë në 7 ditë (24/7).
- Fillimisht duhet të kryhet vlerësimi i rrezikut, por ai duhet të bëhet vazhdimisht edhe gjatë periudhës së përgjimit.
- Ju duhet të keni gati një plan ndërhyrjeje në rast se rezulton që dikush është në rrezik serioz. Ky plan duhet të ketë për qëllim mbrojtjen e personit.
- Duhet të mbani parasysh se mund të keni nevojë për përkthyes; ata duhet të jenë të konfirmuar, pasi do t'u duhet të kenë qasje tek produkti i kësaj teknike delikate.
- Është një praktikë e mirë që të bëhen përpjekje për të identifikuar gjuhët me të cilat mund të keni të bëni gjatë procesit të hetimit, në mënyrë që të siguronit përkthimin përkatës.
- Kur ndani me të tjerët apo kërkoni përdorimin e përgjimit të komunikimeve në jurisdiksionet e tjera, duhet të keni njohuri se cilat janë rregullat që zbatohen atje. Mund të ketë protokolle ekzistuese mbi çfarë mund të ndahet ose të jetë e lirë për përdorim, dhe në rast se nuk ka të tilla, lidhni paraprakisht marrëveshjet e rastit.
- Thjesht sepse keni në dorë produktin e përgjimit të komunikimeve nuk do të thotë që duhet ta përdorni atë automatikisht. Kjo mund t'i ekspozojë njerëzit ndaj rrezikut për të cilin ju mund të mos keni dijeni, ose mund të shkelë rregullat dhe udhëzimet e jurisdiksioneve të tjera, gjë që mund të çojë në dështim të rasteve.

Përgjimi i komunikimeve – Ushtrimi 1

Ky ushtrim përdor Ushtimin me Rastin 1 – Personi i zhdukur.

Ndani klasën në grupe të vogla.

Shpërndani pjesën e parë të Ushtrimit me Rastin 1 – pjesën e historisë.

Kërkoni nga grupet që ta lexojnë ushtrimin dhe të vendosin nëse dhe në ç'mënyrë mund të zbatohet për këtë rast përgjimi i komunikimeve.

Lejoni 10 minuta diskutime dhe pasi t'i mblihdhini përsëri së bashku drejtoni pyetje nxitëse, duke përdorur metodën tuaj të parapëlqyer.

Informacion për pyetjet nxitëse

Ushtrimi me Rastin 1 jep udhëzime të dobishme për këtë seancë, veçanërisht seksioni 'Si do të veproni?'.

Informacioni shtesë që mund të jetë i dobishëm përfshin:

- Monitorimi i komunikimit të telefoni i vajzës mund të ndihmojë të identifikohet niveli i rrezikut me të cilin mund të përballet dhe mundëson marrjen e vendimeve për ndërhyrje.
- Numri i telefonit të celulari i vajzës mund të çojë tek ai i trafikantëve. Kjo, nga ana tjetër, mund to ofrojë mundësi për të monitoruar telefonin e trafikantit dhe marrë prova që

lidhen me rastin në shqyrtim, p.sh. diskutime mbi marrëveshjet financiare dhe përpjekjet për të rekrutuar vajza të tjera.

- Duhet të mundësohet marrja e numrit të telefonit të një shoqeje/shoku; të dhënat e komunikimeve të marra nga telefoni i shoqes/shokut mund të ndihmojnë identifikimin e trafikantit nëpërmjet ekzaminimit të numrave të gjetur ndër të dhënat e tjera.
- Mund të merrni në konsideratë që të përgjoni komunikimet te telefoni i shoqes/shokut, në rast se keni arsye të mjaftueshme për të besuar që ajo/ai mund të jetë përfshirë në trafikim.

5. Të dhënat e komunikimeve

5.1 Kohëzgjatja

30-40 minuta.

5.2 Mësimdhënia

Prezantim didaktik të 'Informacioni për trainuesin', si më poshtë, i ndjekur nga një ushtrim rasti.

5.3 Informacion për trainuesin

Të dhënat nga komunikimet kanë të bëjnë më shumë me informacionin rreth komunikimit se sa me përmbajtjen e vetë komunikimit.

Shpesh është më lehtë të kesh qasje tek të dhënat e komunikimeve se sa të organizosh përgjimin e komunikimeve. E vetmja mangësi, sigurisht, është që ju nuk do të mund as ta lexoni dhe as ta dëgjoni këtë komunikim.

Si edhe në rastin e përgjimit të komunikimeve, ka mundësi që ju të përdorni specialistët për të marrë të dhënat. Detyra më e mundshme për hetuesit dhe prokurorët do të jetë aplikimi për të siguruar garancinë apo autorizimin e duhur, informuar specialistët mbi të dhënat në dispozicion dhe çfarë kërkohet me saktësi, e më pas, për të analizuar produktin.

Disa nga shembujt e të dhënave të komunikimeve, përfshijnë:

- Të dhënat mbi telefonin që është përdorur për të kontaktuar të tjerët.
- Hollësi mbi vendin nga janë bërë telefonatat, nga telefonat fiks apo celularë, duke përdorur analizën e asaj që njihet me emrin 'analiza e qelizës së sitit' ku është përdorur telefoni.
- Informacionin mbi kush paguan për një telefon të caktuar.
- Informacionin mbi kush ka bërë abonimin e telefonit fiks apo celular.
- Regjistrimet e e-mailit tek e-maili tjetër.
- Adresat postare mbi njësitë fizike.

'Produkti' që përftohet nga përdorimi i teknikës së të dhënave të komunikimeve përfshin regjistrimet e numrave të marrë, raportet që tregojnë vendet ku është bërë telefonata, listat e adresave të e-maileve të kontaktuar, etj.

Shembuj mbi si mund të përdoren të dhënat e komunikimeve përfshijnë:

- Për të treguar ku ndodhet telefoni.
- Për të treguar ku ndodhej telefoni.
- Për të identifikuar rrjetet.
- Për të identifikuar individët më aktivë në atë rrjet.
- Për të identifikuar ku janë aktualisht individët, ose ku mund të jenë në të ardhmen.

Çështjet kyçe

Disa nga çështjet kyçe për t'u konsideruar, kur planifikohet përdorimi i të dhënave të komunikimeve, janë:

- Kur celularët lëvizin nga një vend te tjetri, ata mund të shfrytëzojnë rrjetin e më shumë se një ofruesi të shërbimit celular. Ky 'roaming' lidhet veçanërisht me rastin kur celulari përdoret jashtë vendit ku është regjistruar. Kjo do të thotë që ju do të keni nevojë të kontaktoni shumë ofrues shërbimesh, gjë që nënkupton nevojën e bashkëpunimit ndërkombëtar në rast se celulari është përdorur jashtë vendit.
- Me shtrirjen e gjërë të telefonisë celulare nëpër botë, ekziston mundësia që ju të siguron qasje tek të dhënat gjatë të gjitha fazave të procesit të trafikimit.
- Në një numër rastesh, viktimave ose iu është dhënë mundësia e përdorimit të celularit ose kanë mundur ta përdorin atë, dhe kjo ka bërë që ata të diktohen.
- Analiza e të dhënave të komunikimeve mund të ndihmojë që hetimi juaj të përqendrohet mbi disa vende të veçanta, gjë që mund të rritë efektivitetin e hetimeve tuaja dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve kritike, si shpëtimi i viktimave.
- Shumë kriminelë janë bërë të vetëdijshëm që agjencitë e zbatimit të ligjit përdorin teknikat e të dhënave të komunikimeve dhe për këtë arsye përdorin teknika kundër vëzhgimit.
- Këto janë thjesht ndërrimi i shpeshtë i telefonave, mbajtja e tyre 'pastër' dhe 'pisët', duke ia dhënë celularin një tjetri, duke e lënë në makinë ose në një mjet transporti publik.
- Disa nga teknikat që mund të përdorni për të trajtuar këto çështje, përfshijnë:
 - Lidhjen e momentit të vëzhgimit me kohën kur përdoret telefoni, p.sh. kur një i dyshuar shihet që po përdor telefonin në orën 12.17 të pasdites dhe regjistrimi shënon të njëjtën gjatësi vale nga ku personi nën vëzhgim ka bërë telefonatën, dhe se telefonata është bërë nga vendndodhja e tij, kjo tregon qart që ky është numri që përdor ky person.
 - Në rast se telefoni i të dyshuarit 'zhduket nga qarkullimi', kontrolloni regjistrimet e kontakteve të njohura të tyre dhe identifikoni numrin e ri që po përdor ai ose ajo. Personi mund të ndryshojë numrin e vet, por nuk është në gjendje të ndryshojë të gjitha kontaktet që ka.
 - Ngarkoni informatorin me detyrën e gjetjes së numrit të ri.
 - Kontrolloni faturat financiare për të kuptuar se si janë blerë telefonat dhe paguar tarifa e tyre.
- Në shumë jurisdiksione, hetuesit tanimë kanë fituar përvojë në zbatimin dhe përdorimin e të dhënave të komunikimeve. Megjithëse, kjo mund të kërkojë shumë kohë, në rrethana emergjente përdorimi i tyre shpesh arrin të organizohet shpejt.
- Në ato raste kur kërkohen autorizime, duhet theksuar rreziku i mundshëm që i kanoset viktimës.

Trajtimi i pajisjeve të komunikimit

- Është e mundur që të nxirren të dhëna nga pjesa më e madhe e mjeteve të komunikimit, megjithëse mund të krijohet ndonjë vonesë për shkak të daljes së mjeteve apo programeve të reja dhe nivelit të aftësisë së specialistëve për t'u qasur tek to.
- Këshilla e përgjithshme është që nëse është e mundur, pajisjet e komunikimeve të mos mbyllen asnjëherë. Por, meqenëse modelet ndryshojnë nga njëri-tjetri, rekomandohet që të kërkohet ndihma e ekspertëve.
- Bëni kujdes që t'i trajtoni mjetet në një mënyrë që të mos prishen provat fizike, si për shembull, shenjat e gishtave.
- Kur bëhet kërkimi i vendit dhe i personave, mbani shënim se ku u gjetën pajisjet e komunikimit dhe kush i zotëronte ato.
- Kërkoni fjalëkalimet. Mund edhe të mos i merrni dot, por gjithsesi kërkoni që t'ju jepen pasi kjo do t'ju shpëtojë nga shumë telashe më vonë. Kërkojini sa më herët, në fillim të hetimit, pasa se të dyshuarit të kenë shfrytëzuar rastin për të mbledhur mendjen dhe planifikojnë një taktikë të re të tyre.

Të dhënat e komunikimeve – Ushtrimi 1

Ky ushtrim përdor seksionet e Studimit të Rastit 1 – Shfrytëzimi i punës.

Duhet të printoni pjesët e mëposhtme të studimit të rastit:

- Seksioni 3.1 'Zbulimi i inspektorëve'.
- Seksioni 3.2 'Raporti i inspektorëve'.

Ndani klasën në grupe të vogla.

Shpërndani ekstraktet nga Studimi i rastit 1 – Shfrytëzimi i punës.

Kërkoni nga grupet që të lexojnë ushtrimin dhe të vendosin nëse dhe në ç'mënyrë mund të zbatohen të dhënat e komunikimeve të SIT në rastin në fjalë.

Lejoni që të diskutojnë midis tyre për 10 minuta dhe mblidhni të gjithë në një grup duke u bërë pyetje nxitëse sipas metodës suaj të parapëlqyer.

Informacioni për nxitjen e diskutimeve

Seksioni 3.3 i Studimit të rastit 1 – Shfrytëzimi i punës ('Faza e parë e hetimit') jep disa udhëzime të dobishme për nxitjen e diskutimeve.

Një informacion shtesë, që mund të jetë i dobishëm, përfshin edhe:

- Meqenëse numrat që kemi gjetur në celular dalin të jenë numra biznesi, ka mundësi që ata të kenë gjeneruar një sasi të konsiderueshme informacioni.

- Informacioni është i kufizuar tani për tani, por do të jetë me interes të shënohet nëse ndonjë nga numrat e kapur flet për një kontakt jashtë vendit – kjo mund të jetë me vlerë për ndjekjen nga ana e inspektorit të ndonjë shenje të ‘gjuhës së huaj’.
- Detajet mbi abonentin e telefonit mund të ndihmojnë të ndërtohet një pamje se kush i kontrollon aktivitetet në atë fermë.
- Janë me rëndësi të gjitha llojet e detajeve mbi furnitorët e fermës dhe blerësit e vezëve të tyre. Ata mund të jenë një burim dëshmish, ose mund të bëhen bashkëpunëtorë. Këto të dhëna mund të jenë me shumë vlerë, kur do të duhet të ndërtohet profili financiar i fermës. Po ashtu, kjo mund të ndihmojë të përcaktohen dallimet midis asaj që mund të jetë e ligjshme dhe asaj që mund të jetë e paligjshme.
- Mund të arrihet që të identifikohet një aktivitet i pazakonshëm telefonik pas vizitës së inspektorëve, gjë që do të sugjeronte se personeli i fermës është i frikësuar se mos janë pikasur nga inspektorët.

6. Vëzhgimi

6.1 Kohëzgjatja

30-40 minuta.

6.2 Mësimdhënia

Prezantim didaktik i seksionit të mëposhtëm 'Informacion për trainuesin', i ndjekur nga një ushtrim mbi rastin.

6.3 Informacion për trainuesin

Vështrim i përgjithshëm

Vëzhgimi është një taktikë e përdorur shpesh nga hetuesit. Një problem që lind në këtë rast është se vëzhgimi, të paktën për disa lloje, mund të duket sikur mund ta kryejë gjithkush. Megjithatë, ashtu si dhe me të gjitha teknikat e tjera SIT, vëzhgimi duhet të kryhet vetëm nga një personel i trainuar posaçërisht për këtë taktikë. Vëzhgimi mund të menaxhohet dhe drejtohet nga hetuesit që punojnë ngushtë me specialistë të trainuar.

Meqenëse TQNJ mund të jetë e ndryshme nga krimi i përgjithshëm, ka rëndësi që menaxherët e hetimit të informojnë oficerët e vëzhgimit mbi çështje të tilla si, identifikimi kur dikush është në rrezik dhe se çfarë masash kontrolli duhen ushtruar mbi viktimën.

Ekzistojnë një numër formash vëzhgimi, që përfshijnë:

- Pikat statike të vëzhgimit.
- Ndjekja me këmbë.
- Ndjekja me mjet levizës.
- Mjetet elektronike të vëzhgimit.
- Vëzhgimi ndërhyrës.

Pikat statike të vëzhgimit

Siç nënkupton dhe termi, këtu flitet për pika fikse të vëzhgimit. Ato vendosen, përgjithësisht, nëpër ndërtesa që mundësojnë një pamje të veprimtarisë nën vëzhgim. Aty mund të vendoset një personel, ose mund të bëhet monitorimi apo regjistrimi nga larg.

Ndjekja me këmbë

Këtu flitet thjesht për një ndjekje me këmbë të dikujt. Përgjithësisht, ajo realizohet nga një ekip që e realizon ndjekjen me radhë për të ndjekur një të dyshuar me qëllim që ky i fundit të mos dyshojë se është duke u ndjekur.

Vëzhgimi me mjet lëvizës

Kjo nënkupton përdorimin e mjeteve lëvizëse për të ndjekur të dyshuarit. Më së shumti, kjo është ndjekja e personave, të cilët lëvizin dhe vetë me mjet, por që mund të lëvizin edhe në këmbë.

Vëzhgimi i fshehtë rural

Është i ngjashëm me vëzhgimin statik, por që kryhet në mjedise të hapura, si lulishte, fusha dhe pyje.

Ndjekja me mjete elektronike

Kjo do të thotë vendosja e mjeteve përgjuese në mjetin lëvizës dhe ndjekja e lëvizjes së tyre.

Vëzhgimi ndërhyrës

Nënkupton vendosjen e mjeteve të fshehta në një mjedis privat për të dëgjuar, parë, regjistruar apo filmuar të dyshuarin.

Çështjet kyçe

Disa nga çështjet kyçe që duhen mbajtur parasysh kur kryhet teknika e vëzhgimit:

- A është i nevojshëm realisht vëzhgimi? Për disa detyra bazike, është e mundur që të përdoren veprimtaritë policore rutinë. Këto mund të përfshijnë patrullime të rregullta në kërkim të disa provave, si për shembull, targat e automjeteve, ose ndalimin e mjeteve për kontrollë, në dukje, rutinë. Kriminelët e të gjitha llojeve janë të mësuar me veprimtarinë rutinë të policisë, dhe mund ta konsiderojnë atë sikur nuk bëhet posaçërisht për të. Po këto konsiderata mund të përdoren për përdorimin e aviacionit policor, gjë që zbatohet rregullisht në shumë vende.
- Në shumë vende përdoret sot CCTV (televizioni me qark të mbyllur) për të monitoruar veprimtarinë në kohë reale. Kjo teknikë është realisht e padiktueshme nga 'shënjestra' dhe mund të pakësojë mbështetjen mbi teknikat që mund të diktohen më lehtësisht nga të dyshuarit.
- Mbrojtja e detajeve mbi vendndodhjen e pikës së vëzhgimit është gjithmonë shumë e rëndësishme, por kjo mund të jetë akoma më me vlerë për rastet e TQNj, pasi ka të

Ushtrim

Ndani klasën në grupe të vogla.

Shpërndani Burimin mediatik 2 – Ushtrimi me Vëzhgimi i trafikimit të punës.

Në rast se nuk e keni përdorur ende Studimin e Rastit 1 – Shfrytëzimi i punës, shpërndani pjesët e mëposhtme të studimit të rastit:

- Seksioni 3.1 'Zbulimi i inspektorëve'.
- Seksioni 3.2 'Raporti i inspektorëve'.

Përndryshe, informoni studentët mbi përmbajtjen e dy seksioneve si më lart.

Kërkoni nga secili grup që të studiojë të gjitha format e mëposhtme të vëzhgimit:

- Pikat statike të vëzhgimit.
- Ndjekja me këmbë.
- Ndjekja me mjet lëvizës.
- Vëzhgimi i fshehtë rural.
- Ndjekja me mjet elektronik.
- Vëzhgimi ndërhyrës.

Duke mbajtur parasysh rrethanat për të cilat flet rasti, studentët duhet të identifikojnë:

- Përparësitë e teknikës 'së tyre'.
- Mangësitë e kësaj teknike.
- Rekomandimet dhe mendimet e tyre nëse ajo teknikë është e përshtatshme për këtë rast dhe në këtë fazë.

Informacion për nxitjen e debatit

Pikat statike të vëzhgimit (PV-të)

- Ka shumë ndërtesa që ofrojnë mundësi për vendosjen e PV-ve.
- Asnjëra nga këto ndërtesa nuk të jep një pamje të drejtpërdrejtë të fermës (me ndonjë përjashtim të disa shtëpive me pamje nga jugu).
- Objektivi më i besueshëm për vendosjen e një PV është që të merren hollësi mbi automjetet që lëvizin lart e poshtë rrugës për në fermë – meqenëse është e vetmja rrugë për tek ferma, dhe e vetmja mënyrë për të hyrë dhe dalë, dhe ka shumë mundësi që këto mjete të jenë të lidhura me aktivitetet në fermë.
- Tani për tani nuk e dijmë nëse njerëzit që banojnë apo punojnë brenda ndërtesave pranë, i njohin apo janë miq me personat që drejtojnë fermën.
- Nuk rekomandohet që të përdoren PV-të nëpër ndërtesat që banohen nga të tjerët.

Ushtrim

Ndani klasën në grupe të vogla.

Shpërndani ushtrimin e rastit – **Vëzhgimi i trafikimit për punë të detyruar**.

Në rast se nuk e keni përdorur ende Studimin e Rastit 1 – Shfrytëzimi i punës, shpërndani pjesët e mëposhtme të studimit të rastit:

- Seksioni 3.1 'Zbulimi i inspektorëve'.
- Seksioni 3.2 'Raporti i inspektorëve'.

Përndryshe, informoni studentët duke u dhënë përmbajtjen e dy seksioneve si më lart.

Kërkoni nga secili grup që të studiojë secilën nga format e mëposhtme të vëzhgimit:

- Pikat statike të vëzhgimit.
- Ndjekja me këmbë.
- Ndjekja me mjet lëvizës.
- Vëzhgimi i fshehtë rural.
- Ndjekja me mjet elektronik.
- Vëzhgimi ndërhyrës.

Duke mbajtur parasysh rrethanat për të cilat flet rasti, studentët duhet të identifikojnë:

- Përparësitë e teknikës 'së tyre'.
- Mangësitë e kësaj teknike.
- Rekomandimet dhe mendimet e tyre nëse ajo teknikë është e përshtatshme për këtë rast dhe në këtë fazë.

Informacion për nxitjen e debatit

Pikat statike të vëzhgimit (PV-të)

- Ka shumë ndërtesa që ofrojnë mundësi për vendosjen e PV-ve.
- Asnjëra nga këto ndërtesa nuk të jep një pamje të drejtpërdrejtë të fermës (me përjashtim të disa shtëpive me pamje nga jugu).
- Objektivi më i besueshëm për vendosjen e një PV është që të merren të dhëna mbi automjetet që lëvizin lart e poshtë rrugës për në fermë – meqenëse është e vetmja rrugë për tek ferma, dhe e vetmja mënyrë për të hyrë dhe dalë, dhe ka shumë mundësi që këto mjete të jenë të lidhura me aktivitetet në fermë.
- Tani për tani nuk e dijmë nëse njerëzit që banojnë apo punojnë brenda ndërtesave pranë, thjesht i njohin apo janë miq me personat që drejtojnë fermën.
- Nuk rekomandohet që të përdoren PV-të nëpër ndërtesat që banohen nga të tjerët.

- Duket se ekziston të paktën një njësi tregtare bosh, e cila mund të ofrojë mundësi për të vendosur një PV.
- Mund të ketë mundësi që të vendoset kamera që operojnë/regjistrojnë nga larg CCTV në një nga ndërtesat pranë fermës.
- Duket se ekziston një kamera CCTV e vendosur në një ndërtesë (një bar) që u përmend më parë. Kjo do të thotë se mund të ketë tashmë regjistrime tek kjo kamera, ose ajo mund të na shërbejë në të ardhmen.

Ndjekja me këmbë

- Aktualisht nuk kemi ndonjë informacion që të sugjerojë se është e nevojshme që të ndiqet dikush.
- Mundësia kryesore duket se është që thjesht të kalohet pranë fermës duke ndjekur një shteg – informacioni i dhënë sugjeron që ky shteg përdoret rregullisht.
- Kjo mund të japë një mundësi që të vëzhgohet aktiviteti në fermë. Por më realisht, gjithsesi, taktika do të lejojë përfitim të numrave të regjistrimit të automjeteve.
- Në rast se në këtë zonë kryhen rregullisht patrullime të policisë, mund të merren informacione nga oficeret e patrullës. Por, ndalimi i patrullimeve të rregullta mund të zgjojë dyshime se meqenëse policia nuk po vepron hapur, është duke ndërmarrë veprime të fshehta.

Ndjekja me mjet lëvizës

- Mund të lindë mundësia që të identifikohen automjetet pasi largohen nga ferma dhe të ndiqen.
- Problemi kryesor këtu është që nuk ka një objektiv të qartë – ndjekja me automjet mund të mos japë në këtë fazë informacion të dobishëm në krahasim me informacionin që mund të përftohet thjesht nga regjistrimi i numrit të targës së këtyre automjeteve.
- Po të përdoren numrat e targave të automjeteve, atëherë informacioni i përftuar në këtë mënyrë mund të kombinohet me informacionin fillestar të marrë nëpërmjet pikave statike të vëzhgimit (PV-ve), duke dhënë hollësi të mëtejshme mbi automjetet, kur janë në lëvizje, drejtimin për nga lëvizin, etj. Kjo do t'u lejojë njësitë të vëzhgimit lëvizës të qendrojnë "larg" rrugëve, por në pikën e kryqëzimit më të afërt.
- Mund të realizohet përdorimi si i pikave statike PV ashtu dhe i atyre të vëzhgimit lëvizës për të identifikuar automjetet që duhen ndaluar dhe kontrolluar nga patrullat lëvizëse me uniformë, për një kontroll në dukje rutinë. Kjo taktikë është e dobishme, por nuk duhet të teprohet me përdorimin e saj, pasi mund të alarmohen subjektet që janë nën shënjestrën e policisë.

Pika e fshehtë e vëzhgimit rural (CROP)

- Në afërsi të fermës ka me siguri një numër mundësish për të vendosur një CROP.
- Përparësia e vendosjes së një CROP është se do të japë një rreze më të gjërë pamjeje mbi atë se ç'është duke ndodhur në fermë.

- Vendosja e një CROP-i në këtë zonë mund të jetë disi e vështirë, sepse megjithëse ka një numër ndërtesash që e kanë drejtimin e shikimit nga ferma, vetë ferma është e vendosur në një zonë plot me ndërtime, gjë që mund të çojë në zbulimin e CROP-it.

Hartëzimi elektronik

- Është i mundshëm, pasi kemi tashmë një informacion që rreth e rrotull lëvizin automjete.
- Problemi më i madh është se çfarë do të arrihet në rast se përdoret kjo formë vëzhgimi me informacionin që kemi konkretisht në dorë.
- Kjo mund të jetë një taktikë e vështirë për t'u vënë në jetë, dhe në disa rrethana mund të rrezikojë që të zbulohen teknikët që merren me instalimin e pajisjes.

Vëzhgimi ndërhyrës

- Përparësia e kësaj teknike është se ajo do të na mundësojë sigurimin në kohë reale të informacionit.
- Mangësia më e madhe është se mund të jetë jashtëzakonisht e vështirë dhe të harxhohet shumë kohë për ta instaluar pajisjen me saktësi. Ky është veçanërisht rasti kur ndërtesa është e banuar 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, siç mund të jetë rasti në situatën që po shqyrtojmë.

7. Informatorët dhe agjentët sekretë

7.1 Kohëzgjatja

30-40 minuta

7.2 Mësimdhënia

Prezantim didaktik i “Informacioni për trainuesin”, si më poshtë, i pasuar nga një ushtrim mbi rastin.

7.3 Informacioni për trainuesin

Të përgjithshme

Nga të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit në botë përdoren informatorë të njërit lloj apo tjetër.

Agjentët e fshehtë përdoren më rrallë, por çdo juridiksion kombëtar i përdor ata në një farë forme.

Si informatorët ashtu dhe agjentët e fshehtë u sigurojnë informacionin e përftuar drejtpërdrejt agjencive të zbatimit të ligjit, që shpesh është i pamundur ose i vështirë për t’u siguruar ndryshe.

Dallimi bazë midis të dyve është që informatorët nuk punësohen drejtpërdrejt nga agjencitë e zbatimit të ligjit (megjithëse mund të paguhen për informacionin e dhënë); dhe agjentët e fshehtë janë personel të zbatimit të ligjit, që (përgjithësisht) infiltrohen në rrjetet kriminale.

Llojet e informatorëve

Përgjithësisht, ekzistojnë katër lloje kryesore informatorësh. Ata janë:

- Pjesë e publikut.
- Viktima të krimit.
- Anëtarë të rrjeteve kriminale.
- Anëtarë të agjencive të zbatimit të ligjit.

Kjo e fundit ka nevojë për një shpjegim të vogël. Një ‘anëtar i një agjencie të zbatimit të ligjit’ nuk do të thotë një agjent sekret. Ai/ajo është dikush që gjatë kryerjes së detyrave normale të punës siguron informacion për hetuesit. Ata, përgjithësisht, nuk marrin pagesë shtesë për këtë informacion, por mund t’u jepen detyra ashtu sikurse dhe informatorëve të tjerë (shih më poshtë).

Si përdoren informatorët

Kjo varet nga informatori dhe nga procedurat dhe legjisllacioni i jurisdiksionit në fjalë.

Informatorët mund të rekrutohen ose mund të jenë persona që ofrojnë informacion për një sërë arsyesh.

Informatorëve mund t'u jepen 'detyra', me fjalë të tjera, udhëzime për të gjetur ndonjë të dhënë të veçantë. Normalisht, informatori të cilit i është dhënë 'detyra', rekrutohet zyrtarisht më parë si pjesë e një programi të strukturuar dhe të menaxhuar. Informatorët e ngarkuar me 'detyra' tipike janë ata që operojnë brenda një rrjeti kriminal ose janë afër me këto rrjete.

'Detyra' mund t'u caktohet, gjithashtu, informatorëve në një agjenci zbatimi të ligjit. Për shembull, inspektorëve të punës mund t'u kërkohet që të bëjnë një inspektim në dukje rutinë dhe t'u raportojnë agjencive të tjera gjetjet e tyre.

Si përdoren agjentët sekretë

Një dallim thelbësor midis një agjenti të fshehtë dhe një informatori është se ky i fundit ka një farë marrëdhënieje që ka ekzistuar më parë me individin ose grupin rreth të cilëve ai do të sigurojë informacionin e kërkuar. Kjo mund të bazohet mbi një fakt të thjeshtë që informatori banon pranë vendit ku kryhet veprimtaria kriminale deri tek qenia një anëtar pjesëmarrës në atë aktivitet kriminal. Është e qartë, që një agjent i fshehtë, duke qenë pjesë e zbatimit të ligjit, nuk e ka këtë marrëdhënie. Për këtë arsye, ata duhet t'u prezantohen të tjerëve/grupit në një farë mënyre.

Futja e një agjenti të fshehtë në një rrjet kriminal është një detyrë e koklavitur dhe e vështirë, e cila duhet të realizohet vetëm nga një personel i trajnuar dhe me përvojë. Në thelb, prezantimi ka të bëjë me një seri prezantimesh të një personi tek një tjetër, për rreth katër apo pesë prezantime me radhë; është shumë e vështirë që rrjetet kriminale të arrijnë të diktojnë nëse 'i porsaardhuri' është një agjent sekret.

Agjentët e fshehtë kanë atë që quhet 'legjendën' e vet pas tyre: një histori se kush janë, çfarë kanë bërë në të kaluarën, etj. Këto, shpesh, janë shumë të ndërlikuara dhe kërkojnë aftësi të mëdha për të ndërtuar një legjendë bindëse dhe të veprojnë sipas saj.

Agjentët e fshehtë përdoren në thelb në të njëjtën mënyrë si dhe një informator me 'detyrë', d.m.th. për të siguruar pjesë specifike informacioni. Përparësia e një agjenti sekret mbi informatorin është se ka një mundësi më të madhe që detyra e të parit të realizohet, madje kur arrihet një rezultat, ai do të jetë i një standardi më të lartë.

Çështjet kyçe

- Arsyeja kryesore e përdorimit të informatorëve dhe të agjentëve të fshehtë është ajo e përmendur më lart: sigurimi i informacionit i cili do të ishte i vështirë, ose i pamundur të merrej në forma të tjera.
- Natyra e disa llojeve të TQNj (shume njerëz të përfshirë dhe nevoja për të ndërvepruar më pas me një shoqeri të ligjshme) tregon që ekzistojnë më shumë mundësi për të rekrutuar informatorë dhe vendosur më shumë agjentë, se sa për krimet e tjera.
- Informacioni sigurohet shpejt me informatorët dhe agjentët e fshehtë dhe me pak kosto.
- Përdorimi i informatorëve dhe i agjentëve sekretë nuk kërkon teknika të shtrenjta.
- Informatori ose agjenti sekret mund të ndodhet në pozicion shumë të zbuluar, dhe madje, të përfshihet në marrëdhënie me persona të rrezikshëm, që mund të përbëjë një rrezik serioz, ndoshta dhe në humbje jete, në rast se zbulohet. Siguria e jetës së një informatori apo agjenti sekret duhet të jetë përherë përparësia juaj më e parë.
- Është gjithmonë vështirë të mbrohet identiteti i informatorit, madje ndonjëherë e pamundur.
- Informatorët mund të kenë motive që mund të shkojnë kundër interesave të hetimit.
- Marrëdhënia midis një informatori dhe atyre që e menaxhojnë atë mund të jetë problematike. Ka një ngasje të mundshme për të kaluar nga një rol pasiv në atë aktiv (në atë të agjentit provokator) për të siguruar një rezultat. Gjithashtu, informatori mund të bëjë përpjekje që të nxjerrë informacione nga menaxhuesi i zbatimit të ligjit.
- Një informator, që është pjesë e një rrjeti kriminal, mund të vazhdojë të bëjë krim, duke përdorur ndonjëherë si justifikim se ai është në rolin e tij si informator.
- Menaxhimi si duhet i informatorëve mund të kërkojë kohë, veçanërisht nëse bëhet fjalë për ata me histori krimi dhe një mënyrë jetese kaotike, pjesë e së cilës ata shpesh janë.
- Në rastin e agjentëve sekretë mund të dalë nevoja që ata të kryejnë vepra kriminale për të vendosur “kredencialet” e tyre në radhët e rrjetit kriminal. Ky është qartësisht një kërcënim i mundshëm për integritetin e një hetimi dhe të procedurave gjyqësore në vijim. Një këshillë e përgjithshme për këtë rast, do të ishte:
 - Akti kriminal mund të kryhet vetëm kur nuk ka asnjë rrugëdalje tjetër.
 - Agjentët e fshehtë duhet të autorizohen për të kryer një akt të tillë, para se ta kryejnë atë.
 - Çdo autorizim i tillë duhet të marrë parasysh kërkesat dhe kufizimet ligjore të jurisdiksionit ku punohet.
 - Mendoni edhe inskenime të akteve “të sajua, në dukje”, p.sh. dorëzimi i një objekti që duket se ka qenë i vjedhur dhe tani po dorëzohet, në një kohë kur objekti nuk është i vjedhur.
 - Agjentët sekretë asnjëherë nuk duhet të thonë se janë të gatshëm për shfrytëzimin seksual.
 - Agjentëve sekretë u duhet vënë detyra e zbulimit të provave të veprimtarisë kriminale para mbërritjes së tyre tek një rrjet kriminal; kjo do t’u hiqte mundësinë e akuzave “agjentit provokator” gjatë seancave dëgjimore gjyqësore.
 - Sa herë të jetë e mundur, agjentët sekretë duhet të mbledhin prova sipas standardeve gjyqësore të provave; është veçanërisht e rëndësishme që të konfirmohen, mbështeten provat e mbledhura nga agjentët sekretë.

Ushtrim

Ky ushtrim përdor Studimin e Rastit 1 – Shfrytëzimi për punë.

Pyeteni klasën nëse, duke marrë për bazë njohuritë e fituara nga Studimi i Rastit 1, ekzistojnë mundësi për të përdorur në këtë rast informatorë apo agjentë të fshehtë, dhe cilat do të ishin të mirat dhe të metat e përdorimit të secilit prej tyre.

Lista e mëposhtme nuk është shtruese. Duhet të theksohet fort, gjithashtu, se rreziqet që shoqërojnë përdorimin e këtyre taktikave duhet të shqyrtohen imtesisht para se të përdoren.

Veçanërisht duhet mbajtur parasysh, që agjentët sekretë nuk duhet të përdoren në rast se nuk janë të trainuar specifikisht për detyrën, dhe nëse nuk menaxhohen e mbështeten në rolin e tyre.

Duket se ekzistojnë mundësitë e mëposhtme:

Inspektorët e punës

Përparësitë – ata ka shumë mundësi që të marrin më shumë informacion duke qenë brenda fermës dhe pa tërhequr shumë vëmendjen e të tjerëve.

Mangësitë – ata nuk janë të trainuar dhe mund të ndodhen në situata të rrezikshme. Ndërkohë që trafikantët e dyshuar mund të mos dyshojnë për inspektorët e punës, vetë sjellja e inspektorëve të punës mund të bëjë që trafikantët të dyshojnë se po planifikohet ndonjë formë e ndërhyrjes së civilëve apo të administratorëve të shtetit. Ata mund të alarmohen dhe mund të largojnë viktimat.

Banorët afër fermës

Përparësitë – ata janë afër vendit (fermës) dhe ka mundësi që të japin informacion cilësor rreth lëvizjeve përreth dhe brenda fermës.

Mangësitë – ata mund ta njohin fermerin dhe mund t'i tregojnë se çfarë po përpiqen të bëjnë zbatuesit e ligjit. Ata nuk janë të trainuar mbi si kryhen vëzhgimet dhe mund të zbulohet shpejt se janë, në fakt, duke ndjekur dhe vëzhguar se çfarë po ndodh në fermë. Gjithashtu, duke qene se janë shumë pranë kriminelëve të dyshuar, mund të shndërrohen në objekt sulmesh apo kërcënimesh.

Pronarët e dyqaneve dhe bizneseve të tjera në zonë

Përparësitë – të ngjashme me ato të “banorëve”, me një përparësi plus që ata mund të jenë në një pozicion që të vëzhgojnë gjatë gjithë ditës, në një kohë që banorët nuk e kanë këtë mundësi. Përveç kësaj, pronarët mund të kenë ndonjë lidhje tregtare me fermën apo me menaxherët e fermës, gjë që shton mundësi të mira për hetimin.

Mangësitë – gjithashtu të ngjashme me “banorët”, por me një mangësi të shtuar që nëse kanë marrëdhënie tregtare me fermën, ata mund të kenë interes që t’u tregojnë menaxherëve të fermës se ç’kanë ndërmend të bëjnë zbatuesit e ligjit, duke mbrojtur kështu interesat e biznesit të tyre.

Pjesëmarrësit në krim

Përparësitë – duke qenë se janë të përfshirë vetë në operacion, ata kanë mundësi që të japin informacionin më të mirë.

Mangësitë – është gjithmonë shumë e vështirë që të rekrutohen informatorë të tillë, dhe duke u nisur nga të dhënat për rastin në fjalë, duket se në këtë fazë nuk ka shumë informacion që mund të përdoret për të identifikuar informatorë të mundshëm. Nga ana tjetër, ky proces zakonisht merr shumë kohë për t’u realizuar dhe në rastin tonë, duket se nuk do të ketë nevojë për ndonjë operacion “shpëtimi”, në kuptimin që nuk ka shumë kohë në dispozicion. Mund të paraqiten sfidat e zakonshme për menaxhimin e informatorëve të tillë.

Agjentët e fshehtë

Përparësitë – duke qenë se janë oficerë të zbatimit të ligjit, ata do të jenë mbledhësit më të besueshëm të provave. Mund të shfrytëzohet edhe mundësia e një ndërhyrjeje shumë të thjeshtë të një agjenti, duke e vendosur atë në rolin e klientit të fermës. Duke qenë se janë agjentë të trajnuar, ata kanë më shumë mundësi se informatorët e tjerë që të identifikojnë dhe të merren me rreziqet.

Mangësitë – përdorimi i një agjenti sekret për diçka si një vizitë e thjeshtë në fermë, siç e përshkruam më lart, ka të ngjarë që të shpenzojë kohë të tepërt dhe të jetë e ndërlikuar. Për rastin që kemi në dorë, nuk duket se ka nevojë që në këtë fazë të përdorim këtë lloj informatori.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1	Audienca e synuar	6
1.2	Objektivat e të mësuarit	6
1.3	Njohuritë e mëparshme	6
2.	Regjistrat e vendimeve	7
2.1	Kohëzgjatja	7
2.2	Mësimdhënia	7
2.3	Informacioni për trainuesin	7
3.	Apendiksi A – Regjistri i paplotësuar i vendimeve	10
4.	Apendiksi B – Regjistri i plotësuar i vendimeve	21

1. Hyrje

Në një regjistër vendimesh regjistrohen ngjarjet që ndodhin gjatë procesit të hetimit, pra një regjistrim i vendimeve të marra në lidhje me si duhet reaguuar ndaj atyre ngjarjeve, dhe i shënimeve mbi arsyet (logjikën) që qendron pas vendimeve të marra.

Forma e saktë dhe përdorimi i regjistrave të vendimeve shpjegohet me hollësi më poshtë. Në përmbledhje:

- Regjistrat janë mbajtja e shënimeve të njëpasnjëshme të ngjarjeve, vendimeve dhe të logjikës së përdorur në mbështetje të vendimeve të marra.
- Ato janë, përgjithësisht, në formën e blloqeve të shënimeve.
- Këto blloqe kanë një numër të vetëm reference.
- Në rastet kur ka më shumë se një bllok shënimesh, blloqet e tjera që përdoren për të njëjtin rast hetimor, shënohen me një numër reference pasardhës.
- Në përgjithësi, regjistrat e vendimeve nuk paraqiten si provë në gjyq. Gjithsesi, ato nuk janë të pazbulueshme për gjykatën, përfshirë dhe mbrojtjen.
- Në përgjithësi, një regjistër vendimesh do të mbahet nga hetuesi kryesor, por edhe nga, për shembull, menaxherët e skenës së krimit dhe prokurorët.

Mbajtja e regjistrave të vendimeve është një praktikë e mirë kur hetohet skena e krimit të rëndë. Përparësitë e mbajtjes së tyre përfshijnë:

- Zotërimi i një regjistrimi të auditueshëm.
- Sigurimi që të mos ketë përpjekje të dyfishta të panevojshme.
- Ndhima për menaxherët e hetimit që të ruajnë një qasje logjike ndaj ngjarjes.
- Ndhima për hetuesit që menaxhohen nga hetuesi kryesor, që ata të kuptojnë se çfarë kërkohet prej tyre.
- Lejimi i sugjerimeve dhe i rishikimeve të shënimeve nga të tjerët.
- Mundësia që u ofrohet gjykatave që të kenë një pasqyrë transparente të veprimeve të ndërmarra.

Megjithatë, ekzistojnë edhe sfida që përfshijnë:

- Mundësinë e kritikave në rast se ngjarjet, etj., nuk merren parasysh, apo është marrë një vendim i gabuar.
- Përdorimin e regjistrat të vendimeve nga pala mbrojtëse për të identifikuar taktikat dhe teknikat hetimore të përdorura.
- Vështirësitë në gjyq që mund të lindin nëse regjistri i vendimeve nuk pasqyron ato çfarë janë paraqitur si prova.

Ju mund të përdorni regjistrin e vendimeve ose diçka të ngjashme me të në juridiksionin tuaj. Mund të ndodhë që në disa juridiksione ato të mos lejohen në formatin që kemi paraqitur këtu.

Megjithatë, edhe nëse nuk i përdorni këto regjistra, vetë procesi i të menduarit që të imponon mbajtja e tyre, është provuar botërisht të jetë shumë i dobishëm.

1.1 Audiencia e synuar

Ky leksion është kryesisht për ata që kanë një rol në menaxhimin e hetimit të TQNj, përfshirë:

- Oficerët e policisë.
- Prokurorët.
- Hetuesit.

1.2 Objektivat e mësimit

- Nënvizimi i sfidave që ndeshen gjatë intervistave përzgjedhëse të rasteve të TQNj.
- Përcaktimi i qëllimit të një interviste përzgjedhëse të TQNj.
- Rifreskimi i elementeve bazë të modelit PEACE të intervistimit.
- Përshkrimi i modelit PEACE dhe i zbatimit të tij për intervistat përzgjedhëse të TQNj.
- Shpjegimi i qasjeve të ndryshme që kërkohen për intervistat e planifikuara dhe të paplanifikuara përzgjedhëse.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Pritet që nxënësit të kenë njohuri bazë mbi hetimet e rasteve të TQNj, të fituara nga mësimet e mëparshme të këtij programi, apo nga përvoja e tyre në terren.

2. Regjistrat e vendimeve

2.1 Kohëzgjatja

30-40 minuta

2.2 Mësimdhënia

Prezantimi didaktik 'Informacioni për trainuesin' (më poshtë pika 2.3), i ndjekur nga një ushtrim mbi rastin.

2.3 Informacion për trainuesin

Appendiksi A është një shembull i një regjistri vendimesh, i thjeshtë dhe i paplotësuar. Do të vini re se ai përmban 10 faqe, për t'ju lejuar që ta printoni dhe ta përdorni për ushtrimet. Rekomandohet që, nëse është e mundur, ta printoni nga të dy anët që t'ju ndihmojë juve dhe studentëve për të siguruar një koncept më të përmbledhur e të qartë.

Ju mund të vendosni që ta përdorni këtë format në mënyrë operationale, i cili përdoret nga Policia Metropolitane e Londrës dhe është shumë i ngjashëm me regjistrat e vendimeve të përdorura nga forcat e tjera të policisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në vendet e tjera të botës.

Faqja e parë tregon:

- Kur ka filluar regjistrimi.
- Kur ka mbaruar regjistrimi.
- Numrin sekuencial të bllokut të shënimeve (kur është pjesë e një serie)
- Numrin e referencës së rastit.

Faqet e brendshme ndjekin të njëjtin model.

Faqja në të majtë është Ditari i Hetimit. Kjo ka kolona ku hidhen shënimet (nga e majta në të djathtë):

- Data dhe ora.
- Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.
- Numri i vendimit.

Faqja në të djathtë është faqja e vendimeve. Kjo ka hapësirë për të regjistruar (nga e majta në të djathtë), si më poshtë:

- Numrin e vendimit.
- Arsyet e përdorura në mbështetje të vendimit.

Koncepti që duhet të respektohet këtu është që çdo ngjarje e shënuar në faqen e majtë do të duhet të përputhet me vendimin e shënuar në faqen e djathtë.

Apendiksi B është një regjistër vendimesh i plotësuar pjesërisht. Ai përdor Ushtrimin me Rastin 2 – Shfrytëzimi seksual dhe tregon se si mund të plotësohet një regjistër vendimesh. Rekomandohet që ta printoni nga të dy anët për të lehtësuar perceptimin pamor të konceptit. Zërat tek shembulli i plotësuar, sigurisht që shënohen me shtyp. Megjithatë, regjistrat e vendimeve do të jenë përgjithësisht dokumente fizike, të plotësuara me dorë.

Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.

Këtu trajtohen të gjitha çështjet që mund të ndodhin gjatë hetimit. Shembujt përfshijnë:

- Raportin fillestar rreth një incidenti apo krimi.
- Cilat njësi u dërguan në skenën e incidentit/krimin.
- Çfarë u raportua, kur mbërritën në vendngjarje.
- Të gjitha veprimet apo hetimet e kryera.
- Rezultatet e këtyre veprimeve/hetimeve.
- Çdo ‘Ngjarje kyçe, etj.’ mbaron me një vendim (shpjegohet më poshtë). Kur mbarojnë veprimet që çojnë në marrjen e një vendimi, ai vendim të orienton drejt një ‘ngjarjeje tjetër kyçe’.

Vendimet – logjika mbështetëse

Vendimet duhet të shpjegohen qart dhe të lidhen me secilën çështje të identifikuar në seksionin ‘Ngjarjet kyçe, etj.’

Logjika mbështetëse është procesi mendor që ka çuar në vendimin e marrë, bazuar mbi informacionin tek ‘Ngjarjet kyçe, etj.’

Apendiksi B jep shembuj se si duhet të ndiqet ky proces.

Ushtrim

Ky ushtrim përdor Studimin e rastit 2 – Shfrytëzimi seksual

Shpërndani kopjet e paplotësuara të Regjistrit të Vendimeve.

Lexoni ose shpërndani Pjesën 1 të Studimit të rastit (thirrja telefonike e nënës në polici).

U thoni studentëve që të plotësojnë regjistrat e tyre duke identifikuar çështjet kyçe, etj., duke dhënë vendimin e tyre dhe duke shpjeguar logjikën që kanë përdorur në mbështetje të atij vendimi.

Jepni dhjetë minuta për të mbaruar ushtrimin.

Shpërndani Apendiksin B (regjistrin e plotësuar të vendimeve).

Lejoni dy minuta që studentët ta lexojnë atë.

Bëni pyetjet e mëposhtme:

- A kanë ndryshime midis vendimeve të studentëve?
- A arritën të identifikojnë çështjet që munguan në Regjistrin e plotësuar të vendimeve?
- Si do t'i modifikojnë shënimet e tyre tani që lexuan Regjistrin e plotësuar të vendimeve?

3. Apendiksi A – Regjistri i paplotësuar i vendimeve

Regjistri i hetimit të krimit

Data e fillimit të regjistrimit	Data e mbarimit të regjistrimit
Numri i regjistrimit	Numri i referencës

Ditari mbi hetimin

Data & ora	Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.	Numri i vendimit

Vendimet

Numri i vendimit	Vendimi - arsyet në mbështetje të tij

Ditari mbi hetimin

Data & ora	Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.	Numri i vendimit

Vendimet

Numri i vendimit	Vendimi - arsyet në mbështetje të tij

Ditari mbi hetimin

Data & ora	Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.	Numri i vendimit

Vendimet

Numri i vendimit	Vendimi - arsyet në mbështetje të tij

Ditari mbi hetimin

Data & ora	Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.	Numri i vendimit

Vendimet

Numri i vendimit	Vendimi - arsytet në mbështetje të tij

Ditari mbi hetimin

Data & ora	Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.	Numri i vendimit

Vendimet

Numri i vendimit	Vendimi - arsyet në mbështetje të vendimit

4. Apendiksi B – Regjistri i plotësuar i vendimeve

Regjistri i hetimit të krimit

Data e fillimit të regjistrimit	Data e mbarimit të regjistrimit
Numri i regjistrimit	Numri i referencës

Ditari mbi hetimin

Data & ora	Ngjarjet kyçe/dislokimet/raporti mbi situatën, etj.	Numri i vendimit
27.05.2014 Ora: 19.13	Znj. Anna Blu nga Grandtaun në Vendin Blu telefonoi dhe tha se i dashuri i vajzës se saj sapo kishte marrë në telefon e kishte thënë se vajza e zonzjës, Monika Blu e kishte marrë atë në telefon dhe i kishte thënë se ndodhej në Vendin e Kuq; se i ishte shitur një burri dhe ishte përdhunuar. Kontrolli që u bë në sistemin e informimit policor në lidhje me detajet e rastit të kallzuar, treguan se nuk kishte asnjë të dhënë rreth Monikës.	1
27.05.2014 Ora: 22.30	<p>Detektivët Smith dhe Xhonson raportojnë si vijon:</p> <p>Përshkrimi i Monika Blu, lindur 19.5.1995. Femër, racë e bardhë, 1.65 e gjatë, lëkurë e çelët, e dobët, flokë kafe, të gjata deri te shpatullat. Është parë herën e fundit veshur me tuta të zeza me rrip të verdhë dhe xhakoventë ngjyrë gri të hapur.</p> <p>Përdoret celulari me numër+38 263 445 671</p> <p>Herën e fundit është parë te adresa e të dashurit. Shih Raportin mbi personin e zhdukur 137/20114 për të dhëna të plota.</p> <p>U sigurua fotografia dhe iu bashkëngjiti raportit mbi personin e zhdukur.</p> <p>Në të gjitha sistemet që u kontrolluan, Monika rezulton si e zhdukur.</p> <p>Anna Blu, lindur më 4.8.1966, banore në rr. 66, Distrikti 33, Grandtaun, Vendi Blu.</p>	2

Vendimet

Numri i vendimit	Arsyet në mbështetje të vendimit
1	<p>Vendimi</p> <p>Detektivët Smith dhe Xhanson shkojnë te shtëpia e znj. Blu dhe e intervistojnë. Arrijnë të marrin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshkrimin e hollësishëm të Monikës për raportimin e personave të zhdukur dhe e dorëzojnë këtë raport. 2. Kur e ka takuar për herë të fundit Monikën. 3. Detajet mbi të dashurin e Monikës. 4. Numrin e telefonit të të dashurit. 5. Pas marrjes së të dhënave, ata kontrollojnë të dhënat mbi t'ëmën, të dashurin dhe Monikën në sistemin e informacionit policor. <p>Arsyetimi i përdorur</p> <p>Tani për tani nuk ka informacion të mjaftueshëm mbi Monikën që të qarkullohet si person i zhdukur, duhen bërë kërkime, apo të ndërmerret ndonjë veprim. Sapo të plotësohet informacioni, duhet të fillojnë kërkimet.</p>
2	<p>Vendimi</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të qarkullohen të dhënat mbi personin e zhdukur në Tokën e Kuqe. 2. Të sigurohen regjistrimet telefonike të telefonit të Monikës, dhe fillimisht të analizohen thirrjet e bëra javën e kaluar. 3. Të dërgohet një kërkesë me përparësi të lartë në Tokën e Kuqe për të marrë detajet e telefonit të klientit dhe të qelizës së thirrjeve që të identifikohet (nëse është e mundur) mbajtësi i telefonit dhe vendndodhja e tij/të saj. 4. Të sigurohet material i ADN i Monikës, nëse është e mundur. 5. A ka kompiuter ajo, apo ka patur mundësi përdorimi të tij? Në rast se po, të sigurohet kompiuteri për t'i bërë analizat e duhura. <p>Arsyetimi i përdorur</p> <p>Informacioni i siguruar sugjeron që ajo është në Vendin e Kuq – kërkimet të bëhen atje me urgjencë. Analiza e regjistrimeve të telefonit të Monikës në Vendin e Kuq flasin për një rekrutim të mundshëm dhe mund të konfirmojnë ose jo atë çka thënë i dashuri. Regjistrimet/kërkimet në Vendin e Kuq do të ngushtojnë rrezën e kërkimit për vendndodhjen e Monikës dhe mund të përcaktojnë se kush është me të. Materiali i ADN do të ndihmojë identifikimin e ardhshëm, nëse nevojitet. Vetë kompiuteri mund të përmbaje detaje të kontaktit me rekrutët e mundshëm, etj.</p>

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat e të mësuarit	5
1.3	Njohuritë e mëparshme.....	6
2.	Njohuritë bazë	7
2.1	Kohëzgjatja	7
2.2	Mësimdhënia.....	7
2.3	Informacion për trainuesin	7
3.	Skenat e krimit të TQNj	12
4.	Menaxhimi i skenave të krimit.....	14
4.1	Objektivat	14
4.2	Arritja e objektivave.....	14
4.3	Veprimet në skenën e krimit	15

1. Hyrje

Shqyrtimi i skenës së krimit në rastet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore është një komponent jetësor i procesit hetimor. Megjithatë, disa ndërlikime që paraqet TQNj si dhe mungesa e të kuptuarit të krimit dhe elementeve të tij, mund të sjellë si rezultat që shqyrtimi i skenës së krimit të mos bëhet me efektivitetin e duhur.

Një nga të mirat e shqyrtimit të kujdesshëm të skenës së krimit të rasteve të TQNj është se ai redukton nevojën e mbështetjes mbi dëshminë e viktimës.

1.1 Audiencia e synuar

Ky leksion është pikësëpari për ata që kanë një rol në menaxhimin e hetimit të TQNj, përfshirë:

- Oficerët e policisë që menaxhojnë hetimet e TQNj.
- Specialistët që merren me teknikat hetimore të specialistit (SIT) që punojnë me rastet e TQNj.
- Prokurorët.
- Hetuesit dhe të tjerët që sigurojnë dhe autorizojnë përdorimin e SIT në hetimet e TQNj.

1.2 Objektivat e mësimit

Me përfundimin e këtij moduli, të gjithë studentët duhet të jenë në gjendje të:

(Këtu flitet për ata studentë që nuk janë profesionistë të zbatimit të ligjit, që nuk janë në frontin e parë të zbatimit të ligjit)

- Përshkruajnë se çfarë është një skenë krimi.
- Shpjegojnë konceptin, “çdo kontakt le pas një gjurmë”.
- Të bëjnë një përmbledhje të “gjurmëve” të gjetura në skenat e krimit.
- Shpjegojnë përse është e rëndësishme për ta në profesionin e tyre që të krijojnë një “ndërgjegjësim për një skenë krimi”.
- Listojnë veprimet që mund të ndërmarrin në ndihmë të ruajtjes së skenave të krimit për një shqyrtim të mëtejshëm të mundshëm.

(Ata që kanë një rol menaxhuesi në skenën e krimit të TQNj)

- Përcaktojnë objektivat e sakta për shqyrtimin e skenave të krimit të TQNj.
- Identifikojnë se si mund të arrihen këto objektiva.
- Përshkruajnë veprimet që duhen bërë në skenat e krimit të TQNj.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Nuk kërkohen njohuri të mëparshme për ata që nuk janë të angazhuar në zbatimin e ligjit, apo nuk janë kontakti i parë për zbatimin e ligjit.

Ata që janë të punësuar në poste që lidhen me menaxhim të skenës së krimit, duhet të kenë një njohuri bazë rreth shqyrtimit të skenës së krimit në rastet kriminale në përgjithësi.

2. Njohuritë bazë

2.1 Kohëzgjatja

5-10 minuta.

2.2 Mësimdhënia

Prezantim didaktik i “Informacion për trainuesin”.

2.3 Informacion për trainuesin

Meqenëse ky material nuk synon vetëm praktikantët e drejtësisë penale, informacioni i mëposhtëm jep mundësi që pjesëmarrësit e angazhuar në luftimin e TQNJ të kenë një ndërgjegjësim më të lartë mbi parimet bazë të nevojës së shqyrtimit të skenës së krimit. Kjo është e rëndësishme për tri arsye:

- Së pari, do të ndihmojë të kalohen vështirësitë që dalin në skenën e krimit dhe të mos dëmtohen provat e mundshme.
- Së dyti, mund të ndihmojë në ruajtjen e provave të mundshme para mbërritjes së ekspertëve të zbatimit të ligjit.
- Së treti, mund t’u lejojë praktikantëve jashtë sistemit gjyqësor penal të identifikojnë më lehtë zonat që mund të paraqesin interes për menaxherët dhe ekzaminuesit e skenës së krimit.

Çfarë është një skenë krimi?

Një skenë krimi është çdo skenë që përmban gjurmë fizike të krimit. Mund të jetë një ndërtesë, një vend, një mjet, ose trupi i një personi.

Më poshtë përshkruhen disa aspekte specifike të skenave të krimit të TQNJ.

Çfarë është shqyrtimi i skenës së krimit?

Shqyrtimi i skenës së krimit është përdorimi i një metode teknike dhe shkencore për të analizuar një skenë krimi, për të lokalizuar dhe mbledhur prova nga çdo lloj gjurme fizike të pranishme në atë skenë.

Parimi “çdo kontakt le pas një gjurmë”

Parimi kryesor shkencor i shqyrtimit të një skene krimi është që, “çdo kontakt le pas një gjurmë”.

Pra, nëse:

- Dikush ka rënë në kontakt me një person tjetër;
- Dikush ka rënë në kontakt me një objekt të veçantë; ose
- Një objekt ka rënë në kontakt me një objekt tjetër;

atëherë do të jetë lënë një farë gjurme mbi atë tjetrin.

Shembujt përfshijnë:

- Një person ka bërë seks me një tjetër – secili transferon material biologjik tek tjetri.
- Një person ulet në një mjet – fibrat nga veshja e këtij personi do të mbeten mbi sediljen e maiknës, dhe materiali i sediljes do të transferohet mbi veshjet e personit.
- Një makinë përplaslet mbi një mur – fragmente të bojës dhe metalit do të gjinden mbi mur, dhe gjurmë tulle apo llaçi do të gjinden mbi makinë.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur të bëhet lidhja e personit me personin, etj.

Përdorimi i parë i këtij procesi të zbatimit të ligjit (nga fundi i shekullit të 19-të) ishte shfrytëzimi i shenjave të gishtave për të identifikuar të dyshuarit dhe për t'i lidhur këto subjekte me krimet e kryera. Që nga ajo kohë, është shënuar një përparim i madh në aspektin e teknikave dhe të teknologjisë të përdorura në zbatim të parimit “çdo kontakt le pas një gjurmë”.

Një zhvillim relativisht i kohëve të fundit, që revolucionarizoi hetimet e krimit, është përdorimi i analizës së Acidit Deoxyribonucleic (ADN). ADN është një molekulë me një kod unik gjenetik. Ai ndodhet në të gjitha indet e gjalla. Kur u zbulua dhe u zbatua për herë të parë për hetimin e krimit, u nevojiten sasi të medha mostrash (për shembull, një sasi e konsiderueshme gjaku) për të arritur një ‘profil’ të saktë të ADN. Me kalimin e kohës, u pakësua sasia e mostrave që kërkohej për analizat, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, është rritur mosha, koha e ruajtjes së materialit nga i cili mund të arrihet tek një profil. Tani është e mundur që të merret një profil nga mostra shumë të vegjël dhe shumë të vjetër (në kohë).

Në rastin e shenjave të gishtave, këto mund të merren nga një numër shumë i madh sipërfaqesh, përfshirë lëkurën, letrën, rrobat. Është bërë një kryqëzim midis shenjave të gishtave dhe ADN në kuptimin që tani është e mundur të merret ADN nga qelizat e lëkurës të pasqyruar te shenjat e gjishtave.

Teknika të tjera të rëndësishme, si imazheria (fotografia) dhe analiza kimike janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme vitet e fundit.

Cilat janë 'gjurmët' që kërkojmë ne?

(Lutem mbani parasysh që lista e mëposhtme nuk është shtruese)

Biologjike

- Gjaku.
- Sperma.
- Pështyma.
- Qelizat e lëkurës.
- Fryma.

Të gjitha këto përmbajnë ADN. Se sa praktike është që të marrësh ADN nga këto gjurmë varet nga një numër faktorësh, përfshirë llojin e materialit, vendin ku është gjetur, kohën që ka kaluar nga ngjarja, sasinë që zotërohet, etj.

Shenjat trupore

Shenja nga:

- Gishtat.
- Këmbët.
- Veshët.
- Buzët.
- Bërrylat.

Shenjat e gishtave janë ato që përdoren më shpesh dhe më gjërësisht, por është arritur që të merren edhe lloje të tjera gjurmësh dhe janë përdorur në formën e provave, megjithëse shenjat nga veshët, buzët dhe bërrylat nuk janë të zakonshme dhe kanë ngjallur kundërshti.

Fibra dhe shenja të tjera mikro

Fibra nga:

- Veshjet.
- Shtretërit.
- Ndenjëset.
- Shtrojet e dyshemesë.
- Peshqira tualeti.

Gjurmë të tjera mikro:

- Xhami

- Boja.
- Metali.
- Farat.
- Dheu.
- Guri.
- Tulla.

Pra, çfarë do të thotë kjo për mua?

Është mëse e qartë që llojet e gjurmave dhe të teknikave që përdoren për t'i marrë ato përbëjnë një mjet të fuqishëm hetimor. Megjithatë, fakti që ato janë bërë kaq materiale të ndjeshme për procesin hetimor, përbën problem më vete.

Vini re që fraza është 'çdo lloj kontakti le pas një gjurmë'. Kjo nuk do të thotë që vetëm kontakti kriminal le pas një gjurmë – edhe ju leni pas gjurmë kudo që shkoni, 24 orë në ditë. Pra, nëse hyni në një 'skenë krimi', gjurmët tuaja do të mbeten aty. Dhe kjo mund të shkaktojë shkatërrimin e provës nëpërmjet ndotjes së saj, por në fund të fundit do ta ndërlikojë më tepër hetimin.

Për arsye të ndryshme ju mund të ndërmerrni veprime të drejtpërdrejta që mund të prishin provën e mundshme.

Në kontekstin e TQNj, më poshtë po japim disa shembuj mbi si mund të ndodhë kjo:

- Ju jeni një punonjës i një OJQ-je që merret me TQNj për shfrytëzim seksual. Një grua ju raporton se është trafikuar për seks dhe dhunuar nga disa burra në një shtëpi publike. Ajo zhvishet në një dhomë private dhe jua jep rrobat e saj, të cilat ju i futni në një sirtar. Ju e pyesni nëse dëshiron të bëjë një dush, ajo thotë po dhe shkon të bëjë dush. Kur prekni rrobat e saj, pak lëkurë nga qelizat tuaja do të transferohen tek to. Dushi do të ketë larguar të paktën pak nga materiali biologjik që është transferuar tek ajo gjatë aktit seksual.
- Ju jeni një inspektor pune në një fabrikë veshjeje. Ju vini re se një nga makinat e qepjes është e vjetër, e ndotur dhe, në dukje, e rrezikshme për të punuar me të. Ju e fikni makinën, tërhiqni prizën dhe fshini pluhurin mbi të për ta parë më mirë dhe nga afër. Duke vepruar kështu, ju do të keni prishur disa nga ish shenjat e gishtave dhe do të keni lënë shenjat e gishtave tuaj.
- Jeni një punonjës social në një fshat. Afrohet një grua në gjendje shumë të dëshpëruar dhe ju thotë se ka marrë një letër nga vajza e saj ku i thotë se po e mbajnë si skllave mbyllur në një shtëpi në një vend të huaj. Ju merrni letrën në dorë, e lexoni dhe ia kaloni dy kolegëve tuaj, e merrni mbrapsht dhe e mbani përsëri në dorë. Ju, ka shumë mundësi, që me shenjat tuaja dhe ato të kolegëve të keni dëmtuar çdo lloj shenje gishtash që do të ishte me interes për hetimin.

Ju duhet të jeni 'të vetëdijshëm se keni të bëni me një skenë krimi', dhe kjo nënkupton që duhet të jeni shumë të kujdesshëm në punën tuaj.

Më poshtë po rendisim disa nga masat e thjeshta që mund t'ju vijnë në ndihmë për këtë:

- Prekini objektet sa më pak të jetë e mundur.
- Në rast se i keni prekur objektet, njoftoni hetuesit për këtë.
- Proveni të merrni këshilla nga njerëz që kanë njohuri mbi shqyrtimin e skenës së krimit para se të ndërmerreni veprimet tuaja.
- Në rast se punoni në një mjedis të caktuar (p.sh. si punonjës OJQ-je që merret me viktimat e shfrytëzuara seksualisht, shembulli më lart) ku, si rregull, ju mund të lidheni me një punonjës të zbatimit të ligjit vetëm nëse kështu dëshiron viktima, kërkoni këshilla mbi të paktën si të ruani objektet që mund të jenë me interes të veçantë për hetimin e mundshëm.
- Ju mund të jeni specialist në një fushë të caktuar, për shembull inspektor shëndeti apo sigurie në punë. Ju mund të jeni në gjendje të vini në dukje se cilat janë disa pjesë specifike të makinerisë, për shembull, që mund të analizohen për të treguar se kush i ka përdorur apo mirëmbajtur ato.

3. Skenat e krimit të TQNj

Skenat e krimit të TQNj paraqesin një numër sfidash specifike, që përfshijnë:

Krimin e TQNj

Ata që janë përgjegjës për shqyrtimin dhe menaxhimin e skenave të krimit mund të jenë me shumë përvojë, por të pavetëdijshëm mbi disa kërkesa të veçanta që lidhen me skenat e krimit të TQNj.

Ka shumë mundësi që në skenën e krimit të gjinden pjesë të veçanta të provave të pakthyeshme dhe inkriminuese, si për shembull një palë shenja të dukshme gishtash mbi një thikë.

Suksesi i një shqyrtimi të skenës së krimit të TQNj përcaktohet nëse realizohet një grumbullim i vazhdueshëm i një sasive të madhe provash të vogla, që në fund do të ndihmojnë në formimin pak nga pak të një pamjeje të plotë të asaj skene.

Skenat e shumëfishta

Pjesa më e madhe e krimeve 'klasike' realizohen në një numër të vogël skenash krimi, përgjithësisht brenda një zone të vogël gjeografike.

Krimi i TQNj mund të ndodhë në shumë skena krimi, të përhapura në një zonë të gjërë dhe nëpër të gjitha fazat e procesit të TQNj, d.m.th., rekrutimi, transportimi dhe shfrytëzimi.

Shpjegimet/tregimet

Për shkak të efekteve traumatizuese të TQNj, shpjegimet e dhëna nga viktimat mund të jenë të ngatërruara dhe kontradiktore, duke e bërë të vështirë identifikimin e skenave të krimit, ose, edhe kur identifikohen ato, të kuptohet se ku dhe çfarë duhet të kërkohet e të hetohet.

Njerëzit

Në 'skenat' e krimit të TQNj mund të jenë të pranishëm shumë njerëz në kohën e shqyrtimit të skenës së krimit. Për shembull, fabrikat, baret dhe vendet e tregtisë së seksit. Kjo e vështirëson menaxhimin e skenës së krimit.

Shumë gjurmë

Kjo lidhet pikërisht me 'njerëzit e pranishëm' për të cilët folëm më lart. Meqenëse vendet e TQNj mund të kenë shumë njerëz që kalojnë nëpër to, mund të ketë shumë shenja gishtërinjsh, apo mostra dhe fibra biologjike të lëna pas.

Kohën

Edhe kjo është e lidhur me 'njerëzit' dhe me 'shumë gjurmë'. Meqenëse shfrytëzimi nga TQNj mund të realizohet përgjatë një kohe të gjatë, ka shumë mundësi që të gjinden shumë e shumë gjurmë nëpër vendet e shfrytëzimit.

Kjo e bën të vështirë menaxhimin e gjurmëve. Gjithsesi, faktori kohë mund të jetë edhe shumë i dobishëm në rastin kur trafikantët mund të pretendojnë se personi në fjalë ka qendruar në atë vend për një kohë shumë të shkurtër (në një kohë kur prania e një numri të madh gjurmësh flet për të kundërtën).

4. Menaxhimi i skenave të krimit

Skenat e krimit të TQNj, sigurisht, kanë shumë ngjashmëri me skenat e tjera të krimit. Megjithatë, ka disa dallime, siç u shpjegua dhe më lart. Dallimet kryesore qendrojnë më së shumti në mënyrën se si duhet të menaxhohet skena e krimit të TQNj. Këto ndahen në tri:

- Objektivat.
- Realizimi i atyre objektiveve.
- Veprimet në skenën e krimit.

4.1 Objektivat

Objektivi i përgjithshëm është që të krijohet një pamje sa më e plotë e asaj çfarë ka ndodhur në një skenë. Mund të ketë me qindra objektiva specifike që ndihmojnë të arrihet objektivi i përgjithshëm. Këtu do të japim vetëm disa shembuj, që përfshijnë:

- Lidhja e një viktime të dyshuar me një makineri të caktuar, kur flitet për TQNj për punë të detyruar.
- Gjetja nëse një i/e dyshuar ka dorëzuar dokumentet e përdorura në një biznes që shfrytëzon trafikimin për punë të detyruar.
- Lidhja e një personi me një telefon të përdorur për të kontrolluar një rrjet të TQNj.
- Përcaktimi nëse gruaja është përdhunuar në shtratin e gjetur në një vend, ku është ushtruar shfrytëzimi seksual.
- Zbulimi sa kohë ka jetuar personi në dhomë, kur shfrytëzohet për punë në familje.

4.2 Arritja e objektiveve

Dallimi më i madh (dhe sfida më e madhe) midis llojeve të shumta të krimit dhe TQNj është numri i gjurmëve të mundshme të lëna në një vend, ose, në disa raste, mbi një person. P.sh., kur flitet për përcaktimin nëse gruaja është dhunuar në shtratin, ku është ushtruar për shfrytëzim seksual.

Mund të ketë mijra shenja gishtërinjsh në afërsi të shtratit. Po ashtu, mund të ketë flokë, qeliza lëkure, gjak dhe gjurmë të tjera të lëna pas nga dhjetra e qindra persona të ndryshëm. Ju mund të arrini t'i mblidhni të gjitha shenjat dhe mostrat dhe të përpiqeni të identifikoni të gjithë individët që kanë qenë pranë ose në atë shtrat. Është e qartë që kjo kërkon shumë kohë, kosto dhe mund të jetë përtej aftësive të shumicës së zbatuesve të ligjit. Por, çfarë do të arrihet saktësisht me këtë hetim? Do të arrihet, me siguri, që të provohet se ka ndodhur një aktivitet i shumtë seksual në shtrat, por qëllimi i hetimit mund të mos jetë që të provohet ky fakt. Qëllimi kryesor ka mundësi që të jetë të provuarit se aktet kanë ndodhur ose jo me pëlqimin nga ana e gruas, dhe për këtë do të duhet të përdoren mënyra të tjera të hetimit.

Ju mund të realizoni atë që i keni vënë qëllim vetes duke treguar, për shembull, se janë gjetur shumë shenja gishtërinjsh të një gruaje (duke dëshmuar që shfrytëzimi i saj seksual është kryer për shumë kohë); se u gjetën shumë shenja gishtërinjsh të shumë personave të paidentifikuar (duke dëshmuar se ka qenë i madh numri i atyre që kanë shkuar me atë grua në atë shtrat); dhe (mundësisht) se u gjetën shumë gjurmë sperme nga meshkuj të paidentifikuar (duke sugjeruar që ata kanë bërë seks me atë grua).

Të njëjtat argumentime mund të bëhen, por në shkallë të ndryshme, për të gjithë shembujt e dhënë më sipër. Çështja këtu qendron që të përcaktohet ajo çfarë mund të arrihet objektivisht, në varësi të rrethanave të rastit dhe të burimeve që keni në zotërim.

4.3 Veprimet në skenën e krimit

Supozohet që ata që menaxhojnë skenat e krimit të TQNj, janë tashmë të vetëdijshëm rreth koncepteve të mëposhtme:

- Ruajtja e skenës.
- Regjistrimi i skenës.
- Regjistrimi dhe ruajtja e provës.
- “Zinxhiri i ruajtjes”, d.m.th. regjistrimi sa herë një objekt kalon nga një person tek tjetri.

Disa nga çështjet specifike të TQNj, që duhen mbajtur parasysht, përfshijnë:

- Mund të ketë shumë vetë në vendin ku ju shkoni; mbani shënim ose regjistroni me kamera apo video se ku gjenden ata në momentin që ju mbërrini atje. Në fazat e hershme të një hetimi, shpesh është e vështirë që të përcaktohet se kush është trafikant i dyshuar dhe kush një viktimë e mundshme. Në rast se vendosni që të filmoni, bëheni atë me kujdesin dhe ndjeshmërinë e duhur.
- Kontrolloni njerëzit (në respekt të ligjit të vendit mbi privacinë dhe dinjitetin e tjetrit), regjistroni se çfarë objektesh u gjetën atyre, ruajini dhe paketojini, dhe identifikoni çdo artikull me interes të veçantë për hetimin e mëtejshëm.
- Mendoni të bëni regjistrimin ‘duke ecur me ngadalë nëpër skenën e krimit’ (sigurisht, pa e prishur apo dëmtuar atë), gjë që do t’ju mundësojë që të përmbledhni mendimet tuaja në sqarim të objektivave që doni të arrini.
- Informoni analizuesit e skenës së krimit se cilat janë objektivat tuaja. Diskutoni me ta se çfarë është e arritshme në varësi të rrethanave dhe burimeve në zotërim. Ndërkohë që kjo qasje duhet të jetë realiste, ju duhet të jeni të përgatitur që ta sfidoni analizuesin që të ndërmarrë disa veprimë disi ndryshe nga ato që merren nëpër skenat e krimit në përgjithësi.
- Ju mund të dëshironi t’i intervistoni të pranishmit para se të fillojë shqyrtimi i skenës së krimit, në mënyrë që më pas të përqendrohet në shqyrtimin e skenës. Është pranuar gjërësisht, që kjo mund të jetë shumë sfiduese në disa rrethana të caktuara.

Vini re, se të gjitha shqyrtimet, analizat e skenës së krimit duhet të kryhen **gjithmonë në përputhje me ligjin** e juridiksionit ku punoni.

Shqyrtimet e viktimave të dyshuara/të mundshme

- Përparësia më e madhe, kur shqyrtohet një person, duhet të jetë sigurimi personal i atyre që kryejnë shqyrtimin dhe të atyre që shqyrtohen. Një person mund të jetë i armatosur, mund të ketë objekte që mund të dëmtojnë shqyrtuesit ose dhe veten, ose të jenë bartës të sëmundjeve infektive. Këtu nuk arrijmë të japim udhëzimet e plota për të gjitha rastet që ndeshen, por shqyrtimet duhet të kryhen në përputhje me 'praktikën më të mirë' të sigurisë personale në vendin ku zhvillohet ngjarja.
- Në përgjithësi, shqyrtimi i viktimave të mundshme kërkon lejen e personit në fjalë, megjithëse ka disa juridiksione ku ai kryhet në zbatim të një urdhri ligjor. Por edhe kur ka një urdhër, arsyet e shqyrtimit duhet të shpjegohen me kujdes dhe ndjeshmëri.
- Ekzistojnë dy lloje shqyrtimesh, të cilat janë:

- Shqyrtimet përzgjedhëse.

Këto kryhen kur gjeni një viktimë të dyshuar në një vend të caktuar. Objektivi i parë i këtyre shqyrtimeve nuk lidhet drejtpërdrejt me shqyrtimin e skenës së krimit; ato bëhen për të përcaktuar nëse ka dëmtime apo sëmundje që do të kërkonin një ndërhyrje të menjëhershme mjeksore. Objektivi i shqyrtimit të skenës së krimit është që të identifikojë çdo provë që përndryshe mund të humbasë dhe që kërkon një vëmendje dhe hapa të menjëhershëm për regjistrimin dhe/ose ruajtjen e tij. Këto janë shqyrtime 'jo intime' në terren dhe përgjithësisht, do të jenë të shpejta.

- Shqyrtimet mbi bazën e provave të gjetura

Këto lloj shqyrtimesh ka shumë gjasë që të kryhen në stacionin e policisë, në klinikë apo kirurgji, sipas natyrës së rastit dhe rregullave e rregulloreve të juridiksionit. Objektivi kryesor i këtyre shqyrtimeve është që të rikuperojë gjurmët e krimit për të arritur standardin që këto gjurmë të konsiderohen si një provë. Përgjithësisht, prova që kërkojmë është e formës së abuzimit fizik apo seksual që lidhet me dukurinë e shfrytëzimit dhe të kontrollit të jetës së tjetrit. Këto prova ka mundësi të jenë të karakterit intim, që ndoshta do të kërkojnë heqjen e ca veshjeve, dhe në rastin e shfrytëzimit seksual, vizitën mjeksore të viktimës së dyshuar. Zakonisht, ka rregulla shumë të forta në lidhje me analizat e pjesëve intime dhe personale. Për shembull, ka rregullore që parathënë se lejohen vetëm praktikantët e mjeksisë që të bëjnë kontrollin; ose që kontrolli të bëhet vetëm nga persona të së njëjtës gjini; apo rregulla që përcaktojnë me saktësi se ku duhet të kryhet një shqyrtim i tillë, etj. Është shumë e rëndësishme që këto rregulla të respektohen me korrektësi për të ruajtur integritetin e rastit dhe nevojat e viktimave të dyshuara/të mundshme.

- Pavarësisht nëse kryeni shqyrtimin përzgjedhës apo atë mbi bazën e provave të një personi, është praktikë e mirë që të merret fillimisht shpjegimi i tyre para se të fillojë shqyrtimi, në mënyrë që më pas të mund të përqendrohemi tek shqyrtimi.

- Në shumë raste të krimit të përgjithshëm, vërtetimi i lidhjes midis personave është i mjaftueshëm për hetimin; në rastet e TQNj mund të mos jetë kështu pasi njerëzit mund të kenë patur kontakte për shumë kohë dhe të dyshuarit e pranojnë këtë fakt.
- Viktimat mund të japin informacion rreth ngjarjeve që kanë ndodhur shumë kohë më parë. Në këto rrethana, mund të mos ketë mundësi reale që të rikuperohen prova gjurmësh. Në konsultim me ekspertët, duhet të vendosni nëse ia vlen që të shtohet stresi dhe trauma që vjen nga një shqyrtim i viktimës së dyshuar, kur ka shumë pak gjasa që të merren prova me vlerë për hetimin.
- Në rastin kur flitet për një industri të veçantë (shfrytëzimi për punë të detyruar) kërkoni të punoni me specialistë të industrisë në fjalë për të identifikuar se cilat janë praktikat e punës, të cilave i është nënshtruar viktimat e dyshuar/e mundshme nëpërmjet shenjave apo provave të ndryshme që mund të gjinden mbi trupin e personit.

Shqyrtimi i të dyshuarve

- Këtu përfshihet pjesa më e madhe e konsideratave të parashtruara më lart. Ndryshimi më i rëndësishëm në shumë jurisdiksione është që ka shumë mundësi që pushteti ligjor të shqyrtojë të dyshuarit pa pranimin e tyre, se sa të shqyrtojë viktimat pa pranimin e tyre.
- Megjithëse të gjithë personat e pranishëm paraqesin një rrezik të mundshëm 'shëndetësor apo sigurie' kur kontrollohen apo analizohen, rreziku mund të jetë më i madh në rastin e të dyshuarve, pasi ata kanë interes që t'i ikin drejtësisë.
- Ekziston një mundësi më e madhe që të dyshuarit të fshehin apo dëmtojnë me qëllim provat, pasi ata kanë një interes të qartë që të pengojnë drejtësinë.
- Para se të kryhet shqyrtimi mbi bazën e provës, përcaktimi me saktësi se kush është viktimë e mundshme dhe kush është i/e dyshuar mund të jetë i vështirë.

Shqyrtimi i vendngjarjes

- Shumë nga vendngjarjet e TQNj që do t'ju duhet të shqyrtoni do të kenë rreziqe të lidhura me shëndetin apo sigurinë, për shkak të karakterit të këtyre bizneseve dhe mungesës së vëmendjes për këto çështje nga ana e atyre që i zotërojnë apo i menaxhojnë ato.
- Dokumentet kanë rëndësi të madhe për hetuesit e TQNj, si për informacionin që mund të përmbajnë ashtu dhe për gjurmët me rëndësi shkencore që i lidhin këto dokumente me individët, duke përcaktuar rolin e atij individit në një ndërmarrje të veçantë.
- Duhet sekuestruar kompiuterat, telefonat, printerat dhe pajisjet e tjera informatike. Rekomandohet që të kërkoni këshilla nga ekspertët mbi mënyrën e sekuestrimit të këtyre pajisjeve në mënyrë që të mundësoni ruajtjen më të sigurtë të provave që përmbahen në to.

Ushtrim

Ndani grupin në çifte.

Shpërndani për secilin çift nga një pamje të ndryshme të Burimit mediatik 3, 'Shqyrtimi i skenës së krimit – Trafikimi për punë'. Ky burim përmban 10 pamje. Në rast se keni më pak se njëzet pjesëmarrës në grup, përsëri e ndani grupin në çifte dhe shpërndani më pak pamje.

Në rast se nuk e keni përdorur Studimin e Rastit 1, 'Shfrytëzimi për punë', atëherë shpërndani pjesë të këtij studimi, si më poshtë:

- Seksionin 3.1 'Zbulimi i inspektorëve'.
- Seksionin 3.2 'Raporti i inspektorëve'
- Seksionin 3.3 'Faza e parë e hetimit'.
- Seksionin 4.1 'Para aksionit'.
- Seksionin 4.2 'Aksioni'.

Si alternativë, informoni studentët me gojë rreth përmbajtjes së këtyre seksioneve.

Kërkoni nga secili çift që të vështrojnë 'pamjen' që u është shpërndarë dhe të mbajnë parasysh pyetjet në vijim:

- Çfarë gjurmë provash mendoni se mund të gjeni në pjesën tuaj të skenës?
- Cilat gjurmë do të ishte praktike që të rikuperohen, duke marrë parasysh burimet me të cilat ju punoni në punën tuaj reale?
- Cilat do të ishin objektivat tuaja?

Informacion për nxitjen e diskutimit

Nuk është gjithmonë e mundshme që të trajtohen të gjitha elementet e pamjeve të shpërndara, por më poshtë po japim disa pika kyçe.

Prova gjurmësh

Shenjat e gishtave:

- Përreth zonës 'së shtratit'.
- Mbi dhe brenda pajisjes së punës.
- Mbi shkopin e bejzbollit.
- Mbi aparatet/enët e kuzhinës.
- Në pajisjet e pastrimit, detergjentët pastrues dhe letrën e tualetit.
- Mbi njoftimet.
- Brenda valixheve dhe objekteve që gjinden aty.
- Mbi qeset e plehrave.
- Tek plehrat.
- Brenda makinës.

Flokë mbi:

- 'Shtretërit'.
- Rrobat e nderura.
- Rrobat në valixhe.
- Ndenjësen e makinës.

Fibra nga:

- Rrobat në shtrat (p.sh. veshjet e përdorura nga viktimat kur u gjetën dhe shpëtuan gjatë aksionit; veshjet e gjetura në valixhe, etj.).
- Çarçafët mbi veshjet.
- Ndenjësja e makinës mbi rrobat.
- Veshjet mbi ndenjësen e makinës.

Më praktiket

- Marrja e shenjave të gishtave duket se është mënyra më praktike dhe më me pak kosto për t'u recuperuar në këtë situatë.
- Materiali biologjik do të jetë i shumtë, sidomos flokët në shtrat. Megjithatë, në rast se njerëzit kanë jetuar në atë vend për një kohë të gjatë, do të ketë shumë material për t'u recuperuar. Por, recuperimi dhe ekzaminimi i tyre do të kërkojë shumë kohë dhe do të jetë me kosto, duke mos siguruar më shumë prova se sa ato që përftohen nëpërmjet shenjave të gishtave.

Objektivat

Disa nga objektivat kyçe përfshijnë, si vijon:

- Lidhja e individëve me zonën 'e shtratit' nëpërmjet shenjave të gishtave. Kjo do të ndihmojë mbështetjen e shpjegimeve të viktimave të mundshme, dhe do të mund të ndihmojë, gjithashtu, të përcaktohet nëse një person i identifikuar ishte një viktimë apo një trafikant. Vini re se kjo mund të mos jetë shumë e saktë, por, ama, kushtet e degraduara të kësaj zone sugjerojnë se nuk ka mundësi që aty të ketë fjetur një trafikant.
- Përcaktimi se sa kohë ka fjetur një person aty. Megjithëse këtu nuk flitet për shkenca ekzakte, recuperimi i një numri të madh shenjash sugjeron, zakonisht, se ai vend është përdorur për shumë kohë.
- Lidhja e individëve me valixhet nëpërmjet shenjave të gishtave. Edhe këtu, përsëri, kjo do të ndihmojë që të mbështetet shpjegimi që japin ata.
- Lidhja e individëve me makineritë dhe pajisjet e tjera. Kjo do të ndihmojë të demonstron: kush ka punuar në 'linjën e prodhimit' (pasi ka shumë mundësi të flitet në këtë rast për një viktimë) duke identifikuar shenjat e gishtave të gjetura mbi pajisjen, mbi paketimet, kutitë, etj.

- Kush ka punuar në anën 'e menaxhimit' (pasi ka shumë mundësi të flitet në këtë rast për një trafikant) duke identifikuar shenjat e gishtave të gjetura brenda dhe jashtë pajisejeve pajisjeve si telefonat, kompiuterat dhe printerat (veçanërisht te vendi i baterive, kartave SIM, etj., të cilat preken më së shumti).
- Lidhja e nje individi me një shkop bejzbolli. Këtu nuk flitet për një shkencë ekzakte, por kjo, gjithsesi, mund të përcaktojë se kush e ka përdorur shkopin për të kërcënuar dhe, për pasojë, për të kontrolluar njerëzit.
- Përcaktimi se kush është marrë më parë me artikujt, para se të hidhen në plehra. Nëpërmjet identifikimit të shenjave të gishtave mbi llojet e ndryshme të artikujve mund të sigurohet një tregues, provë, se kush ishte ai/ajo që 'kontrollohej' dhe se kush 'kontrollonte'.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
2.	Studimi i rastit.....	6
3.	E Hënë, 12 maj	7
3.1	Zbulimi i inspektorëve	7
3.2	Raporti i inspektorëve	8
3.3	Faza e parë e hetimit	8
4.	E Martë, 13 maj	10
4.1	Para bastisjes	10
4.2	Bastisja	10
4.3	Intervista e viktimave	11
4.4	Raporti mbi skenat e krimit	14
5.	E Mërkurë, 14 maj.....	15
5.1	Intervista e menaxherit të fermës Pol Smith	15
5.2	Intervista e kryepunëtorit Xhon Braun.....	15

1. Hyrje

Ky studim rasti ndjek formatin e zakonshëm të të gjitha studimeve të rasteve të këtij programi.

Ai jep një përshkrim të një rasti nga fillimi i tij deri tek intervistimi i të dyshuarve. Është i ndarë në disa informacione rreth rastit, i pasuar nga detajet e hetimit dhe rezultatet e atyre hetimeve. Treinuesit kanë në dispozicion udhëzime të shumta dhe mbështetje përgjatë gjithë tekstit.

Studimi i rastit mbështetet nga një sërë burimesh mediatike që duhet t'i mundësojnë treinuesit të krijojnë një mjedis përfshirës dhe ndërveprues.

2. Studimi i rastit

Duhet të vihet në dukje se rasti që studiohet është një rast fiktiv. Gjatë trajtimit të këtij materiali ka dalë në pah që shumë studentëve u duket disi e vështirë të besojnë që nuk bëhet fjalë për një rast të vërtetë, aq reale duken ngjarjet.

Ai bazohet mbi një numër rastesh që kanë ngjashmëri të mëdha me rastin që prezantohet më poshtë. Vendet ku u krye rekrutimi apo shfrytëzimi ishin Franca, Italia, Polonia, Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar. Besohet që transporti i viktimave është bërë nëpër një numër vendesh të Bashkimit Europian. Meqenëse realisht numri i rasteve të proceduara e të regjistruara në vendet përfituese të këtij programi është i vogël, nuk mund të thuhet me siguri që rrethanat e rastit janë tipike për këto vende. Megjithatë, duke u nisur nga i gjithë informacioni në dispozicion, mund të thuhet se ka mjaft ngjashmëri.

3. E Hënë, 12 maj

3.1 Zbulimi i inspektorëve

Më 12 maj, ditën e hënë, në orën 10.30, dy inspektorë nga Ministria e Bujqësisë e Vendit të Kuq vizituan një fermë të zgjeruar prodhimi vezësh në Midtaun të rrethit Istshair të vendit.

Një fermë e zgjeruar e prodhimit të vezëve është ajo fermë ku zogjtë mbahen në kafaz në sipërfaqe të mëdha. Inspektorët po vizitonin fermën me synimin për të siguruar që respektohen rregullat në lidhje me numrin e zogjve për kafaz, pajisjet higjienike, etj. Menaxheri i fermës i takoi, u tregoi vendet e zogjve dhe pastaj u largua për t'iu përgjigjur një telefonate. Inspektorët vazhduan inspektimin dhe nuk gjetën ndonjë shkelje.

Në fund të vizitës, njëri nga inspektorët shkoi në kërkim të menaxherit për t'i dhënë çertifikatën e respektimit të rregullave. Meqenëse nuk po e gjente dot, vazhdoi ta kërkonte duke hyrë nëpër kaponet dhe godinat e tjera të sitit.

Tek një ndërtesë në krye të fermës dëgjoi disa zëra. Hapi derën dhe hyri brenda. Pa tre vetë, dy gra dhe një burrë që po paketonin vezë në një hapësirë që dukej si një vend i vogël. Ai vuri re diçka që dukej si shtrat dhe një valixhe diku në mes të disa kutive.

Një burrë me kominoshe blu iu kthye inspektorit dhe filloi t'i bërtasë duke e pyetur se ç'punë kishte dhe çfarë kërkonte në atë vend. I shpjegoi se ishte inspektor i Ministrisë së Bujqësisë. Burri me kominoshe u step në fillim, por kur inspektori i shpjegoi se po kërkonte menaxherin për t'i dorëzuar çertifikatën, u qetësua. Iu afrua inspektorit, e mori me mirësjellje për krahu, e ktheu me fytyrë nga dalja dhe e përcolli jashtë dere. E tërhoqi derën duke e mbyllur atë pas vetes me kujdes. Në të dalë, inspektori vuri re një shënim në gjuhë të huaj, të varur në anën e brendshme të derës.

Burri me kominoshe e përcolli inspektorin tek shtëpia e menaxherit, dhe inspektori ia dha çertifikatën menaxherit. Më pas, të dy inspektorët u larguan.

Gjatë rrugës për në zyrën e tyre, inspektori i tha kolegut të tij se çfarë kishte vënë re dhe se iu duk disi e çuditshme që punëtorët duket sikur jetonin në vendin ku punonin. Kolegu tha se edhe atij i duket disi e pazakontë dhe se mbante mend që disa muaj më parë kishte dëgjuar diku për një rast të trafikimit njerëzor dhe se ndoshta ky mund të ishte një rast, që po ndodhte në atë fermë.

Ata vendosën që ta raportnin çështjen në polici.

3.2 Raporti i inspektorëve

Inspektorët raportojnë në polici dhe japin informacionin si më poshtë:

- Adresën e fermës – Ferma e Vezëve Midtaun, Long Lane, Midtaun.
- Numrin e celularit të menaxherit të fermës.
- Numrin e telefonit fiks të fermës së vezëve.
- Përshkrimin e zonës ku inspektori pa punëtorët dhe ‘shtratin’.
- Përshkrimin e asaj që vuri re.
- Emrin e menaxherit – z. Paul Smith.
- Përshkrimin e burrit me kominoshe.

3.3 Faza e parë e hetimit

Caktohet një hetuese. Ajo thirri me urgjencë një takim me ekipin e saj për të diskutuar raportin e inspektorëve. Më poshtë, një përmbledhje e çështjeve kyçe që u identifikuan:

- Në këtë fazë, nuk është e sigurt që njerëzit që u panë në atë ndërtesë të ishin të trafikuar.
- Mund të thuhet që fjetja në vendin ku punon njihet të jetë një nga treguesit e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj) për shfrytëzim të punës (dhe të formave të tjera të shfrytëzimit).
- Të fjeturit në vendin e punës, si nëpër fermat bujqësore, nuk është e zakonshme në Vendin e Kuq.
- Nuk ka prova të drejtpërdrejta që të sugjerojnë se njerëzit që u panë në ndërtesë të kenë qenë objekt dhune apo kërcënimi.
- Nga informacioni i ofruar, doli që njerëzit ishin duke paketuar vezë; kjo nuk duket të jetë një punë e rrezikshme.
- Edhe nëse mund të ketë punë të rrezikshme në një fermë zogjsh, nuk duket se aty mund të ndodhin të njëjtat dëmtime apo rreziqe pune si nëpër miniera apo gurore.
- Shënimi mbi derë është në gjuhë të huaj, por nuk dijmë se çfarë shkruhet në të.
- Shënimet e vendosura në anën e brendshme të derës mund të jetë një tregues i masave të kontrollit që ushtrohen zakonisht në rastet e TQNj.
- Kërkimet treguan se e vetmja e dhënë e njohur për fermën është se ka patur tri raportime për vjedhje pajisjesh gjatë dy viteve të fundit.
- Një nga këto raportimet është bërë nga menaxheri Paul Smith; raportimet e tjera nga një person me emrin Xhon Braun, i cili u prezantua si kryepunëtori i fermës.
- Të dy burrat dhanë ditëlindjen e tyre kur denoncuan krimet, pra mund të bëhen kontrole në sistemin e të dhënave; por asgjë tjetër nuk dihet për ata të dy.
- Ferma është në fund të një rruge të gjatë – e vetmja rrugë për në fermë.
- Ka një sërë njësisish tregtare dhe pronash rezidenciale në udhëkryqin e rrugës së fermës, që pritet me atë kryesoren.

- Këto prona ofrojnë mundësi për vëzhgim statik të njerëzve dhe automjeteve atje.
- Vetë ferma nuk duket nga godinat e tjera.
- Ferma mund të shihet si nga fushat ashtu dhe nga një zonë me pemë të dëndura.
- Kjo ofron mundësi për vëzhgime rurale.
- Numrat e telefonave njihen. Kjo jep mundësi për analizën e të dhënave të komunikimit dhe përgjimin e komunikacioneve.
- Tani për tani, nuk ka të dhëna rreth automjeteve që punojnë me fermën.
- Ferma është një biznes i stabilizuar, me sisteme telefonie fikse, energji dhe gaz.
- Kjo mundëson fillimin e analizës financiare.
- Vendi ku punojnë dhe jetojnë njerëzit njihet nga autoritetet lokale.
- Kjo ofron mundësi për të vendosur mjete të vëzhgimit të fshehtë.
- Ka një shteg që të çon tej fermës, që përdoret rregullisht nga publiku.
- Për shkak të vjedhjes në fermë dhe vjedhjeve të tjera në zonë, aty shihen rregullisht patrulla policie, të cilat, për ato arsye, pranohen si normale.
- Ekipi pranon që kërkohet të ruhet një balancë ndërmjet nevojës së rekuperimit/shpëtimit të viktimave të mundshme të trafikimit dhe lejimit të vazhdimit të shfrytëzimit për të mundësuar mbledhjen e provave sa më bindëse.
- Burimet e disponueshme janë të kufizuara.
- Do të duhet të kalojnë disa ditë për të gjetur vendet e përshtatshme dhe fiksuar mjetet statike të vëzhgimit ndër godinat apo zonat përreth, etj.
- Duhet të kalojë të paktën një javë për vëzhgimin, vendosjen e pajisjeve të fshehta.
- Nuk është e mundur që të dëshifrohet gjuha me të cilën flasin punëtorët.

Më poshtë, lista e vendimeve të marra nga ekipi:

- Është siguruar autorizimi për të marrë të dhëna mbi komunikimet telefonike.
- Një patrullë policie do të bëjë një kontroll rutinë të rreptë të zonës për të identifikuar çdo mjet të pranishëm në zonë dhe të ndjekë çdo aktivitet me interes.
- U planifikua një bastisje policie për ditën e ardhshme në orën 7 të mëngjesit.
- U sigurua nga gjykata një mandat gjyqësor për të kryer bastisjen.
- U kontaktuan ekzaminuesit e skenave të krimit dhe iu tha që të jenë në gatishmëri.
- Logjika pas vendimit të ndërhyrjes, në vend që të bëhen vëzhgime të tjera, është se:
 - Sipas informacionit të dhënë, ekziston një 'shënjestër' specifike (ndërtesa ku hyjnë personat që u gjetën në fermë).
 - Do të duhet kohë e gjatë që të vendosen pajisjet e vëzhgimit në atë vend, etj.
 - Ndërkohë që nuk ka prova të drejtpërdrejta dhune apo abuzimi tek njerëzit që u panë në fermë (në fakt, deri tani ka vetëm disa tregues që ata janë viktimat të TQNj), gjatësia e kohës që do të duhet për të nisur veprime të tjera hetimore do të bëjë që shfrytëzimi i njerëzve për punë të vazhdojë deri në nivele të papranueshme.
 - Në rast se njerëzit janë të trafikuar, trafikantët mund të vendosin që t'i largojnë ata, sidomos tani që u vunë re nga inspektorët e Ministrisë së Bujqësisë.

4. E Martë, 13 maj

4.1 Para bastisjes

Para bastisjes, merret informacioni i mëposhtëm:

- Policia vendore raporton që në fermë janë dy mjete, një mikrobuz blu dhe një veturë e kuqe.
- Këto mjete janë regjistruar në pronësi të fermës.
- Analiza e të dhënave të komunikimeve është mjaft komplekse dhe do të duhet pak kohë që të përfundojë, por tashmë është e qartë një gjë: janë bërë shumë telefonata drejt telefonave me kodin e Vendit Blu.
- Kur hetuesi kryesor njihet me këtë fakt, megjithëse nuk është i sigurt që personat flasin gjuhën e Vendit Blu, ai kërkon të ketë në dispozicion një përkthyes të gjuhës së Vendit Blu.
- Sigurohen fletushkat me simbole flamujsh dhe pyetje të ndryshme në disa gjuhë (të prodhuara si pjesë e programit të anti-trafikimit).

4.2 Bastisja

Bastisja u krye në orën 7.00 të mëngjesit. U gjet, si vijon:

- 4 vetë janë në hangarin ku qenë identifikuar nga inspektorët, 2 gra dhe 2 burra.
- Të katërt janë të dobët, por nuk ka shenja dëmtimi fizik.
- Atyre iu kërkua të tregojnë se nga janë duke u nisur nga simbolet e flamujve në njërin nga fletushkat.
- Ata tregojnë se janë nga Vendi Blu.
- Duke kombinuar fletushkat dhe shërbimin e përkthimit, nga tre personat u arrit të merret ky informacion:
- Ata mendonin se mund të kishin qenë në atë hangar për rreth tre muaj.
- Nuk lejoheshin që të lëviznin nga ai vend.
- Kërcënoheshin nga një burrë. Ishin të uritur.
- Njëra nga gratë është shumë e shqetësuar dhe kërkon t'u thotë diçka policëve.
- Tregon një shkop bejzbolli bojë portokalli.
- Nëpërmjet përkthimit me telefon, polici beson se ajo thotë të vërtetën që shkopi i bejzbollit është përdorur për t'i kërcënuar.
- Asnjë nga ata nuk ka pasaportë apo dokument tjetër identifikimi.
- Ka 3 shtretër në ndërtesë me nga një dyshek të hollë të shtruar në dysHEME.
- Pranë çdo shtrati ndodhet një valixhe.

- Ka një kovë mbi disa kuti pranë një pakoje me letra tualeti dhe detergjent për duart.
- Nuk duket të ketë pajisje tualeti.
- Ka dhe tregues të tjerë, si rroba të nderura për tharje, që tregon se ky vend përdoret nga këta njerëz për banim.
- Në anën e prapme të ndërtesës është një lavaman.
- Lavamani duket se është në zonën që shërben si kuzhinë.
- Pajisjet e gatimit dhe të ngrënies përbëhen nga një furnellë e vogël, ca enë dhe ca pjata plastike.
- I vetmi ushqim që u gjet ishin ca konserva zarzavatesh dhe nja dy pako makarona.
- Ka shumë kuti që përdoren për paketim dhe transportim vezësh.
- Ka disa telefona, një kompiuter dhe një printer.

Veprimet e tjera gjatë bastisjes:

- Policia viziton shtëpinë e menaxherit të fermës dhe e arreston.
- Gruaja dhe familja e fermerit ndodhen në shtëpi.
- Bëhet kontroll për të gjetur burrin që i përgjigjet përshkrimin të personit me kominoshe blu.
- Ndërkohë që kryhet kontrolli, një burri i veshur me kominoshe blu mbërrin në një makinë, mesa duket për të vajtur në punë.
- Ai identifikohet si kryepunëtori i fermës, Xhon Smith.
- Thirret ekzaminuesi i skenës së krimit, i cili fillon të marrë foto dhe bën ekzaminime të tjera sipas udhëzimeve të kryehetuesit.

4.3 Intervista e viktimave

Personat që u gjetën në fermë u dërguan në polici. Ata dhanë detaje të tjera rreth vetes:

- Gratë e identifikuan veten si:
 - Anna Blu, lindur më 19.03.1993.
 - Monika Grin, lindur më 03.11.1992.
- Burrat e identifikuan veten si:
 - Tom Red, lindur më 21.08.1991.
 - Martin Orenxh, lindur më 03.12.1990.

Ata u kontrolluan nga mjeku dhe u deklaruan të aftë për intervistim. U thirrën përkthyesit dhe intervistimet filluan pasdite vonë.

Që të katër treguan histori të ngjashme.

Faza e rekrutimit

- Të gjithë kishin qenë studentë në kryeqytetin e Vendit Blu, Qyteti Blu.
- Pas mbarimit të shkollës ishte shumë e vështirë të gjindej punë në Qytetin Blu, por ishte edhe më e vështirë të gjindej punë në një qytet të vogël, në qytetin e tyre të origjinës.
- Që të katër frekuentonin kafenetë dhe merrnin pije gratis për disa punë të vogla që bënin, si larje dhe pastrim gotash.
- Kishin mundësi të qendronin në Qytetin Blu pasi aty kishin kushërinjtë e tyre.
- Anna dhe Monika ishin shoqe. Tom dhe Martin ishin edhe ata miq, por asnjë palë nuk njihnte palën tjetër.
- Secilës palë i ishte afruar një burrë dhe i kish pyetur nëse do të dëshironin të shkonin në Vendin e Kuq për të punuar në fermë.
- Oferta parashikonte që ata të dërgoheshin në Vendin e Kuq (Vendi i Kuq ndodhet në të njëjtën zonë të lirë të udhëtimit si dhe Vendi Blu, prandaj udhëtimi ishte i mundur pa vizë), atyre do t'u sigurohej strehimi dhe ushqimi dhe do t'u paguhej paga minimale e Vendit Blu, e barabartë me rreth 10 dollarë amerikanë në orë.
- Do të paketonin vezë.
- Të katërt kishin pranuar.

Faza e transportit

- Rruga e përdorur për në Vendin e Kuq, ishte e njëjta për të gjitha rastet.
- Ata mbërritën në një udhëkryq në periferi të Qytetit Blu, ku i priste një kamion i madh.
- Ata kaluan nëpër disa shtete për tre ditë dhe dy netë para së të arrinin në Vendin e Kuq.
- U dërguan drejt e në fermë.
- Anna dhe Monika udhëtuan bashkë dhe kishin mbërritur në Vendin e Kuq rreth tre muaj më parë.
- Tomi dhe Martini rreth dhjetë ditë më vonë.

Faza e shfrytëzimit

- Kur Anna dhe Monika arritën në fermë, shoferi i kamionit i prezantoi te një burrë me emrin 'Xhoni'.
- Shoferi u tha që Xhoni ishte një njeri me karakter të keq dhe se ato duhet të bënin çfarë t'i urdhëronte ai, përndryshe do e kishin pisk.
- Xhoni dinte disa fjalë nga gjuha e Vendit Blu, kryesisht fjalë të ndyra dhe ca fjalë në lidhje me punën, vezët.
- Ua treguan 'shtretërit' në dyshe-menë e ndërtesës. Ua treguan kovën, letrën e tualetit dhe sapunin dhe nëpërmjet shenjave, ua treguan se si duhet të kryenin nevojat personale.
- Ua treguan furnellën e vogël, pak makarona dhe kanoçet me domate në fund të godinës.

- Puna e tyre e parë (që filloi menjëherë pasi i njohën me vendin) ishte të shkarkonin vezët nga kamioni, që i kishte transportuar deri aty.
- Ata punuan deri natën vonë, deri kur 'Xhoni' i la të flinin brenda ndërtesës.
- Ai u kthye mëngjesin tjetër, kur ishte ende natë, dhe vajzat vazhduan të shkarkojnë.
- Kur u boshatis kamioni, shoferi iu afrua grave edhe njëherë dhe ua kujtoi që duhet të qendrojnë atje dhe t'i binden Xhonit, përndryshe 'do ta kishin pisk'.
- Ai u tha, gjithashtu, që duhet t'ia jepnin pasaportat e tyre Xhonit, sepse i duheshin për të nxjerrë lejet e tyre të punës nga autoritetet e Vendi të Kuq.
- Xhoni u tregoi grave se cilat ishin punët e tjera që duhej të bënin.
- Xhoni do të sillte sasi të mëdha vezësh dhe ata duhet t'i paketonin nëpër kuti të vogla dhe më pas t'i ngarkonin në furgona, kamionçina dhe makina jashtë ndërtesës ku punonin dhe banonin.
- Anna u shqetësua dhe filloi t'i thërrasë Xhonit me zë të lartë.
- Xhoni shkoi të marrë shkopin e bejzbollit dhe iu afrua grave, duke i parë gratë në sy e duke e rrahur shkopin me dorë.
- Të dyja gratë u frikësuan dhe nuk u ankuan më.
- Të nesërmen Xhoni ngjiti në derë shënimin në gjuhën e Vendi Blu.
- Kur mbërritën Tomi dhe Martini, atyre u dhanë të njëjtat shpjegime dhe u kërcënuan menjëherë nga Xhoni me shkopin e bejzbollit.
- Tomi kupton pak nga gjuha e Vendi të Kuq; ai vuri re se kutitë ku vinin vezët mbanin markën 'Midtaun' dhe shënimin 'Prodhim i Vendi të Kuq'.
- Iu duk çudi, pasi të gjitha vezët që paketonin vinin nga kamionët me të cilët kishin udhëtuar nga vendi i tyre, pra nga Vendi Blu, dhe foli për këtë me të tjerët.
- Gjatë kohës që ishin në ndërtesë, ata ushqeheshin me makarona, domate në konserva, misër të ëmbël dhe ngadonjëherë pak djath.
- Të gjithë humbën shumë në peshë.
- Moti ishte shumë i ftohtë, ishte dimër.
- E vetmja pajisje për ngrohje, ishte një ngrohëse e vogël gazi.
- Kamionët nga Vendi Blu vinin të ngarkuar me vezë çdo tre deri katër ditë.
- Punonin përgjithësisht dhjetë orë në ditë, por kur vinte kamioni, edhe më shumë.
- Asnjëherë nuk morën para për punën e tyre.
- Pastaj u pyetën se në cilin 'shtrat' flinte secili dhe cila ishte valixhja e tij/e saj. Nga përgjigjet doli që:
 - Anna flinte në 'shtratin' afër hyrjes dhe kishte dy valixhe të vogla të zeza.
 - Monika flinte menjëherë pas Annës; kishte një valixhe të madhe të zezë, e vendosur midis saj dhe Annës.
 - Tomi flinte në dhomën e dytë, menjëherë në anën e majtë pas harkut; kishte një valixhe të madhe portokalli.
 - Martini flinte në fund fare të dhomës së dytë; kishte një valixhe të madhe të zezë dhe një më të vogël blu.
- Të gjithë me radhë shpjeguan se çfarë kishin nëpër valixhet e tyre.

4.4 Raporti mbi skenat e krimit

Raporti mbi skenat e krimit jep informacionin, si më poshtë:

- U siguruan fotografi të skenës.
- U bë regjistrimi i një 'realiteti virtual'.
- U gjetën shumë gjurmë gishtërinjsh rreth secilit shtrat.
- Kjo tregon se njerëzit kanë qendruar aty për një kohë shumë të gjatë.
- U gjet një shkop bejzbolli në dhomën e dytë të ndërtesës; u rikuperuan një numër i madh shenjash gishtash mbi këtë shkop bejzbolli.
- Nuk është e mundur që të bëhet ndarja e plotë se cilat shenja i përkasin cilit person, por në pak ditë do të bëhet e mundur që të jepen disa nga gjetjet.
- Këto gjetje do të bëjnë të mundur që të identifikohen nëpër grupe shenjat e njëjta.
- Pranohet se këto shenja gishtërinjsh i përkasin si viktimave të dyshuara ashtu dhe trafikantëve të dyshuar.
- U konfiskuan të gjithë telefonat, kompiuteri dhe printeri.
- Këto pajisje do të analizohen si për të dhënat që përmbajnë ashtu dhe për provat shkencore fizike, si shenjat mbi kartat SIM brenda telefonave celularë, etj.

5. E Mërkurë, 14 maj

5.1 Intervista e menaxherit të fermës Pol Smith

Pol Smith u intervistua në orën 9.00 të mëngjesit. Pikat kryesore të thënieve të tij:

- Personat janë rekrutuar nga një partner i tij i biznesit në Vendin e Kuq.
- Ai nuk kishte asnjë lidhje me këta persona, që në momentin kur arritën në fermë.
- Për ata kujdeset kryepunëtori i fermës, Xhon Braun.
- Ai dha adresën e shtëpisë së kryepunëtorit Xhon.
- Pol Smith, në fillim, hezitoi të fliste për pagat që merrnin.
- Oficerët e policisë ngulën këmbë që të tregonte, dhe ai tha se arsyeja përse nuk ka dëshirë të flasë për këtë temë është sepse ai e paguan Xhon Braunin me para në dorë, që ky i fundit të paguante punëtorët, dhe për këtë arsye ishte i shqetësuar se mund ta raportonin tek autoritetet tatimore.
- Ai e di që personat jetojnë në fermë; nuk është i kënaqur me këtë fakt, por Xhon Braun i pat thënë se vetë personat ia kishin kërkuar këtë për të kursyer paratë.
- Ai tha se nuk kishte asnjë dizeni për shënimet e vendosura në ndërtesë.
- Ai tha se nuk dinte asgjë rreth shkopit të bejzbollit.
- Ai tha se kishte pasë hyrë në atë ndërtesë disa herë.
- Ai u pyet nëse kishte vënë re kushtet e jetesës në atë ndërtesë; ai tha që po.
- Ai u pyet nëse e shihte të pranueshme që njerëzit të jetonin në ato kushte në mjedisin e tij; ai tha se, siç pat përmendur dhe më parë, ajo ishte zgjedhja e tyre, por, nga ana tjetër, kështu jetojnë njerëzit e Vendit të Kuq.
- Ai u pyet nëse ishte ai përgjegjës për mbajtjen e llogarive; ai tha se po.
- Ai u pyet nëse ishte përgjegjës për sigurimin e ushqimit për punëtorët; ai tha se po, por i jepte para në dorë Xhon Braun që të merrej ai me këtë çështje.

5.2 Intervista e kryepunëtorit Xhon Braun

Edhe Xhon Braun u intervistua atë mëngjes në orën 9.00. Pikat kryesore të thënieve të tij:

- Ai punon si kryepunëtor në fermën pranë Midtaun.
- Bosi i tij është Pol Smith.
- Rreth 4 muaj më parë, Pol Smith i tha se po kërkonte të rekrutonte punëtorë nga Vendi Blu, sepse ata njiheshin si punëtorë të mëdhenj, punonin për pak para dhe tani mund të udhëtonin nga Vendi Blu, si zonë e përbashkët e 'lëvizjes së lirë'.
- Për këtë arsye, ai filloi të mësojë gjuhën e Vendi Blu.

- Ai tha se kur arritën punëtorët, ai përdori shoferin e kamionit që t'i pyeste ku dëshironin të qendronin.
- Ai u tha punëtorëve se do t'u duhej të paguanin rreth një të tretën e pagës së tyre për qiranë.
- Ata i kërkuan nëse mund të qendronin në fermë pa paguar qira; ai foli me Pol Smith, i cili ra dakord.
- Ai tha se u jepte punëtorëve paratë që fitonin.
- Ai nuk e di se ku janë këto para tani dhe hamendëson se ata mund t'i kenë fshehur diku.
- Kur u pyet rreth shkopit të bejzbollit, ai qeshi dhe pranoi se ecte me të në dorë, por ishte thjesht një lojë e vogël midis tij dhe punëtorëve.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
2.	Studimi i Rastit	6
3.	E Hënë, 13 maj	7
3.1	Telefonata e parë.....	7
3.2	Intervista e znj. Blu.....	7
3.3	Intervista e të dashurit, Peter Red	7
3.4	Veprimet e fazës së parë të dedektivit të Vendit Blu	8
4.	E Martë, 13 maj.....	9
4.1	Përgjigja e parë e policisë së Vendit të Kuq	9
5.	E Mërkurë, 14 maj.....	10
5.1	Mesazhi për znj. Blu.....	10
5.2	Veprimet e fazës së dytë të dedektivëve të Vendit Blu	10
5.3	Përgjigja e dytë e policisë së Vendit të Kuq	10
5.4	Veprimet e fazës së tretë të dedektivëve të Vendit Blu	11
5.5	Biseda telefonike 'katërshe'	11
5.6	'Shpëtimi'	12
6.	Hetimi	13
6.1	Intervista e parë e Monikës.....	13
6.2	Arrestimi i të dyshuarve të parë	13
6.3	Intervista e dytë e Monikës	14
6.4	Identifikimi i Danit.....	15
6.5	Kërkimet e tjera.....	16

1. Hyrje

Ky studim i rastit ndjek formatin e zakonshëm të të gjitha studimeve të tjera të rastit, të trajtuara në këtë program.

Ai bën një përshkrim të një rasti që nga fillimi i tij deri tek intervistimi i të dyshuarve. Është i ndarë në pjesë informative rreth rastit në fjalë, i pasuarr nga detajet e hetimit dhe të rezultateve të atyre hetimeve. Trainuesve u jepen udhëzime të plota dhe mbështetja e nevojshme përgjatë gjithë tekstit.

2. Studimi i rastit

Ky rast është një rast fiktiv, por në thelb është bazuar mbi një rast të vërtetë.

Shumë raste si ky janë ndeshur në pjesë të ndryshme të botës. Është një rast që trajtohet shpejt me teknika të tilla si loja me role, përdorim imazhesh satelitore ose të tjera, si dhe me detyra në grup, që mundësojnë një mësimdhënie përfshirëse, ndërvepruese dhe dinamike.

3. E Hënë, 13 maj

3.1 Telefonata e parë

Ditën e hënë, më datë 12 maj në orën 5.15 pasdite, policia e Vendit Blu mori një telefonatë nga një grua, e cila tha se i dashuri i vajzës së saj e kishte njoftuar se e bija i kishte telefonuar atij. Ai informoi që vajza e saj i kishte thënë se ndodhej në Vendin e Kuq dhe se atë e kishin shitur dhe përdhunuar.

3.2 Intervista e znj. Blu

U dërguan detektivët e policisë që të intervistonin nënën.

Emri i nënës është Anna Blu, lindur më 16.10.1970.

Emri i vajzës së saj është Monika Blu, lindur më 19.05.1995.

Znj. Blu thotë se e ka parë vajzën e saj për herë të fundit rreth dhjetë ditë më parë. Ajo i kishte thënë se kishte ndërmend të kërkonte punë në kryeqytet. Nëna shpjegon se vajza e saj është një vajzë normale, me as më pak e as më shumë shqetësime se të tjerat, por që mërzohej se nuk po gjente punë pranë shtëpisë.

Ajo e përshkruan Monikën si një femër bardhoshe, 1.65 cm e gjatë, me fytyrë të çelur, e imët, me flokë të drejtë kafe deri tek supet. Nuk e mbante mend se çfarë kishte veshur kur e pa për herë të fundit.

Znj. Monika i dha detektivëve numrin e telefonit të të dashurit të Monikës.

Detektivët e morën në telefon të dashurin dhe lanë një takim me të.

3.3 Intervista e të dashurit, Peter Red

Emri i tij është Peter Red, lindur më 21.02.1994. Banon me të ëmën në të njëjtin qytet si dhe familja Blu.

Ai thotë se e ka parë Monikën tri ditë më parë. Kishte veshur tuta të zeza sportive me një rrip të verdhë dhe një xhup të lehtë bojë gri. Monika i kish vajtur në shtëpi dhe dukej shumë e eksituar. Ajo i tha se ishte miqësuar me dikë që do e çonte në Vendin e Kuq dhe do t'i gjente punë në një bar, për pastrim ose shërbim. Të ardhurat do të ishin goxha të mira dhe ajo, si pjesë e marrëveshjes, do të kishte dhe një vend ku të sistemohej. Monika i kish thënë Peterit se do të rrinte vetëm një muaj për të parë sesi do të shkonin punët. Nëse gjërat do të ecnin mbarë, ajo do t'i telefononte dhe ai mund të shkonte e të bashkohej me të.

Herën e fundit që kishte dëgjuar për Monikën ishte atë pasdite kur kishte marrë telefonatën. Telefonata vinte nga një numër i panjohur, të cilin ai nuk e njihte. Monika ishte tepër e shqetësuar dhe po qante në telefon. Ajo i tha se mund të fliste vetëm një minutë, ose 'ai burri mund të më rrahë'. Ajo tha se e kishin shitur te një burrë dhe ishte përdhunuar, dhe se Peter duhej t'i telefononte të ëmës. Pastaj, telefoni u mbyll.

3.4 Veprimet e fazës së parë të dedektivit të Vendit Blu

Dedektivët ndërmorën veprimet si vijon:

- Folën me nënën e Peterit, e cila mbështeti rrëfimin e Peterit që Monika u kish vajtur në shtëpi tri ditë më parë. Ajo tha, gjithashtu, se e kish dëgjuar Peterin që fliste në telefon atë ditë dhe se dukej i tronditur, dhe se i tha asaj që kishte marrë një telefonatë të çuditshme nga Monika.
- Morën numrin e telefonit të celularit të Monikës nga znj. Blu. Ata i thanë znj. Blu që t'i kontaktonte nëse do të kishte ndonjë të re nga Monika.
- Kryen kontrolle urgjente të celularit të Monikës. Gjetën se hera e fundit që ishte përdorur ishte kur mori Peterin tri ditë më parë.
- Folën me 'autoritetin e tyre qendror' që merret me ndërlidhjet me vendet e tjera dhe me ndihmën e tyre bën një kërkesë urgjente 'polici me polici' që të mund të bënin kërkime në mënyrë që të gjindej se kujt i përkiste numri i telefonit që pat përdorur Monika, dhe të provonin të identifikonin nga cili vend ishte bërë telefonata.
- U shpërndanë të dhënat mbi Monikën dhe përshkrimi i saj nëpërmjet sistemeve normale të Vendit Blu dhe hollësitë mbi Monikën u dërguan në Vendin e Kuq.

4. E Martë, 13 maj

4.1 Përgjigja e parë e policisë së Vendit të Kuq

Policia e Vendit të Kuq kontaktoi policinë e Vendit Blu me disa rezultate nga kontrollet e telefonit. Ata raportuan si më poshtë:

- Celulari që kishte përdorur Monika për të marrë Peterin ishte një celular me kartë dhe nuk kishte të dhëna mbi klientin.
- Celulari ishte përdorur kryesisht në një rajon të kryeqytetit të Vendit të Kuq që quhet Ist Taun.
- Telefonata, që besohet se e kishte bërë Monika, kishte ardhur pikërisht nga Ist Taun.
- Telefoni ishte përdorur, gjithashtu, në një numër qytetesh të vogla në pjesën qendrore të Vendit të Kuq.
- Ata njoftuan që telefonata e Monikës u bë në një zonë rreth gjysmë kilometri katror dhe se në zonë kishte më shumë se 1,000 apartamente dhe shtëpi.
- Ata do të vazhdojnë të përpiqen të lokalizojnë telefonin më me saktësi.

5. E Mërkurë, 14 maj

5.1 Mesazhi për znj. Blu

Në orën 2.30 të pasdites, znj. Blu kontaktoi policinë e Vendit Blu. Ishte shumë e tronditur. Kishte marrë një mesazh me tekst:

‘Mami, kam shumë frikë. Ata po më detyrojnë të bëhem prostitutë’.

Dedektivi shkoi menjëherë tek shtëpia e znj. Blu dhe analizoi tekstin e mesazhit dhe numrin e telefonit. Ata vunë re se mesazhi ishte dërguar nga një numër i Vendit të Kuq, por i ndryshëm nga i pari që pat përdorur Monika kur mori Peterin.

5.2 Veprimet e fazës së dytë të dedektivëve të Vendit Blu

Dedektivët ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Kontaktuan me urgjencë ‘autoritetin qendror’ dhe ua dhanë numrin e ri të telefonit me një kërkesë që ata të kontaktonin autoritetet përkatëse të Vendit të Kuq për të gjuaruar se nga ku u dërgua mesazhi i fundit.
- Dërguan një mesazh nga celulari i znj. Blu duke i shkruar Monikës që të dërgonte një mesazh kur të ishte vetëm dhe e sigurtë për ta dërguar atë.
- Pritën me znj. Blu që të vinte ai mesazh.
- Planifikuan që t’i telefononin Monikës në rast se do të dërgonte mesazh dhe ‘ta intervistonin’ atë për të identifikuar vendin ku ndodhej dhe të merrnin masa për shpëtimin e saj me anë të policisë së Vendit të Kuq.
- Siguruan një oficer që fliste gjuhën e Vendit të Kuq të vinte te shtëpia për të folur drejtpërdrejt me policinë e Vendit të Kuq dhe të përpiqeshin t’i orientonin ata për të gjetur vendin ku ishte Monika.

5.3 Përgjigja e dytë e policisë së Vendit të Kuq

Kaloi një orë. Policia e Vendit të Kuq kontaktoi policinë e Vendit Blu me informacionin e mëposhtëm:

- Mesazhi është dërguar nga një vend diku nga një qytet me emrin Midtaun, në pjesën qendrore të vendit.
- Vendi nga i cili u dërgua mesazhi mund të lokalizohej vetëm po të jetë brenda 300 metrave katrorë.
- Ajo zonë kishte me qindra shtëpi të vogla dhe apartamente.
- Midtaun ishte, gjithashtu, një nga vendet ku ishte përdorur telefoni nga Monika kur kishte kontaktuar Peterin.

- Policia e Vendit të Kuq kishte kontaktuar policinë vendore të Midtaun, ia shpjegoi situatën, dhe vendosën që ata të prisnin udhëzime të mëtejshme.
- U dhanë detajet e numrave të telefonit të policisë së Midtaun.
- Oficeri i Vendit Blu, që njëjtte gjuhën e Vendit të Kuq, kontaktoi policinë e Midtaun për të fiksuar një lidhje komunikimi me të dhe informuar drejtpërdrejt mbi planet e policisë së Vendit Blu.
- Policia e Midtaun dërgoi një mjet patrullimi në zonën e identifikuar nga analiza e telefonatës dhe u tha që të presin udhëzime të mëtejshme.

5.4 Veprimet e fazës së tretë të dedektivëve të Vendit Blu

Kaloi një gjysmë ore. Në telefonin e znj. Blu mbërriti ky mesazh:

‘Jam vetëm. Më merrni menjëherë. Ju lutem’.

Dedektivët morën veprimet e mëposhtme:

- I ranë menjëherë numrit të celularit me të cilin u dërgua mesazhi.
- Kontaktuan menjëherë policinë e Midtaun, vendosën lidhjen dhe u thanë se ‘ngjarja ishte gjallë’.

5.5 Biseda telefonike ‘katërshe’

Veprimet vijuan me një bisedë telefonike katërshe. Një dedektive e Vendit Blu i bëri disa pyetje Monikës. Celulari ishte vendosur me zë të hapur. Një dedektive e dytë e Vendit Blu dëgjonte bisedën midis koleges dhe Monikës. Kjo ia përkthente, duke përdorur një celular të dytë, kontrollorit në Midtaun, në Vendin e Kuq. Kontrollori i Vendit të Kuq i përgjigjej informacionit që merrte dhe sugjeronte pyetje të tjera për t’ia bërë Monikës. E tëra kjo përkthehej nga dedektivja e Vendit Blu, dhe nëpërmjet koleges së saj, i transmetohej Monikës, e kështu me radhë.

Nëpërmjet këtij procesi komunikimi, Monika dha informacionin në vijim:

- Ajo ndodhej në një dhomë gjumi në katin e sipërm të një shtëpie të vogël, me pamje nga rruga.
- Karshi kishte shumë shtëpi të vogla të ngjashme.
- Shtëpitë kishin një derë e dy dritare si në katin e parë, ashtu dhe në të dytin.
- Disa nga shtëpitë kishin nga një kopësht të vogël, të tjerat, jo.
- Ndodheshin shumë makina të parkuara në rrugë.
- Burri, nga i cili ajo kishte frikë, mund të kthehej në çdo çast.
- Ajo dëgjonte të kalonin trenat në afërsi. Ajo e dinte se aty afër, prapa shtëpisë, ishte një linjë hekurudhore që rrihej nga trena të shumtë.

5.6 'Shpëtimi'

Informacioni kalonte sa nga njëra palë tek tjetra. Problem doli përshkrimi i shtëpisë, pasi ai përshkrim ishte i ngjashëm me shumë shtëpi të tjera në atë zonë. Deri kur:

- Kontrollori i Vendit të Kuq pyeti nëse Monika mund të dallonte targat e automjeteve aty pranë.
- Ajo dalloi tre dhe ua dha informacionin.
- Këto targa u kontrolluan nga policia.
- Dy nga ato targa ishin regjistruar tek një rrugë në Midtaun, e njëjtë me përshkrimin që kish dhënë Monika.
- Patrulla e policisë u udhëzua që të niseshin për tek rruga ku ndodheshin automjetet, duke ndezur dritat blu, dhe duke mbajtur derën e pasme të hapur.
- Monika u udhëzua që të priste makinën dhe sapo ta shihte të dilte me vrap jashtë dhe të futej në makinë.
- Makina arriti, Monika vrapoi, hyri me të shpejtë në makinë dhe shpëtoi.

6. Hetimi

6.1 Intervista e parë e Monikës

Situata ishte mjaft e ndërlikuar. Policia e Vendit të Kuq e shoqëroi Monikën te stacioni i policisë së Midtaun. Duke përdorur policinë e Vendit Blu për të përkthyer gjatë bisedës telefonike, policia e Vendit të Kuq siguroi rrëfimin e mëposhtëm të Monikës mbi atë çfarë kishte ndodhur.

Rrëfimi i parë i Monikës:

- Asaj i thanë se po shkonte në Vendin e Kuq për të punuar në një bar.
- Nga kryeqyteti i Vendit Blu ajo fluturoi për në aeroportin e Vendit të Kuq e shoqëruar nga një shok, nga një grua dhe një tjetër vajzë e re thuajse në të njëjtën moshë me të.
- Kur arriti në Vendin e Kuq ajo fillojë të dyshojë. Vajzën tjetër e larguan për një moment. Kur e kthyen, ajo ishte duke qarë dhe tha se i ishte shitur për prostitucion një burri.

Pas këtij çasti, rrëfimi u bë shumë i ngatërruar.

- Monika nuk e kishte takuar ndonjëherë atë vajzë më parë.
- Monika i ishte shitur një burri, mendonte se ishte dërguar në kryeqytetin e Vendit të Kuq, pastaj e kishin kthyer mbrapsht në Midtaun nga një burrë me emrin Stivi dhe një burrë tjetër që ajo e kishte takuar sapo kishte mbërritur në Britaninë e Madhe, me emrin Bobi.
- Ajo e mbante mend se makina që e kishte çuar në Midtaun ishte një BMW blu.
- Ajo tha se Stivi i kishte dhënë asaj celularin që ajo të mos qante e të mos ankohej më.

Ajo i dorëzoi policisë këto sende:

- Kartën e imbarkimit në avionin e Vendit Blu dhe biletën për në kryeqytetin e Vendit të Kuq.
- Celularin që, sipas saj, ia kishte dhënë Stivi.
- Një fotografi të Stivit.

6.2 Arrestimi i të dyshuarve të parë

Policët shkuan përsëri tek shtëpia. Nuk kishte njeri. Bën kontrollin e saj dhe gjetën ca dokumente që lidheshin me një BMW blu.

Ata identifikuan pronarin e shtëpisë, i cil tha se e kishte dhënë makinën me qira dy javë më parë një të huaji.

U kontrolluan të dhënat e veturës në sistemin informativ/kompiuterin e policisë përkatëse. Pas pak kohe policia rrugore e vuri re në autostradë, e ndaloi dhe arrestoi dy burrat që ishin në makinë.

- Robert Grin (ditëlindja 21.05.1974).
- Stiven Grei (ditëlindja 30.07.1079).

Këta persona u shoqëruan në stacionin e policisë së Midtaun.

6.3 Intervista e dytë e Monikës

Më pas u bë intervista më e hollësishme e Monikës nga ana e policisë së Vendit të Kuq, nga intervistues që ishin trenuar për viktimat e pambrojtura. Ajo tregoi se:

- Ishte miqësuar në Vendin Blu me një burrë, Xhonin dhe një grua me emrin Lana.
- Njohu Xhonin dhe Lanan nga disa shokë të përbashkët në kryeqytetin e Vendit Blu.
- Xhoni e pyeti Monikën nëse kishte menduar ndonjëherë që të shkonte të punonte në Vendin e Kuq. Ajo i tha që jo, por në fund ia mbushën mendjen që të shkonte e të shihte se si mund të ishte atje.
- Xhoni e pyeti nëse kishte pasaportë; e kishte (është e ligjshme për shtetasit e Vendit Blu të udhëtojnë për te Vendi i Kuq).
- Xhoni caktoi ditën kur do ta çonte Monikën në Vendin e Kuq. Një ditë para se të merrnin avionin, ai e mori Monikën nga shtëpia e një shoqeje dhe e çoi tek apartamenti i vet.
- Atje ndodhej Lana me një vajzë me të njëjtën moshë me Monikën, me emrin Diana.
- Ditën e nesërme, që të katërt – Xhoni, Lana, Monika dhe Diana – mbërritën në aeroportin e kryeqytetit të Vendit Blu.
- Në aeroport, Xhoni bleu biletat për të katërt.
- Monika mendon se pagesa u bë me para në dorë.
- Të gjithë fluturuan për në Vendin e Kuq; Monika beson se u ulën në aeroportin e qytetit.
- Që të katër kaluan procedurat në zyrat e imigrimit dhe të doganave.
- Sapo hynë në zonën e mbërritjes së aeroportit, Monika pa që Lana po i thoshte diçka Dianës; Diana filloi të qajë.
- Monika e pyeti Dianën përse qante; Lana i kishte thënë se ajo (Diana) ishte shitur për prostitucion. Diana tha edhe se mendonte që e njëjta gjë do i ndodhte Monikës.
- Xhoni dhe Lana i çuan të dyja vajzat te parkimi i aeroportit ku u takuan me dy burra, të cilët u prezantuan si 'Bobi' dhe 'Dani'.
- Vajzat iu dorëzuan Bobit dhe Danit; vajzave ua morën celularët.
- Udhëtuan në autostradë për rreth tre orë deri sa mbërritën tek një hotel.
- E vetmja gjë që mbante mend Monika për hotelin ishte se emri i tij kishte numrin '7'.
- Bobi i la vajzat me Danin në një dhomë hoteli.
- Rreth pas një ore, Bobi u kthye dhe e çoi Monikën në një bar. Hera e fundit që ajo pa Dianën, ishte kur ajo mbeti në dhomë me Danin.
- Tek bari, Bobi e prezantoi Monikën me 'Maikëllin'.
- Pas disa gotash, Bobi i tha Monikës që të shkonte me Maikëllin; Monika refuzoi.

- Maikëlli e çoi në shtëpinë e tij, që ishte rreth dy orë larg.
- Të nesërmen ai e përdhanoi.
- Monika u trondit shumë.
- Maikëlli u përpoq ta qetësonte, dhe e mori për të blerë rroba të reja.
- Ai e përdhanoi edhe dy herë të tjera.
- Kur ra për të fjetur, Maikëlli la celularin mbi tavolinë. Monika i telefonoi të dashurit sepse ai ishte i vetmi numër që mbante mend.
- Ditën tjetër, Maikëlli i tha se do ta çonte përsëri te Bobi, sepse ajo nuk po i bindej.
- Monika beson se apartamenti i Maikëllit ndodhet në një vend të quajtur Ist Taun, në periferi të kryeqytetit të Vendit të Kuq, sepse ai e pat përmendur njëherë atë zonë.
- Ajo arrin të bëjë një përshkrim të mirë të apartamentit, të ndërtesës ku ndodhet ai, dhe çfarë mund të shihet nga dritaret.
- Atë mbrëmje Bobi mbërriti me Stivin me një makinë dhe morën Monikën.
- Gjatë rrugës, Bobi i tha Monikës se ajo i kishte kushtuar atij shumë para dhe telashe, aq shumë sa jeta e tij ishte vënë në rrezik, dhe nëse i ndodhte ndonjë gjë atij, një diçka akoma më e rëndë do t'i ndodhte asaj. Ai i tha se ia kishte dhënë mundësinë, por tani do të shitej si prostitutë.
- Përsëri, rruga zgjati rreth dy orë përgjatë autostradës. Monika mendon se u kthyen në të njëjtin qytet ku ishte hoteli, por nuk është e sigurt.
- Ajo u dërgua tek shtëpia nga e cila u shpëtua, dhe mbeti aty me Stivin.
- Ajo beson se shtëpia ishte e Stivit.
- Stivi doli të nesërmen me Monikën për të blerë ca veshje dhe për të rregulluar flokët. Ajo kuptoi se po e përgatitnin për të bërë jetën e prostitutes.
- U shqetësua shumë. Stivi bëri një marrëveshje me të. Nëqoftë se do të rrinte urtë, ai do t'i jepte një celular që t'i dërgonte mesazh t'ëmës. Ajo pranoi dhe i dërgoi mesazh t'ëmës.
- Ajo mori një mesazh ku i thuhej që të lidhej përsëri me mesazh kur të ishte vetëm. Ajo i fshiu të dyja mesazhet dhe gjeti si justifikim se nuk dinte ta përdorte atë celular.
- Ditën tjetër, Stivi i tha Monikës që do të fillonte punën si prostitutë pas tri ditësh. Pasdite ai doli nga shtëpia, duke lënë celularin në shtëpi.
- Monika bëri telefonatën, e cila u ndoq nga policia e Vendit Blu.

6.4 Identifikimi i Danit

Monika u intervistua në një dhomë të veçantë të stacionit të policisë së Midtaun. Kur mbaroi intervista, ajo u dërgua në një strehëz për gratë e trafikuar. Ndërsa po kalonte nga zona e hyrjes së publikut të stacionit të policisë, ajo filloi të bërtiste duke treguar me dorë një burrë që qendronte tek sporteli i informacionit.

Në fillim burri u hutua, por më pas kërkoi të largohej me të shpejt nga stacioni i policisë. Oficerët e policisë e ndaluan. Monika arriti t'u thotë oficerëve se ai burri ishte Dani.

Dani u arrestua. Emri i tij i vërtetë ishte Daniel Grin, lindur më 04.11.1976. Ai kishte vajtur te stacioni i policisë për të marrë vesh se çfarë kishte ndodhur me vëllain e tij, Robertin.

6.5 Kërkimet e tjera

Personat që janë të ndaluar tani:

- Robert Grin, lindur më 21.05.1974 – i njohur si ‘Bobi’.
- Stiven Grei, lindur më 30.07.1979 – i njohur si ‘Stivi’.
- Daniel Grin, lindur më 04.11.1976 – i njohur si ‘Dani’.

‘Maikëlli’ nuk është identifikuar ende.

U kryen kërkimet e mëposhtme:

- Monika mori pjesë në identifikimin në rresht dhe i njohu të tre burrat.
- Imazhet e qarkut të mbyllur televiziv, CCTV, të marra nga zona e mbërritjeve të aeroportit dhe të zonës së parkimit të aeroportit, mbështeten shpjegimet e Monikës mbi ngjarjet.
- Hoteli u identifikua si një hotel i lirë që i përkiste zinxhirit të hoteleve ‘Lucky 7’ dhe ndodhej afër autostradës në buzë të Midtaun.
- U siguruan imazhet e qarkut të mbyllur të hotelit. Nga imazhet u bë e mundur të identifikohen Roberti (‘Bobi’), Danieli (‘Dani’), dhe Monika. Aty duket dhe një vajzë tjetër me ta, që nuk është identifikuar ende, por besohet të jetë Diana.
- Nga imazhet CCTV të hotelit, duket që Roberti është duke tërhequr Monikën; Danieli atë që besohet të ishte Diana. Nga filmi është e qartë që vajzat detyrohen me forcë që të shkojnë bashkë me burrat.
- Telefoni i përdorur nga Monika për të folur me policinë u lidh me Stiven (‘Stivi’) nga shqyrtimi i shenjave të gishtave. Një ekzaminim i mëtejshëm i celularit tregoi që është përdorur për të marrë numrat që lidhen me Robertin dhe Danielin.
- Të tri celularët që u gjënden tek të tre burrat lidheshin me numrin që pat përdorur Monika për t’i telefonuar të dashurit të saj.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
2.	Studimi i rastit.....	6
3.	E Hënë, 12 maj	7
3.1	Raporti fillestar	7
3.2	Informacion i përgjithshëm.....	8
3.3	Veprimet e hetuesve	8
3.4	Rezultatet e kërkimeve	9
4.	E Martë, 13 maj.....	10
4.1	Kërkimet nga ana e policisë së Oranxhtaun	10
4.2	Rezultatet e kërkimeve të policisë së Oranxhtaun.....	10
5.	E Mërkurë, 14 maj.....	11
5.1	Hetime të mëtejshme të policisë së Oranxhtaun	11
5.2	Rezultatet e vëzhgimeve.....	11
5.3	Në stacionin e policisë dhe intervista e Luçia Grei	12
5.4	Intervista e Martin Black.....	14

1. Hyrje

Ky studim rasti ndjek formatin e përbashkët të përdorur për të gjitha studimet e rasteve të trajtuara në këtë program.

Ai bën një përshkrim të një rasti që nga fillimi deri tek intervistimi i të dyshuarve. Ndahet në pjesë të ndryshme informative rreth rastit në fjalë, i pasuar nga detajet e hetimit dhe të rezultateve të atyre hetimeve. Treinuesve u jepen udhëzime të zgjeruara dhe një mbështetje përgjatë gjithë tekstit.

2. Studimi i rastit

Rasti që studiohet këtu është një rast fiktiv, por bazohet shumë mbi një rast real.

Është disi e pazakontë që viktimi të dërgojë një letër me shkrim, ndryshe nga sa ndodh zakonisht kur viktimi dërgon ndonjë mesazh me sms apo me zë. Megjithatë, edhe në këto raste mbeten të njëjta parimet bazë të hetimeve. Por një gjë është e vërtetë që (si dhe në rastin që studiohet) viktimi u rikuperua menjëherë pas dërgimit të letrës që iu dorëzua policisë, pavarësisht se gjetja e saj kërkoi një bashkëpunim shumë të ngushtë ndërkombëtar.

Rasti demonstroi, gjithashtu, se si Trafikimi i Qenieve Njerëzore (TQNj) mund të ndeshet edhe në zonat më të largëta e më të varfëra të një vendi.

3. E Hënë, 12 maj

3.1 Raporti fillestar

Në orën 10.30 të mëngjesit, një oficer policie ishte në detyrë në stacionin e policisë së Vendit Blu, kur një grua hyri në stacion dhe la mbi banak një zarf të hapur. Gruaja ishte shumë e shqetësuar dhe i kërkoi oficerit që ta lexonte letrën. Në letër shkruhej:

E dashur mam,

E di që ti mendon se shkova në Grintaun për punë dhe se jam ende aty. Po, shkova, por pastaj në fund të verës ika në Oranxhtaun, në Vendin e Kuq, në kërkim të një pune më të mirë. Një burrë më ofroi një vend ku mund të rrija falas. Unë kisha nevojë për atë sepse nuk kisha të holla. Por ai po më mban mua në shtëpinë e tij si në burg. Nuk e di se ku ndodhet ajo shtëpi me saktësi, por është diku në një fshat mbi kodër në kurriz të Oranxhtaun. Ai nuk ka grua dhe më detyron që të kujdesem për tre fëmijët e tij të vegjël. Më detyron të gatuj, pastroj, ... çdo gjë. Nuk më le asnjëherë të dalë jashtë dhe unë nuk kam para. Të lutem, të lutem, mami, më ndihmo! E di që kemi patur probleme midis nesh, por sikur ta dish ti sa shumë frikë që kam!

Me dashuri, vajza jote

Lucia

Gruaja e ka emrin Anna Grei, lindur më 19.10.1961, shtetase e Vendit Blu dhe banore në Blutaun, ku kishte jetuar përherë. Oficeri e intervistoi Annën dhe siguron informacionin si vijon:

- Ditëlindja e Luçias është 12.04.1982.
- Ajo është vajza e vetme e Annës, por Anna ka dhe dy djem më të rritur se Luçia.
- Luçia kish banuar me t'ëmën gjatë gjithë kohës deri 15 muaj më parë.
- Pas largimit nga shkolla, Luçia kishte bërë punë të ndryshme jo të kualifikuara, si pastruese, por dukej se kishte vështirësi të vazhdonte të punonte.
- Për rreth një vit, Luçia kishte mbetur pa punë; marrëdhënia e saj me mamanë ishte e tensionuar.
- 15 muaj më parë, ajo tha se ishte mërzhitur, kishte nevojë për para, dhe se do të shkonte në qytetin Grintaun pranë detit, sepse kishte dëgjuar që kishte shumë nevojë për pastrues atje dhe se dëshironte të ishte pranë detit. Luçia iku.
- Rreth 9 muaj më parë, djali i Annës, Xhoni i tha t'ëmës se kishte marrë një telefonatë nga Luçia, e cila i tha se ishte në Grintaun, por meqenëse ishte fundi i sezonit, nuk kishte më punë për pastrues dhe se nuk dinte se çfarë do të bënte më tej. Megjithatë, Xhoni tha se Luçia dukej mjaft e kënaqur në telefon.
- Që nga ajo kohë, informacioni i parë që mori Anna nga e bija ishte atë mëngjes, kur mbërriti letra e saj.

Informacioni i marrë iu përcoll ekipit hetimor.

3.2 Informacion i përgjithshëm

Disa informacione me karakter të përgjithshëm:

- Vendi Blu dhe Vendi i Kuq ndodhen në zonën e përbashkët të lëvizjes së lirë.
- Ata përdorin të njëjtën gjuhë, megjithëse ka dallime midis dialekteve.
- Vendi Blu dhe Vendi i Kuq ndajnë të njëjtin bregdet, që është mjaft popullor dhe një zonë pushimesh në zhvillim për europianët perëndimorë.
- Qyteti Oranxhtaun në Vendin e Kuq, ku Luçia thotë se ndodhet, shtrihet rreth 300 km në jug-lindje të qytetit Grintaun në Vendin Blu (vendi ku Luçia i tha t'ëmës se do të shkonte, dhe nga ku i tha vëllait se po merrte në telefon).
- Si Oranxhtaun ashtu dhe Grintaun janë qytete rezortesh për pushime.

3.3 Veprimet e hetuesve

Hetuesit ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Ata kontaktuan 'autoritetin qendror' për këshillim. Autoriteti qendror i siguron që nuk ka ndonjë problem në rast se bëhen kontakte polici me polici.
- Ata flasin me policinë e Oranxhtaun (më poshtë, rezultatet).
- Ata marrin zarfin dhe letrën nga nëna.
- Fillimisht, fotografuan të dyja anët e letrës dhe të zarfit; pastaj e mbështjellin dhe e depozitojnë në një mënyrë të tillë që ata të mund të marrin shenjat e gishtave dhe mostra biologjike (pështyma mbi zarf për analizën e ADN-së).
- Ata vejnë re se zarfi është shumë i vjetër, dhe se vetë letra ishte si me njolla, edhe ajo dukej e vjetër.
- Një ekzaminim me sy i zarfit tregon që vula mbi pullën e Oranxhtaun mbante datën e tri ditëve më parë.
- Ata intervistojnë nënën dhe pyesin nëse e pat prekur letrën dikush para saj; ajo thotë se është e vetmja që e ka prekur.
- Ata e pyesin, gjithashtu, nëse shkrimi është i Luçias; Anna thotë se mesa e njuh ajo, shkrimi është i Luçias.
- Nënës i merren shenjat e gishtave për të përjashtuar shenjat e saj nga letra dhe zarfi (zarfi mund të ketë shenja të shumë njerëzve, pasi do të ketë kaluar dorë më dorë nga punonjësit e postës; ndersa letra ka të ngjarë që të ketë shumë më pak, ndoshta vetëm të Luçias dhe t'ëmës).
- Ata sigurojnë një përshkrim dhe një foto të Luçias nëpërmjet Annës.
- Ata, gjithashtu, marrin një furçë flokësh, disa letra të vjetra dhe artikuj të ndryshëm nga dhoma e gjumit të Luçias, në mënyrë që të mund të përdoren , nëse do të duhet, që të marrin shenjat e gishtave dhe material biologjik për t'i krahasuar me ato të mbetura në letër.
- Fotografia e Luçias skanohet dhe i dërgohet me e-mail policisë së Oranxhtaun.

3.4 Rezultatet e kërkimeve

- Policia e Oranxhtaun bën një kërkim te sistemi i tyre i të dhënave në emër të Luçia Grei; nuk gjejnë asnjë të dhënë mbi të.
- Ata i thonë policisë së Blutaun që ekzistojnë një numër fshatrash në rrethin e Oranxhtaun; tipike për atë rreth dhe që shtrihen në zona të gjëra me shumë hapësirë midis shtëpive..
- Policia e Oranxhtaun kërkon një foto cilësore të zarfit dhe të pullës së postës; gjë që plotësohet menjëherë.
- Nga artikujt e gjetur në dhomën e gjumit të Luçias sigurohen shenjat e gishtave, që besohet se janë të saj.
- Do të duhet rreth 48 orë që të analizohen shenjat e gishtave mbi letër dhe zarf.

4. E Martë, 13 maj

4.1 Kërkimet nga ana e policisë së Oranxhtaun

- Policia fillon kërkimet për të identifikuar një burrë me tre fëmijë të vegjël dhe pa bashkëshorte.
- Meqenëse ka shumë pak çifte të pamartuara në këtë rajon shumë tradicional, policia krijon një hipotezë të përkohshme që burri ka qenë ndoshta i martuar dhe se fëmijët janë produkt i asaj martese.
- Ata krijojnë, gjithashtu, hipotezën se e shoqja ose e ka lënë të shoqin, ose ka ndërruar jetë para se Luçia të hynte në atë familje.
- Cilido që të jetë rasti, është e sigurt që vdekja ose largimi ka ndodhur para se Luçia të ikte nga shtëpia e saj në Blutaun, ndoshta, dhe mjaft më vonë në rast se është e vërtetë që Luçia telefonoi nga Grintaun.
- Meqenëse letra përmendte fëmijët 'e vegjël', ka gjasa që bashkëshortja të ishte relativisht e re, kur qe larguar apo kishte ndërruar jetë.
- Ata flasin me policinë vendore dhe pyesin nëse kishin dëgjuar për një grua të martuar e me fëmijë të vegjël që të kishte ndërruar jetë kohët e fundit.
- Ata bëjnë po këto pyetje kur u drejtohen drejtuesve të fesë në atë rreth.
- Ata flasin me postierin e zonës dhe i tregojnë shënjen e pullës së zarfit.
- Ata kontrollojnë regjistrin civil vendor të lindjeve, martesave dhe vdekjeve për të parë nëse mund të sigurojnë ndonjë tregues të dobishëm.

4.2 Rezultatet e kërkimeve të policisë së Oranxhtaun

- Një oficer policie i rajonit të fshatit Griville thotë se një burrë me emrin Martin Blek, gruaja e të cilit kishte vdekur 18 muaj më parë, kishte tre fëmijë të vegjël.
- Martin Black jeton në një shtëpi në buzë të fshatit Grinville.
- Martin Black ka një histori vjedhjesh të vogla dhe histori dehjesh.
- Policia vendore thotë se kur e shoqja ishte gjallë, ata ishin thirrur dy herë për shkak të grindjeve familjare midis burrit dhe gruas, por nuk ishte marrë ndonjë veprim zyrtar.
- Kërkimet në regjistrin civil të lindjeve, vdekjeve dhe martesave konfirmojnë që Elena Black kish ndërruar jetë nga pneumonia 18 muaj më parë, ajo rezultoi si gruaja e Martin Black dhe nëna e tre fëmijëve.
- Ka mundësi që edhe të tjerë mund t'i përgjigjen profilit të ngjashëm me Martin Blek, por nuk u kërkuan sugjerime të tjera dhe kërkimet nuk çuan në ndonjë drejtim tjetër.
- Postieri konfirmoi se ajo është shenja e postës së Oranxhtaun. Daton më 10 maj, ditën e shtunë. Kjo do të thotë që letra mund të ishte postuar diku midis orës 5.30 të pasdites së të Premtes, 9 maj dhe orës 1.00 të pasdites se ditës së Shtunë, 10 maj. Mund të ishte hedhur në nja nga 37 kutitë postare të qytetit Oranxhtaun dhe rrethinave, por nuk mund të saktësohet se në cilën.

5. E Mërkurë, 14 maj

5.1 Hetimet e mëtejshme të policisë së Oranxhtaun

- Ekipi hetimor organizon një diskutim.
- U vendos që të vëzhgohet shtëpia e Martin Blek.
- Objektivi është që të ndiqet nëse ai largohet nga shtëpia, dhe nëse po, t'i afrohen shtëpisë dhe të shikojnë nëse ka ndonjë person tjetër brenda.
- Shtëpia e Martin Blek është në buzë të një rruge të vogël me pak trafik.
- Oficerët të veshur civil kalojnë pranë shtëpisë dhe shikojnë se aty ndodhet një makinë e vjetër e parkuar jashtë; ata mbajnë shënim numrin e targës.

5.2 Rezultatet e vëzhgimeve

- Rreth orës 8.30 të mëngjesit, makina e Blek u pa të drejtohet nga shtëpia drejt Oranxhtaun; ai i jep makinës dhe duket se në makinë janë dhe dy fëmijë.
- Oficerët i afrohen shtëpisë dhe i bien ziles.
- Nuk përgjigjet njëri.
- Dëgjojnë një zë fëmije. Zëri thotë "Luçia është dikush ke dera".
- Megjithatë, asnjë nuk vjen të hapë derën.
- Policia thotë "Luçia, jemi policia. Kemi ardhur të të ndihmojmë. Hape derën".
- Përsëri nuk ka përgjigje.
- Fëmija fillon të qajë dhe thërret "Luçia, çfarë duan ata burrat? Luçia, kam frikë".
- Policia vazhdon t'i bjerë ziles, duke i kërkuar përsëri Luçias të hapë derën.
- Ajo nuk vjen.
- I afrohen dritareve të shtëpisë dhe shohin një vajzë të vogël, rreth 5 vjeç, që qan në mes të dhomës; nuk shikojnë asnjë tjetër.
- Policia e hap me forcë derën.
- Fëmija fillon të therrasë sapo ata hyjnë brenda.
- Një oficer përpiqet ta qetësojë fëmijën, të tjerët kontrollojnë shtëpinë.
- Ata hapin një derë depoje prapa kuzhinës.
- Shohin një grua të strukur në qoshe, ulur mbi diçka që duket si një farë krevati.
- Ata i afrohen; ajo tërhiqet duke mbyllur fytyrën me duar.
- Ata e bindin që të tregojë fytyrën; është Luçia Grei.
- Ajo është tepër e frikësuar dhe përsërit vazhdimisht "Ju lutem mos më rrihni, nuk e kisha me gjithë mend" duke u përpjekur që të tërhiqej sa më larg nga policët.
- Me shumë vështirësi ata e bindin Luçian që të shkonte me ta. Ndërkohë që po largoheshin, ajo thotë "Ku po shkoni? Ku po më çoni? Të lutem mos më goditni, nuk e kisha me tërë mend".

- Një oficer i thotë “Luçia, ne na dërgoi nëna juaj. I dërgove një letër duke i kërkuar ndihmë, apo jo. Është ajo që na dërgoi këtu të të ndihmojmë”.
- Kjo duket sikur e qetësoi Luçian pak, por është ende e mpirë dhe jashtëzakonisht e frikësuar, kur e hypin në makinën e policisë.

5.3 Në stacionin e policisë dhe intervista e Luçia Grei

- Luçia vazhdon të jetë shumë e frikësuar në stacionin e policisë.
- Nuk ka shenja dhune në trup, por është e dobët dhe përgjithësisht në gjendje jo të mirë shëndetësore.
- Për shkak të gjendjes së saj fizike dhe psikologjike, u vendos që të thirrej një mjek për të vizituar Luçian.
- Vizita u krye dhe mjeku u thotë hetuesve që Luçia mund të intervistohet, por është e nevojshme që intervista të bëhet me shumë kujdes; së bashku ata vendosin që hapi më i mirë për t’u bërë është që të therrasin një punonjës social që të jetë i pranishëm gjatë intervistës.

Punonjësja sociale

- Një punonjëse sociale flet me Luçian për t’i shpjeguar se “çfarë do të ndodhë dhe se të gjithë duan ta ndihmojnë”.
- Luçia vazhdon të thotë njësoj, “ata të gjithë janë shokët e tij, shokët e tij”.
- Kur e pyetën për kë e kishte fjalën, Luçia u përgjigj “policët”.
- Kur e pyetën se ç’kërkon të thotë, Luçia thotë që disa policë, shokë me Martin Blek, kishin vajtur në shtëpinë e tij dhe e kishin kërcënuar Luçian, duke i thënë që nëse ajo nuk do t’i bindej Martinit, ata do ta arrestonin dhe do ta futnin në burg.

Intervista në polici

Polici dhe punonjësja sociale arritën ta bindin Luçian se nuk është në rrezik dhe se ata thjesht kërkojnë të kuptojnë se çfarë ka ndodhur me të. Megjithëse ajo është ende dyshuese, ata arritën të marrin këtë informacion:

- Luçia shkon në Oranxhtaun për të punuar, pas mbarimit të sezonit në Grintaun.
- Gjeti një farë pune, por nuk arriti të gjejë ndonjë vend për të banuar dhe flinte në çfarëdo strehe që arrinte të gjente.
- Një mbrëmje Luçia vuri re Martin Blek duke pirë në park me shokë; ata bisedonin.
- E ndeshi Martinin disa herë; zunë shoqeri dhe asaj filloi t’i dukej i lezetshëm.
- Rreth një javë më vonë, Martin Blek e pyet Luçian se ku banonte, ajo i tha ‘asgjëkund’ dhe i shpjegoi se ajo kishte gjetur një farë pune dhe se nuk do ta kishte më për një kohë të gjatë, pasi do të mbaronte sezoni turistik.
- Martin Blek i thotë se edhe ai ishte i varfër, por kishte një shtëpi dhe se ajo mund të banonte me të.
- Luçia pranon, dhe të nesërmen ai e merr me makinë dhe e çon te shtëpia e vet (atje ku e gjeti policia).
- Sapo mbërriti atje, ajo vuri re të tre fëmijët.

- Martin Blek i tha se e shoqja kishte ndërruar jetë disa muaj më parë dhe e kishte shumë të vështirë të kujdesej për fëmijët dhe punët e shtëpisë; tani Luçia do të mbante fëmijët dhe shtëpinë.
- Luçia pyeti se si do të bënte me punën që kishte.
- Martini i tha që tani ajo do të punonte për të.
- Luçia refuzoi.
- Martin Blek i tha se ose do ta bënte me të mira, ose, përndryshe do ta rrihte.
- Luçia u frikësua dhe nuk foli më në atë çast.
- Asaj iu tregua depoja prapa kuzhinës dhe iu tha se do të flinte atje. Martin Blek i dha ca batanije të vjetra dhe ca rraqe me të cilat të mbulohej.
- Të nesërmen, Martin Blek i tha se do të shkonte në punë dhe se asaj as mos t'i shkonte nëpër mend që të largohej, sepse ai kishte marrëdhënie shumë të mira me fqinjët dhe ata do ta njoftonin Martinin nëse e shikonin Luçian të dilte jashtë shtëpisë. E vetmja zgjedhje që kishte Luçia, tha Martini, të shkonte në pyll dhe të vdiste urie.
- Megjithatë, dy ditë më vonë Luçia vendosi të largohej dhe u nis drejt rrugës; Blek e gjeti, e tërhoqi drejt shtëpisë dhe i tha se kishte thirrur policinë.
- Pas nja dy orësh, erdhën tre burra të veshur me uniforma policie. Ata thanë se ishin shokët e Martin Blek dhe se ai kishte bërë një ankimim rreth 'thyerjes së një kontrate'; ata i thanë Luçies se kjo konsiderohej një thyerje e rëndë e ligjit në Vendin e Kuq dhe se ajo do të dënohej me 5 vjet burg po të thyente përsëri kontratën.
- Luçia u tha se nuk kishte asnjë kontratë. Një nga burrat filloi të bërtiste e ta shante 'shtrigë gënjeshtare' dhe e kërcënoi se nëse ikte përsëri, burgosja do të ishte e keqja më e vogël që i kanosej.
- Pas kësaj Luçia qendroi në atë shtëpi dhe vepronte siç i thonin.
- Asaj i kërkohesh të ngrihej në mengjes në orën 6.30, t'i bënte dy fëmijët më të rritur gati për shkollë. Do të merrej gjithë ditën me fëmijën më të vogël. Kujdesej për shtëpinë, gatuar, ushqente derrat e shtëpisë, kujdesej për kopshtin, etj.
- Luçia nuk u pagua asnjëherë dhe ushqehesh vetëm me mbeturinat e kuzhinës.
- Kur u sëmur rëndë në dimër, nuk u lejua të shkonte të vizitohej, por mori ndonjë ilaç që i pat sjellë Martin Blek.
- Gjatë gjithë kohës, Blek vazhdonte ta kërcënonte me policinë dhe se do ta rrihte (pavarësisht se nuk e goditi ndonjëherë) dhe se të gjithë komshijtë do të raportnin po të ikte.
- Luçia kishte vënë re një grua që kalonte rregullisht pranë shtëpisë, kur punonte në kopësht.
- Kjo grua i buzëqeshte dhe i thoshte 'Miredita' sa herë shihte Luçian.
- Luçia gjeti ca zarfa të vjetër në shtëpi dhe pak letër shkrimi.
- Ajo shkroi letrën, dhe herën tjetër kur ishte vetëm dhe e pa gruan të kalonte aty pranë, Lucia vrapoi i dha letrën duke iu lutur që ta postonte në postë.
- Gruaja megjithëse si me frikë, e mori letrën.
- Luçia priste një përgjigje të shpejtë, por kaluan dhjetë ditë para se të vinte policia.
- Kur mbërriti policia, Luçia mendoi se gruaja ia kish dhënë letrën Martin Blek dhe se policia kish ardhur ta arrestonte, dhe ndoshta edhe ta rrihnin.

5.4 Intervista e Martin Blek

Martin Blek u arrestua. Ai u intervistua dhe bëri rrëfimin e mëposhtëm:

- Për herë të parë e kishte njohur Luçian në tetor, në fund të sezonit të pushimeve.
- Ajo i ishte afruar kur ai po pinte me shokët në një park të Oranxhtaun. Luçia i kishte pyetur burrat nëse dinin se ku mund të gjente një dhomë.
- Martin Blek i ishte përgjigjur se kishte një vend ku mund të flinte ajo; nuk ishte ndonjë gjë e madhe sepse ai ishte i varfër, por ajo ishte e mirëpritur ta perdorte atë vend nëse do të pranonte të bënte ca punë e të ushqente fëmijët.
- Ai tha se Luçia u duk entuziaste, kur ai pat përmendur fëmijët.
- Ajo shkoi me të te shtëpia dhe për aq sa mori vesh ai, ajo ishte e kënaqur me marrëveshjen.
- Ai pranoi se vendi ku do të flinte nuk ishte i përshtatshëm, por ai i pat thënë asaj se edhe shtretërit e tyre nuk ishin kushedi se çfarë, sepse ishin të varfër. E vetmja alternativë do të ishte që ajo të flinte me të në krevatin e tij, por hetuesit, me siguri, nuk do të mendonin se kjo do të ishte një ide e mirë, apo jo?
- Hetuesit e pyetën rreth shokëve të tij 'policë'. Ai u përgjigj se nuk e kuptonte se për kë e kishte fjalën. Luçia gabohej. Kishin ardhur ca miq për të pirë ndonjë gotë, por ata nuk ishin policë.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
2.	Studimi i Rastit	6
3.	E Hënë, 12 maj	7
3.1	Telefonata e parë.....	7
3.2	Policia mbërrin te vendngjarja.....	7
3.3	Intervista e parë e vajzave	7
3.4	Intervista e pronares së kioskës dhe e dëshmitarëve të tjerë	8
4.	E Martë, 13 maj.....	9
4.1	Intervista e dytë e vajzave	9
4.2	Hetimet në Blutaun	9
5.	E Mërkurë, 14 maj.....	10
5.1	Intervista me nënën Rita Blu.....	10
5.2	Historia e Robert Grei	10
5.3	Veprimet për të rënë në gjurmë të Robert Grei.....	11
6.	E Enjte, 15 maj.....	12
6.1	Lokalizimi i Robert Grei.....	12
6.2	Shfaqet Robert Grei	12
6.3	Në apartament	13
6.4	Intervista e Molli Grei	13
7.	E Premte, 16 maj	14
7.1	Intervista e Robert Grei.....	14

1. Hyrje

Ky studim rasti ndjek formatin e përbashkët për të gjitha studimet e rastit të këtij programi.

Ai bën përshkrimin e një rasti që nga fillimi deri tek intervistimi i të dyshuarve. Është i ndarë në disa pjesë informative rreth rastit, i pasuar nga detajet e hetimit dhe të rezultateve të atyre hetimeve. Treinuesve u jepen udhëzime të shumta dhe u ofrohet mbështetje përgjatë tekstit.

2. Studimi i rastit

Rasti në vijim është një rast fiktiv, por i bazuar mbi një numër rastesh të ndodhura realisht.

Rastet mbi të cilat është mbështetur rasti ynë kanë ndodhur në Europën Lindore dhe Perëndimore; megjithatë, raste të ngjashme me këtë janë ndeshur në shumë vende të botës. Termi 'veprimtari e paligjshme' i përdorur këtu ka të bëjë me lypjen. Ka një problem të vogël, se lypja e thjeshtë (pra pa përdorur kërcënimin apo detyrimin) nuk penalizohet në disa jurisdiksione. Pavarësisht nga kjo, do të kemi të bëjmë me akte penale në rast se një person trafikohet për të bërë punën e lypësit; me fjalë të tjera, në ato raste kur përdoren veprimet dhe mjetet për të shfrytëzuar dikë. Për më tepër, në rast se bëhet fjalë për fëmijë (siç është rasti në fjalë) këtu lindin dhe probleme të mbrojtjes së fëmijës.

3. E Hënë, 12 maj

3.1 Telefonata e parë

Vendi i Blertë ka realizuar muajt e fundit një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore (TQNj). Një nga fushat ku u përqendrua fushata është trafikimi për veprimtari të paligjshme, në mënyrë të veçantë për lypjen e organizuar.

Në orën 2.00 të pasdites, linja falas e anti-TQNj në kryeqytetin e Vendlit të Blertë, Grintaun, mori një telefonatë nga një grua që thotë se është pronare e një kioskoje në kryqëzim të rrugës Avenu 9 dhe Bulevardit Banduing. Ai është një nga kryqëzimet kryesore shumë i rrahur nga trafiku, në periferi të kryeqytetit.

Gruaja thotë se disa fëmijë po lypin në kryqëzim. Pamja e lypësve në një kryqëzim është një diçka pak a shumë normale, por këta fëmijë ishin mjaft të vegjël. Ata flasin gjuhën e Vendlit të Kuq, por me një theks të fortë jugor. Ata u dukën në atë vend ditët e fundit dhe gruaja thotë se mendon se aty i la një burrë që erdhi në një makinë të vjetër.

Personeli i linjës telefonike falas, kontaktoi policinë dhe informoi për këtë fakt.

3.2 Policia mbërrin në vendngjarje

Një patrullë policie arrin te kryqëzimi. Shikojnë tri vajza. Të trija largohen me vrap kur shikojnë policinë. Policët dalin nga makina dhe i ndjekin me këmbë. Arrijnë të kapin dy vajza, por e treta, që ishte më e madhe në moshë, u shpëton nga duart.

Dy vajzat më të vogla duken shumë të frikësuara dhe nuk i përgjigjen policit. Nuk kanë ndonjë dokument identifikimi. Janë të dobëta, të palara, të veshura me rrecka.

Vajzat i dërgojnë te stacioni i policisë.

3.3 Intervista e parë e vajzave

Policët intervistojnë vajzat. Ata nuk përdorin specialistë të treinar, sepse nuk kanë ndonjë të tillë dhe policët ndruhen rreth sigurisë së vajzës që arriti t'u ikë nga duart. Ata përdorin një punonjëse sociale për raste emergjencash në përputhje me legjislacionin e Vendlit të Blertë.

Informacioni i mbledhur nga intervistat:

- Vajza më e rritur thotë se e thërrasin Aleks – duket të jetë rreth 12 vjeç.
- Vajza me e vogël thotë se e thërrasin Krisi – duket të jetë rreth 10 vjeç.
- Nuk e dijnë se çfarë mbiemri kanë.

- Ato thonë se vajza që iku me vrap është motra e tyre dhe quhet Rita.
- Asnjëra nga ato nuk e dijnë se në ç'qytet ndodhen.
- Nuk e dijnë se ku mund të jetë tani Rita; mund të jetë edhe 'në shtëpi', dhe se shtëpia është në një 'ndërtesë të madhe'.
- Aleks i mendon se kanë qenë në këtë qytet për rreth katër, pesë ditë. Krisi nuk e di se përsa kohë kanë qenë në qytet.
- Të dyja thonë se nuk e dijnë se si kanë mbërritur atje.
- Kur u pyetën se me kë rrijnë, të dyja heshtën dhe duken të frikësuara.

3.4 Intervista e pronares së kioskës dhe e dëshmitarëve të tjerë

Policia shkon te kryqëzimi dhe flasim me pronaren e kioskës.

Ajo jep informacionin e mëposhtëm:

- Ajo mendon se vajzat kanë qendruar atje për tri ditë.
- Ajo nuk mund të thotë nëse rrinin atje gjithë ditën, por i ka vënë re herët në orën 8 të mëngjesit deri në orën 8 të darkës.
- Ajo ka parë se vajzat flisnin herëpashere me shoferin e një makine të kuqe, të vjetër.
- Ajo nuk arrin të mbajë mend numrin e targës së makinës.
- Shoferi i makinës është një mashkull.
- Ajo nuk dinte se si të vepronte, por pastaj pa një poster mbi TQNj me numrin e telefonit falas dhe vendosi që t'i bjerë atij numri.

Policët bëjnë kerkime të tjera në zonë. Gjejnë një dëshmitar të dytë, një recepsionist të një zyre me dritare mbi kryqëzimin e rrugëve.

Ai jep informacionin në vijim:

- Makina është një makinë e tipit të vjetër Lada 'Nova', ose 'Klasik'.
- Ai nuk e mban mend numrin e targës së makinës.
- Shoferi ishte një mashkull.
- Mund të thoshte se shoferi ishte i bardhë, me shtat të mesëm, rreth të tridhjetave, që mbante një xhaketë gri.
- Nuk mund të thotë me saktësi se sa i gjatë ishte shoferi.
- Të vetmit pasagjerë që kishte vënë re në makinën e tij, ishin fëmijët.
- Ai konfirmon se vinin në atë vend rreth orës 8 të mëngjesit dhe i shihte vajzat që lëviznin përreth atij vendi gjatë gjithë ditës, por nuk arrin të thotë se çfarë bënin ato vajza pas orës 5 të pasdites, pasi ai mbyllte zyrën në atë orë.

4. E Martë, 13 maj

4.1 Intervista e dytë e vajzave

Aleksi dhe Krisi intervistohen tani nga intervistues të specializuar.

Rezultatet e intervistave janë si më poshtë:

- Ato ndodhen në Grintaun me një burrë, të cilin ata e quajnë 'xhaxhai'.
- Aleksi thotë se emri i saj i plotë është Aleksandra, dhe emri i Krisit është Kristina, por ato njihen me emrin e tyre shkurt.
- Aleksi thotë se motra që iku me vrap quhet 'Molli'.
- Nëna e tyre quhet Rita; mbiemri i nënës është Blu.
- Ato nuk dijnë të thonë se kur e kanë parë nënën për herë të fundit.
- Asnjëra nuk di të shpjegojë se sa kohë kanë që e kanë njohur 'xhaxhain', por dijnë se nuk ka shumë kohë që e kanë njohur.
- Nuk e dijnë se ku ndodhet e ëma.
- Janë nga një qytet tjetër.
- Aleksi mendon se ai qytet quhet Blutaun.
- Ata tregojnë se si është ai.
- Erdhën në Grintaun në makinën e 'xhaxhait' të tyre.
- Disa ditë më parë ato ishin mbajtur në një dhomë të vogël të një ndërtese të madhe, të bardhë, me shumë dhoma të tjera.
- Çdo ditë 'xhaxhai' i dërgonte te kryqëzimi.
- Aleksi thotë se dijnë çfarë duhet të bëjnë, sepse bënin të njëjtën gjë në Blutaun.

4.2 Hetimet në Blutaun

Policia e qytetit Grintaun kryen hetime urgjente bashkë me kolegët e tyre të qytetit Blutaun dhe zbulojnë të dhënat e mëposhtme:

- Nga përshkrimi që bëri Aleksi, duket me të vërtetë se bëhej fjalë për Blutaun.
- Policia e Blutaun kanë të regjistruar një grua që quhet Rita Blu.
- Gjashtë muaj më parë, një grua me atë emër dhe moshë të ngjashme me moshën e nënës së fëmijëve, ishte arrestuar për prostitucion dhe ishte burgosur.
- Për aq sa dihej nga policia e Blutaun, Rita Blu kishte dalë tani nga burgu.

5. E Mërkurë, 14 maj

5.1 Intervista me nënën Rita Blu

Policia e qytetit Blutaun bëjnë kërkimet e tyre gjatë gjithë natës dhe në orën 6.15 të mëngjesit bien në gjurmë të Ritës në një vend të përhumbur në lindje të qytetit.

Ajo merret në stacionin e policisë dhe jep informacionin në vijim:

- Vajzat janë bijat e saj.
- Ajo konfirmon emrat dhe moshat e tyre: Kristina, e njohur si Krisi, 10 vjeç; Aleksandra, e njohur si Aleks, 12 vjeç; dhe Molly, 14 vjeç.
- 'Xhaxhai' është burri i saj jo formal.
- Ajo thotë se e njeh me emrin Robert Grei, por nuk është e sigurt nëse është emri i tij i vërtetë.
- Ai nuk ka lidhje gjaku me fëmijët e saj.
- Për disa muaj me radhë ai e detyroi të gjithë familjen që të lypnin në Blutaun.
- E detyroi Ritën të bëhej prostitutë, para se ajo të përfundonte në burg.
- Kur ishte në burg, ai i tha se po i merrte fëmijët me vete që të lypnin në një qytet tjetër, ku kishte më shumë para.
- Ajo i ishte lutur që të mos e bënte këtë, por ai i ishte përgjigjur se nëse do bënte numra, ai do t'i tregonte policisë për një vjedhje ku kishte marrë pjesë ajo, dhe se nuk do t'i shihte më kurrë fëmijët e saj.
- Ajo kishte folur dy herë me Robertin këto ditët e fundit.
- Roberti i kishte thënë se fëmijët janë mirë dhe nëse ajo nuk do të krijonte ndonjë problem, do t'ia kthente pas nja dy muajsh, kur të kishin bërë mjaft para.
- Ajo i dha policisë dy numrat e celularit të Robertit dhe një adresë në Blutaun.
- Ajo i ka fotot e vajzave dhe të Robertit.
- Roberti kishte qenë i dhunshëm me të, shumë shpesh i dehur, dhe e shante vazhdimisht.
- Për aq sa dinte ajo, ai nuk kishte qenë i dhunshëm me vajzat.
- Ndonjëherë i shante dhe ato, por kjo ndodhte rrallë.

5.2 Historia e Robert Grei

Policia e Blutaun ka shumë informacion mbi këtë burrë. Pikat kryesore janë:

- Ka një të shkuar burgosjeje për vjedhje dhe dhunë fizike.
- Ata kanë dijeni për emrat e shokëve të tij në Blutaun.
- Kontrolli i fundit që i bënë, ishte në makinën e tij, një Lada 'Klasik' e kuqe e vjetër në Blutaun tri javë më parë, kur edhe u gjobit për shkelje të rregullave të qarkullimit.

- Në kohën kur u ndalua nga policia, ai ishte vetëm në makinë.
- Ai u kish dhënë të njëjtën adresë banimi, si ajo që ua dha Rita Blu.
- Kur u gjobit, ai kish dhënë numrin e celularit të tij.
- Kontrollat treguan se ai numër ishte i njëjtë me njërin nga ato që kishte dhënë Rita.

5.3 Veprimet për të rënë në gjurmë të Robert Grei

Hetuesit e Grintaun ndërmorën veprimet e mëposhtme bazuar mbi informacionin e siguruar nga kolegët e tyre të Blutaun:

- Sigurojnë autorizimin për të përdorur qelizat telefonike dhe të dhënat në dy numrat e celularëve që ata kanë për Robert Grei dhe nënën e fëmijëve Rita Blu.
- Sigurojnë autorizim për të monitoruar bisedat telefonike në celularët e Robert Grei.
- Përdorin fotot e vajzave për të kontrolluar nëse janë ato vajza që i kanë intervistuar; kjo konfirmon se ato janë dy vajzat më të vogla të Rita Blu.

Këto veprime sigurojnë informacionin në vijim:

- Celularët e përdorur nga Robert Grei kanë qenë përdorur dhe po përdoren ende në qytetin Grintaun.
- Regjistrimet tregojnë se janë përdorur në shumë pjesë të qytetit Grintaun, por kryesisht (veçanërisht në mëngjes dhe mbrëmje) në një zonë të vogël të Nju Grintaun.
- Përgjimi regjistron një bisedë kur ai flet me një shok. I flet për vajzat, duke i thënë se dy nga ato janë kapur nga policia duke lypur, dhe se e treta është me të. Ai nuk di se çfarë të bëjë me atë vajzë, atij i ka ardhur në majë të hundës i gjithë ky biznes, dhe se po mendon të kthehet në qytetin Blutaun.

Nën dritën e këtij informacioni, u kryen hetimet e mëtejshme:

- Policisë vendore të Nju Grintaun i kërkohet të bëjë një kontroll gjatë natës në kërkim të Lada së kuqe në zonat ku është përdorur celulari i Robert Grei.

6. E Enjte, 15 maj

6.1 Lokalizimi i Robert Grei

Kërkimet e policisë së Nju Grintaun prodhuan këto rezultate:

- Në orën 4.55 të mëngjesit, një patrullë policie gjen makinën e Robert Grei të parkuar në një vend parkimi midis katër blloqeve me apartamente.
- Çdo bllok ka rreth tetëdhjetë apartamente.
- Policia vendore e vëzhgojnë makinën nga larg.
- Asnjë nuk i afrohet makinës ndërkohë që ajo është nën vëzhgimin e policisë.

Hetuesit ndërmarrin hapat e mëposhtëm:

- Sigurojnë një ekip vëzhguesish që të vazhdojë vëzhgimin në 6 të mëngjesit.
- Vendosin një ekip për të arrestuar Robert Grei, nëse ai i afrohet makinës.
- Të gjithë anëtarëve të ekipit u shpërndahet fotografia e Robert Grei.
- Kontrollojnë regjistrimet e qirasë, por ato dalin të vjetëruara.
- Në orën 7 të mëngjesit, dedektivët takojnë administratorët e apartamenteve; ata nuk mund të japin informacion.
- Bëjnë një kontroll të numrit të celularit që Robert Grei pat përdorur për të marrë shokun e tij në telefon; celulari është i hapur dhe është në zonën e shënjestruar.

6.2 Shfaqet Robert Grei

Në orën 7.50 të mëngjesit një burrë del nga një bllok apartamentesh dhe i afrohet makinës.

- Oficerët e njohin nga fotografia se kanë të bëjnë me Robert Grei.
- Ai arrestohet.
- Aty për aty merret në pyetje.
- Ai refuzon t'u tregojë se ku banon.
- Ai kontrollohet.
- Në xhep i gjindet një celular.
- U gjetën edhe një tufë me çelësa.
- Policia i thotë se do të shkojnë te blloku i apartamenteve dhe do të provojnë çdo derë derisa të gjejnë se cila është dera e tij.
- Me të dëgjuar këtë, Robert Grei pranon t'u tregojë apartamentin.

6.3 Në apartament

Robert Grei hap derën e apartamentit dhe oficerët hyjnë. Ata gjejnë si më poshtë:

- Apartamenti ka një dhomë ndenje, një kuzhinë dhe një banjo.
- Te dhoma e ndenjes ndodhet një krevat.
- Apartamenti është i pisët, veçanërisht kuzhina dhe banjo.
- Ushqimi është i pakët.
- Te dhoma e ndenjes duket një derë e mbyllur me çelës.
- Oficerët i kërkojnë Robert Grei të hapë derën; ai e hap.
- Në atë dhomë ata shohin një vajzë, të cilën e njohin se është Mollie Blu.
- Dhoma nuk ka krevat.
- Duket që njerëzit në atë dhomë flejnë në dyshe me mbi ca rroba të vjetra.
- Mollie është në të njëjtën gjendje si të motrat, e dobët dhe e palarë.
- Ajo duket shumë e frikësuar, veçanërisht nga policët me uniformë.

6.4 Intervista e Mollie Grei

Mollie u intervistua nga specialistë. Pikët kryesore të asaj që ajo tha, janë në vijim:

- Ajo mbështet gjithë çfarë kishin thënë të motrat.
- Ato ishin sjellë nga Blutaun te Grintaun nga Robert Grei.
- Kishin udhëtuar me makinë.
- Robert Grei i kishte lënë te kryqëzimi për të lypur.
- Ai u kishte thënë se policët do t'i rrihnin po t'i kapnin, prandaj, nëse shikonin policë, të iknin me vrap.

7. E Premte, 16 maj

7.1 Intervista e Robert Grei

Robert Grei u intervistua. Pikat kryesore të asaj që tha:

- Ai pranoi se kishte sjellë vajzat në qytetin Grintaun.
- Ai thotë se nuk është i kënaqur me kushtet e apartamentit, por nuk mund të bënte ndryshe me vështirësitë që po kalonte në ato kohë.
- Ai thotë që megjithëse vajzat nuk janë të tijat, ai i do njësoj sikur të ishte babai i tyre.
- Ai thotë se i solli në Grintaun që t'i largonte nga e ëma që ishte një pijanece dhe abuzonte me to.
- Ai shtoi se e ëma e tyre është edhe një prostitutë dhe pavarësisht përpjekjeve të tij për të mos e lejuar të ushtronte atë profesion, ajo vazhdon po të njëjtën mënyrë jetese.
- Ai është shumë i shqetësuar sepse ka frikë se mos vajza më e madhe, në mënyrë të veçantë, do të shtyhet ose madje edhe do të detyrohet me forcë nga nëna e saj që të bëhet prostitutë.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	5
1. Ushtrimi i Rastit 1 – Personi i zhdukur	6
1.1 Tregimi	6
1.2 Çfarë treguesish kemi këtu?	6
1.3 Çfarë duhet kërkuar në këtë rast?	7
1.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?	7
1.5 Si do të veproni?	7
2. Ushtrimi i Rastit 2 – Në rrugë	9
2.1 Tregimi	9
2.2 Çfarë treguesish kemi këtu?	9
2.3 Çfarë duhet të kërkojmë?	10
2.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?	10
2.5 Si do të veproni?	10
3. Ushtrimi i Rastit 3 – Shërbimi në familje	12
3.1 Tregimi	12
3.2 Çfarë treguesish kemi këtu?	12
3.3 Çfarë duhet të kërkojmë?	12
3.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?	13
3.5 Si do të veproni?	13
4. Ushtrimi i Rastit 4 – Shtëpia publike	14
4.1 Tregimi	14
4.2 Çfarë treguesish kemi në këtë rast?	15
4.3 Çfarë duhet të kërkojmë?	15
4.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?	15
4.5 Si do të veproni?	16
5. Ushtrimi i Rastit 5 - Ferma	17
5.1 Tregimi	17
5.2 Çfarë treguesish kemi në këtë rast?	17
5.3 Çfarë duhet të kërkojmë?	18
5.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?	18
5.5 Si do të veproni?	18
6. Ushtrimi i Rastit 6 – Veprimtari e paligjshme – Lypja	20
6.1 Tregimi	20
6.2 Çfarë treguesish kemi në këtë rast?	20
6.3 Çfarë duhet të kërkojmë?	20
6.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?	21
6.5 Si do të veproni?	21

Hyrje

Këto ushtrime me rastet janë projektuar kryesisht për t'u përdorur bashkë me Planin Mësimor 2, 'Treguesit e Trafikimit të Qenieve Njerëzore'. Megjithatë, disa mund të përdoren edhe për lojrat me role, sepse kanë vetinë e përshtatjes për të gjitha përdorimet.

Një 'ushtrim i rastit' në këtë material është ekzaminimi i një faze specifike të procesit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj). Të gjitha ushtrimet janë mjaft të shkurtra; asnjë tregim i 'rastit' nuk i kalon 400 fjalët.

Dallimet kryesore midis ushtrimeve të rastit, që kemi krijuar, dhe 'studimeve të rastit' qendrojnë në faktin që studimet e rastit janë më të plota dhe shumë më të gjata.

Të gjitha ushtrimet e rastit që trajtohen këtu janë fiktive. Gjithsesi, tregimet e rasteve dhe këshillat që jepen bazohen fort mbi njohuritë dhe përvojën e përfutur nga procesi i TQNj dhe nga përgjigjet e dhëna.

Siç do ta vini re, juve si trainues ju ofrohen udhëzime dhe mbështetje përgjatë trajtimit të këtyre ushtrimeve të rastit. Megjithatë, ju këshilloheni fort që të përdorni përvojën dhe njohuritë tuaja dhe t'ia përshtatni kontekstit; ju, gjithashtu, inkurajoheni të përdorni përvojën e studentëve tuaj për të përmirësuar prezantimin dhe për të zgjeruar njohuritë tuaja për mësimdhënien e ardhshme.

Të gjitha ushtrimet e rastit ndjekin të njëjtën strukturë:

- Tregimin (rrëfimin e historisë së rastit)
- Çfarë treguesish kemi këtu?
- Çfarë duhet kërkuar në këtë rast?
- Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?
- Si do veproni?

1. Ushtrimi i Rastit 1 – Personi i zhdukur

1.1 Tregimi

Policia merr një telefonatë që njofton se është zhdukur një vajzë 17 vjeç. Ata shkojnë te shtëpia e kësaj vajze dhe flasin me nënën e saj.

Nëna u thotë oficerëve se e bija ka ikur rreth gjashtë javë më parë. Ajo nuk kishte mundur të gjente punë diku afër shtëpisë pasi kishte lënë shkollën 18 muaj më parë. Ajo kishte filluar t'i pyeste të njohurit e saj dhe fqinjët nëse njihnin ndokënd që mund t'i gjente punë në kryeqytet.

Një nga miqtë e t'ëmës tha se ajo njihte dikë që mund të ndihmonte.

Dikur, një grua e mori vajzën në telefon. Nëna nuk foli me atë grua, por e bija dukej shumë e shqetësuar dhe i tregoi se gruaja i kishte thënë që i kish gjetur një punë të mirë në një bar. Asaj do t'i sigurohej strehimi, do t'i jepej një rrogë e arsyeshme dhe do të kishte një ditë në javë pushim.

Pak ditë më vonë, e bija iku. Ajo i premtoi nënës se do ta merrte rregullisht në telefon dhe do t'i dërgonte para sapo të mundte.

Nëna mori dy telefonata nga e bija gjatë dy ditëve të para. Ajo dukej mjaft e kënaqur dhe i tha se ishte në makinë me 'Katrinen'; gruan që i kishte ofruar punë, dhe me dy gra të tjera.

Nëna nuk mori më asnjë telefonatë për katër javë rresht dhe u përpoq t'i telefononte të bijës. Pavarësisht që linte mesazhe me zë dhe me tekst, nuk mori asnjë përgjigje nga e bija.

Kur më në fund mori e bija, nuk e mori nga celulari i saj. Ishte e shqetësuar, por nuk i tha çfarë i kishte ngjarë. Ajo i tha t'ëmës që për ca kohë të mos priste para nga ajo.

1.2 Çfarë treguesish kemi këtu?

- Rekrutimin 'e parregullt'.
- 'Legjendën' që tregon rekrutuesja (një histori shumë e ngjashme me rastet në botë).
- Shenjat e frikës ose të shqetësimit.
- Kontrollin e mundshëm mbi mjetet e komunikimit.
- Nuk dërgohen para në shtëpi.
- Profilin e së bijës – e re, femër, e brishtë për shkak të mungesës së mundësive për punë, dhe varfërisë.

1.3 Çfarë duhet kërkuar në këtë rast?

(Lutemi, vini re se lista në vijim nuk është shtruese)

- Kush është shoqja e nënës që bëri prezantimin me rekrutuesen?
- Të gjindet nëpërmjet shoqes së nënës se kush është rekrutuesja?
- Cili është numri i celularit të së bijës?
- Me ç'numër celulari mori e bija në telefon herën e fundit?

1.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?

Ky lloj rasti është i vështirë për t'u gjykuar sepse ka shumë pak informacion në të, dhe ai që është, është i mjegullt. Megjithatë, kombinimi i profilit të vajzës, i 'legjendës' që tregon rekrutuesja dhe i mungesës së komunikimit, etj., të gjithë këto janë tregues 'klasikë' të TQNj, dhe në rastin tonë, të shfrytëzimit seksual.

Marrja e një vendimi përfundimtar ndërlikohet, gjithashtu, nga fakti që nuk kemi qasje tek viktima e mundshme, duke penguar sigurisht, në këtë mënyrë, intervistimin e saj dhe kontrollin e kushteve ku jeton.

Po ta marrim në tërësi, ky është një rast që duhet të hetohet më tej. Megjithatë, duhet pranuar që mund të mos jetë e lehtë.

1.5 Si do të veproni?

Nëna duhet të intervistohet me kujdes për të marrë sa më shumë informacion që të jetë e mundur. Duhet siguruar foto të së bijës, dhe përcaktohet identiteti i shoqes që rekomandoi 'rekrutuesen'. Gjithashtu, mund të sigurohen prova për një analizë të ardhshme të ADN-së, si flokë nga furça e flokëve e përdorur nga e bija. Po ashtu, mund të merren shenjat e gishtave nga artikujt që ka përdorur vajza në shtëpi. Në disa vende të botës, ndiqet praktika e marrjes së shenjave të gishtave për dokumentet e identitetit.

Regjistrimet telefonike janë thelbësore. Ne kemi nevojë të gjejmë numrin që përdori vajza, ose telefonin e saj, etj. Në disa rrethana, mund të na duhet të marrim telefonin e mamasë për të gjetur informacionet që kërkohen. Në rrethana të tjera, mund të jetë i mjaftueshëm thjesht numri i telefonit të nënës dhe të dhënat e ofruesit të shërbimit telefonik. Ju mund të vendosni, gjithashtu, që t'ia leni më mirë telefonin nënës, pasi mund të ndodhë që vajza të telefonojë përsëri. Nëna duhet të këshillohet që të kontaktojë policinë nëse e merr në telefon e bija.

Biseda me shoqen që prezantoi rekrutuesen është me shumë rëndësi. Gjithsesi, duhet vepruar me shumë kujdes. Ka shumë mundësi që shoqja të punojë ende me dhe për rekrutuesen, pra, para se të bëhet intervistimi i saj, duhet të këshilloheni me hetuesit ose

specialistët e trafikimit njerëzor. Këta mund të jenë në gjendje të bëjnë kontrollet e situatës ose të sugjerojnë mënyrat se si duhet të realizohen intervistat.

Vitet e fundit, trafikantët po përdorin gjërësisht internetin dhe mediat sociale për të rekrutuar viktimat. Madje edhe në zonat e largëta dhe të varfëra njerëzit kanë qasje në internet, qoftë nëpërmjet mjeteve që zotërojnë, nëpërmjet internet-kafesë, apo lokaleve të tjera të ngjashme. Kjo ofron mundësinë e hetimit, por mund të jetë jashtëzakonisht e ndërlikuar për shkak të kodifikimit, fshirjes së regjistrimeve/të dhënave dhe të shërbimeve të internetit që 'mbulohen' nga jurisdiksonet e tjera.

Kjo fushë është vazhdimisht në ndryshim, por rekomandohet që në një rast si ky, të pyesni se çfarë mjetesh përdor personi apo cilat janë vendet me internet që mund të frekuentojë dhe cilat janë adresat e tij të e-mailit apo të mediave të tjera sociale që mund të ketë përdorur. Atje ku ka mundësi, duhet të flisni me ekspertët e zbatimit të ligjit dhe të ndiqni këshillën e tyre për veprimet që mund të ndërmerren.

2. Ushtrimi i rastit 2 – Në rrugë

2.1 Tregimi

Jeni oficer policie dhe keni dalë në një patrullim me makinë me një koleg tuajin. Ju kanë udhëzuar që të kontrolloni grupe njerëzish që udhëtojnë bashkë, sepse ky mund të jetë një tregues i TQNj. Ora është 3 e mëngjesit.

Shikoni një mjet me 5 persona brenda. I thoni shoferit të ndalojë në anë të rrugës.

Një burrë i jep makinës dhe një grua rri në sediljen e parë të pasagjerit. Prapa ndodhen tre vetë, dy gra dhe një burrë.

Sapo i afroheni makinës, gruaja e sediljes së pasagjerit ju del përballë dhe fillon të flasë. Ajo e flet rrjedhshëm gjuhën e vendit dhe pa ndonjë theks të huaj. Ajo tregohet miqësore dhe e hapur me ju. Ju e pyesni se kush janë dhe ku po shkojnë. Ajo përgjigjet që ajo dhe miqtë e saj po shkojnë në kryeqytet, ku sapo kanë gjetur nga një punë në fabrikë. Ju i kërkonit dokumentet e identitetit.

Ajo ju paraqet kartën kombëtare të identitetit.

Ju u kërkonit të gjithë të tjerëve të dalin nga makina. Në fillim flisni me shoferin. Edhe ai e flet gjuhën e vendit; por nuk duket shumë i qetë kur flet me ju. I kërkonit atij të identifikohet dhe ai paraqet një kartë kombëtare të identitetit.

Ju u drejtoheni burrit dhe dy grave që ishin në sediljet e prapme të makinës. Sapo përpiqeni të flisni me ta, gruaja e sediljes së parë fillon të flasë në gjuhë të huaj. Ju mendoni se është gjuha e një vendi për të cilin ju kanë udhëzuar se është vend origjine viktimash të TQNj. Ju i drejtoheni asaj dhe e pyesni se çfarë kërkon të bëjë. Ajo thotë se po përkthen për ju. Ju përsëri përpiqeni që të flisni vetë me ata, ajo përsëri ndërhyr duke përdorur një gjuhë që duket një tjetër gjuhë e huaj. Ju u kërkonit atyre që të zbrasin xhepat. Xhepat janë bosh. U tregoni një kartë identiteti duke u shpjeguar se kërkonit dokumentet e tyre. Ata nuk kuptojnë.

2.2 Çfarë treguesish kemi këtu?

(Lutemi vini re se lista në vijim nuk është shterruese)

- Një person që flet në emër të të tjerëve.
- Gjuha është e një vendi që njihet se është origjinë e viktimave të TQNj.
- Duket se kemi të bëjmë me një grup me nacionalitete të ndryshme.
- Disa persona nuk kanë të holla.
- Ata, mesa duket, nuk kanë dokumente identiteti.

2.3 Çfarë duhet të kërkojmë?

(Lutemi vini re që kjo listë nuk është shtruese)

- Ku janë dokumentet e tyre të identitetit?
- Cila është marrëdhënia midis anëtarëve të grupit?
- A e njohin njëri-tjetrin? Nëse po, në ç'mënyrë?
- Në rast se ato thonë që e njohin njëri-tjetrin, si i kanë emrat?
- Nga janë?
- Çfarë gjuhe fllasin?
- Cili nga ata, nëse është dikush, ka para?
- Çfarë ka tjetër në makinë? Për shembull, çfarë bagazhesh kanë dhe çfarë ka brenda tyre?
- A ka celularë apo artikuj të tjerë me interes të mundshëm në makinë?
- Përse dhe për ku po udhëtojnë?

2.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?

Kjo lloj situatë ndeshet shpesh nga oficerët e zbatimit të ligjit në të gjithë botën – këto situata nuk janë të gjitha identike, por ekzistojnë faktorë të përbashkët.

Këtu ka disa tregues të trafikimit – por mund të jetë edhe diçka tjetër. Mund të kemi të bëjmë me kontrabandim njerëzish. Është po ashtu e mundshme që të jetë e vërtetë ajo çfarë thotë gruaja që flet në emër të grupit – një grup miqsh që udhëtojnë bashkë për qëllime punësimi.

Është disi e ndërlikuar (siç janë më të shumtët e rasteve) edhe nga fakti se ju nuk e njihni gjuhën që përdorin ata. Ju mund të keni burime të kufizuara në atë moment – pasi jeni vetëm me një koleg tuajin.

Situata është sfiduese. Megjithatë, ekzistojnë tregues të mjaftueshëm që ju ftojnë të bëni kërkime të mëtejshme.

2.5 Si do të veproni?

Mënyra kryesore për të gjetur më shumë, të paktën në fazat fillestare, është intervistimi i kujdesshëm i të gjithë personave të pranishëm. Kjo duhet të bëhet në përputhje me udhëzimin në Planin mësimor 2, 'Treguesit e Trafikimit të Qenieve Njerëzore'. Në përmbledhje, ka rëndësi që grupi të ndahet, në mënyrë që ata të mos i frikësohen tjetrit, dhe (nëse është e mundur) mos përdorni personat e grupit ose ndonjë 'vullnetar' të panjohur, si përkthyes. Nëse do t'ju duhet t'i përdorni, bëni sa më pak pyetje dhe gjithmonë kontrolloni përgjigjet më vonë, kur të jeni me një përkthyes që e njihni dhe e besoni.

Artikujt e tjerë të gjetur në makinë janë, po ashtu, me interes. Për shembull, zotërimi i të gjitha dokumenteve të grupit vetëm nga një person do të sugjeronte se kemi të bëjmë me një person që i mban të tjerët nën kontroll, në një farë mënyre; po i njëjti argumentim qendron

edhe për zotërimin e të hollave. Nëse gjinden celularë, duhet të shihet mundësia që të analizohen regjistrimet e të dhënave, të cilat do të mund të mbështetnin ose hidhnin poshtë rrëfimet e personave. Sendet e thjeshta, si faturat, gazetatat, biletat e pagesës së taksës së rrugës, shënimet me dorë, etj., mund të jenë të dobishme për të ndërtuar një ide nëse është ose jo TQNj.

Disa nga këto hetime mund të sjellin rezultate të shpejta; të tjerat mund të kërkojnë më shumë kohë. Ka shumë mundësi që e vërteta e plotë mbi rastin, të kërkojë pak kohë sa të dalë në dritë.

3. Ushtrimi i rastit 3 – Shërbimi në familje

3.1 Tregimi

Policia viziton një shtëpi për të bërë hetime rreth një automjeti të vjedhur jashtë, në rrugë. Derën e hap një vajzë e re. Ajo duket shumë e frikësuar. Është e dobët, dhe rrobat duken të pista. Oficerët e pyesin vajzën nëse e ëma ndodhet në shtëpi. Ajo përgjigjet që kjo nuk është shtëpia e nënës së saj dhe se nuk ka njeri në shtëpi. Oficerët e pyesin se e kujt është shtëpia dhe ajo thotë e znj. A, e zonjës që e ka marrë në punë.

Oficerët e pyesin nëse mund të hyjnë brenda. Vajza u thotë po dhe i shoqëron në kuzhinë. Në qoshe të dhomës, varen perdet gjysmë të mbyllura. Pas atyre, oficerët vejnë re një dyshek, ca batanije të vjetra dhe pak artikuj veshjesh. Mbi tavolinë është një pjatë me ca mbeturina ushqimesh, të shtruara për t'u ngrënë. Ata vejnë re disa njolla të kuqe në krahët e vajzës.

3.2 Çfarë treguesish kemi këtu?

(Lutemi, vini re se kjo listë nuk është shtruese)

- Vajza fle aty ku punon (ushqimi, kuzhina, valixhet me rrobat, disa artikuj te tjerë, etj.).
- Ajo fle në një vend fare të papërshtatshëm.
- Vajza ka shumë pak roba.
- Asaj i kërkohet bindje nëpërmjet dhunës (shenja në krahë).
- Ka mundësi që të ushqehet vetëm me mbeturinat e ushqimeve të tjerëve.

3.3 Çfarë duhet të kërkohet?

(Lutemi, vini re se kjo listë nuk është shtruese)

- A banon vajza në atë shtëpi?
- A fle vajza mbi atë dyshek?
- A ka kjo vajzë ndonjë vend të saj, privat, si p.sh. një dhomë më vete?
- Ato mbeturina ushqimesh janë për të, apo përdoren për ndonjë qëllim tjetër?
- A largohet ajo ndonjëherë nga shtëpia?
- Cilat janë marrëdhëniet e saj me të zotët e shtëpisë?
- Çfarë pune bën?
- Sa orë punon në ditë?
- A paguhet për punën që bën? Nëse po, sa merr?
- A flet me familjen, miqtë e saj, etj.? Nëse jo, përse?

- Çfarë bën në kohën e lirë?
- Sa vjeç është? (pasi mund të jetë shumë e vogël për t'u futur në punë).

3.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?

Megjithëse nuk mund të thuhet me siguri, gjithsesi ka tregues të fortë që këtu kemi të bëjmë me trafikim dhe që ia vlen që të bëhen kërkime të mëtejshme.

3.5 Si do të veproni?

Ju keni shumë të dhëna në dorë nga vëzhgimet që keni bërë deri tani – shtrati në kuzhinë, mbeturinat e ushqimit, sjellja e frikësuar e vajzës, shenjat në krahë, etj. Është e qartë që vajza duhet intervistuar.

Intervista shpesh shihet si një proces shumë formal, veçanërisht kur realizohet nga oficerët e zbatimit të ligjit. Në këtë rast, do të ishte më mirë që ju të mbani një qendrim aspak formal dhe intervistën ta shndërroni në një bisedë të qetë e me karakter të përgjithshëm e mepyetje të hapura. Në rastin në fjalë ka shumë mundësi që intervista të marrë karakter bisede.

Për shembull, mund ta pyesni se çfarë lloj ushqimi i pëlqen më shumë. Kjo do të çojë në një pyetje tjetër, se sa shpesh i bie që ta konsumojë atë, dhe më pas, sa herë ha në ditë, ku ha, e kështu me radhë. Mund ta pyesni se çfarë ka më shumë dëshirë të bëjë gjatë ditës së pushimit; dhe kjo mund të sqarojë nëse i lejohet ndonjë ditë pushim, apo asnjë. Ka shumë gjëra të tjera për të cilat mund të tregoni interes dhe që mund të trajtohen në formë jo zyrtare.

Kini parasysh, kjo intervistë është vetëm një intervistë përzgjedhëse që ju ndihmon të vendosni, nëse kërkohet, një hetim i mëtejshëm, më i hollësishëm, ose jo. Nuk është e këshillueshme të përpiqeni që me intervistimin e parë të siguronit një përshkrim shumë të detajuar se përse janë ato njolla në krahët e saj, kush ia ka shkaktuar, etj. Të gjitha këto pyetje kanë nevojë për përgjigje, por kjo do të ndodhë kur të fillojë hetimi formal.

Aty mund të kete edhe skena krimi për hetim. Kur të flisni me hetuesit, sigurohuni që të përmendni elementet që keni vënë re, si për shembull vendi i fjetjes, etj., në mënyrë që ata të dijnë ku të drejtohen e të fillojnë të kontrollojnë.

4. Ushtrimi i rastit 4 – Shtëpia publike

4.1 Tregimi

Në polici mbërrinë ankesa për një ndërtesë që përdoret si shtëpi publike. Policia ‘bastis’ ndërtesën.

Në atë mjedis gjejnë dhjetë gra.

Një nga ato duket se është e zonës; qendronte te sporteli ballor kur hyri policia. Nëntë të tjerat janë me kombësi të huaj. Asnjëra nuk flet gjuhën e vendit, përveç rastit kur një polic kërkoi të flasë me një nga gratë, ajo iu përgjigj me një numër fjalësh në gjuhën e vendit, por që lidhen me seksin. Oficerët dallojnë njëren nga gjuhët që përdorin gratë, por përveç tyre përdoren të paktën edhe dy gjuhë të tjera.

Aty është një kuzhinë, ka pjata me makarona të gatuar, domate konservash dhe ca ushqime të lira. Kuzhina është e papastër. Në një litar të fiksuar në tavan varen rroba.

Shtëpia publike është e ndarë në një numër kabinash të vogla. Nëpër kabina, nën secilin shtrat ndodhen ca valixhe. Oficerët i kontrollojnë dhe gjejnë se ato përmbajnë pak rroba secila. Pjesa më e madhe e këtyre veshjeve janë artikuj ‘seksi’. Në disa nga këto kabina gratë kanë fshehur fotografi të fëmijëve të tyre, artikuj të vegjël zbukurues dhe letra në gjuhën e tyre amtare.

Në dy nga kabinat, ka ca gjurmë të vjetra gjaku nëpër mure. Në dy kabina të tjera, u gjetën njolla të tjera gjaku nëpër shtrojet e shtretërve.

Në muret e kabinave ka shenja në gjuhën e vendit, të cilat duken se kanë të bëjnë me një ‘meny’ shërbimesh që ofrohen. Disa janë me kod dhe duket se i referohen praktikave seksuale, si seks anal dhe dy çmime të ndryshme për secilin akt seksual, çmimi i dytë është dy herë më i lartë se i pari.

Asnjëra nga gratë nuk ka dokumente identifikimi. Në fillim, ato nuk kuptojnë se u kërkohet që të paraqesin dokumentet e tyre për t’i parë, por njëra thërret papritur “bosi, bos!” në gjuhën e vendit dhe tregon me gisht gruan në sportel. Policët flasin me të, por ajo thotë se nuk di asgjë për dokumentet.

Asnjëra nga gratë nuk kishte me vete para dhe as nëpër kabina nuk u gjend ndonjë. Një shumë e madhe parash u gjet në një sirtar në një zyrë të vogël.

4.2 Çfarë treguesish kemi në këtë rast?

(Lutemi, vini re se kjo listë nuk është shtruese)

- Njerëzit flejnë atje ku punojnë (ushqimi, kuzhina, valixhet me rroba, artikujt e zbukurimit, etj.)
- Veshje të pakta.
- Përdorimi i shumë gjuhëve në mes të stafit.
- Veshja që lidhet me shërbimet seksuale.
- Njohin fjalë që lidhen vetëm me seksin.
- Janë pa dokumente.
- Janë pa para.
- Prova të mundshme të dhunës së ushtruar (gjurmët e gjakut në kabina, etj.)
- Ofrimi i akteve 'ekstreme' seksuale.
- Mundësia e ofrimit të seksit të pambrojtur (dy çmime të ndryshme).

4.3 Çfarë duhet të kërkojmë?

(Lutemi, vini re se kjo listë nuk është shtruese)

- Konfirmoni nëse gratë banojnë në atë mjedis.
- A i zhvendosin ato nga një vend në një tjetër?
- A shoqërohen ato kur zhvendosen?
- Cilat janë orët e punës së tyre?
- Çfarë ndodh me paratë që fitojnë?
- A mund të refuzojnë ndonjë klient/lloj shërbimesh seksuale/seks të pambrojtur?
- Cilat janë dokumentet e tyre të identitetit?

4.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?

Kemi një sërë treguesish të rëndësishëm që bëhet fjalë për trafikim, por situata është e ndërlikuar.

Dallimi midis pranimit për t'u bërë një punëtorë seksi dhe të qenit e/i detyruar me dhunë që të bëhesh e/i tillë, shpesh është i paqartë. Ata që e ndërlikojnë këtë janë personat që kanë qenë punëtorë seksi në të kaluarën, ata që kanë pranuar se janë punëtorë seksi, por pa përcaktuar se sa shumë kanë punuar si të tillë dhe as llojin e shërbimeve që detyrohen të ofrojnë me dhunë, si dhe të trafikuarit e mëparshëm, por që tani mbajnë pozicione 'menaxheriale'.

Tani për tani nuk ka prova të drejtpërdrejta që ky është një rast trafikimi, por ka shumë vend për dyshimet tona.

4.5 Si do të veproni?

Ekziston mundësia e marrjes së informacionit të nevojshëm gjatë intervistave 'përzgjedhëse' fillestare në vendin e ngjarjes, në rast se kemi të siguar shërbimin e përkthimit. Një nga gratë mund të japë informacion të drejtpërdrejtë që sugjeron se ajo ndodhet në atë mjedis kundër dëshirës së saj. Megjithatë, këto intervista duhet të kryhen në një mënyrë të kujdesshme dhe të sigurojnë vetëm informacionin bazë, apo atë që kërkohet menjëherë për të parandaluar dëmtime të tjera serioze, apo mbrojtur e jetës së tyre. Gjatë një interviste përzgjedhëse, nuk është e përshtatshme të kërkosh informacion rreth çështjeve të ndjeshme, si lloji i akteve seksuale që gratë detyrohen të ofrojnë, etj.

Intervistat e mëtejshme do të duhet të kryhen duke përdorur teknikat e dëshmitarit të cënueshëm. Por këtu mund të përballeni me sfidën që njerëzit të refuzojnë të vijnë e të japin intervistë.

Ka shumë të ngjarë që në mjedisin në fjalë të ketë burime të tjera informacioni të dobishëm për hetimet e mëtejshme, për shembull, telefonat celularë apo fiks, të dhëna mbi numra të tjerë celularësh, të holla, prova nga gjurma gishtërinjsh të personave që mund të kenë vënë postera si reklamë, etj.

Megjithatë, mund të mos sigurohet informacion sipas të cilit të konfirmohet menjëherë nëse ka ndodhur TQNj, apo jo. Në përgjithësi, detyra më kryesore e kontaktuesit të parë është që të ruajë materialet që mund të shërbejnë si prova të mundshme për hetimet e ardhshme. Detyra e dytë është që të informojë hetuesit mbi të gjitha provat që mund të ketë në atë mjedis. Në disa situata (lokalitete shumë të largëta, me mungesë burimesh, etj.) kontaktuesve të parë mund t'u kërkohet që të rekuperojnë ata vetë provat, si material për hetim të mëtejshëm.

Edhe kur përzgjedhja e parë nuk është përfundimtare, informacioni i siguar duhet t'i mundësojë hetuesit që të monitorojnë dhe hetojnë në mënyrë proaktive njerëzit e përfshirë. Kjo do të japë informacionin bazë e të mëtejshëm për të vendosur nëse ka ndodhur ose jo trafikimi njerëzor.

5. Ushtrimi i rastit 5 - Ferma

5.1 Tregimi

Oficerët e policisë janë thirrur në një fermë, në vijim të një raportimi se ishin vjedhur disa makineri bujqësore. Ata vendosin të bëjnë disa kontrole në fermat fqinje.

Ata mbërrijnë në një nga këto ferma. Aty ndodhet një shtëpi fermeri dhe ndërtime të tjera përreth. Nuk duket asnjë person në ato rrethina. Dëgjojnë zhurmë që vjen nga një strehëzë e gjërë.

Shkojnë tek ajo strehëza dhe provojnë të hapin derën, që është e mbyllur. Ata dëgjojnë zëra njerëzish që punojnë në brendësi të strehëzës. I bien derës, por nuk vjen njeri ta hapë.

Një polic i afrohet dritares në anë të godinës dhe duke u ngjitur pak, vështron brenda. Sheh një grup burrash dhe grash që punojnë brenda. Duket sikur po ambalazhojnë patate. Njëri nga punëtorët e ve re policin. Atëherë, të gjithë punëtorët ndalojnë menjëherë punën dhe duken të frikësuar. Dera e ndërtesës hapet dhe oficerët hyjnë në ndërtesë.

Brenda ata gjejnë dymbëdhjetë vetë. Një person duket se flet gjuhën e vendit, por me një theks të fortë të huaj. Asnjë tjetër nuk e flet gjuhën e vendit. Të gjithë personat janë veshur me rroba të lehta, të përditshme.

Oficerët venë re që aty pranë duken ca si shtretër, disa pranë makinerive, dhe disa të tjerë ku depozitohen patatet dhe thasët.

Nuk duket të ketë ndonjë vend tualeti në atë ndërtesë.

Diku, në një vend të vogël janë të vendosur ca ushqime të konservuara, nja dy enë dhe një furnellë e vogël gatimi.

Nëpër ndërtesë ka disa shenja të varura e të shkruara në gjuhë të huaj.

Asnjë nga personat nuk ka dokument identiteti.

5.2 Çfarë treguesish kemi në këtë rast?

(Lutemi, vini re se kjo listë nuk është shtruese)

- Njerëzit flejnë aty ku punojnë ('shtretërit' në mes të pajisjeve, etj.)
- Ata banojnë në kushte të rrënuara dhe të papërshtatshme.

- Duket që ata varen nga punëmarrësi për shërbime jetësore (akomodimi, tualeti, mjetet për gatimin e ushqimit, etj.).
- Veshje të papërshtatshme.
- Kontrolli (i mundshëm) mbi lëvizjet e tyre.

5.3 Çfarë duhet të kërkojmë?

(Lutemi, vini re se kjo listë nuk është shtruese)

- A jetojnë ata në këtë mjedis?
- Ku flejnë?
- Çfarë ushqimi u japin për të ngrënë?
- Ku shkojnë për nevojat e tyre personale?
- Me çfarë lloj pajisjeje janë duke punuar?
- A janë treinuar për të kryer këtë punë me atë pajisje?
- A kanë një kontratë pune? Nëse po, ku është dhe a e dijnë së çfarë parashikon?
- A i lejojnë që të largohen?
- Çfarë lexohet në shenjat e varura nëpër mure?
- Sa orë në ditë punojnë?
- A marrin para për punën e tyre?
- Cilat janë dokumentet e tyre të identifikimit?
- Kush është përgjegjës?

5.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?

Siç ndodh edhe me rastet e tjera, duke mos qenë shterrues, ekzistojnë tregues të fortë që kemi të bëjmë me të vërtetë me trafikim, shfrytëzim të punës, dhe kërkohet një hetim i mëtejshëm.

5.5 Si do të veproni?

Ka shumë mundësi që të merren informacione që me intervistat fillestare ‘përzgjedhëse’ në vendin e konstatimit, në rast se gjindet mundësia e përdorimit të një përkthyesi (kur nuk njihet gjuha e të intervistuarve). Këto intervista, gjithsesi, duhet të kryhen në një mënyrë të ndjeshme e të kujdesshme dhe të merret vetëm informacioni bazë, ose informacioni që nevojitet për të parandaluar dëmtime serioze apo mbrojtur jetën e tyre. Intervistat përzgjedhëse në rastet e shfrytëzimit të punës mund të mos kenë të bëjnë me çështje aq delikate sa ato që ndeshen në rastet e shfrytëzimit seksual, por edhe këtu duhet bërë kujdes. Gjatë hetimeve të mëtejshme, personave do t’u kërkohet informacion mbi si u rekrutuan, etj.,

që të punojnë në fermë, por edhe kjo lloj pyetjeje, ndoshta, nuk është e përshtatshme gjatë fazave fillestare.

Ka shumë mundësi që në mjediset e fermës të gjindet sasi e konsiderueshme informacioni, i cili do të ndihmojë hetimin e mëtejshëm, përfshirë, të dhënat mbi telefonat celularë apo fiks, regjistrime të numrave të telefonit, para, prova gjurmash të atyre që kanë varur posterat dhe shënimet rreth e qark ndërtesës, etj.

Në rastet e shfrytëzimit për punë të detyrueshme, do të jetë me vlerë që të dihet se në cilën makineri apo me cilën pajisje ka punuar secila viktimë. Kjo mund të ndihmojë që të tregojë shfrytëzimin, përdorimin e pajisjeve të papërshtatshme, etj. Sasia e shenjave të gishtave të gjetura mbi makinerinë/pajisjen mund të ndihmojnë të tregojnë se përsa kohë ka punuar aty personi. I njëjti argumentim shërben edhe për vendet e fjetjes – prania e një numri të madh shenjash gishtash në ato vende flet për kohën e gjatë që ai person ka fjetur aty.

Është e vështirë të thuash që ky lloj materiali të mund të konfirmojë menjëherë se në këtë rast kemi të bëjmë me TQNj. Në përgjithësi, detyra kryesore e kontaktuesit të parë është që të ruajë materialin si një provë të mundshme. Detyra e dytë do të jetë të informojë hetuesit mbi provat e mundshme ekzistuese. Në disa situata (vende shumë të largëta, me mungesë burimesh, etj.) kontaktuesve të parë mund t'u kërkohej të rekuerojnë materialet që mund të shërbejnë si prova.

6.Ushtrimi i Rastit 6–Veprimtaria e paligjshme–Lypja

6.1 Tregimi

Një person ka si pronë një kiosk të vogël pranë një kryqëzimi mjaft të rrahur nga trafiku, në një qytet të madh. Ai ve re tre katër fëmijë të moshës midis 12 dhe 14 vjeç që lypin nga shoferët dhe pasagjerët e automjeteve që ndalojnë pranë semaforëve.

Ai vazhdon të vëzhgojë dhe ve re që fëmijët zbresin aty nga një makinë e vjetër. Shoferi i asaj makine është një burrë rreth të tridhjetave. Rreth orës 12 të pasdites, burri kthehet dhe duket sikur merr paratë e mbledhura nga fëmijët dhe u jep atyre diçka për të ngrënë. Largohet, por kthehet përsëri rreth orës 4 të pasdites, merr paratë dhe u jep fëmijëve pak ujë. Rreth orës 8 të mbrëmjes, ai kthehet përsëri dhe largohet me fëmijët në makinë.

Pronari i kioskës merr në telefon policinë, dhe ju jeni polici që shkoni në vend për verifikim. Ju vini re se situata është ashtu siç ishte përshkruar – janë katër fëmijë, dy djem dhe dy vajza, që u afrohen makinave që qendrojnë në semafor, dhe lypin para. Fëmijët janë të dobët, por nuk duken se vuajnë për bukë. Veshjet janë relativisht të mira. Është një ditë jave, pra ditë shkolle dhe fëmijët janë në moshën shkollore.

6.2 Çfarë treguesish kemi në këtë rast?

Kjo nuk është listë shterruese

- Ata sillen sikur kontrollohen nga dikush (sillen me makinë, ua marrin paratë, etj.)
- Fëmijë pa qasje në shkollë (lypin në rrugë, kur duhet të ishin në shkollë).
- Janë të përfshirë në një punë të papërshtatshme për fëmijë.
- Ndodhen në një situatë varësie.

6.3 Çfarë duhet të kërkojmë?

Kjo nuk është listë shterruese

- Kush janë këta fëmijë?
- Sa vjeç janë?
- Kush është burri?
- Cila është marrëdhënia e tyre me burrin?
- Çfarë udhëzimesh u jepen fëmijëve?
- Nga kush? Nga burri, apo ndonjë tjetër?
- Si kontrollohen ata? Kërcënohen, abuzohen, mashtrohen, detyrohen me forcë, etj.?
- Si është gjendja e tyre e përgjithshme shëndetësore?
- A dhunohen ata fizikisht?

- A dhunohen psikologjikisht?
- Çfarë ndodh me paratë që ata fitojnë?

6.4 Pra, a kemi të bëjmë me trafikim?

Në pamje të parë, këtu ka tregues të fortë që ky është një rast TQNj. Burri operon/sillet si të jetë në një rol kontrollues dhe i shfrytëzon fëmijët duke ua marrë paratë që ata marrin nëpërmjet lypjes. Mbani parasysh, se sipas së drejtës ndërkombëtare, ashtu edhe sipas rasteve më të shumta të legjislacioneve kombëtare, fëmijët nuk mund t'i nënshtrohen shfrytëzimit. E drejta ndërkombëtare e përcakton fëmijën si një person nën moshën 18 vjeç (mosha e saktë mund të ndryshojë sipas ligjit kombëtar të vendeve të ndryshme, por ka shumë mundësi që në rastin në fjalë, ata janë fëmijë edhe sipas ligjit të vendit).

6.5 Si do të veproni?

Është e qartë që ju duhet t'u afroheni fëmijëve, të flisni me ta dhe të kontrolloni për ndonjë dëmtim në trup, etj. Ky rast paraqet një mëdyshje, e cila nuk është e lehtë të zgjidhet. Domethënë, nëse do t'i lini fëmijët të vazhdojnë derisa të kthehet burri, dhe kështu do të ndaloni trafikantin, apo të ndërhyni, duke i çuar kështu një sinjal trafikuesit dhe duke e ndërlikuar më shumë hetimin?

Në këtë rast, ju duhet të zbatoni teknikat e Vlerësimit të Rrezikut. Vendimi që do të merrni do të bazohet mbi një sërë faktorësh. Mënyra se si lypin fëmijët mund t'ua rrezikojë jetën, qendrojnë në mes makinash, që do të nënkuptojë se duhet të ndërhyni për t'i mbrojtuar ata. Një tjetër faktor këtu është dhe mosha e fëmijëve; një fëmijë shumë i vogël mund të jetë më i zbuluar ndaj rrezikut sepse nuk janë të vetëdijshëm për rrezikun e trafikut, ose, thjesht, janë shumë të vegjël për t'u vënë re nga shoferët. Ju mund të merrni numrin e targës së makinës së burrit nëpërmjet pronarit të kioskës, në të cilin rast mund të jeni të sigurt që do të arrini ta gjurmoni burrin, pavarësisht nëse kthehet ose jo tek fëmijët. Nga ana tjetër, ju mund të vendosni se keni një përshkrim të mjaftueshëm të burrit dhe makinës së tij, kështu që mund t'i merrni fëmijët e t'i largoni nga ai vend, dhe pastaj të prisni kur të vijë burri për t'i marrë fëmijët.

Intervistimi i fëmijëve është gjithmonë sfidues dhe legjislacioni juaj mund të ketë kërkesa specifike mbi si duhet të kryhet ai. Si një udhëzim i përgjithshëm, gjatë fazës së intervistimit përzgjedhës, ju mund t'u bëni fëmijëve një minimum pyetjesh. Në një moment tjetër, mund të bëhen intervistat e mëtejshme, idealisht nga intervistues, specialistë të treinuar.

Gjithashtu, ju duhet të jeni të vetëdijshëm se ka mundësi që një ose më shumë nga fëmijët të kenë telefona celularë dhe mund të jenë udhëzuar që të njoftojnë burrin, nëse ndeshen me një problem, si për shembull, me ardhjen e policisë.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	6
1.1	Audienca e synuar	6
1.2	Objektivat mësimore	6
1.3	Njohuritë e mëparshme.....	6
2.	Skenari.....	7
3.	Metoda e mësimdhënies	8
3.1	Përgatitja për lojën me rolet.....	8
3.2	Udhëzimet për ata që do të luajnë rolet.....	9
3.3	Realizimi i lojës	10
3.4	Pyetje përgjigje për lojën e roleve.....	10

1. Hyrje

Qëllimi i këtij leksioni është që të ofrojë praktika të mira bazë për t'u përdorur në intervistat përzgjedhëse. Ky leksion nuk përdoret për t'i mësuar studentët se si të kryejnë një intervistë të plotë me viktimën/viktimën dëshmitar/të dyshuarin.

Ai bazohet tek Ushtrimi i Rastit 2 – Në rrugë.

1.1 Audiencia e synuar

Ky leksion ka për synim secilin që mund të ndeshet me Trafikimin e Qenieve Njerëzore (TQNj) gjatë kryerjes së detyrës së tij/të saj, përfshirë:

- Oficerët e policisë.
- Policët e kufirit.
- Inspektorët e punës.
- Punonjësit socialë.
- Inspektorët e shëndetësisë dhe të sigurisë.
- Punonjësit e arsimit.

Në këtë leksion ka një sërë ushtrimesh që trajtojnë një formë të veçantë të TQNj dhe kontekstet specifike që lidhen me atë formë. Këto ushtrime mund të mos kenë shumë lidhje me disa nga profesionet e listuara më lart, megjithatë programi ofron një seri të gjërë ushtrimesh mbi rastin që mund të përshtaten me kontekstin e një profesioni të veçantë, duke përdorur sfondin bazë të këtij plani mësimor.

1.2 Objektivat mësimore

Objektivi i kësaj loje me role është të ndihmojë mësimin nëpërmjet një demonstrimi praktik të rastit dhe të vlerësojë drejt situatën nëpërmjet një përjasjeje korrekte.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Mendohet që studentët të kenë përfunduar 'Mësimin 2 – Treguesit e TQNj'.

Ju, ndoshta, mund të dëshironi të trajtoni edhe 'Mësimin 3 – Intervistat përzgjedhëse në rastet e TQNj', para se të punoni me këtë lojë rolesh.

2. Skenari

Ky skenar do t'u shpërndalet atyre që do të luajnë rolet. Më poshtë, shikoni udhëzimet e mëtejshme.

Personi A (gruaja në sediljen e parë të pasagjerit) është një trafikante. Ajo është banore e vendit ku u ndalua makina (Vendi Blu). Ajo ka punuar me një agjent pune për të sjellë njerëz në Vendi Blu për të punuar në industrinë e ndërtimit.

Njoftimet për punë janë bërë nëpërmjet internetit. Njoftimet shkruajnë se puna paguhet mirë. Viktimat përgjigjen, sillen në Vendi Blu dhe pastaj detyrohen, nëpërmjet kërcënimeve, dhunës dhe detyrimit të borxhit, që të punojnë për një pagë ekstremisht të vogël. Puna e A është që të presë viktimat para kalimit të kufirit të Vendi të Kuq dhe t'i kalojë ata në mënyrë të parregullt. Makinës i jep një mik i saj, personi B. Ajo e ka bërë këtë rrugë shumë herë gjatë vitit të kaluar.

Personi B (shoferi i makinës) është, edhe ai, banor i Vendi Blu. Ai është mik me A dhe e ka rrahur këtë rrugë disa herë me të.

Personat C,D dhe E janë viktimat të TQNj. Të gjitha ata janë banorë të Vendi të Kuq. Asnjë nga ata nuk e njihnin njëri-tjetrin para se të takonin personin A.

C, D dhe E iu përgjigjen një njoftimi për punë në Vendi Blu, që qarkulloi në internet. Njoftimet flitnin për kërkesa për punëtorë ndërtimi. U zhvilluan disa korrespondenca me e-mail, dhe të gjithëve iu tha që të shkonin në një qytet të Vendi të Kuq, në kufi me Vendi Blu. Atje, në një hotel të vogël ata u takuan me A.

Personi A ua mori pasaportat dhe ju tha që do të dërgoheshin po atë natë në Vendi Blu. Ajo, gjithashtu, ua mblodhi paratë, nën justifikimin e ruajtjes më të sigurt të tyre.

Ata u nisën duke ndjekur disa rrugë dytësore, përderisa u ndaluan nga një patrullë policie rreth katër orë më vonë.

3. Metoda e mësimdhënies

3.1 Përgatitja për lojën me rolet

Studentët duhet të jenë të familjarizuar me përmbajtjen e 'Ushtimit të Rastit 2 – Në rrugë'.

Loja me role është më efektive në rast se studentët e kanë përfunduar 'Mësimin 2 – Treguesit e TQNj', si dhe detyrat shoqëruese që përfshihen në modulën e ushtrimeve të rastit.

Kërkoni pesë vullnetarë që të luajnë rolet.

Nxirrini 'aktorët' jashtë dhomës.

Ndani pjesën tjetër të klasës në grupe treshe (kjo varet dhe nga mënyra se si patrollojnë oficerët e policisë në vendin tuaj).

Shpërndani tekstin/skenarin secilit grup.

Udhëzoni ta lexojnë mirë skenarin dhe planifikojnë veprimet e tyre (si patrullues policie).

Shkoni tek 'aktorët' dhe ose ua shpërndani rolet e tyre që t'i lexojnë ato, ose i udhëzoni me gojë rreth roleve që duhet të luajnë.

Është një praktikë e mirë që t'u kërkohet 'aktorëve' që të përsërisin veprimet e tyre.

Nëse keni ndonjë makinë aty pranë, vendosini aktorët në makinë. Rekomandohet që makina të qendrojë në vend gjatë gjithë kohës. Përparësia e përdorimit të një makine është se i shton lojës elementet e realizmit; mangësitë do të jenë se do t'ju duhet që ta nxirrni gjithë klasën jashtë, të rrethuar prej zhurmës që mund të ketë jashtë, por dhe me probleme që do të jetë e vështirë për të gjithë studentët të ndjekin se çfarë ndodh në makinë (në rast se 'aktorët' do të qendrojnë brenda makinës), pa folur pastaj dhe për kohën që mund të mos jetë e mirë.

Një metodë që është provuar të jetë e dobishme, ka qenë ajo e vendosjes së një grupi karrikesh duke imituar makinën – dy karrike para dhe tre prapa. Përparësitë e kësaj metode janë: organizohet lehtë, të gjithë kanë mundësi ta ndjekin dhe kursethet kohë; mangësia mund të jetë se mund të krijojë në fillim një farë ilariteti në klasë – megjithatë, përvoja na ka treguar se kjo kalon shpejt dhe mund të shtojë nivelet e energjisë për të gjithë grupin.

3.2 Udhëzimet për ata që do të luajnë rolet

‘Aktori’ A

Ju jeni trafikant. Jeni banor i Vendit Blu. Ju punoni për një agjent pune që sjell njerëz në Vendin Blu për të punuar në industrinë e ndërtimit. Njoftimi është bërë në internet. Njoftimet shkruajnë se puna paguhet mirë. Ju e dini që njerëzit, realisht, po mashtrohen, dhe se ata do të detyrohen nëpërmjet kërcënimeve, dhunës dhe detyrimit të borxhit, që të punojnë për një pagë ekstremisht të ulët.

Detyra juaj është që t’i takoni viktimat fare pranë kufirit në Vendin e Kuq dhe t’i kaloni përtej kufirit në mënyrë ilegale duke përdorur rrugë të fshehta. Ju ua keni marrë viktimave të gjitha pasaportat dhe paratë që kishin me vete. Ju thatë se vepruat ashtu për t’i ruajtur më mirë paratë dhe dokumentet e tyre. Në fakt, kjo është mënyra se si ju dhe trafikantët e tjerë arrijnë t’i kontrollojnë duke u thënë se do t’i raportoni në polici për kalim të parregullt të kufirit të Vendit Blu dhe se do t’i mbani paratë për ‘shpenzimet’, por dhe për t’u siguruar që ata të mos kenë të holla që do t’i mundësonin të largoheshin.

B është një mik shtëpie. Ai ju ka shoqëruar disa herë në këtë rrugë. Ju e paguani mirë atë, por nuk i keni thënë asnjëherë plotësisht se çfarë ndodh në realitet.

‘Aktori’ B

Ju jeni shoferi. Jeni banor i Vendit Blu, jeni mik i A, të cilën e njihni prej shumë kohësh. Ju i shërbeni asaj dhe e bëni rregullisht këtë rrugë me të për të marrë njerëz në Vendin e Kuq dhe për t’i kaluar ata ilegalisht përtej kufirit, për te Vendi Blu. Paguheni mirë. Por, ju asnjëherë nuk keni pyetur se çfarë ndodh realisht, por besoni se ka të bëjë me kontrabandim njerëzish.

‘Aktorët’ C, D dhe E

Udhëzimet janë të njëjta për të tre aktorët. Jeni të papunë në vendin tuaj, në Vendin e Kuq.

Keni punuar më parë në disa sektorë në ndërtim. Për fat të keq, industria e ndërtimit në vendin e Kuq ka stanjacion dhe nuk ka punë.

Keni parë një njoftim në internet për punëtorë ndërtimi dhe keni dhënë përgjigje. Keni patur një intervistë me telefon dhe u pranuat.

Juve ju është thënë të shkoni te një farë hoteli në një qytet në Vendin e Kuq që është në kufi me Vendin Blu, në një datë e orë të caktuar dhe të sillni pasaportën.

Kur mbërrini atje, ju pret A. Nuk i keni njohur më parë të tjerët. Ajo ju tha të hyni në makinën që e nget shoferi B, dhe nëse e ndalojnë makinën, do të jetë ajo që do të flasë.

Keni udhëtuar me këtë makinë përmes disa rrugëve dytësore, përderisa pas rreth katër orësh ju ndalon policia.

3.3 Realizimi i lojës

Kjo lojë nuk duhet të vazhdojë më shumë se 10 minuta. Kohë kjo kur do të jenë trajtuar të gjitha pikat e mundshme të mësimi, që do të përdoren për diskutim të mëtejshëm gjatë sesionit të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Informacion për trainuesit.

Trainuesit duhet të kërkojnë përgjigje për sa vijojnë:

- A e morën policët situatën nën kontroll?
- Sidomos, a i ndan ata 'pasagjerët' e makinës nga njëri-tjetri?
- A bën ata pyetjet e duhura, për shembull:
 - Kush janë ata që udhëtojnë me ju?
 - Përse po udhëtoni?
 - Ku po udhëtoni?
 - Nga keni ardhur?
 - Kush i ka dokumentet tuaja?
 - Nëse nuk i keni dokumentet, kush jua mori?
 - Çfarë arsye të dhanë kur ta morën pasaportën?

3.4 Pyetje përgjigje për lojën e roleve

Kur mbaron loja e roleve, ju vazhdoni me sesionin pyetje përgjigje sipas këtij rendi:

- Me 'oficerët e policisë'.
- Me 'pasagjerët e makinës'.
- Me vëzhguesit.

'Oficerëve të policisë' do t'u kërkohet të përshkruajnë se cili ishte plani i tyre; të komentojnë se sa arritën ta menaxhojnë situatën, dhe të identifikojnë sfidat që ndeshën.

'Pasagjerëve' do t'u kërkohet të shpjegojnë nëse krijuan përshtypjen që 'oficerët e policisë' i trajtuan ata si duhet, d.m.th. nëse i morën nën kontroll përpjekjet e 'trafikantes' për të ndërhyrë, kur ata po përpiqeshin të flitnin me 'pasagjerët'.

Vëzhguesve duhet t'u kërkohet të komentojnë nëse plani i tyre ndryshonte në ndonjë aspekt nga ai i përshkruar nga 'oficerët e policisë', dhe nëse po, në ç'mënyrë. Atyre duhet t'u kërkohet, gjithashtu, se si mendojnë t'i kalojnë sfidat me të cilat përballet 'policia'.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat e të mësuarit	5
1.3	Njohuritë e mëparshme.....	6
2.	Loja me role në fazën ‘Përfshirja dhe shpjegimi’	7
2.1	Metoda e mësimdhënies	7
2.2	Pyetje përgjigje për ‘aktorin’ – viktimë e mundshme	7
2.3	Diskutimi i lojës me rolin	8
3.	Loja me rolin në fazën ‘Tregimi’	9
3.1	Metoda e mësimdhënies.....	9
4	Modifikimi	10
4.1	Ushtrimi i Rastit 4 – Shtëpia publike	10
4.2	Ushtrimi i Rastit 5 - Ferma	11

1. Hyrje

Qëllimi i këtij leksioni është që të ofrojë praktika të mirëbazuara për t'u përdorur në intervistat përzgjedhëse. Ky leksion nuk është për t'u përdorur për t'i mësuar studentët se si të kryejnë një intervistë të plotë të viktimës/viktimës dëshmitar/të dyshuar.

Këtu përdoret një version i përshtatur i modelit standard PEACE të intervistimit.

Loja kryesore e roleve bazohet mbi Ushtrimin e Rastit 3 – Shërbimi në familje.

Gjithashtu ofrohet një udhëzim specifik për përdorimin e Ushtrimit të Rastit 4 – Shtëpia publike, dhe e Ushtrimit të Rastit 5 – Ferma, si bazë për lojra të ngjashme me role.

1.1 Audiencia e synuar

Ky leksion ka për synim secilin që mund të ndeshet me Trafikimin e Qenieve Njerëzore (TQNj) gjatë kryerjes së detyrës së tyre, përfshirë:

- Oficerët e policisë.
- Policët e kufirit.
- Inspektorët e punës.
- Punonjësit socialë.
- Inspektorët e shëndetësisë dhe të sigurisë.
- Punonjësit e arsimit.

Në këtë leksion ka një sërë ushtrimesh që trajtojnë një formë të veçantë të TQNj dhe kontekstet specifike që lidhen me atë formë. Këto ushtrime mund të mos kenë shumë lidhje me disa nga profesionet e listuara më lart, megjithatë programi ofron një numër ushtrimesh mbi rastin, që mund të përshtaten me kontekstin e një profesioni të veçantë duke përdorur sfondin bazë të këtij plani mësimor.

1.2 Objektivat e mësimi

- Të përcaktojë sfidat që ndeshen, kur kryhen intervistat përzgjedhëse për TQNj.
- Të përcaktojë qëllimin e një interviste përzgjedhëse për rastin e TQNj.
- Të rikujtojë elementet bazë të modelit PEACE të intervistimit.
- Të përshkruajë se si mund të zbatohet modeli PEACE tek intervistat përzgjedhëse për rastin e TQNj.
- Të shpjegojë përjasjet e ndryshme që kërkohen, kur kryhen intervistat e planifikuara dhe të paplanifikuara përzgjedhëse.
- Të demonstrojë zbatimin e objektivave të mësipërme përgjatë lojës së roleve.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Mendohet që studentët të kenë përfunduar tashmë 'Leksionin 2 – Treguesit e TQNj'.

Ju mund të jepni edhe 'Leksionin 3 – Intervistat përzgjedhëse në rastet e TQNj' para përdorimit të lojës së roleve.

Kjo lojë me role bazohet mbi Ushtrimin e Rastit: 'Punëtori në familje'.

2. Loja me role në fazën ‘Përfshirja dhe shpjegimi’

2.1 Metoda e mësimdhënies

Kërkoni një vullnetar që të luajë rolin e viktimës së mundshme të TQNj për ushtrimin e rastit: ‘Punëtor në familje’.

Kërkojini këtij personi të largohet nga dhoma.

Pjesën tjetër të klasës ndajeni në çifte (ata mund të jenë ndarë tashmë, në rast se po merreni me Planin Mësimor 3: ‘Intervistat përzgjedhëse’).

U thoni studentëve që duhet të planifikojnë dhe zbatojnë metodën ‘Përfshirja dhe shpjegimi’ me personin që luan rolin te ‘Punëtori në familje’. Pas pesë minutash caktoni një çift studentësh që të zbatojnë metodën ‘Përfshirja dhe shpjegimii’ me ‘viktimën e mundshme’.

2.2 Pyetje përgjigje për ‘aktorin’ – viktimë e mundshme

Udhëzoni atë që do të luajë rolin e ‘viktimës së mundshme’, si më poshtë:

‘Jeni rekrutuar nga një agjent punësimi për të punuar si punëtor/shërbyes në familje. Ju kanë premtuar se do të paguheni 10 Euro në ditë, do të keni tri vakte ushqimi, do të keni dhomën tuaj, nuk do të punoni më shumë se 10 orë ne ditë, dhe se do të keni të paktën një ditë në javë pushim. Ju i keni pranuar këto kushte.

Ju kanë çuar te shtëpia, ku keni qendruar 3 muajt e fundit. Gjatë kësaj kohe keni fjetur në një depo të vogël, prapa kuzhinës, jeni ushqyer vetëm me mbeturinat e të tjerëve, keni punuar të paktën 12 orë në ditë, madje 16 orë. Ju besoni se jeni paguar rreth 10 Euro në javë.

Pak ditë më parë, ju iu ankuat punëdhënësit tuaj duke i kujtuar se ju kishin premtuar më shumë para. Ai/ajo u zemërua dhe filloi të bërtasë. Ai/ajo tha se po të provonit të largoheshit, ai/ajo do t’ju raportonte në polici se jeni hajdut/e. Ju i thatë se nuk jeni hajdut/e. Punëdhënësi ju kapi nga kyçet e duarve, filloi të bërtasë e t’ju shajë në fytyrë’.

Tani ju vjen polici në shtëpi dhe ju nuk po e kuptoni përse kanë trokitur në derë.

Ky ushtrim ndihmon për të kuptuar se si arrijnë intervistuesit ‘të përfshijnë dhe të shpjegojnë’. Përgjigjuni kur ata ju bëjnë pyetje të përgjithshme rreth ditës suaj. Mos u përgjigjini në rast se ju pyesin drejtpërdrejt mbi si u trafikuat, ose nëse ju bëjnë pyetje që ju venë në pozitë të vështirë (në rolin që po luani).

Rikujtojani ‘aktorit’ pikat kyçe të sesionit, ose kërkojini që të përsëritë udhëzimet.

Pyeteni 'aktorin' nëse ka ndonjë pyetje. Kthehuni te klasa.

Në shumë raste është e mundshme që të vendosni një tavolinë dhe karrike përreth dhe t'i thoni klasës të imagjinojë sikur është një mjedis i një kuzhine. Kjo mund të mos besohet lehtë nga të tjerët, por shumë ushtrime të ngjashme janë realizuar me sukses në këtë mënyrë. Madje, sapo fillon ushtrimi, të gjithë fillojnë të interesohen e të përfshihen në atë që duhet të bëjnë, ose të vëzhgojnë.

Zgjidhni çiftin që do të realizojë intervistën dhe u kërkoni që të largohen nga dhoma, por të mos komunikojnë me aktorin që do të luajë rolin e 'viktimit të mundshme'.

Përcaktoni detyrat e çifteve të mbetura, që do të bëjnë vëzhguesin, të cilat duhet të jenë në përputhje me informacionin që jepet në seksionin 'Përfshirja dhe shpjegimi' të Planit mësimor 3: 'Intervistat përzgjedhëse'.

Detyrat e vëzhguesve të intervistuesit janë:

- A dëgjuan dhe respektuan si duhet të intervistuarin/rën?
- A bën pyetje të përgjithshme në fillim të intervistës së tyre?
- A ngjau intervista e tyre fillestare me intervistën përzgjedhëse për një rast TQNj?
- A përdorën një gjuhë të hapur?
- A vëzhguan të intervistuarin/rën?
- A e realizuan intervistën si duhet?

Vëzhguesve duhet t'u kërkohet që të mbajnë shënime provat që mbështesin gjetjet e tyre.

Pasi të jenë udhëzuar të gjithë, aktorët duhet të kthehen në dhomë dhe fillojnë lojën me rolet.

Meqenëse kjo pjesë e lojës me role kufizohet me fazën 'Përfshirja dhe shpjegimi' të procesit PEACE, loja me role ka mundësi të jetë mjaft e shkurtër.

Një dukuri që ndodh zakonisht në lojën me role kur përdoret 'Përfshirja dhe shpjegimi', është që intervistuesit kalojnë ose menjëherë apo shumë shpejt në fazën e 'Tregimit'. Megjithëse intervistat përzgjedhëse shpesh kalojnë shumë shpejt në këtë fazë, për shkak të presionit të rrethanave, kjo duhet të menjanohet. Vështirësia qendron në marrjen e vendimit se kur duhet ndaluar diçka, që të mos kalohet para kohe te 'Tregimi'. Ky është një vendim që duhet marrë nga ju – ndalimi tepër shpejt mund të bëjë që 'aktorët ta ndiejnë veten të pavlerësuar, madje edhe sikur kanë gabuar diçka; ndalimi tepër vonë mund të përçojë mesazhin që do të ishte më mirë të kalohej drejtpërdrejt te tregimi.

2.3 Pyetje përgjigje për lojën me rolin

Kur mbaron loja me rolin, diskutoni me aktorët, sipas këtij rendi:

- Me intervistuesit.
- Me të intervistuarit
- Me vëzhguesit.

3. Loja me rolin në fazën ‘Tregimi’

3.1 Metoda e mësimdhënies

Loja me rolin në fazën ‘Tregimi’, trajtohet thajse njëloj si me lojën me rolin ‘Përfshirja dhe shpjegimi’.

Rekomandohet që të përdorni të njëjtin aktor, atë që luan rolin e ‘të intervistuarit’. Është një praktikë e mirë që të rifreskojnë herëpashere historinë ‘e tyre’.

Ndani grupin përsëri në çifte. Udhëzoni që të planifikojnë se çfarë pyetjesh të bëjnë në fazën ‘Tregimi’ me të njëjtin të intervistuar. Pas dhjetë minutash do të zgjidhni një çift që të sigurojë marrjen e ‘Tregimit’ nga ‘viktima e mundshme’.

Caktoni detyrat e vëzhguesit për çiftet e tjera. Këto duhet të përputhen me informacionin e marrë gjatë seksionit ‘Tregimi’ të Planit mësimor: ‘Intervistat përzgjedhëse? Detyrat e vëzhguesve të intervistuesve janë:

- A bën pyetje të hapura?
- A e zhvilluan më tej përgjigjen e të intervistuarit?
- A përdorën pyetje të mbyllura?
- A trajtuan pikat e duhura?
- A i përdorën me kujdes pyetjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me TQNj?
- A treguan se po dëgjonin aktivisht?
- A i sugjeruan të intervistuarit ndonjë ‘shenjë sekrete’?

Vëzhguesve duhet t’u kërkohet që të mbajnë shënim çdo provë që mbështet gjetjet.

Kur të ndaloni lojën me role, kaloni tek pyetje-përgjigje sipas radhës së mëposhtme:

- Me intervistuesit.
- Me të intervistuarin.
- Me vëzhguesit.

4. Modifikimi

Ju mund të dëshironi të modifikoni diçka te loja me rolin për t'iu përgjigjur më mirë roleve të ndryshme të studentëve, aktorëve të ndryshëm ose karakteristikave të TQNj në vendin tuaj.

Duhet të jetë e thjeshtë që të përdoret struktura e sipërme për të organizuar një lojë me role që t'i përshtatet kërkesave tuaja.

Kur keni audienca të ndryshme, ju duhet thjesht të modifikoni rolet e intervistuesve për t'ua përshtatur punonjësve socialë, inspektorëve të punës, etj., sipas rastit. Duhet të bëhet e besueshme që gjithsecili në atë rol të sillet sipas situatës që njih.

Përjasja e mësipërme nuk duhet të kufizohet vetëm me rastet e intervistave formale. Ajo mund të zbatohet për çdo lloj interviste. Në shumë vende edhe në rastet kur një individ nuk ka autoritetin zyrtar të intervistojë, asgjë nuk mund ta ndalojë që të flasë jo formalisht me atë që dëshiron. Ajo çfarë përftohet nga ajo bisedë, bashkë me informacionin e marrë nëpërmjet treguesve të identifikuar, mund t'i kalohet më pas atyre që kanë rol të drejtpërdrejtë në hetimin e një rasti të dyshuar për TQNj.

Në vijim jepen sugjerime si të përdoren ushtrimet e rasteve për të krijuar lojrat tuaja me role.

4.1 Ushtrimi i Rastit 4 – Shtëpia publike

Intervista me një nga gratë e gjetura në shtëpinë publike.

Faza 'Përfshirja dhe shpjegimi' do të jetë shumë e ngjashme me atë të përshkruar më lart.

Për fazën 'Tregimi' gjindet informacion në ushtrimin e rastit që mund t'ju ndihmojë të krijoni 'historinë' e të intervistuarit.

Mund të dëshironi ta kufizoni tregimin vetëm me përshkrimin e mjedisit. Në rast se doni që të shtoni aty edhe fazat e tjera të procesit të TQNj, ju mund t'i shpjegoni 'aktoret' se ajo u rekrutua pasi i kishin thënë se do të punonte si banakiere/pastruese, etj. Por, kur kishte mbërritur, asaj i thanë që, në fakt, do të punonte në një shtëpi publike. Mund të shtoni hollësi duke përshkruar kushtet e lokalit.

Duhet të mbani parasysh që për shkak të natyrës ndoshta të ndjeshme dhe personale të përmbajtjes së kësaj loje me role, ju duhet ta trajtoni atë me kujdes. Aktori që do të luajë të intervistuarin duhet të jetë realisht një vullnetar/e; atij/asaj duhet t'i shpjegohet me kujdes dhe ndershmëri roli që do të luajë dhe të lejohet të tërhiqet nëse dëshiron. Për hir të besueshmërisë, 'aktori' duhet të jetë një femër; në shumë audienca ndodh që të ketë pak gra, por pavarësisht nga kjo, ju nuk duhet të bëni presion që të marrin përsipër me domosdo ta luajnë atë rol.

Shënim: zbatoni të njëjtën qasje për gratë e zgjedhura si intervistuese.

4.2 Ushtrimi i rastit 5 - Ferma

Intervista me një nga punëtorët e gjetur në godinë.

Faza 'Përfshirja dhe shpjegimi' do të jetë shumë e ngjashme me atë të përshkruar më lart.

Për fazën e tregimit ekziston një informacion i konsiderueshëm te ushtrimi i rastit, që mund të ndihmojë të bëhen shumë pyetje.

Nëse dëshironi të shtoni fazat më të hershme të procesit të TQNj, ju mund t'i shpjegoni aktorit/aktoret që ai/ajo u rekrutua pas premtimeve të ngjashme me ato që u gjetën në Ushtrimin e rastit 'Punëtori/rja në familje' – pra, pas premtimeve për një sistemim të përshtatshëm, ushqim normal, pagë minimale, etj.

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje.....	5
1.1	Audienca e synuar	5
1.2	Objektivat e mësimit.....	5
1.3	Njohuritë e mëparshme.....	5
2.	Pamje e përgjithshme	6
3.	Planifikimi dhe përgatitja	7
3.1	Metoda e mësimit.....	7
4.	Përfshirja dhe shpjegimi.....	Error! Bookmark not defined.
4.1	Metoda e mësimit.....	9
4.2	Informimi i ‘aktorit’ – ‘Pol Smith’	9
4.3	Pyetje përgjigje rreth lojës me role.....	10
5.	Tregimi	11
5.1	Metoda e mësimit.....	11
5.2	Pyetje përgjigje rreth lojës me role.....	11
6.	Mbyllje	12
6.1	Metoda e mësimit.....	12
7.	Vlerësimi	13
7.1	Metoda e mësimit.....	13
8.	Modifikimi	14

1. Hyrje

Kjo lojë me rolin fokusohet mbi një model intervistimi PEACE të një të dyshuari. Ajo bazohet mbi Studimin e rastit 1 – Shfrytëzimi i punës.

Është zgjedhur një intervistë me të dyshuarin për të treguar se modeli PEACE i intervistimit mund të përdoret për të gjitha llojet e intervistave. Loja me rolin 2 – Shërbimi në familje, trajton çështje që lidhen me intervistimin e viktimave dëshmitare. Ndërkohë që Loja me rolin 2 lidhet me një intervistë përzgjedhëse, shumë probleme të ngjashme ndeshen edhe në intervistat mbi bazën e provave.

Mund të ketë një farë rezistence për të përdorur modelin PEACE për intervistimin e të dyshuarit. Koncepte të tilla si 'kërkim i përqendruar', 'raporto gjithçka', dhe 'transferimi i kontrollit' mund të duken disi në konflikt me përjashtimet tradicionale të trajtimit të intervistës së të dyshuarit. Gjithsesi, ato janë njëlloj të zbatueshme, pasi i japin të dyshuarit një mundësi maksimale për të paraqitur anën e vetë të historisë së rastit. Në rast se ai apo ajo zgjedh të mos tregojë një histori të plotë, apo të mos thotë të vërtetën rreth disa aspekteve të përfshirjes së tij/të saj, këto probleme mund të diskutohen me të gjatë intervistave të mëtejshme, ose nëpërmjet proceseve të tjera gjyqësore. Sido që të përgjigjen, ata nuk mund të thonë se nuk kanë qenë të shtyrë, të kërcënuar apo të ngatërruar qëllimisht në rast se intervista është kryer në një mënyrë të planifikuar, metodike dhe të respektueshme.

1.1 Audiencia e synuar

Ky leksion është për çdo person, të cilit i kërkohet të realizojë intervista gjyqësore ose mbi bazë provash të rasteve të TQNj, pra për:

- Oficerët e policisë.
- Prokurorët që kryejnë intervista gjyqësore.
- Gjyqtarët që kryejnë intervista gjyqësore.

1.2 Objektivat e mësimi

- Të përshkruajë sfidat e intervistave të dëshmitarit dhe të dyshuarit për TQNj.
- Të përcaktojë qëllimin e një interviste të dëshmitarit/të dyshuarit për TQNj.
- Të rikujtojë elementet bazë të modelit PEACE të intervistimit.
- Të tregojë si zbatohet PEACE te intervistat e dëshmitarit/të dyshuarit për TQNj.
- Të tregojë zbatimin e objektivave të mësipërme përgjatë lojës me role.

1.3 Njohuritë e mëparshme

Studentët duhet të kenë mbaruar më parë Planin Mesimor 6–'Intervistat mbi bazën e provave'. Do të ishte mirë të kenë përfunduar Planin Mësimor 3 – 'Intervistat përzgjedhëse'.

2. Pamje e përgjithshme

Kjo lojë me role bazohet mbi Studimin e Rastit 1 – Shfrytëzimi për punë.

Ky studim i rastit është mjaft i ndërlikuar. Ai mbështetet me burime të ndryshme, dhe planet e tjera mësimore i referohen shpesh atij.

Planet mësimore që i referohen Studimit të Rastit 1 janë:

- Plani mësimor 7 – ‘Teknikat e specialistit’.
- Plani mësimor 9 – ‘Shqyrtimi i skenës së krimit’.

Burimet mediatike që e mbështetin trajtimin e Studimit të Rastit 1 janë:

- Burimi mediatik 1 – Skenari i fermës së pulave.
- Burimi mediatik 2 – Ushtrimi mbi vëzhgimin.
- Burimi mediatik 3 – Ushtrimi mbi skenën e krimit.

Ju, si instruktor keni një sërë mundësish zgjedhjeje mbi mënyrën si të realizoni këtë lojë me role.

Sipas një rrjedhjeje logjike të ngjarjeve, një intervistë do të realizohej pas procesit të vëzhgimit dhe pas shqyrtimit të skenës së krimit. Për këtë arsye, ju mund të vendosni që fillimisht t’i trajtoni të gjitha leksionet e mëparshme duke përdorur burimet mediatike mbështetëse si dhe informacionet shtesë të studimit të rastit, para se të trajtoni Planin mësimor 6 – ‘Intervistimi mbi bazë provash’ dhe më pas të kaloni te kjo lojë me role. Përparësitë e kësaj përjasjeje janë se studentët do të njihen paraprakisht me pjesën më të madhe të ‘historisë’, dhe radha e leksioneve dhe e studimeve të rastit do të ndjekë një ‘rrjedhë’ të natyrshme logjike ashtu siç rrjedhin ngjarjet në realitet. E vetmja mangësi është se i tërë ky proces kërkon shumë kohë në dispozicion.

Ju mund ta trajtoni këtë lojë me role si një ushtrim mbështetës kur të jepni Planin mësimor 6 – ‘Intervistat mbi bazën e provave’. Në rast se do ta përdorni këtë alternativë, do t’ju duhet që më parë t’i informoni studentët mbi pjesën më të madhe të Studimit të Rastit 1. Nga ana tjetër, mund të dëshironi të përdorni burimet mediatike që mbështetin studimin e rastit. Udhëzimet e mëtejshme jepen në seksionet në vijim tek ‘Mënyra e mësimdhënies’.

Ndërkohë që krijohet më shumë përvojë në mësimdhënie, ju mund të jepni kurse që i përshtaten specifikisht rolit/nevojave të studentëve. Kjo kërkon marrje vendimesh mbi çfarë duhet përdorur, dhe çfarë nuk duhet përdorur prej të gjitha planeve mësimore dhe burimeve të përshkruara më lart.

3. Planifikimi dhe përgatitja

3.1 Metoda e mësimdhënies

Struktura e mësimdhënies do të përcaktohet nga leksionet që kanë marrë më parë studentët.

Studentët duhet të njohin historinë e Studimit të Rastit 1 deri tek Pjesa 5 – Intervista e menaxherit të fermës, Pol Smith.

Në rast se studentët e kanë kryer Leksionin 7 – ‘Teknikat specialiste’, dhe Leksionin 9 – ‘Shqyrtimi i skenës së krimit’, ju duhet të drejtoheni tek Studimi i Rastit 1 për çdo informacion shtesë për të cilin ata mund të mos kenë dijeni, dhe ofrojani këtë informacion klasës.

Në rast se jeni duke trajtuar Planin mësimor 6 – ‘Intervistat mbi bazë provash’ si një leksion më vete, ju duhet të trajtoni me klasën edhe Studimin e Rastit 1 në variantin e përmbledhur. Rekomandohet, që ju të përqendroheni veçanërisht mbi Pjesën 4.3 – Intervista e viktimave.

Ju duhet të përdorni burimin mediatik 1 – Skenari i fermës së pulave, kur trajtoni Studimin e Rastit 1, në variantin e përmbledhur.

Pasi të keni dhënë informacionin e përmbledhur, ndani klasën në grupe intervistuesish dhe kërkoni nga ata që të ‘Planifikojnë dhe përgatiten’ për intervistimin e menaxherit të fermës, Pol Smith.

Numri i studentëve në çdo grup varet nga jurisdiksioni dhe nga numri i personave që kryejnë intervistat mbi bazë provash në atë jurisdiksion. Në përgjithësi, intervistat realizohen nga të paktën dy vetë, por edhe më shumë në disa raste. Për shembull, në disa jurisdiksione policia mund të bëjë intervistën me dy oficerë policie. Në disa të tjera, mund të ketë më shumë të pranishëm, si polic, prokuror, avokat mbrojtës dhe një tjetër që mban shënime.

Lejoni rreth 15 minuta që studentët të mbarojnë detyrën dhe pastaj filloni me pyetje e përgjigje.

Informacioni në vijim nuk është shterrues, por ndihmon sesionin pyetje-përgjigje.

- A dhanë prova intervistuesit se, edhe duke mbajtur parasysh ‘historinë e deritanishme’, pra se farë informacioni kemi tashmë në dorë?
- A demonstuan intervistuesit se:
 - Kishin njohuri mbi mjedisin rrethanor të fermës?
 - Ishin të vetëdijshëm mbi hollësitë e tregimeve të viktimave dëshmitare?
 - Kishin dijeni mbi vizitën e mëparshme që kishin bërë inspektorët e punës?

- A i identifikuan ata se çfarë kërkohet të arrihet, pra se cilat janë objektivat e intervistës? Shembuj të objektivave të synuara përfshijnë:
 - Identifikimi i rolit që kishte Pol Smith në fermë.
 - Identifikimi nëse ai i njihnte personat që punonin në fermë.
 - Përcaktimi nëse ai kishte dijeni mbi kushtet e punës në fermë.
 - Përcaktimi nëse ai kishte dijeni mbi procesin e rekrutimit të punëtorëve.

- Në ç'vend do të kryhet intervista?
 - Kjo do të përcaktohet nga kërkesat e jurisdiksionit të vendit ku zhvillohet ngjarja.

- Kush do ta bëjë intervistën?
 - Edhe këtu, përsëri, kjo përcaktohet nga kërkesat e jurisdiksionit.
 - Këtu mund të lindë nevoja e rishikimit të kualifikimeve që kërkohen për të realizuar një intervistë të suksesshme.

- Si do të bëhet regjistrimi?
 - Kjo është një fushë tjetër që do të përcaktohet nga legjislacioni.
 - Aty ku ka hapësirë dhe mundësi zgjedhjeje, mund të jetë një rast i mirë për të diskutuar dhe marrë parasysh përdorimin e metodave të ndryshme.

4. Përfshirja dhe shpjegimi

4.1 Metoda e mësimdhënies

Kërkoni një vulnetar të luajë rolin e Pol Smith, të menaxherit të fermës, Studimi i Rastit 1.

I thoni të dalë pak nga dhoma.

Informoni grupet; ata duhet të planifikojnë fazën 'Përfshirja dhe shpjegimi' me personin te Studimi i Rastit 1: 'Punëtor në familje'. Pas pesë minutash ju do të zgjidhni njërin nga grupet për të përfshirë të dyshuarin dhe të shpjegoheni me të.

Ndërkohë që grupet punonjnë me detyrën e tyre, dilni nga dhoma dhe informoni 'aktorin' sipas linjave në vijim.

4.2 Informimi i 'aktorit' – 'Pol Smith'

'Pol Smith' është i ndërgjegjshëm se njerëzit që punojnë në fermë janë trafikuar. Ai e di se punëtorët nga Vendi Blu janë marrë me mashtrim. Dhe kjo i ishte sugjeruar nga partneri i tij në biznes, i cili kishte thënë se mund të siguronte krahë të lirë pune për të ulur edhe më shumë kostot. Megjithatë, Pol Smith kishte vendosur që nëse pyetej ndonjëherë nga autoritetet, do të tregonte historinë, si më poshtë:

- Njerëzit në fermë ishin rekrutuar nga partneri i tij i biznesit në Vendiin Blu.
- Ai nuk kishte patur aspak punë me ta qëkur kishin mbërritur në fermë.
- Për ata kujdeset kryepunëtori i tij, Xhon Braun.
- Ai i jep Xhon Braun para në dorë, që ky t'u japë punëtorëve pagat.
- Njerëzit banojnë në fermë sepse Xhon Braun i kish thënë se ata kërkuan të jetojnë në fermë për të kursyer paratë e tyre.
- Ai nuk di asgjë rreth shënimeve që janë varur në ndërtesën e fermës.
- Ai nuk di asgjë për shkopin e bejzbollit.
- Ai i kishte parë njerëzit të punonin brenda godinës në fermë.
- Ai i kishte parë kushtet e punës brenda asaj godine.
- Por thotë që ajo ishte zgjedhja e vetë atyre, dhe, gjithsesi, njerëzit e Vendiit Blu ashtu jetojnë të gjithë.
- Ai është përgjegjës për llogaritë e biznesit.
- Ai është përgjegjës për blerjen e ushqimit, por i jep para në dorë Xhon Braun që ai të blejë ushqimet që duhen.

Pyeteni 'aktorin' nëse ka nevojë për sqarime të tjera.

Mund të kërkonti nga 'aktori' që të përmbledhë shkurtazi atë që iu shpjegua.

Kthehuni në klasë.

Rregulloni një pjesë të dhomës së trenimit në formën e një dhome intervistimi, sipas jurisdiksionit të vendit. P.sh. në formën e një dhome ku policia bën intervistat me numrin e duhur të karrikeve, tavolinën, etj.

Zgjidhni grupin me të cilin do të bëni intervistën dhe u thoni të dalin nga dhoma, por të mos diskutojnë asgjë me 'aktorin Pol Smith'.

Grupeve të tjera caktojuni disa nga detyrat prej vëzhguesi, të përshkruara në vijim. Këto detyra duhet të jenë në një linjë me informacionin të seksioni 'Përfshirja dhe shpjegimi' të Planit mësimor 6 – 'Intervistat mbi bazë provash'. Detyrat janë:

Si vepruan intervistuesit:

- A shpjeguan qëllimin e intervistës?
- A përdorën një gjuhë të hapur trupore?
- A i ndoqën përgjigjet e të intervistuarit?
- A shpjeguan 'kërkimin e përqendruar'?
- A shpjeguan 'raporto gjithçka di'?
- A shpjeguan 'transfertën e kontrollit'?

Vëzhguesve duhet t'u kërkohet që të mbajnë shënim çdo provë që mbështet gjetjet e tyre.

Pas shpjegimeve për secilin, ftojini aktorët në dhomë dhe le të fillojnë lojën me role.

Meqenëse kjo pjesë e lojës me role është e kufizuar me fazën 'Përfshirja dhe shpjegimi' të procesit PEACE, loja e roleve ka mundësi që të zgasë pak.

Një dukuri që ndodh zakonisht në lojën me role vetëm në rastet kur përdoret faza 'Përfshirja dhe shpjegimi', është se intervistuesit kalojnë menjëherë ose tepër shpejt në fazën e 'Tregimit'. Vështirësia qëndron në marrjen e vendimit se kur duhet ndaluar diçka, që të mos kalohet para kohe te 'Tregimi'. Ky është një vendim që duhet të merret nga ju – ndalimi tepër shpejt mund të bëjë që 'aktorët ta ndejnë veten të pavlerësuar, ose sikur kanë gabuar; ndalimi tepër vonë mund të përçojë mesazhin që duhet kaluar drejtpërdrejt te tregimi.

4.3 Pyetje përgjigje rreth lojës me role

Kur ndalon loja me role, ndiqni sesionin pyetje-përgjigje me 'aktorët' sipas rendit të mëposhtëm:

- Me intervistuesit.
- Me të intervistuarit.
- Me vëzhguesit.

5. Tregimi

5.1 Metoda e mësimdhënies

Loja me rolin 'Tregimi' trajtohet në thuajse të njëjtën mënyrë si dhe loja me rolin 'Përfshirja dhe shpjegimi'.

Rekomandohet që të përdorni të njëjtin 'aktor' që luajti rolin e 'të intervistuarit'. Është një praktikë e mirë që ata të rifreskojnë historinë 'e tyre'.

Ndani klasën në grupe, përsëri. U shpjegoni se duhet të planifikojnë të bëjnë pyetje në fazën 'Tregimi' me të njëjtin të intervistuar. Pas dhjetë minutash ju do të zgjidhni një grup për të dëgjuar variantin e 'Tregimit' nga 'i dyshuari'.

Grupeve të tjera caktojini detyrat e vëzhguesve. Këto detyra duhet të jenë në linjë me informacionin te seksioni 'Tregimi' i Planit mësimor 6 – 'Intervistat mbi bazën e provave'.

Çështjet që duhet të ndjekin vëzhguesit për intervistuesit, janë:

- A i përcaktuan mirë synimet e tyre?
- A bëjnë pyetjet e duhura për të arritur ato synime?
- A demonstuan përdorimin e 'kërkimit të përqendruar'?
- A demonstuan përdorimin e 'raporto gjithçka që di'?
- A demonstuan përdorimin e 'transferimit të kontrollit'?
- A bën pyetje të hapura?
- A i zhvilluan më tej përgjigjet e të intervistuarit?
- A përdorën pyetje të mbyllura?

Vëzhguesve duhet t'u kërkohet të mbajnë shënime provat që mbështetin gjetjet.

5.2 Pyetje përgjigje rreth lojës me role

Kur mbaron loja me role, ndiqni sesionin pyetje-përgjigje me 'aktorët', sipas rendit të mëposhtëm:

- Me intervistuesit.
- Me të intervistuarit.
- Me vëzhguesit.

6. Mbyllje

6.1 Metoda e mësimdhënies

Mënyra si do të veproni në këtë pikë, do të përcaktohet shumë nga koha që keni në dispozicion. Ushtrimet e lojrave me rastet që u trajtuan më sipër ka mundësi që të kërkojnë shumë kohë për t'u plotësuar, dhe me siguri, mjaft angazhuese si për ju ashtu dhe studentët. Për rrjedhojë, ju mund të dëshironi të përdorni disa alternativa më të shpejta.

Mund t'u thoni grupeve që të planifikojnë mbylljen e intervistës dhe pastaj (duke përdorur të njëjtin aktor që bën rolin e 'të dyshuarit') kërkojini grupit që të mbyll intervistën, dhe caktojuni grupeve të tjera detyrat e vëzhguesve, njëlloj si në seksionet e mëparshme. Ky do të jetë opsioni që konsumon më shumë kohë.

Përndryshe, mund t'i kërkonte grupit që kreu pjesën 'Tregimi' të intervistës, ta mbyllë atë dhe të shpjegojë mënyrën si e realizuan mbylljen.

Mënyra më e shpejtë është ta pyesni grupin para klasës se si duhet mbyllur intervista, si duhen regjistruar përgjigjet me metodën e zgjedhur nga ata vetë, dhe më pas të diskutojnë përgjigjet e marra. Kjo përjasje është përdorur me efektivitet në shumë raste. Për lehtësi referimi, po japim më poshtë pikat kyçe të mënyrës së Mbylljes:

Për të gjitha llojet e intervistave:

- Përsëritja e pikave kyçe për të kontrolluar që keni kuptuar shpjegimin e dhënë.
- I intervistuari duhet të falenderohet por jo të lavdërohet për kohën e tij/të saj (se si do të bëhet kjo me saktësi do të ndryshojë sipas llojit të intervistës – viktimë/dëshmitare, dëshmitar/e, i/e dyshuar, etj. Mund të jetë e këshillueshme që në disa intervista me 'të dyshuarin/ren' të ruhen marrëdhëniet me të; megjithatë kjo mund të mos jetë e përshtatshme, në rast se i intervistuari 'i/e dyshuar' nuk i është përgjigjur pyetjeve.
- Të intervistuarit duhet t'i thuhet se cilat do të jenë fazat e tjera.
- Të intervistuarit duhet të pyeten nëse kanë ndonjë pyetje; këto pyetje duhet të marrin përgjigje për aq sa do të lejojnë rrethanat.
- Në asnjë rrethanë nuk duhet të bëhen premtime, që nuk do të mund të mbahen.

Për intervistat me viktimën/dëshmitare:

- Në rastin e viktimave atyre duhet t'ju jepet mundësia që të bëjnë një 'deklaratë personale e viktimës', e cila është deklarata që tregon si ka ndikuar krimi mbi ta.
- Viktimave duhet t'u ofrohet informacion rreth ndihmës dhe shërbimeve në dispozicion; në shumë raste të TQNj, hetuesit dhe të tjerët do të kenë marrë tashmë masat për mbështetjen e duhur sipas rregullimeve paraprake dhe/ose mekanizmave kombëtarë të referimit

7. Vlerësimi

7.1 Metoda e mësimdhënies

Mënyra e rekomanduar e trajtimit të kësaj faze të ushtrimit të lojës me role, është që t'i kërkonti grupit që të vlerësojë para klasës përmbajtjen e intervistës, të vlerësojë regjistrimet e përgjigjeve që kanë marrë duke përdorur metodën që kanë zgjedhur vetë, t'i diskutojnë ato. Më pas kërkonti nga grupi të japin sugjerime të shkurtra për hartimin e një plani për intervistim të mëtejshëm, ose hetime të tjera.

Rekomandohet që gjatë procesit të vlerësimit të shqyrtohen pikat në vijim:

- A zbuloi intervista probleme që kërkojnë vlerësim të rrezikut?
- Në rast se po, cilët ishin ato?
- Cili është vlerësimi i parë i rrezikut të atyre problemeve nga ana e grupit (mund t'i referoheni matricës së shqyrtimit të rrezikut në Planin mësimor 4 – 'Vlerësimi i rrezikut')?
- A u arritën objektivat?
- Cilat nuk u arritën?
- Çfarë informacionesh të tjera kemi ne tani?
- Çfarë veprimesh kërkohen bazuar mbi këtë informacion?
- A duhet ndonjë intervistë tjetër me 'Pol Smith, në këtë fazë?
- Nëse po, cilat do të ishin objektivat e asaj interviste?
- Si duhet të strukturohet intervista tjetër – një rikujtim i lirë, trajtimi i disa pikave specifike, etj?

8. Modifikimi

Loja me role mund të modifikohet në shumë mënyra, në rast se dëshironi.

Do të jetë fare e thjeshtë që të ndryshoni të dyshuarin, nga menaxheri i fermës Pol Smith, tek kryepunëtori i fermës, Xhon Braun, duke përdorur përmbajtjen e Studimit të Rastit 1 – ‘Shfrytëzimi për punë’.

Një tjetër modifikim i thjeshtë do të ishte të ndërroni gjininë e menaxherit të fermës, për të lejuar që atë rol ta luajë një studente.

Disi më i vështirë do të ishte ndryshimi dhe trajtimi i intervistës si intervistë me viktimën/viktimën dëshmitare për të njëjtin studim të rastit. Informacioni i gjetur në Planin mësimor 6 – ‘Intervistat mbi bazë provash’, studimi i rastit dhe ky dokument mbi lojën me role duhet të jenë të mjaftueshëm që ju ta realizoni atë. Mund të jetë me dobi ju që t’u referoheni shënimeve në Lojën me role 2 – ‘Shërbimi në familje’ për të planifikuar lojrat me role viktimë/dëshmitare, diskutimet mbi to, etj.

Së fundi, (veçanërisht nëse keni përvojë) shënimet dhe udhëzimet që gjinden në të gjitha planet mësimore respektive, në studimet e rasteve dhe lojrat me role, duhet t’ju ofrojnë informacion të mjaftueshëm për t’ju ndihmuar që të modifikoni materialet tuaja dhe për t’i përshtatur sipas kontekstit të studentëve tuaj.

Burimet mediatike

Të gjitha burimet mediatike janë të disponueshme në formatin elektronik. Mund t'i gjeni në DVD e bashkëngjitur këtij Manuali.

Burimi mediatik 1: Ferma e pulave

Për ta hapur këtë dosje ju do të keni nevojë për Quick Time Player të instaluar te kompiuteri juaj. Në DVD do të gjeni udhëzimet e hollësishme se si të veproni dhe si të lundroni nëpër përmbajtjen e dosjes.

Burimi mediatik 2: Skenari i trafikimit për shfrytëzimin e punës – Pamjet e lokalit nga jashtë. I disponueshëm në pdf.file.

Burimi mediatik 3: Shqyrtimi i skenës së krimit – Ushtrimi mbi trafikimin e krahut të punës. I disponueshëm në pdf.file.

Prezantimet në Power Point

Janë krijuar gjashtë prezantime në Power Point për t'u përdorur nga ju. Ato janë të disponueshme vetëm në formatin elektronik. Ju mund t'i përdorni sipas udhëzimeve që jepen në planet mësimore.

Tek DVD e bashkëngjitur këtij Manuali do të gjeni prezantimet e mëposhtme:

- PowerPoint1: Përkufizimet mbi TQNj dhe kontrabandimin e njerëzve
- PowerPoint2: Identifikimi i TQNj
- PowerPoint3: Modeli PEACE i intervistimit
- PowerPoint4: Vlerësimi i rrezikut në rastet e TQNj
- PowerPoint5: Nevojat e viktimës
- PowerPoint6: Skenat e krimit

Shënime
